

Raport

Mbi rrjedhën e procesit të konsultave mbi instrumentet e përcaktimit të fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut në vendet e ish Jugosllavisë

maj 2006. - qershor 2009

Raport

Mbi rrjedhën e procesit të konsultave mbi instrumentet e përcaktimit të fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut në vendet e ish Jugosllavisë

maj 2006. - qershor 2009

Hyrje

As 14 vjet pas konflikteve të armatosura në Kroaci dhe Bosnje e Hercegovinë, dhe 10 vjet nga përfundimi i konfliktit në Kosovë, viktimat e luftës ende nuk janë emëruar dhe nuk njihen, dhe vetëm një numër i vogël i atyre që janë përgjegjës për krime janë nxjerrë para gjyqit të drejtësisë.

Debatin mbi mekanizmat e kërkimit dhe tregimit të fakteve mbi të kaluarën e afërt e kanë filluar në shtator të vitit 2005 tri organizata për drejtat e njeriut, Fondi për të Drejtën Humanitare (*Fond za humanitarno pravo*, Serbi), Documenta (Kroaci) dhe Qendra Hulumtuese-Dokumentuese (*Istraživačko-dokumentacioni centar*, Bosnje dhe Hercegovinë), me pjesëmarrjen e ekspertëve të Qendrës Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale. Pjesëmarrësit e tubimit, përfaqësuesit e 10 organizatave më të mëdha për të drejtat e njeriut nga rajoni, kanë përkrahur gjykimet për krimet e luftës si mekanizëm juridik më i rëndësishëm për përcaktimin e përgjegjësisë individuale; dhe kanë theksuar veçanërisht ndikimin që ka bashkëpunimi ndërmjet prokurorisë dhe gjyqeve në rajon që zëri i viktimave të krimeve të luftës të dëgjohet edhe nga komunitetet tjera etnike. Duke pasur parasysh

fokusimin e proceseve penale në të akuzuarit, tri organizatat kanë iniciuar debatin rajonal mbi instrumentet e kërkimit dhe të tregimit të fakteve mbi krimet e luftës, ku fokusi është te viktimat, gjë që mund të kontribuojë që të kemi një pamje më complete mbi të gjitha ato çka kanë ndodhur në të kaluarën. Debati (procesi konsultativ i kërkimit dhe tregimit të fakteve mbi krimet e luftës) është konceptuar si një seri e debateve rajonale, kombëtare dhe lokale në përbërjet më të vogla (rreth 30 pjesëmarrës) me përfaqësues të grupeve të ndryshme të shoqërisë civile. Pjesë e procesit janë bërë edhe forumet për drejtësinë tranzicionale, si tubime me më shumë pjesëmarrës (rreth 250), në të cilat si mysafirë ftohen edhe përfaqësuesit e shtetit dhe të organizatave ndërkombëtare. Që nga fillimi, qëllimi i procesit të konsultave ka qenë krijimi i një platforme publike në bazë të të cilës viktimat dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile do të paraqitnin nevojat e tyre lidhur me shkeljen e të drejtave të njeriut dhe padrejtësitë e bëra në të kaluarën. Qëllimi i dytë, po aq i rëndësishëm, ishte fuqizimi i përkrahjes për aprovimin e nismës për qasjen rajonale në përcaktimin e fakteve mbi krimet e luftës, në mënyrë që ajo të përkrahjet si nga qytetarët ashtu edhe nga pushteti në të gjitha vendet e rajonit. Në maj të vitit 2008 nisma është ngritur në propozim për krijimin

e Komisionit rajonal mbi kërkimin dhe tregimin e krimeve të luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut. Që nga atëherë procesi konsultativ ka edhe qëllimin e tretë: ndërtimin e modelit të Komisionit rajonal (KOMRA).

1. Zhvillimi i procesit të konsultimeve

Procesin konsultativ e karakterizojnë dy faza. Për fazën e parë të procesit është karakteristikë debati mbi atë se çfarë mekanizma i duhen rajonit për zbardhjen e fakteve mbi krimet e luftës. Kjo fazë fillon me Forumin e Parë rajonal për drejtësinë tranzicionale¹ dhe zgjatë deri në mbajtjen e konsultës së parë rajonale me përfaqësuesit e shoqatave të viktimave, me viktimat dhe me veteranët, në Podgoricë, Mali i Zi, më 9 maj 2008. Në këtë periudhë janë mbajtur gjithsejtë nëntë konsultime (pesë rajonale dhe katër kombëtare) si dhe tre forume. Në forumin e tretë rajonal për drejtësinë tranzicionale që është mbajtur në Beograd, debati i deriatëhershëm për mekanizmat jashtëgjyqësor konkretizohet – fillohet të flitet për nevojën e krijimit të një *trupit rajonal* për zbardhjen e fakteve mbi krimet e luftës. Pjesëmarrësit e forumit e kanë përkrahur iniciativën e FDH, Documenta dhe QHD mbi themelimin e *trupit rajonal* (komisionit rajonal) si dhe propozimin që në konsultimet me shoqërinë civile të formësohen mandati, aktivitetet dhe qëllimet e këtij trupi. Në këtë forum për herë të parë është organizuar dëgjimi publik i viktimave, dëgjim ky i cili nga pjesëmarrësit është vlerësuar si një aktivitet i rëndësishëm për Komisionin rajonal të ardhshëm, që mund të stimulojë bashkëndjesinë me viktimat nga ana e komuniteteve tjera etnike. Konsultimet e përmendura rajonale me përfaqësuesit e shoqatave të viktimave, viktimat dhe veteranët në Podgoricë, kanë qenë vendimtare: FDH, Documenta dhe QHD dolën me propozimin për krijimin e *Komisionit Rajonal për Përcaktimin e Fakteve mbi Krimet e Luftës dhe Shkeljet Tjera të Rënda të të Drejtave të Njeriut në Ish SFRJ – KOMRA*. Menjëherë pas kësaj më 10 maj të vitit 2008, propozuesit e nismës krijuan Këshillin koordinues me anëtarë të ftuar, i cili e kishte për detyrë krijimin e Koalicionit për themelimin e KOMRA-s dhe përgatitjen e kushteve për bartjen e kompetencave të drejtimit të procesit të konsultimeve në këtë koalicion. Deri më 28. tetor të vitit 2008, kur në Prishtinë filloi punën Forumi i katërt rajonal për të drejtën tranzicionale, iniciativën për themelimin

e KOMRA-s e kanë përkrahur mbi 100 organizata dhe shoqata, përfaqësuesit e të cilave kanë marrë pjesë në konsultimet në Kroaci, Mal të Zi, Serbi dhe në Kosovë. Në forumin e përmendur është themeluar *Koalicioni për KOMRA*, me cilin akt nisma për themelimin e Komisionit rajonal bëhet pronë e *Koalicionit për KOMRA*, ndërkaq që FDH dhe Documenta² morën përsipër rolin e shërbimit për përkrahjen teknike-administrative të procesit të konsultimeve.

1.1. Organizimi i procesit të konsultimeve

Nga maji i vitit 2008, kur filloi faza e dytë e procesit të konsultimeve, që karakterizohet me debatet intensive, deri në qershor të vitit 2009, janë mbajtur 31 tubime: 10 lokale, 18 konsultime kombëtare, 1 konsultim rajonal dhe 2 forume për drejtësinë tranzicionale. Gjatë janarit, shkurtit dhe marsit të vitit 2009, Këshilli koordinues ka mbajtur mbledhjet përgatitore me përfaqësuesit e organizatave për të drejtat e njeriut dhe shoqatat e viktimave në shtetet e rajonit, në të cilat janë formuar grupet për koordinimin e konsultimeve në nivelin lokal dhe nacional. Në mars të vitit 2009 Këshilli koordinues ka emëruar koordinatorët nacionalë në të gjitha shtetet e rajonit. Ata kanë për detyrë që të ndihmojnë anëtarët e Koalicionit në organizimin e konsultimeve, t'i njoftojnë ata rregullisht mbi rrjedhën e procesit të konsultimeve dhe të



Forum i pestë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budva, Mali i Zi, 29-30 maj 2009

kujdesën që i tërë procesi të regjistrohet dhe dokumentohet. Në periudhën prill-maj 2009, grupet për koordinimin e konsultimeve kanë organizuar 20 konsultime lokale dhe kombëtare në BH, Kroaci, Serbi, Kosovë dhe Mal të Zi.

Në kuadër të Forumit të Pestë për të Drejtën Tranzicionale në Podgoricë, më 29-30 maj 2009, është mbajtur seanca e parë e Kuvendit të *Koalicionit për KOMRA*, në të cilin është aprovuar Statuti i Koalicionit dhe janë zgjedhur anëtarët e Këshillit Koordinues.³ Me këtë ka përfunduar procesi i konstituimit formal të kompetencave të Koalicionit për KOMRA.

Procesi i konsultave do të zhvillohet deri në qershor të vitit 2010, kur do të filloj mbledhja e një milion nënshkrimeve të qytetarëve në të gjitha shtetet në hapësirat e RSFJ të dikurshme, të cilat e përkrahin themelimin e KOMRA. Një milion nënshkrime si dhe propozimi i mandatit të KOMRA që do të formësohet gjatë procesit të konsultimeve, do t'i dërgohen parlamenteve kombëtare për aprovim. Po dëshmohej se konsultimet kanë rëndësi qenësore për sigurimin e kredibilitetit të nismës dhe përkrahjen e grupeve të ndryshme të shoqërisë civile.

*Cila është rëndësia reale e procesit të konsultimeve? Mendoj se ekzistojnë dy pjesë të rëndësishme. E para është përkrahja e opinionit. Një institucion i tillë (komisioni) nuk mund të qëndrojë nëse nuk e ka përkrahjen e opinionit sepse ai ushqehet me deklaratat që i japin qytetarët.*⁴

*Ne kemi nevojë për debat në nivelin e shoqërisë për nevojën e formimit të Komisionit dhe pastaj edhe për debat mbi modalitetet, mbi modelet e ndryshme të Komisionit.*⁵

Në periudhën nga mbajtja e Forumit të parë mbi drejtësinë tranzicionale⁶ deri në korrik të vitit 2009,⁷ në kuadër të procesit të konsultimeve janë mbajtur 43 konsultime: 23 kombëtare, nëntë lokale dhe gjashtë rajonale, si dhe pesë forume mbi drejtësinë tranzicionale.⁸ Në këto konsultime kanë marrë pjesë 2.185 individë, përfaqësues të organizatave për të drejtat e njeriut, të shoqatave të viktimave, të atyre që kanë qenë nëpër kampe, të ushtarakëve invalidë të luftës, të veteranëve, të organizatave rinore dhe të gruaz, të asociacioneve të historianëve, të gazetarëve dhe të artistëve. Pjesa dërmuese e pjesëmarrësve e ka

përkrahur qasjen rajonale në kërkimin e fakteve dhe në këtë kontekst edhe themelimin e trupit rajonal për kërkimin dhe tregimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut - KOMRA.

Koalicioni për KOMRA me datën 1 korrik 2009 kishte 376 anëtarë, nga të cilët 165 janë nga organizatat joqeveritare për të drejtat e njeriut, të rinjve dhe të tjera, 36 janë nga shoqatat e viktimave dhe të familjeve të viktimave, të kampistëve, veteranëve, familjet e të zhdukurve, invalidëve ushtarakë, dhe shoqatave tjera, pastaj 167 janë në cilësinë individuale, dhe më në fund janë edhe 8 medime.⁹

2. Qasja rajonale në kërkimin e fakteve mbi krimet e luftës

Nga fillimi i procesit të konsultimeve pjesëmarrësit kanë shpalosur shembujt konkret pse është e rëndësishme qasja rajonale për zbardhjen e fakteve mbi krimet e luftës.

*Ne në Kroaci thjesht nuk mund ta dimë dhe të shohim çka ka ndodhur me ata që janë shpërngulur pas aksionit ushtarak Oluja në gusht të vitit 1995, ngase ata më nuk jetojnë në Kroaci, ndërkaq shumica jetojnë në BH dhe në Serbi.*¹⁰

*Çka do të mund të dinim, pa qasjen rajonale, për deportimin e refugjatëve boshnjakë që janë strehuar në Malin e Zi? Çka do të mund të dinim, pa qasjen rajonale, për 30 veta të ekzekutuar, refugjatë nga Kosova, të cilët armata [Armata Jugosllave] i shfarosi në Mal të Zi? Çka do të mund të dinim për gjithë atë dramë të spastrimit etnik të një pjesë të malit të Zi, të Bukovicës?*¹¹

Prokurorët i dhanë përkrahje qasjes rajonale, duke theksuar se bashkëpunimi ndërmjet prokurorëve ndikon në mënyrë vendimtare që në gjykimet për krimet e luftës të dëgjohet zëri i viktimave.

*Në kemi bërë përparim në kërkimin e autorëve [të krimeve] dhe në kërkimin e të vërtetës duke vendosur kontakte të ndërsjella dhe duke nënshkruar memorandumimin për bashkëpunim, këmbimin e të dhënave, bërjen e mundshme që dëshmitarët nga një shtet të vijnë në shtetin tjetër, ose që të sigurohen bisedat dhe deponime që shfrytëzohen gjatë proceseve gjyqësore.*¹²

3 Qasja në Statutin e Koalicionit për KOMRA që rregullon funksionet e Koalicionit, të Kuvendit dhe të Këshillit koordinues, është e mundshme për çdokëndë në www.korekom.org

4 Stefan Priesner, zëvendëse e përfaqësueses rezidente për Bosnje dhe Hercegovinë, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5.-6. maj 2006. Shtojca I, fq. 17

5 Refik Hodzic, Tribunali penal ndërkombëtar për ish Jugosllavi, Outreach programe, zyra në BeH. Forumi i parë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Sarajevë, BeH, 5-6 maj 2006. Shtojca I, fq. 17

6 5.-6. maj 2006. Sarajevë, BH.

7 Propozimet, mendimet dhe rekomandimet nga konsultat dhe forumet për periudhën e vëzhguar mund të lexohen në Shtojcën I.

8 Filmi *Nisma KOMRA*, i cili flet për historinë e procesit të konsultave mund t'i qasni në <http://www.korekom.org/news/read/17>

9 Në sajtin www.korekom.org mund t'i qasni pasqyrave tabelare të procesit të konsultimeve <http://www.korekom.org/webpage/108> dhe të anëtarëve të Koalicionit <http://www.korekom.org/webpage/>

10 Vesna Teršelić, Documenta, Kroaci, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Prishtinë, Kosovë, 4. tetor 2008. Shtojca I, fq 59

11 Esad Kočan, javorja *Monitor*, Mali i Zi, Forumi i Parë Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Sarajevë, BH, 5.- 6. maj 2006. Shtojca nr. I, fq. 17

12 Mladen Bajčić, Prokuroria shtetërore e Republikës së Kroacisë, Forumi i Dytë Rajonal, Zagreb, Kroaci, 8.-9. Shkurt 2007. Shtojcag I, fq. 23

13 Marko Veličković, Qendra për zhvillimin e resurseve civile, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat e të drejtave të njeriut, Frushka Gora, Serbi, 10 tetor 2008, Shtojca I, fq. 59

14 Aleksandar Zeković, hulumues i shkëlqejve të të drejtave të njeriut, Mali i Zi, Konsultime rajonale me shkencatarët, Zagreb, Kroaci, 10. Janar 2009. Shtojca I, fq. 78

15 Nataša Kandić, Fondi për të drejtën humanitare, Serbi, Konsultat kombëtare me gazetarët, Frushka Gora, Serbi, 11. Tetor 2008. Shtojca I, fq. 65

16 Igor Graovac, Instituti kroat për histori, Konsulta rajonale me shkencatarët, Zagreb, Kroaci, 10. Janar 2009. Shtojca I, fq. 78

17 Mato Ežegović, Kthimi në Pelagiqevë, BH, Konsultime lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, 11 prill 2009. Shtojca I, fq. 84

18 Ante Nazor, Qendra kroate memoriale-dokumentuese mbi luftën atdhetare, Kroaci, Konsulta rajonale me shkencatarët, Kroaci, 10. janar 2009. Shtojca I, fq. 78

19 Srdan Dvornik, Këshilli i Helsinkit kroat për të drejtat e njeriut, Kroaci, Konsulta rajonale me organizatat për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, 29 tetor 2007. Shtojca I, fq. 39

20 Forumi i Tretë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Beograd, Serbi, 11.-12. shkurt 2008. Shtojca I, fq. 41

21 Amir Kulagić, Shoqata *Gratë e Srebrenices*, BH, Forumi i Tretë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Beograd, Serbi, 11.-12. shkurt 2008. Shtojca I, fq. 41

22 Marko Veličković, Qendra për zhvillimin e resurseve civile, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, 10. tetor 2008. Shtojca I, fq. 59

23 Stjepan Mesić, Kryetar i Republikës së Kroacisë, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007. Shtojca I, fq.

24 Oliver Dulic, Kryetar i Kevendit të Republikës së Serbisë, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11-12 shkurt 2008. Shtojca I, fq. 41

Aktivistët për të drejtat e njeriut vlerësojnë që qasja rajonale ngushton hapësirën për gënjeshtër dhe manipulime,¹³ i kontribuon objektivitetit,¹⁴ mundëson zbardhjen e të dhënave të cilat askush nuk mund t'i mohojë.¹⁵ Historianët tregojnë për mundësinë e këmbimit të informatave mbi humbjet njerëzore,¹⁶ ndërkaq që të gjithë pjesëmarrësit të cilët përkrahin qasjen rajonale presin që trupi rajonal të kontribuojë në zgjidhjen më efektive të fatit të personave të zhdukura.¹⁷

Disa pjesëmarrës kanë frikë nga një e vërtetë për të gjithë,¹⁸ ndërkaq që të tjerët janë të sigurt se qasja rajonale nuk është imponim i pikëpamjeve të përbashkëta por e vetmja mënyrë e përcaktimit se çka ka ndodhur.

*Bashkëpunimi rajonal nuk është ndonjë imponim i pikëpamjeve unike, por është e vetmja mënyrë që në rastin tonë kompleks të zbulohen në tërësi gjërat dhe kjo është e vetmja gjë ku as nacionalistët nuk kanë si të bëjnë vërejtje sepse në vepër demonstronhet çka do të thotë pranimi i përgjegjësive, edhe nëse aspak nuk jemi fajtor, sepse pranojmë përgjegjësinë që krimet që janë bërë në emër të kombeve tona, të hetohen dhe konstatohen si të tilla.*¹⁹

Në Forumin e Tretë për të drejtën tranzicionale²⁰ pjesëmarrësit kanë konkretizuar përkrahjen e tyre qasjes rajonale duke theksuar se trupi, përkatësisht komisioni rajonal, është instrumenti më i besueshëm për kërkimin dhe tregimin e fakteve për të gjitha ato çka ka ndodhur gjatë konflikteve të armatosura në ish SFRJ.

*Unë jam për qasje rajonale dhe formimin e një trupi rajonal edhe për një arsye tjetër të thjeshtë. Ajo çka ka ndodhur në hapësirat e ish Jugosllavisë ka qenë mbi bazën e parimit të enëve të lidhura. Sepse kemi shumë të tillë që kanë ardhur... Kemi shumë të tillë që kanë ardhur në Bosnje ose në Srebrenicë nga anët e ndryshme dhe kanë bërë krime. Ata janë tani të ndarë gjeografikisht dhe është vështirë që të sigurohen informatat se kush ka bërë çka, dhe ku e ka bërë këtë.*²¹

Aktivistët e organizatave rinore fuqishëm përkrahin qasjen rajonale si metodë kundër manipulimeve dhe keqpërdorimit të viktimave.

Dhe nëse viktimat, shoqatat e viktimave (...) edhe dalin disi nga ajo etnikja, dhe lëvizin në kornizën rajonale sepse viktimat kërkojnë të vërtetën, të

*drejtën e tyre që të dinë se çka u ka ndodhur, rruhet absolutisht edhe ajo hapësirë e manipulimeve.*²²

2.1. Përkrahja e përfaqësuesve të pushtetit dhe të institucioneve

Në hapjen e forumit rajonal për drejtësinë tranzicionale në Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Serbi, Kosovë dhe në Malin e Zi, kanë folur përfaqësuesit më të lartë të pushtetit në shtetet e përmendura. Të gjithë përkrahën qasjen rajonale në zbardhjen e fakteve për krimet e luftës në shtetet e përmendura. Të gjithë kanë përkrahur qasjen rajonale në zbardhjen e fakteve mbi krimet e luftës.

*Ne duhet ta dimë të vërtetën patjetër, ajo duhet të kërkohet dhe të konstatohet, dhe me të vërtetën duhet të ballafaqoheni dhe ta bëjmë këtë me dëshirë, pa marrë parasysh se a do ti pëlqej apo jo kjo dikujt. Dhe e vërteta është vetëm një. Kuptohet, ekzistojnë përjetimet e ndryshme të kësaj të vërtete. Ekzistojnë këndet e ndryshme të shikimit të kësaj të vërtete, dhe ekzistojnë edhe interpretimet e ndryshme të kësaj të vërtete. Por, e vërteta mbetet ajo që është, sepse kemi faktet, atë çka ka ndodhur, dhe për këtë nuk ka dhe nuk mund të ketë kurrfarë pazari, kurrfarë hesapësh, kurrfarë relativizimesh.*²³

*Duke i dhënë viktimave rastin që të flasin dhe juve që ti dëgjoni, ju kontribuoni në mjekimin e shoqërisë tuaj. Dhe mendoj se të gjitha shoqëritë tona post konflikte janë duke hyrë në një proces, apo janë tashmë brenda tij, të mjekimit dhe unë shpresoj, për hir të të ardhmes, për hir të të ardhmes tonë të përbashkët, të ardhmes së rajonit, se ky mjekim do të sjell shëndoshje të shpejtë.*²⁴

*Qasja rajonale këtij problemi mendoj se është posaçërisht e rëndësishme për shkak të faktit se vetëm të gjithë së bashku mund t'i zbulojmë të gjitha faktet, që deri më sot nuk janë ndriçuar. Sipas mendimit tim si një fakt ndër më të rëndësishmit, është fakti se duhet të dihet dhe ndriçohet fati i të zhdukurve i të gjitha kombësive. Unë nuk e mohoj se ka të zhdukur nga radhët e komuniteteve tjera në Kosovë, por nuk dua të mohoj faktin se numri më i madh i të zhdukurve i takon komunitetit shumicë.*²⁵

Qëllimi kryesor është që [faktet për krimet e bëra] të futen në tekstet tona shkollore, të bëhet pjesë e edukimit tonë, të bëhet pjesë e kulturës sonë. Ka ardhur koha që të mësojmë për humbjet dhe gabimet tona, jo më pak se për fitoret tona. Kur ta

arrijmë këtë, mendoj se do të arrijmë që si shoqëri të kuptojmë se mësimi mbi ato gabime dhe humbje nga fillimi i viteve '90 të bëhet diga më e madhe në shpirtin e njeriut, që kjo të mos përsëritet më.²⁶

2.2. Dilemat për pajtimin²⁷

Gjatë procesit të konsultimeve pjesëmarrësit kohë pas kohe kanë hapur edhe çështjen e pajtimit, se a duhet pajtimi të jetë qëllim i Komisionit rajonal, por nuk mund të thuhet se rreth kësaj është arritur qëndrim i kristalizuar. Vërehet se viktimat kanë nevojë për bashkëndjesi dhe solidaritet nga njerëzit e komuniteteve tjera etnike. Disa aktivistë të shoqatave joqeveritare pajtimin e shohin si qëllim afatgjatë, e disa janë kundër që pajtimi të futet në mandatin e Komisionit rajonal.

Do ta forcojmë këtë lëvizje nëse e shkrijmë atë dhimbje, që nuk e kemi më vetëm për viktimat tona, por në përgjithësi dhimbje për të gjitha viktimat.²⁸ Francezët dhe gjermanët kanë pritur tridhjetë vjet dhe edhe ne mbase do të pajtohemi pas një periudhe të caktuar.²⁹

Do të ishte bukur të kemi pajtimin, por mendoj se pajtimi nuk duhet të jetë mandat i komisionit rajonal.³⁰

Pos kësaj disa pjesëmarrës kanë thënë se ka ardhur koha për rishqyrtim vetëkritik të përgjegjësive personale.³¹

2.3. Përkrahja komisioneve kombëtare të së vërtetës

Gjatë procesit të deritanishëm të konsultimeve, në debatet e ndara, katër herë është iniciuar çështja e komisioneve kombëtare si model i mundshëm për përcaktimin e të vërtetës se çka ka ndodhur në Jugosllavinë e dikurshme.

Në Forumin e parë rajonal për të drejtën tranzicionale, prokurorët dhe gjykatësit e Gjykatës së BH, kanë tërhequr vërejtjen se gjykimet për krimet e luftës nuk janë të mjaftueshme për përcaktimin e të vërtetës së plotë për gjithë atë që kanë ndodhur në të kaluarën dhe se, sa i përket Bosnjës e Hercegovinës, mangësitë e gjykimeve penale mund të kompensohen dhe e vërteta më e plotë mund të jepet nga Komisioni për të vërtetën në BH. Në këtë kontekst, në forumin e përmendur, kryeprokurori i BH Marinko Juriçević ka thënë: *Me rëndësi të veçantë është të dihet se e vërteta*

e gjyqit ka kufizime të caktuara. Pasi që dihet se vetëm një numër i kufizuar i viktimave merr pjesë në gjykimet për krimet e luftës, një mekanizëm i tillë [komisioni për BH] do të mund të përfaqëson te forumin kryesor për viktimat, ku do të mund të tregonin vuajtjet e tyre. Komisioni për të vërtetën dhe proceset penale kështu do të mund të plotësonin njëri tjetrin.

Mendimin e prokurorit Jurčević e kanë përkrahur anëtarët e Grupit punues të atëhershëm për hartimin e Draftit të Ligjit për formimin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin në Bosnje e Hercegovinë.³²

Të vërtetën për atë se çka ka ndodhur në Bosnje e Hercegovinë në periudhën 1992 deri 1995 e shkruan Tribunali i Hagës, e shkruan Gjyqi Ndërkombëtar i Drejtësisë në Hagë, e shkruan Gjyqi i Bosnjës e Hercegovinës, e shkruajnë gjykatat anëmbanë Bosnjës e Hercegovinës, por është tejet e sigurt se ato nuk do të përfshijnë të gjitha ngjarjet, nuk do të përfshijnë të gjitha faktet dhe është krejtësisht e sigurt se në BH duhet të fillojë edhe një proces në mënyrë që të përcaktohet e vërteta e plotë për atë se çka ka ngjarë në BH në mënyrë që të realizohet ballafaqimi me të vërtetën e plotë.³³

Grupi punues i përmendur më parë e ka ndërprerë punën më 17 maj 2006 duke i ndalur të gjitha aktivitetet që çonin drejt aprovimit të ligjit dhe krijimit të komisionit. Dihet se grupi punues ndryshoi disa nene të draftit të ligjit të trashëguar. Nuk ka pasur asnjë shpjegim zyrtar pse grupi punues e ndërpreu punën.³⁴

Tre vjet më vonë përfaqësuesit e shoqatës të viktimave shqiptare, përballë të rinjve dhe aktivistëve të organizatave joqeveritare në Kosovë, sërish e shtruan çështjen e komisioneve kombëtare. U angazhuan për krijimin e komisionit kosovar, e cila do ta përfaqësonte shtetin e Kosovës në komisionin rajonal.

Shoqata propozon që nisma të fillojë në nivelin lokal dhe vetëm pastaj të lidhen vendet e rajonit... KOMRA nuk mund të fshihet pas asaj që dikur quhej vëllazërim-bashkim. Komisioni është i domosdoshëm, por së pari në nivelin e shteteve, dhe më pas të bëhet edhe në nivelin rajonal.³⁵

Në konsultimet e shoqërisë civile në Mal të Zi, dy pjesëmarrës kanë qenë për themelimin e komisionit

25 Nekibe Kelmendi, Ministre e Drejtësisë e Kosovës, Forumi i Katërt Rajonal mbi të drejtën tranzicionale Prishtinë, Kosovë, 28-29 tetor 2008. Shtojca I, fq. 71

26 Ranko Krivokapić, Kryetar i Kuvendit të Malit të Zi. Forumi i Pestë Rajonal për të drejtën tranzicionale, Budva, Mali i Zi, 29-30 maj 2009. Shtojca I, fq. 120

27 Mark Freeman, Qendra Ndërkombëtare për drejtësi tranzicionale, seminari mbi komisionet e të së vërtetës, Beograd, 26. maj 2008, transkripti mund të gjetet në www.koKOMRA.org; *Pajtimi në kuptimin që e përdorin shumica e komisioneve për të vërtetën ka lidhje me këtë nocion, me idenë se duhet të ndërtohet, sërish të ndërtohet besimi i qytetarëve, të krijohet një nivel i caktuar i bashkëndjesisë ndërmjet grupeve...*

28 Ana Kvesić, Shtëpia evropiane në Vukovar, Kroaci, Forumi i Katërt Rajonal për drejtësi tranzicionale, Prishtinë, 28-29 tetor 2008. Shtojca I, fq. 71

29 Atthe Berisha, *Kalaja*, Kosovë, Konsultime Lokale me shoqërinë civile, Pejë, Kosovë, 26. qershor 2009. Shtojca I, fq. 141

30 Tea Gorjanc-Prelević, Akcioni për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i Katërt Rajonal për drejtësi tranzicionale, Prishtinë, 28-29 tetor 2008. Shtojca I, fq. 71

31 Aleksandar Stojanović, Qendra për zhvillimin e shoqërisë civile, Kosovë, Konsultime kombëtare me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, 26. Qershor 2008. Shtojca I, fq. 54

32 E drejta tranzicionale në vendet post-jugosllave, Raport për vitin 2006. Autorët : FDH, Documenta i QHD: Nga fundi i vitit 2005. *USIP ka ofruar ekspertizën e vet treshës që kryeson Dhomën përfaqësuese të Kuvendit Parlamentar të BH, Šefik Džaferovićit, Nikola Špirićit dhe Martin Raguzit. Kryesuesit i kanë dërguar letër grupeve parlamentare me propozimin që të emërohen përfaqësuesit në grupin punues për hartimin e ligjit. Me vendimin e tre kryesuesëve në nëntor të vitit 2005 është formuar grupi punues, pa paralajmërim të veçantë në opinion.*

33 Šefik Džaferović, zëvendësi i parë i kryesuesit të Dhomës së Përfaqësuesëve të Kuvendit Parlamentar të Bosnjës e Hercegovinës, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006. Shtojca I, fq. 17

34 Në opinion ka pas supozime se kjo kishte ndodh ngase anëtarët e kuptuan duke falënderuar debatit në Forumin e parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, se pa përkrahjen publike dhe kycjen e shoqatave të viktimave në formësimin e mandatit, asnjë komision nuk mund të ketë gjasë për sukses.

35 Bajram Qerkini, Shoqata *Kujtimi*, Kosovë, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësinë Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009. Shtojca I, fq. 120

36 Aida Bagić, Documenta, Kroaci, Konsultime kombëtare me grupet e grave, Zagreb, Kroaci, 21. Maj 2009. Shtojca I, fq. 117

37 Petrit Çarkaxhiu, *Oxygen*, Kosovë, Konsultime kombëtare me artistët, Prishtinë, Kosovë, 10. maj 2009. Shtojca I, fq. 111

38 Ivan Novosel, Grupi rinor i Këshillit të Helsinkit kroat për të drejtat e njeriut, Kroaci, Konsulta rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, 21 tetor 2007. Shtojca I, fq. 36

39 Koča Pavlović, deputet në Kuvendin e Malit të Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, 25. Tetor 2008. Shtojca I, fq. 68

40 Për shembull Adisa Tihic nga Skelani, BH, Forumi i Pare Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006, por edhe shumë deklarime tjera. Shtojca I, fq. 17

41 Ivan Pšenica, Lidhja e shoqatave të familjeve të ushtarëve kroat të zënë rob dhe të zhdukur, Kroaci, Forumi i Tretë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Beograd, Serbi, 11-12 shkurt 2008. Shtojca I, fq. 43

42 Më së shumti konsulta ka pasur me shoqatat e viktimave dhe familjeve të viktimave, 12. Pos kësaj, ata kanë marrë pjesë edhe në shumë konsultime me grupet dhe organizatat tjera. Tre forumet rajonale të fundit për drejtësi tranzicionale kanë pas sesione / punëtori të veçanta kushtuar nevojave të viktimave.

nit kombëtar, e cila pastaj do të bashkëpunonte me Komisionin rajonal.

Herën e katërt, në konsultimet me grupet e grave në Zagreb, 21 maj 2009, një pjesëmarrëse ka shfaqur mendimin e saj që do të duhej që paralelisht me themelimin e KOMRA do të ishte me dobi që të nxitet edhe themelimi i komisionit kombëtar.³⁶

2.4. Përkrahja e bashkësisë ndërkombëtare

Pjesëmarrësit e procesit konsultativ janë duke pritur që përkrahja e Komisionit Evropian për nismën KOMRA do të ketë ndikim në qeveritë e vendeve në rajon për të marrë vendimet mbi themelimin e komisionit rajonal.

Për nevojën e përkrahjes së bashkësisë ndërkombëtare ka folur edhe Petrit Çarkaxhiu, në maj të vitit 2009, në Prishtinë:

Bashkimi Evropian, Zyra e Shteteve të Bashkuara të Amerikës [në Kosovë] duhet të bëjnë presion në qeveritë tona për krijimin e një komisioni të këtyllë. (...) Këto gjëra bëhen me vendime të qeverisë, dhe për to duhet të bëjmë presion nëse mundemi në evropianët dhe amerikanët që t'i detyrojmë të bëjnë diçka. Për shembull, që t'i thuhet Tadiqit 'e vala nuk të jap të holla,' ose 'nuk do ta merrni vizën për Evropë deri sa nuk e bëni këtë', dhe ata do të janë të detyruar ta bëjnë. Kështu bëhen këto punë.³⁷

Shumë pjesëmarrës kanë pas nevojën që të theksojnë se ballafaqimi me krimet e bëra është i rëndësishëm për shkak të përgjegjësisë ndaj vetë shoqërisë dhe jo për shkak të Bashkimit Evropian.

Zgjidhjen e kësaj ne duhet ta bëjmë para hyrjes në Bashkimin Evropian, sepse pas hyrjes nuk do të kemi më çka për të zgjidhur. Ne duhet t'i zgjidhim vetë këto gjërat dhe duhet të jemi më në fund, të paktën një herë nga shekulli i pesë, gjashtë, shtatë, ose e dhe para Krishtit, përgjegjës për shoqëritë tona.³⁸

Disa pjesëmarrës kanë vlerësuar se fuqia e nismës konsiston në karakterin e saj rajonal.

Mendoj se tek kjo një aspekt i rëndësishëm është fakti se ky është një Komision Rajonal, dhe se të qenit e saj rajonal mund të bëhet baza që të tejkalohen këto barriera tona të brendshme dhe lokale.³⁹

3. Nevojat dhe pritjet e viktimave

Në Forumin e Parë Rajonal për të drejtën tranzicionale, përfaqësuesit e shoqatave të viktimave kanë paraqitur qëndrimin se gjetja e kufomave të zhdukurve dhe varrosja e tyre sipas zakoneve është nevojë ekzistenciale e familjeve.⁴⁰

Ivan Pšenica, nga Lidhja e shoqatave të familjeve të ushtarëve kroat të zënë rob dhe të zhdukur, konsideron se Bashkimi Evropian duhet të ketë parasysh se sa është e rëndësishme për familjet zgjidhja e çështjes së personave të zhdukur:

Sepse ne kemi ardhur deri te konstatimi se zgjidhjen duhet kërkuar tek bashkësia ndërkombëtare, duke ia pamundësuar fillimin e integriteteve euroatlantike secilit shtet që nuk e ka zgjidhë çështjen e të pengjeve të luftës dhe të personave të zhdukur.⁴¹

Zgjidhja e fatit të të zhdukurve deri më sot, në më shumë se 40 tubime sa janë mbajtur në kuadër të procesit të konsultimeve, ka qenë njëra nga kërkesat e obligueshme të pjesëmarrësve.⁴²

3.1. Definimi i viktimës

Pjesëmarrësit mendojnë se parakusht për punën e KOMRA-a është definimi i saktë i nocionit viktimë. Përfaqësuesit e disa shoqatave të viktimave konsiderojnë se viktimë assesi nuk mund të janë personat që kanë qenë të armatosura.⁴³



Konsultimet nacionale me shoqatat e viktimave dhe organizatat joqeveritare, Srebrenica, BH, 26 prill 2009

Asgjësimi i popullsisë civile nuk mund të krahasohet me pësimet e atyre që kanë vdekur me pushkë në dorë dhe i kanë takuar formacionit ushtarak, ndërsa sot bëhen përpjekjet që të barazohen pësimet vetëm me numra, dhe kur nuk mund të baraspeshohet me luftën e fundit, atëherë i kthehen luftës së mëparshme (...) Do të thotë, ai që është civil mbetet civil, kurse atyre që kanë vdekur si ushtar, ushtrinë nuk duhet ta përmend, ata megjithatë janë pjesë e ushtrisë dhe kjo është çështje tjetër. Ndërkaq, ne këtu flasim vetëm për civilët, njerëzit që janë marrë nga pragu i derës dhe janë ekzekutuar aty për aty ose në ndonjë vend tjetër, varet se si kanë pësuar.⁴⁴

Mendoj se është shumë e rëndësishme të mos harrohen refugjatët të cilëve thjesht u bëhej gjah në Maqedoni dhe ktheheshin në vendluftimet në Kroaci dhe Bosnje. Dhe mendoj se ndoshta duhet të kihet vëmendja edhe për ata njerëz që nuk kanë dashur të shkojnë në luftë por janë detyruar në mënyra të ndryshme ose përfundonin nëpër burgje.⁴⁵

Juristët flasin për standardet e së drejtës ndërkom-bëtare (Konventa e Gjenevës) dhe thonë si viktimë mund të konsiderohet vetëm personi i mbrojtur ndaj të cilit është bërë krimi i luftës ose ka përjetuar shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, duke përfshirë edhe krimin e luftës ndaj robërve të luftës.⁴⁶

3.2. Problemi i familjeve të personave të zhdukur

Çështja e personave të zhdukur⁴⁷ ka të bëjë para së gjithash me gjetjen e varrezave masive sekrete si dhe të vareve individuale.

Ajo çka është me rëndësi të madhe në këtë moment është që familjet t'i marrin mbetjet mortore të më të dashurve të tyre, por është vështirë të kuptohet, ja tash edhe pas 15 vitesh, ne në rajonin e komunës Zvornik, jemi në kërkim të kufomave të 500 viktimave.⁴⁸

Megjithatë, kjo çështje përcillet edhe nga shumë probleme tjera të cilat viktimat dhe familjet e viktimave i paraqesin si kërkesat e tyre që duhet të janë në mandatin e Komisionit rajonal. Viktimat presin që të mblidhen shënimet për vendet ku kanë pësuar viktimitat dhe që, pos gjetjes së varrezave masive, të hetohen edhe rrethanat në të cilat kufomat e viktimave janë bartur nga varrezat masive

primare, në ato sekondare dhe terciare.⁴⁹ Shumë probleme paraqiten edhe pasi që kufoma e anëtarit të familjes zbulohet dhe i dorëzohet familjes, si p.sh. kërkesa që familjet të deklarohen për datën e vdekjes, madje edhe nëse personi ka qenë i kidnapuar, në mënyrë që të zgjidhen çështjet e trashëgimisë së pronës dhe të shfrytëzimit të ndihmave. Shembulli tjetër është kërkesa që për personin e kidnapuar, të vrasë dhe më vonë të zbuluar, që në certifikatën e vdekjes të shënohet se ka vdekur në mënyrë natyrore.⁵⁰

Mua më pyesin, pra fëmijën e pyesin, cilën datë të vdekjes ta shënojnë. E unë i çoj krahët, nuk e di... E patën lënë datën e kidnapimit. Dhe për se kërkimi shtatë vjeçar? (...) Shkaku i vdekjes nuk përputhej në dokumentacion që e lëshon UNMIK-u me dokumentacionin që e lëshon Instituti për Medicinë Gjyqësore në Mitrovicë. Pra, ekziston dallimi, madje edhe në datën. Do të thotë, është zhdukur në vitin 2000, është gjetur para vitit 2004, kjo është periudhë mjaftë e gjatë, e unë e kam marrë vesh që ka vdekur me 8 shkurt 2007. Në ndërgjegjen time ndoshta e dija që nuk është gjallë, por nuk e kam pas të dokumentuar, nuk kisha fakte.⁵¹

Kërkesat e familjeve të viktimave gjithkund në rajon janë identike - KOMRA duhet t'i ndihmojë familjeve të të zhdukurve në zgjidhjen e shumë problemeve me të cilat ballafaqohen gjatë kërkimit, dhe pas gjetjes së mbetjeve të kufomave.

3.3. Reparacione materiale dhe simbolike

Viktimat presin se do të realizohen rekomandimet e KOMRA-s për kompensime materiale, memorialët dhe shënimin e datës dhe vendit të krimit, pasi që ato ti dërgohen qeverive në rajon.

Shpresoj që me themelimin e këtij Komisioni do të kemi të gjithë dobi. E para, që të zbulohen shkaktarët e vërtetë të kësaj tragjedie, të zbulohet e vërteta e njëmendtë mbi pësimet e më të dashurve tanë. Dhe e dyta, familjet e tëra që kanë përjetuar atë që kanë përjetuar, më në fund të shfrytëzojnë edhe një dëmshpërblim material.⁵²

Pjesëmarrësit kanë theksuar edhe kërkesën që reparacionet në të holla duhet të marrin edhe viktimat e dhunës seksuale, që duhet të kanë përkrahjen morale dhe të trajtohen si të gjitha viktimat tjera civile.

43 Kada Hotić, Shoqata Lëvizja e Nënave të Enklavave Srebrenica dhe Zhepa, BeH, Konsultime lokale me shoqatat e viktimave dhe organizatat tjera të shoqërisë civile, BeH, 26 prill 2009. Shtojca I, fq. 102

44 Hakija Smajlović, Shoqata e familjeve të zënëve rob dhe të personave të zhdukur të komunës së Zvornikut. BH, Konsulta lokale me shoqatat e viktimave dhe organizatat tjera të shoqërisë civile, Srebrenicë, BH, 26. prill 2009. Shtojca I, fq. 102

45 Ljiljana Stojanović, Qendra për demokraci dhe zhvillimin e Jugut të Serbisë, Konsulta lokale me shoqërinë civile, Leskovcë, Serbi, 11. Qershor 2009. Shtojca I, fq. 135

46 Ibro Bulić, Prokuroria e BH, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësinë Transnacionale, Mali i Zi, 29-30 maj 2009, Shtojca I, fq. 120

47 Në rajonin e ish RFSJ ende ka të zhdukur diku rreth 17.000 deri 18.000 persona.

48 Mevludin Lupić, Shoqata e familjeve të zënëve rob dhe të personave të zhdukur të komunës së Zvornikut., BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11-12 shkurt 2008. Shtojca I, fq. 43

49 Dževad Bektašević, Shoqata Familjet e Viktimave të Luftës Vlasenica '92-'95, BeH, Konsulta lokale me shoqatat e viktimave dhe organizatat tjera të shoqërisë civile, Srebrenicë, BH, 26 prill 2009. Shtojca I, fq. 102

50 Nataša Šćepanović, Shoqata e familjeve të të kidnapuarve dhe të vrasëve në Kosovë dhe Metohi, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, 25. prill 2009. Beograd, Serbi, Shtojca I, fq. 102

51 Snežana Zdravković, Shoqata e familjeve të të kidnapuarve dhe të vrasëve në Kosovë dhe Metohi, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, 25. prill 2009. Beograd, Serbi, Shtojca I, fq. 92

52 Saša Ristanović, Shoqata e familjeve të të kidnapuarve dhe të vrasëve në Kosovë dhe Metohi, Serbi, zyra në Shtërpçë, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, 25. prill 2009. Beograd, Serbi, Shtojca I, fq. 92

53 Ružica Spasić, Shoqata e familjeve të të zhdukurve dhe të rrëmbyerve me dhunë të Serbëve, Kroaci, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale Beograd, Serbi, 11-12 shkurt 2008. Shtojca I, fq. 43

54 Smilja Mitrović, Shoqata e luftëtarëve të zhdukur të Ushtrisë së Republika Serbska/Organizata komunale e familjeve të të zhdukurve e komunës Bijelinë, BH, Konsulta lokale me shoqatat e viktimate, Bijelinë, BH, 11 prill 2009, Shtojca I, fq. 84

55 Lidija Zeković, aktiviste e të drejtave të njeriut, Mali i Zi, Forumi i pestë regional për drejtësi tranzicionale, Budva, mali i Zi, 28-29 maj 2009., Shtojca I, fq. 120

56 Kada Hotić, Shoqata Lëvizja e nënave të enklavave Srebrenicë dhe Zhepa, BeH, Forumi i Tretë rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11-12 shkurt 2008. Shtojca I, fq. 43

57 Sonja Biserko, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, Konsulta rajonale me organizatat e të drejtave të njeriut, Beograd, Serbia, 29 tetor 2007. Shtojca I, fq. 39

58 Ivo Goldstein, Fakulteti Filozofik në Zagreb, Kroaci, Konsulta Rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, 10. Janar 2009. Shtojca I, fq. 78

59 Ibro Bulić, Prokuroria e BeH, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009. Shtojca I, fq. 120

3.4. Njohja e të gjitha viktimave

Përfaqësuesit e shoqatës së viktimave serbe në BH, Kroaci dhe në Kosovë, kërkojnë që KOMRA të sigurojë njohjen dhe trajtimin të barabartë të të gjitha viktimave.

Mendoj se edhe te ne këtu në Kroaci duhet të njihen të gjitha viktimat, sepse viktimat e anës serbe shumica e njerëzve i sheh sikur ata kanë qenë kriminelë potencialë që edhe e kanë merituar atë çka u ka ndodhur.⁵³

Nuk do të ketë të vërtetë përderisa në këto hapësira të Bosnjës dhe Hercegovinës të gjitha viktimat nuk do të jenë të respektuara.⁵⁴

4. Mandati i KOMRA

Mbi mandatin e komisionit rajonal ka filluar të debatohet në Konsultimin rajonal me përfaqësuesit e shoqatave të familjeve të viktimave dhe të veteranëve, më 9 maj 2008 në Podgoricë. Propozimet, mendimet dhe rekomandimet që kanë dalë nga ky konsultim tregojnë se shumica dërmuese e pjesëmarrësve konsiderojnë se mandati i Komisionit rajonal (KOMRA) duhet të jetë kërkimi i fakteve për krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut (çka ka ndodhur). Mirëpo, disa historian me renome konsiderojnë se Komisioni duhet të merret, pos dokumentimit të krimeve, edhe me sqarimin e shkaqeve dhe regjistrimin e viktimave. Po kështu, përfaqësuesit e disa organizatave për të drejtat e njeriut dhe shoqatat e familjeve të viktimave insistojnë që KOMRA së pari duhet të përgjigjet *pse* ka ndodhur ajo që ka ndodhur (shkaqet e luftës). Të gjithë pajtohen se KOMRA duhet të merret edhe me ngjarjet e luftës në Slloveni dhe Maqedoni.

Nëse flasim për atë se pse na duhet KOMRA, arsyeja është, ndër të tjerat, sepse kemi nevojë për një gjë të përbashkët, një libër apo dokument të përbashkët, mbi atë çka ka ndodhur dhe rreth të cilës të gjithë pak a shumë edhe do të pajtohemi.⁵⁵

Ne pak flasim për shkaqet e këtij krimi që ka ndodhur këtu. Për shkakun e luftës askush nuk është akuzuar e as dënua, çka do të thotë se viktimat mbetet viktimë dhe drejtësia nuk është përmbushur (...) Gjithnjë merremi me pasojat, flasim për pasojat.⁵⁶

Pasi që po flasim për viktimat, këtu është i rëndësishëm ky nivel, në të cilin prej vitesh punojnë disa organizata. Niveli tjetër janë faktet, dhe jo vetëm ato që lidhen me luftën por edhe atë që i kanë parapri luftës. Bijlana (Kovaçević-Vučo) ka folur këtu për kontekstin politik, do të thotë për politikën që kanë sjell deri te lufta. Këtu para së gjithash mendoj në Serbinë, sepse është më komplekse dhe do të thosha edhe më e rëndësishme. Dhe, e treta, është ai interpretimi që do të ketë forma të ndryshme dhe nga këndvështrimet e ndryshme, gjë që do të jetë çështje e shqyrtimeve në dekadat e ardhshme. Mendoj se ne e kemi para vetës një debat të tillë.⁵⁷

Puna e vërtetë duhet të zhvillohet në tri nivele: të parin e shoh si shkaqet dhe shpjegimet, pra një narracion mbi atë se çka ka ndodhur; i dyti është regjistri i krimeve, përkatësisht dokumentimi i krimit; dhe i treti është regjistri i viktimave. Unë, pra, e kuptoj këtë punë si një lloj bashkëpunimi rajonal.⁵⁸

4.1. Vendosja e mandatit

Gati të gjithë pjesëmarrësit në konsultime janë pajtuar se parlamentet e shteteve suksesore të RSFJ të dikurshme duhet të kenë rolin më të rëndësishëm në themelimin e KOMRA. Në këtë rast mandati i komisionit do të definohej nga ligji.

4.2. Objekti i hetimeve dhe analiza e KOMRA

Në konsultimet për mandatin e Komisionit është shfaqur mendimi se KOMRA duhet të shfrytëzojë faktet që janë konstatuar nga Tribunali i Hagës në të cilat edhe janë bazuar aktgjykimet, por është shtruar pyetja se çka duhet të bëhet me konkluzionet e ndryshme juridike të gjykatave kombëtare mbi karakterin e konflikteve të armatosura. Po kështu, ka pasur edhe mendime se KOMRA duhet të merret me faktet që deri më sot nuk janë trajtuar lidhur me konfliktet në rajon, e më pastaj do të pasonin faktet që kanë të bëjnë me veprat individuale dhe përgjegjësinë individuale.⁵⁹

Të gjithë pjesëmarrësit e konsultimeve kanë përkrahur propozimin e shoqatave të familjeve të të zhdukurve se në mandatin e KOMRA duhet të jetë ndriçimi i fatit të atyre që janë zhdukur dhunshëm, pa marrë parasysh kombësinë e tyre:

Ma jep vetëm informatën që ta gjej, ta varros, dhe ta mbyll kështu një kapitull të jetës sime... Të mund të shkoj në varreza dhe fëmijëve të mi të mund ti them se kush ka qenë gjyshi i tyre... Do të doja të dihet e vërteta dhe të zbulohen të gjithë të zhdukurit, nuk është me rëndësi a janë serbë, kroatë apo boshnjakë, të gjithë të zhdukurit duhet të gjenden, të varrosën dhe të vihet një herë e përgjithmonë pika në i, të bëhet një e vërtetë e plotë, të thuhet se kush, ku dhe si i ka bërë gjërat.⁶⁰

Pjesëmarrësit propozojnë që KOMRA të merret me vrasje, dhunime, kampet dhe dëbimet etnike të përmasave më të mëdha.

Nga veprat gjithsesi do të veçoja varrezat masive, pra këto janë krime më të mëdha... Pasojnë pastaj zhdukurjet me presion dhe të dhunshme... Mendoj se këto gjëra ia vlen të jenë në mandatin e plotë të KOMRA, fati i atyre njerëzve, vendi ku janë varrosur, mënyra se si janë zhdukur. Pastaj vijnë vrasjet, ato në format tjera që nuk lidhen me varrezat masive për të cilat dihet, dhe pastaj janë edhe kampet... Dhe dëbimet etnike, kuptohet të përmasave më të mëdha.⁶¹

Dhunimi si krim i luftës [duhet] të futet në mandatin e komisionit. Besoj se kjo është e rëndësishme dhe se pa këtë komisioni nuk do të jetë i besueshëm, sepse gjithsesi ekziston edhe dimensionin gjinor i luftës.⁶²

Këto komisione duhet të merren me krimet e bëra në të kaluarën e afërt ngase fokusi i tyre duhet të jenë deklaratat e dëshmitarëve, të viktimitave dhe të autorëve të krimeve. Që komisionet të funksionojnë më shpejtë, më saktë dhe në mënyrë më cilësore, duhet të dihet saktë se çka do të punojnë ato, cili do të jetë fokusi i tyre dhe të kanë të definuar saktë edhe kohën dhe hapësirën rajonale ku do të punojnë ato komisione. Komisioni duhet të merret me krimet e rënda, më saktë me krimet ku kanë pësuar shumë njerëz, sepse fokusi i komisionit nuk është që të merret me krime individuale.⁶³

Pjesëmarrësit në konsultimet nga Sllovenia kanë propozuar që KOMRA të merret edhe me ata që janë shlyer nga shtetësia sllovene,⁶⁴ ndërkaq pjesëmarrësit nga radhët e viktimitave serbe propozojnë që në kompetencat e KOMRA të janë edhe viktimitat e bombardimeve të NATO-s.⁶⁵ Ka propozime që KOMRA të merret edhe me përgjegjësinë e institucioneve, veçanërisht të mediave dhe të policisë.

Unë do t'ia jepja mandatin KOMRA-së që të merret jo vetëm me veprimet e individëve, por edhe me veprimtarinë e institucioneve, të organeve. Pse mos të merret KOMRA me krimet që i kanë nxitur shtëpitë mediale... përkatësisht kryeredaktorët, gazetarët e të ngjashme? Pastaj pse KOMRA të mos merret me disa organe të policisë ose edhe policinë në tërësi të vendeve të rajonit, që në njëfarë mënyre kanë qenë ekzekutor ose porositës të krimeve që janë kryer në kampet, burgjet etj.⁶⁶

4.3. Regjistrimi i humbjes së popullsisë

Përfaqësuesit e shoqatave të viktimitave, aktivistët për të drejtat e njeriut, të rinjtë, historianët dhe pjesëmarrësit tjerë të konsultimeve konsiderojnë se në mandatin e KOMRA duhet të jetë edhe regjistrimi i të gjithë të vrarëve, viktimitave dhe të zhdukurve. Duke pas parasysh se disa organizata për të drejtat e njeriut janë duke punuar në listat individuale emërore të humbjeve në njerëz, pjesëmarrësit në konsultimet kanë qenë të mendimit se kjo do të kontribuojë në punën më efektive të komisionit, dhe se me rëndësi është që KOMRA të bëjë verifikimin e rezultateve të këtyre regjistrimeve.

Çdo viktimitë e ka emrin dhe mbiemrin, çdo viktimitë e ka edhe dinjitetin, dhe çdo viktimitë, edhe kur është vetëm numër, fshehtë veçantinë e saj. Dhe nuk mund të flitet për njëqind apo dyqind mijë, nuk mund të flitet as për njëqind dhe dyqind njerëz, nuk mund të flitet për njëqind ose njëqind e një veta. Thjesht të gjitha viktimitat duhet të kanë emrin dhe mbiemrin e tyre. Duhet të janë aty me emra, pra duhet të identifikohen.⁶⁷

4.4. Emërimi i autorëve

Në debatet e deritashme pyetja se a duhet KOMRA ti publikojë emrat e atyre personave të cilët i konsideron se janë përgjegjës për krimet dhe shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut shqyrtohet në kontekstin e përvojave që i kanë pasur vendet tjera dhe kërkesave të viktimitave që të identifikohen përgjegjësit.

A duhet të emërohen, kjo është po ashtu një dilemë, se a duhet të emërohen autorët apo jo, dhe unë mendoj se në kumtimet dhe dëshmitë publike, nuk duhet të bëhet kjo, mirëpo me që të gjitha dëshmitë

60 Slavoljub Pejić, nga Vozuqa, BeH, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006. Shtojca I, fq. 17

61 Salem Čorbo, Shoqata Kthimi dhe qëndrimi i qëndrueshëm, BeH, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budva, Mali i Zi, 29-30 maj 2009. Shtojca I, fq. 120

62 Suzana Kunac, B.a.b.e. Kroaci, Konsulta kombëtare me grupet e grave, Prishtinë, Kosovë, 25. Qershor 2009. Shtojca I, fq. 139

63 Avni Melenica, Shoqata 22 maji, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimitave dhe shoqërinë civile të Kosovës, Prishtinë, Kosovë, 9 maj 2009. Shtojca I, fq. 107

64 Aleksandar Todorović, Nisma civile e të shlyerëve, Slloveni, Forumi i Pestë rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009. Shtojca I, fq. 120

65 Olivera Budimir, Shoqata e familjeve të të kidnapuarve, të zhdukurve dhe të vrarëve në Kosovë dhe Metohi, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009. Shtojca I, fq. 120

66 Ibro Bulić, Prokuroria BH, Forumi i Pestë rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009. Shtojca I, fq. 120

67 Ivan Novosel, *Legalis*, Kroaci, Konsulta kombëtare me studentët, Prishtinë, Kosovë, 15. prill 2009. Shtojca I, fq. 87

68 Ljupka Kovačević, *Anima*, Mali i Zi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009. Shtojca I, fq. 120

69 Tea Gorjanc-Prelević, Aksioni për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009. Shtojca I, fq. 120

70 Nenad Popović, Këshilli për iniciative qytetare, Serbi, Konsulta Lokale me shoqërinë civile, Nish, Serbi, 25. prill 2009. Shtojca I, fq.

71 Tea Gorjanc-Prelević, Aksioni për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i katërt rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishinë, Kosovë, 28-29 tetor 2008. Shtojca I fq. 71

72 Verica Tomanović, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009. Shtojca I, fq. 120 Shoqata e familjeve të personave të kidnapuar dhe të zhdukur në Kosovë dhe Metohi

73 Teki Bokshi, avokat nga Kosova, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, 29.-30. maj 2009. Budvë, Mali i Zi. Shtojca I, fq. 120

74 Olivera Budimir, Shoqata e familjeve të personave të kidnapuar dhe të zhdukur në Kosovë dhe Metohi, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009. Shtojca I, fq. 120

75 Më shumë për propozimet për zgjedhjen e anëtarëve të KOMRA në Shtojca I, fq.

76 Andrej Nosov, Nisma rinore për të drejtat e njeriut, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009. Shtojca I, fq. 120

77 Gordana Đikanović, Shoqata e familjeve të personave të kidnapuar dhe të zhdukur në Kosovë dhe Metohi, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009. Shtojca I, fq. 120

78 Ana Kvesić, Shoqata Nënati e Vukovarit, Kroatia, Forumi i katërt Rajonal për drejtësi tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, 28.-29. tetor 2008. Shtojca I, fq. 71

*nuk do të janë publike, mendoj se thjesht Komisioni duhet ti ketë këto shënime.*⁶⁸

*Pra, nëse kjo KOMRA në të dhënat faktike gjen prova të mjaftueshme tjera për një situatë, ajo edhe mund t'i emërojë pa u shqetësuar fare emrat e autorëve; unë mendoj se në këso raste kjo duhet të bëhet.*⁶⁹

Disa pjesëmarrës konsiderojnë se KOMRA duhet të bëjë listën e fajtorëve (autorëve).⁷⁰

4.5. Amnistia

Për amnistinë ende flitet në parim, por është evidente se familjet e të zhdukurve nuk janë të sigurta a është morale që të përkrahet amnistia e fajtorëve përderisa ende kërkojnë kufomat e të afërmeve të tyre.

*Të zvogëlohet dënimi për ata njerëz që sinqerisht do të tregonin ku janë varrosur viktimat. Kjo është një temë për bisedë. Nëse shumica mes nesh thotë se nuk duam zbutjen e dënimit, atëherë OK, por kjo është një temë që duhet të debatohet.*⁷¹

*Duhet të amnistohen të gjithë ata që bëjnë mirë, ata që duhet të shpërblehen. Mendoj se familjet tona duhet vetë të marrin vendimin për amnistimin. Zoti do ti dënojë të gjithë ata që kanë bërë keq, dhe secili kriminel e ka emrin dhe mbiemrin.*⁷²

4.6. Periudha kohore

Ekzistojnë mendime të ndryshme për periudhën kohore që duhet të mbulojë KOMRA. Anëtarët e Këshillit koordinues të koalicionit për KOMRA janë të prirë që mandati duhet të mbulojë vitet 1991-2001, ndërkaq pjesëmarrësit shqiptarë propozojnë që mandati të jetë nga vitit 1981, ndërkaq që serbët e Kosovës konsiderojnë se duhet të përfshihet edhe periudha pas vitit 2001.

Në Kosovë do të duhej të përfshihej koha nga 11 marsi 1981, kurrë një studentë e hodhi tabakun me ushqim në mensën e studentëve, përderisa në të njëjtën kohë stafeta e Titos kishte arritur në qendër të Prishtinës; dhe aty kërkohej që Kosova të fitojë statusin e republikës, ndërkaq që ai studenti kishte brohoritur «Poshtë Titoja!» ... Kështu që, në esencë, konflikti në Kosovë ka filluar më 11 mars 1981, dhe sipas meje ka përfunduar më 9 qershor 1999 kur

*është nënshkruar marrëveshja e Kumanovës.*⁷³

*Për Kosovën dhe Metohinë vlen rregulla se çështja ende nuk është definuar dhe e kryer dhe aty ende po ndodhin krimet. Nuk përfundon asgjë me vitin 2001 nëse e kemi edhe në vitin 2006 ndonjërin që është kidnapuar dhe për të cilin as ditën e sotme nuk dihet asgjë.*⁷⁴

4.7. Zgjedhja e anëtarëve të komisionit

Pjesëmarrësit propozojnë që KOMRA të jetë komision reprezentativ dhe që të gjitha vendet e rajonit të janë të kyçura në krijimin e komisionit: që çdo shtet të ketë përfaqësuesit e vet, që viktimat, gratë dhe aktivistët për të drejtat e njeriut të janë të përfaqësuar, që anëtarët e komisionit të janë personalitete të respektuara dhe të njohura në të gjitha shoqëritë post-jugosllave.⁷⁵

*Sa i përket vetë kriterëve mendoj se gjithsesi duhet të merren kriteret bazikë, që të mos janë të dënuar penalisht, dhe pos kësaj te struktura e komisionarëve duhet të kihet kujdes që të janë të përfaqësuar në mënyrë adekuate do të thosha të gjitha grupet e interesuara, dhe kjo do të thotë aktivistët për të drejtat e njeriut, organizatat e shoqërisë civile, viktimat, dhe po kështu edhe të gjitha grupet tjera që mund të kontribuojnë për kredibilitetin e Komisionit.*⁷⁶

4.8. Nevoja për solidaritet dhe bashkëndjesi

Pjesëmarrësit e procesit konsultativ konsiderojnë se njëri prej qëllimeve të KOMRA-s duhet të jetë stimulimi i solidaritetit dhe bashkëndjesisë ndaj viktimave nga komunitetet tjera etnike.

*I them faleminderit [Koalicionit për] KOMRA sepse na ka mësuar që të dëgjojmë njëri tjetrin dhe të derdhim lot edhe për hallin e të tjerëve.*⁷⁷

*Do ta forcojmë këtë lëvizje... nëse e shkrijmë atë dhimbje, që mos ta kemi dhimbjen vetëm për viktimat tona por në përgjithësi për të gjitha viktimat.*⁷⁸

4.9. Autorizimet e komisionit

Nuk ka qëndrim të kristalizuar për llojin e autorizimeve që KOMRA duhet ti kërkojë nga organet shtetërore. Disa pjesëmarrës tregojnë se autorizimi

met në letër nuk garantojnë që KOMRA do të ketë fuqi për ti realizojë ato. Ka propozime që KOMRA duhet të ketë të drejtën për ti ftuar, sipas përzgjedhje së tij, duke përfshirë autorët e mundshëm të krimeve dhe përfaqësuesit e institucioneve, që të paraqiten para komisionit, pa marrë parasysh që nuk mund ti detyrojë që të tregojnë të të vërtetën.

Komisioni thjesht mund të jetë edhe një trup hetues i llojit të vet që i ka autorizimet për t'i marrë në pyetje të gjithë ata që mund të ofrojnë informata relevante, dhe që po kështu mund të mbledh provat për rolin që kanë pas institucionet dhe individët në luftërat dhe në gjithë ato që kanë ndodhur.⁷⁹

5. Struktura e KOMRA-s

Nisma KOMRA është unike për atë se përfshinë pesë vende dhe planifikon që të përfshijë edhe dy vende tjera.⁸⁰ Propozimi më frekuentues është që KOMRA të ketë nënkomisionet⁸¹ ose zyre në të gjitha shtetet post-jugosllave, të cilat do kishin detyrë të kryejnë aktivitetet që ua përcakton komisioni rajonal.⁸²

Në Forumin e Pestë Rajonal për drejtësinë tranzicionale, në kuadër të punëtorisë mbi strukturën e KOMRA, është nxjerr propozimi që pos një zyre qendrore dhe më shumë zyra kombëtare, të themelohen edhe përfaqësitë e komisionit në ato vende ku janë bërë më së shumti krimet.

Mendoj se është e domosdoshme që të ketë një zyre qendrore e cila do të mbledhte të dhënat nga zyret rajonale, përkatësisht territoriale. Parashihet që çdo shtet të financojë punën e zyrave të tyre, mendoj se kjo do të ketë anën e saj pozitive nga arsyeja që ekziston mundësia që në çdo vend të zgjerohet, ku më shumë e ku më pak, rrjeti i zyrave territoriale, varësisht nga nevojat.⁸³

6. Dëgjimi publik i viktimave

Dëgjimi publik i viktimave ka has në përkrahjen e madhe të pjesëmarrësve në procesin e konsultimeve⁸⁴ dhe ka pas kërkesa shumë të mëdha që dëgjimi publik të bëhet komponentë e veçantë e KOMRA. Në dhënien publike të dëshmime viktimat e shohin shansin që tregimet e tyre ti paraqesin në një rreth zyrtarë dhe para një trupi zyrtar, para opinionit të shtetit nga janë autorët e krimeve. Edhe

pjesëmarrësit e tjerë të konsultimeve konsiderojnë e dëgjimi publik i viktimave nxit opinionin që të bëhet solidar dhe të shfaq bashkëndjesi jo vetëm me ato viktimat me të cilat ka qenë solidarë, por edhe me viktimat të cilat më parë i ka shikuar si armiq. Shoqatat e viktimave dhe të familjeve të viktimave propozojnë dhe zotohen se do të ndihmojnë punën e komisionit duke nxitur viktimat që të marrin pjesë në dëgjimet publike.⁸⁵

Ka dallim të madh mes dëgjimit publik [dëgjimi në forume] dhe intervistimit të viktimave (...) është dallimi i madh mes dhënies së dëshmisë në gjyq dhe asaj publike [në forumet], sepse aty në publikë nuk ka qenë si dëshmitarë vetëm serbi si dëshmitar, ose shqiptari si dëshmitar, por shqiptari, serbi, kroati dhe myslimani dhe të gjithë të tjerët. Nëse si viktimat, përkatësisht si dëshmitarë, ne jemi të gatshëm që të dalim në publikë me dëshmi, edhe pse ndoshta nuk jemi të vetëdijshëm se a jemi apo jo të sigurt në atë moment, ne e përmbushim një qëllim tonin.⁸⁶

Në konsultimet është folur edhe për atë se çka ndodhë nëse viktimat gjatë dëshmisë publike i përmendin me emër autorët [e krimet]. Aktivistët e të drejtave të njeriut janë të mendimit se të akuzuarve duhet t'u jepet mundësia për përgjigje, përndryshe kjo mund të konsiderohet si shkelje e të drejtave të njeriut. Është kërkuar nga KOMRA që të mos barazohen dëshmia me faktet.⁸⁷

Është fakt se në kohët e fundit shumë njerëz janë akuzuar në bazë të disa deklaratave që më vonë, pas dy apo tre vjetësh, është konstatuar se janë dhënë për interesa të caktuara dhe se nuk kanë qenë të mbështetura dhe të vërteta. Si të pengohen këto gjëra? Unë personalisht i njoh disa persona të dy kombësive të cilët dy apo tre vite kanë qenë nëpër burgje, janë marrë në pyetje etj., dhe në fund janë liruar pasi që është konstatuar faktikisht se gjërat për të cilat ata i kishin akuzuar nuk kanë qenë të vërteta dhe, njëkohësisht, këta persona nuk kanë pas asnjë satisfaksion për gabimin që është bërë. Mendoj se këto janë gjëra shumë të ndjeshme dhe se këto dëgjime publike mund të prodhojnë kundër efekte.⁸⁸

Në konsultimet në Trebinje është theksuar se KOMRA mundëson që rrëfimet e viktimave të regjistrohen zyrtarisht dhe të dëgjohen në publik.

Nuk e kam takuar asnjë viktimë e cila nuk e ka pas nevojën që të dëgjohet rrëfimi i saj. (...) Formimi i

79 Eugen Jakovčić, Documenta, Kroaci, Konsulta Lokale me shoqërinë civile, Livno, BeH, 9. maj 2009. Shtojca I, fq. 105

80 Janë përfshirë Serbia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi dhe Kosova, e në plan është edhe përfshirja Sllovenisë dhe Maqedonisë.

81 Nataša Šćepanović, Shoqata e familjeve të personave të kidnapuar dhe të zhdukur në Kosovë dhe Metohi, Serbi, Konsultat kombëtare me shoqatat e viktimave, Beograd, Serbi, 25. prill 2009. Shtojca I, fq. 92

82 Nataša Kandić, Fondi për të drejtën humanitare, Serbi, Konsulta me shoqatat e familjeve të të zhdukurve të organizatave të mbrojtësve, Vukovar, Kroaci, 24. tetor 2008. Shtojca I, fq. 60

83 Žarko Radić, Organizata republikane e familjeve të luftëtarëve të zënë rob dhe të civileve të zhdukur të Republikës Serbe, BeH, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009. Shtojca I, fq. 120

84 Dëgjimi publik i viktimave është njëri nga komponentët më të rëndësishëm të forumit për drejtësinë tranzicionale. Për herë të parë janë organizuar në kuadër të Forumit të trete rajonal për drejtësinë tranzicionale në Beograd, me 11.-12. shkurt 2008. Në www.korekom.org mund të shihen të gjitha dëshmitë.

85 Gordana Đikanović, Shoqata e familjeve të personave të kidnapuar dhe të zhdukur në Kosovë dhe Metohi, revista *Kosmetske žrtve*, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e familjeve të viktimave, Beograd, Serbi, 25. prill 2009. Shtojca I, fq. 92

86 Snežana Zdravković, Shoqata e familjeve të personave të kidnapuar dhe të zhdukur në Kosovë dhe Metohi, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e familjeve të viktimave, Beograd, Serbi, 25. prill 2009. Shtojca I, fq. 92

87 Nenad Popović, Këshilli për nisme qytetare, Serbi, Konsulta me shoqërinë civile, Nish, Serbi, 25. prill 2009. Shtojca I, fq. 98

88 Nedeljko Simić, Këshilli i të rinjve i Srebrenicës, BH, Konsulta lokale me përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe shoqatat e viktimave, Srebrenicë, BH, 26. prill 2009. Shtojca I, fq. 102

89 Izo Rokolj, i kthyer në Trebinje, BH, Konsulta lokale me shoqatat e viktimave dhe të mbajturit në kampe, Trebinje, BH, 27. qershor 2009. Shtojca I, fq. 143

90 Marinko Jurčević, Prokuroria e BH, Forumi i Parë për drejtësi tranzicionale, Sarajeve, BH, 5.-6. maj 2006. Shtojca I, fq. 17

91 Miroslav Alimpić, Gjykata e qarkut Novi Sad, Serbi, Forumi i Tretë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Beograd, Serbi, 11-12. shkurt 2008. Shtojca I, fq. 43

92 Vesna Teršelić, Documenta, Kroaci, Konsulta rajonale me shoqatat e viktimave dhe veterananët, 9. maj 2008. Podgoricë, Mali i Zi, Shtojca I, fq. 49

93 Ibro Bulić, Prokuroria e BeH, Forumi i Tretë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Beograd, Serbi, 11.-12. shkurt 2008. Shtojca I, fq. 43

94 Sonja Radošević, gazetare e pavarur, Mali i Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, 25. tetor 2008. Shtojca I, fq. 68

*këtij komisioni për krimet e luftës dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, është dhuratë nga qielli për viktimat e luftës. Rasti i fundit që të dëgjohet rrëfimi i tyre, të mbeten të shënuara, sepse kur këto oligarkitë kombëtare tona që janë në pushtet e arrijnë marrëveshjen e ndërsjellë, ne askujt më nuk do ti duhemi.*⁸⁹

7. Raporti i gjykimeve për krimet e luftës dhe KOMRA

Pjesëmarrësit e procesit të konsultimeve pa përjashtim konsiderojnë se komisioni (KOMRA) duhet t'i japë mbështetje gjykimeve të krimeve të luftës. Komisioni nuk është zëvendësim për gjyqin dhe nuk i nënshtrohet prokurorisë, dhe ai askënd nuk mund ta gjykojë. Të dy instrumentet, sipas shumicës së pjesëmarrësve, duhet të kenë rolet komplementare. Për kufizimet dhe mangësitë e gjykimeve vërejtje më meritore japin vetë gjykatësit dhe prokurorët. Ata në komisionin për të vërtetën shohin një platformë publike për dëgjimin e zërit të viktimave dhe për ndërtimin e bashkëndjesisë ndërmjet grupeve etnike, çka nuk është detyrë e gjykatave.

*Me rëndësi të jashtëzakonshme është të tregohet se e vërteta e gjyqit i ka kufizimet e caktuar. Duke pas parasysh se vetëm një numër i kufizuar i viktimave merr pjesë në gjykimet për krimet e luftës, një mekanizëm i tillë [komisioni rajonal] do të mund të paraqiste forumin kryesor për viktimat ku ata do të mund të tregonin pësimet e tyre. Komisioni për të vërtetën dhe procedimet penale kështu do të mund të përplotësonin njëri tjetrin.*⁹⁰

*Është fakt se e vërteta e gjyqit është mbase e orientuar për së tepërmi në faktografi dhe nuk ka emocione të mjaftueshme, nuk ka e qasjen emocionale ndaj viktimave. Këto janë disa nga mangësitë e të vërtetës së gjyqit. Nga ana tjetër, këto dëshmi që i kemi dëgjuar para komisioneve për pajtim, janë shumë më të sinqerta. Jam i bindur se ka më pak dëshmitarë që para komisionit nuk e kanë treguar të vërtetën, se sa para gjykatave.*⁹¹

Gjyqet në vendet tona, në Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi dhe në Kosovë, shikuar veç e veç, zhvillojnë 25 deri 30 gjykime [të krimeve të luftës]. Sa janë këto në krahasim me numrin e madh të të vrarëve, të zhdukurve, të torturuarve, të burgosurve dhe të shpërngulurve me dhunë?! (...) Na duhet pra

*një mekanizëm që është komplementar me atë çka po bëjnë gjykatat.*⁹²

Pjesëmarrësit, kryesisht ata nga radhët e prokurorëve dhe gjykatësve, tregojnë se trupi rajonal mund të mbledh dëshmi relevante, duke iniciuar hetime për krime karakteristike, të organizojë dosjet e kriminelëve, dhe kështu të nxitë gjykimet që janë në zhvillim ose të iniciojë proceset e reja:

*Nevoja për formimin e një trupi rajonal që do të punonte në krijimin një ambienti të pajtimit, të një klime ku do të mund të mblidheshin më shumë dëshmi, më shumë dëshmitarë, do të nxit sigurisht edhe gjykimet që janë në procedim e sipër. Nëse kjo nuk ndodh, do të kemi ngadalësimin e gjykimeve dhe shumë pak kriminel do të dënohen, edhe pse janë në pyetje komandantët dhe zyrtarët më të lartë, në postet publike dhe politike. Dhe është e sigurt që trupi rajonal do të sjellë shumë dëshmi që do të ishin ndihmesë për gjykatat, atyre të rregullt që gjykojnë ë krimet, si dhe prokurorëve.*⁹³

8. Arkiva e Hagës

Tribunali i Hagës posedon arkivin më relevant për krimet e luftës të kryera në RFSJ të dikurshme, për urdhërdhënësit dhe autorët e tyre. Shumica e provave mbi të cilat janë mbështetur verdiktet janë në ueb faqen e Tribunalit dhe opinioni ka qasje në to, ndërkaq që arkiva me të cilën disponon Prokuroria e Tribunalit është e mbyllur për publikë dhe pjesërisht është e hapur vetëm për prokuroritë dhe gjykatat kombëtare, kur janë në pyetje dokumentet që kanë të bëjnë me proceset aktuale. Për atë se kur do të vendoset arkiva si dhe procedurën e shfrytëzimit të saj do të vendos Këshilli i Sigurimit të OKB. Pjesëmarrësit e konsultimeve konsiderojnë se arkiva e Hagës paraqet përkrahje më të besueshme për KOMRA-n.

*Arkivi që ekziston në Tribunalin e Hagës, për këtë ka shkruar edhe Carla del Ponte, është me rëndësi që të kihet qasje në materialet e këtij arkivi nga gazetarët, hulumtuesit, madje edhe qytetarët e zakonshëm, të njohin atë dhe të kuptojnë esencën e ngjarjeve në hapësirat tona. Mendoj se ky material do të ishte shumë i mirëseardhur dhe se shënimet që janë aty do të mund ti ndihmonin këtij komisioni.*⁹⁴

Pos kësaj pjesëmarrësit në procesin e konsultimeve konsiderojnë se komisioni rajonal mund të sigurojë dokumente edhe nga burimet tjera, që nuk janë të disponueshme për opinionin.

Konsideroj se vetëm ky komisioni rajonal mundet me i siguru një numër më të madh të dokumenteve për të cilët ne këtu flasim dhe po i kërkojmë, e nuk kemi pas mundësi që ti kemi ato informata dhe ato dokumente.⁹⁵

9. Mediumet

Mediumet u jepet rëndësia e veçantë e partneritetit në fitimin e përkrahjes të opinionit për themelimin e KOMRA. Nga ana tjetër, pjesëmarrësit në konsultimet shtrojnë pyetjen e përgjegjësive së mediave për përhapjen e urrejtjes ndërmjet popujve të RFSJ të dikurshme, si dhe për instrumentalizimin e opinionit në shërbim të politikës që ka prodhuar dhe arsyetuar krimet e luftës.

Gazetarët që kanë marrë pjesë në konsultimet e kanë përkrahur këtë nismë.⁹⁶ Tetë shtëpi mediale nga rajoni deri më sot janë bërë anëtare e koalicionit për KOMRA.⁹⁷

9.1. Sigurimi i përkrahjes së opinionit për themelimin e KOMRA

Opinionit duhet të përgatitet për aktivitetet e komisionit duke i shpjeguar se cilat janë qëllimet e tij,⁹⁸ në mënyrë që opinionit, dhe para së gjithash viktimat dhe anëtarët e familjeve të viktimave, të japin përkrahjen e fuqishme kështu që pushteti në asnjërin nga shtetet të mos e injorojnë ose të bëjnë obstrukcione për komisionin.

Sido që ta merrni, mendoj se kushti që kjo të ketë sukses është që, nëse është e mundshme, të pritet paksa derisa të përgatitet opinionit gradualisht, nëse kjo është fare e mundshme, (...) në mënyrë që pastaj, çka është më e rëndësishme, që nisma të prezantohet mediatikisht në mënyrën e duhur, dhe vetëm atëherë edhe të krijohet komisioni... Pra, jo ndonjë e ngjashme por mu ky komision.⁹⁹

Njëri nga propozimet për ndryshimin e klimës të mohimit të krimeve në Serbi është ndryshimi i ligjit me të cilin do të lejohej që mediat të transmetojnë pamjet nga gjykata.¹⁰⁰ Gazetarët janë të pajtimit që shërbimet publike e kanë obligim

që të informojnë për nismën KOMRA, por edhe përkrahja e mediave lokale dhe të gjitha mediave tjera është shumë e rëndësishme, sikundër që është e domosdoshme që të sigurohet edhe përkrahja e redaktorëve.¹⁰¹ Pjesëmarrësit në konsultimet, si edhe gazetarët, vlerësojnë se mënyra e informimit të opinionit mbi krimet e luftës është e njëanshme, dhe nuk i kontribuon pajtimit në rajon.

Mediat në një pjesë të vendit [në BH] informojnë vetëm për krimet në pjesën tjetër dhe kriminelët dhe vrasësit janë gjithnjë në anën tjetër, andaj konsideroj se është shumë e rëndësishme që të kalohen këta kufijtë, pa marrë parasysh se a janë ato shtetërore apo të entiteteve, të rajoneve, komunale etj.¹⁰²

9.2. Informimi mbi punën e KOMRA-s

Informimi i opinionit për punën e Komisionit rajonal është vendimtar për suksesin e komisionit. Pjesëmarrësit shohin rolin e madh të mediave në trimërimin e viktimave që të dëshmojnë publikisht dhe ndihmojnë komisionin në mbledhjen e shënimeve mbi dëshmitarët dhe autorët e krimeve.

Faktet dhe argumentet ekzistojnë, por ato në njëfarë mënyre vazhdojnë të mbesin në heshtje, assesi nuk arrijnë të dalin. Familjet e viktimave janë determinant kryesore në lidhje me mbledhjen e këtyre fakteve, dhe ata nuk dinë se ky proces po vazhdon, se edhe më tej po zhvillohet. Në njëfarë mënyre, [mundësia] që të flasim hapur dhe të kemi hapësirë për këso debatesh paraqet një hap para, por bashkëpunimi me mediat është njëri nga faktorët kryesor, pasi që familjet konsiderojnë se zëri i tyre ka mbetur vetëm jehonë.¹⁰³

Mediat duhet të plasojnë edhe tregimet pozitive nga lufta pasi që kjo kontribuon në përmirësimin e raporteve në rajon. Që kjo të bëhet e mundshme është e domosdoshme që ato të gjejnë hapësirë në mediat. Njëra prej mënyrave që të dëgjohen më shumë këto tregime pozitive është që të inkuadrohen në dëgjimet publike të viktimave, që duhet të transmetohen në televizionet.

9.3. KOMRA dhe rishqyrtimi i përgjegjësive morale të gazetarëve

Në konsultimet rajonale me gazetarët,¹⁰⁴ pjesa

95 Negovan Mavrić, Shoqata e familjeve të personave të kidnapuar dhe të zhdukur në Kosovë dhe Metohi, zyra në Hoçë të Madhe, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e familjeve të viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, 15. korrik 2008. Shtojca I, fq. 54

96 Deri më sot janë mbajtur një konsultë kombëtare dhe një konsultë rajonale me gazetarët, por përfaqësuesit e mediave kane qenë rregullisht të pranishëm në të gjitha konsultat, si pjesëmarrës dhe si raportues nga tubimet.

97 Dnevnik *Magyar Szó*, gazeta *Republika*, Shoqata e gazetarëve të pavarur të Vojvodinës, TV Kragujevac, Shtëpia botuese *Libertatea* dhe Kikindske novine nga Serbia, Radio Fontana-Istog nga Kosova, i ZaMirNet nga Kroacia.

98 Nazim Maxhuni, student i Fakultetit të shkencave politike, Kosovë, Konsulta kombëtare me studentë, Prishtinë, Kosovë, 15. prill 2009. Shtojca I, fq. 87

99 Dragan Vesić, *Al Kanal*, Serbi, Konsulta lokale me shoqërinë civile, Nish, Serbi, 25. prill 2009. Shtojca I, fq. 98

100 Gordana Petrović, RTS, Konsulta kombëtare me gazetarët, Frushka Gora, Serbi, 11. tetor 2008. Shtojca I, fq. 65

101 Nadira Avdić Vllasi, RTK, Konsulta rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, 29. shtator 2007. Shtojca I, fq. 33

102 Borka Rudić, Shoqata gazetarët e *BeH*, BeH, Forumi i Tretë Rajonal për Drejtësi Transicionale, Beograd, Serbi, 11.-12. shkurt 2008. Shtojca I, fq. 43

103 Florentina Hajdari, studente e Fakultetit të shkencave politike, Kosovë, Konsulta kombëtare me studentë, Prishtinë, Kosovë, 15. prill 2009. Shtojca I, fq. 87

104 29. shtator 2007. Sarajevë, BeH.

105 Hrvoje Zovko, HRT, Konsulta rajonale me gazetarët, Sarajevë, BeH, 29. shtator 2007. Shtojca I, fq. 33

106 Borka Rudić, Shoqata e gazetareve te BeH, BeH, Konsulta rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, 29. shtator 2007. Shtojca I, fq. 33

107 Srđan Vezmar, Program për dialog të rinjve, Serbi, Konsulta Lokale me të rinjtë, Novi Sad, Serbi, 12. qershor 2009. Shtojca I, fq. 137

108 Daliborka Uljarević, Qendra për edukim qytetar, konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18. maj 2009. Shtojca I, fq. 115

109 Marko Veličković, Qendra për zhvillimin e resurseve civile, Serbi, Konsulta rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, 21. tetor 2007. Shtojca I, fq. 36

110 Marina Škrabalo, Qendra për studime paqësore, Kroaci, Konsulta kombëtare me të rinjtë, Zagreb, Kroaci, 20. maj 2007. Shtojca I, fq. 31

dërmuese e pjesëmarrësve ka shprehur dyshim të madh në mundësinë e ndjekjes gjyqësore të gazetarëve që janë marrë me gazetari luftënxitëse, edhe pse për këtë ekziston nevoja e madhe

Sa i përket dënimit të gazetarëve për propagandë luftënxitëse, është iluzore të pritët që kjo do të ndodhë. Nëse kjo nuk ka ndodhur në 15 vitet e fundit, atëherë më parë do të përgjigjet gjenerali Velko Kadijeviq për Vukovarin, sesa gazetari.¹⁰⁵

Është shprehur qëndrimi se shoqatat e gazetarëve do të mund të «qëronin hesapet me anëtarët e tyre që kanë përhapur propagandën luftënxitëse».¹⁰⁶ Dy vjet më vonë në konsultimet dëgjohen mendimet tjera, dhe njëri nga qëndrimet është se KOMRA duhet të merret me gazetarët që kanë marrë pjesë në propagandën e luftës,¹⁰⁷ dhe se mu për shkak për rolin të cilin e kishin pranuar ta luajnë gjatë viteve '90, mediat sot kanë përgjegjësi në procesin e shëndoshjes së shoqërisë.

Televizioni bart përgjegjësi të veçanta. Ai ka ndikuar shumë në atë çka dikush e quajti fashistizim i shoqërisë malazeze në vitet e nëntëdhjeta, dhe ajo tani duhet të bartë barrën e veçantë në procesin e defashistizimit, përkatësisht në vendosjen e disa normave evropiane.¹⁰⁸

10. Vrojtime përmyllëse

Rrjedha e deritanishme e procesit të konsultimeve tregon se pjesa dërmuese e pjesëmarrësve përkrahë qasjen rajonale në kërkimin e fakteve dhe për themelimin e KOMRA-s. Që nga maji i vitit 2008, kur në konsultimet nisi debati për KOMRA, është arritur përparim cilësor në debatin: pjesëmarrësit lirshëm dhe me interesim të madh shfaqin mendimet, propozimet dhe rekomandimet e tyre mbi mandatin dhe aktivitetet e komisionit. Në rastet kur mendimet janë të kundërta, debati zhvillohet në atmosferë të qetë, ku kujdesshëm përcillen mendimet e tjerëve. Pjesëmarrësit tregojnë se duke i falënderuar debatin rajonal janë mësuar që

të dëgjojnë njëri tjetrin dhe janë bindur se edhe këta të tjerët kanë qenë të ekspozuar vuajtjeve dhe pësimeve të mëdha.

Shoqatat e viktimeve janë tejet aktive në proceset e konsultimeve, duke përfshirë edhe ato që ende nuk janë pjesë e Koalicionit për KOMRA, por rregullisht marrin pjesë në debatet. Të gjithë pajtohen se prioriteti është gjetja e kufomave të të zhdukurve.

Befasi të madhe paraqesin të rinjtë. Të rinjtë që kanë marrë pjesë në konsultimet e deritanishme, pa marrë parasysh se nga i cili shtet vijnë, kanë argumentuar për krijimin e Komisionit rajonal dhe kërkimin e fakteve për krimet e luftës. Mbresëlënëse është se konsiderojnë se edhe atyre i takon përgjegjësia për trashëgiminë e së kaluarës.

A është paqja e qëndrueshme dhe e përhershme, lidhet para së gjithash me raportin ndaj të së vërtetës, dhe në këtë kuptim për të rinjtë është posaçërisht e rëndësishme që të pranojnë këtë përgjegjësi, sepse deshën apo jo, ata e kanë këtë përgjegjësi. Nuk e kanë ndoshta për atë çka është bërë, por e kanë raportin ndaj asaj që ka ndodh. Ne tani nuk jemi më minorë dhe jetojmë në mjedisin që ende nuk është ballafaquar me të kaluarën, dhe në këtë kuptim kemi përgjegjësi.¹⁰⁹

Të rinjtë nuk kanë përgjegjësi për pësimet e luftës që i kanë përjetuar qindra mijëra njerëz gjatë viteve të nëntëdhjeta në shtetet post-jugosllave, dhe na duhet në njëfarë mënyre bisedë e hapur mbi atë se cilët kanë qenë motivet reale, të vërteta, që të marrin përsipër dhe të zgjedhin përgjegjësinë e ballafaqimit me të kaluarën për të cilën ata nuk janë përgjegjës.¹¹⁰

Shfaqet nevoja që në procesin e konsultimeve të futen edhe bashkësitë fetare dhe partitë politike. Sa i përket veteranëve, shumë pjesëmarrës konsiderojnë që participimi i tyre është i rëndësishëm, por ka edhe të tillë që mendojnë se ata mund të marrin pjesë në debate, por jo edhe në punën e KOMRA.

Shtojca I

Procesi i konsultimeve mbi mekanizmat për zbardhjen dhe tregimin e fakteve mbi krimet e luftës dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut në vendet post-jugosllave

maj 2006 – qershor 2009

Pasqyre e mendimeve, propozimeve dhe rekomandimeve

1. Forumi i Parë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale: Nismat dhe perspektivat në Ballkanin Perëndimor

Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë
5-6 maj 2006

Forumit e Parë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, kushtuar nismave dhe perspektivave për zbardhjen e të vërtetës mbi të kaluarën, e kanë organizuar Qendra Kërkimore-Dokumentuese (BH), Fondi për të drejtën humanitare (Serbi) dhe Documenta (Kroaci), nënshkruesit e Protokollit mbi bashkëpunimin në dokumentimin e krimeve të luftës dhe kundër mos dënimit (prill 2004). Në punën e Forumit kanë marrë pjesë rreth 300 përfaqësues të organizatave për të drejtat e njeriut dhe të shoqatave të viktimave nga rajoni, të Gjykatës dhe Prokurorisë së BH, të kryesisë së BH, Zyrës së Përfaqësuesit të Lartë në BH, të OSBE-së – Misioni në BH, ekspertët ndërkombëtarë për të drejtën

tranzicionale, përfaqësuesit e Tribunalit të Hagës, si dhe anëtarët e Grupit punues të partive politike parlamentare të BH i cili në bashkëpunim me Institutin amerikan të paqes, përgatit propozimin e projektligjit për themelimin e Komisionit kombëtar për kërkimin e të vërtetës dhe të pajtimit BH.

Pjesëmarrësit i japin përkrahje të plotë gjykimave para Tribunalit të Hagës dhe në gjykatat kombëtare, por janë të vetëdijshëm se këto gjykime nuk janë të mjaftueshme që të përcaktohet e vërteta mbi të kaluarën e afërt, të sigurohet drejtësia për viktimat dhe të pengohet përsëritja e dhunës.

Sendi i parë... që na duhet, sepse do të na duhet për shumë vite, është drejtësia e verifikuar gjyqësore. (Mirsad Tokača, Qendra Kërkimore-Dokumentuese, BH, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Trajtimi gjyqësor është shumë i rëndësishëm dhe mirë është që edhe në rastin tonë, rastin e ish Jugo-

sllavisë, e kemi ad hoc Tribunalin penal për ish Jugosllavi dhe se kanë filluar gjithkund edhe gjykimet kombëtare për krimet e luftës. (...) Por, po kështu, mendoj se të gjithë e kemi të qartë se nuk ka gjykata të tilla që do të arrijnë t'i nxjerrin para drejtësisë të gjithë ata të cilët kanë komanduar,, planifikuar, bërë marrëveshje, sikur edhe ata që kanë marrë pjesë në krimet e luftës. Kjo do të thotë se duhet të mendojmë edhe për instrumente tjera që mund të ndihmojnë që të përcaktohet, zbulohet dhe zbardhet e vërteta, gjithashtu edhe të tregohet ajo gjë që do të jetë ndihmesë në tejkalimin e pasojave të tmerrshme që na kanë imponuar institucionet, të udhëhequra me politikën e pushtimit të territoreve. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Për mua si njeri i drejtësisë që jam, drejtësia do të ishte nëse BH do të kishte mundësi që të kap njeriun ose grupin që i kanë ekzekutuar të afërmit e mi dhe t'i pyes pse e kanë bërë këtë. A i kanë njohur këta njerëz fare anëtarët e familjes time të afërt? Cila ka qenë arsyeja që i kanë vvarë në mënyrë më katile dhe i kanë varrosur diku ku, të themi ashtu, kurrë nuk do të mund ti gjejmë. Kjo do të ishte për mua Drejtësia. (Amir Kulagić, Shoqata Gratë e Srebrenicës, BH, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Dhe përderisa gjykatat paraqesin mënyrën formale të përcaktimit të të vërtetës dhe kërkimit të drejtësisë, përgjegjësia për ngjarjet e të kaluarës mund të përcaktohet edhe me instrumente tjera, siç është Komisioni për të vërtetën. Vendimi për themelimin e një Komisioni të tillë duhet të bazohet në një proces gjithëpërfshirës konsultativ, në mënyrë që të kuptohet nëse këtë e duan viktimat, por edhe çka mendon për këtë opinionin i gjerë. (James Rodehaver, drejtor i Departamentit për të drejtat e njeriut i misionit të OSBE-së në BH, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Të gjitha krimet më serioze dhe më të mëdha, që shumica e njerëzve në ish Jugosllavi dhe në bashkësinë ndërkombëtare i sheh si ngjarje tejet tragjike, janë hulumtuar, hetuar dhe procesuar në Tribunalin e Hagës, dhe tani disa po dërgohen edhe në gjykata vendore. Mirëpo, unë natyrisht dyshoj se jemi afër numrit përfshirës të krimeve të veçanta, madje nuk i kemi zgjidhur as të gjitha rastet serioze (...) Megjithatë, përkundër të gjitha përpjekjeve dhe proceseve gjyqësore, të gjitha aktiviteteteve outre-

ach dhe konferencave, më duket se nuk është bërë mjaftueshëm. Këtë e shoh nga ankesat e shumta, letrat dhe deklaratat e grupeve dhe shoqatave të viktimave. Nevojiten mekanizmat shtesë që t'i dilet përpara nevojave të tyre. Gjithsesi, me këtë nuk mendoj se këto mekanizma duhet të zëvendësojnë procesin gjyqësor, por vetëm ta plotësojnë atë. (Carla del Ponte, kryeprokurore e Tribunalit të Hagës, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Organet e gjyqësisë nuk guxojnë të veprojnë të izoluar. Nuk mundet vetëm tek ato të bartet barra e rëndë e të kaluarës tonë të përbashkët të errët dhe nuk mund të pritet që gjykatat dhe prokuroritë në Bosnje dhe Hercegovinë, të na zgjidhin traumat e shoqërisë pas-konfliktit, çfarë e kemi sot. (...) Është jashtëzakonisht e rëndësishme të thuhet se e vërteta gjyqësore i ka kufizimet e caktuara. Duke pas parasysh se vetëm një numër i kufizuar i viktimave do të marrë pjesë në gjykimet e krimeve të luftës, një mekanizëm i tillë [Komisioni] do të mund të paraqiste forumin kryesor për viktimit, ku ato do të mund të flisnin për pësimet e veta. Komisioni për të vërtetën dhe procedurat penale do të mund të plotësonin njëri tjetrin. (Marinko Jurčević, kryeprokurore, Prokuroria e BH, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Gjykatat janë të detyruara të kujdesen për personat që kanë përjetuar format më të këqija të keqtrajtimin psikik dhe fizik, njerëz të dhunuar, të torturuar, të poshtëruar, të lënduar. Gjykata nuk mundet me ua lehtësua dhimbjet e tyre e as të bëjë që të zhduken traumat e tyre, por gjykata mundet me i ndihmuar që më në fund të fillojnë të ndihen si anëtarë të sigurt dhe të dobishëm të shoqërisë. Komisionin për të vërtetën, për zbardhjen e të vërtetës së gjithmbarshme, unë e përsërit dhe është një gjë shumë e mirë. Por kjo duhet të bëhet me kushtin që kjo zbardhje të jetë komplementare me proceset gjyqësore që po zhvillohen, si një gjykatën penale ndërkombëtare për ish Jugosllavinë, në Gjykatën e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe në gjykatat e vendeve fqinje të Republikës së Kroacisë, Serbisë dhe Malit të Zi. (Medžida Kreso, Kryetare e Gjyqit të Bosnjës dhe Hercegovinës, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Me individualizimin e krimeve të bëra, do të dalë në shesh e vërteta, madje edhe fakti se krimet janë bërë më pak nga njëra palë, por kjo nuk ka peshë përballë faktit se krimet megjithatë janë bërë, madje

edhe nëse i ka bërë pala që vetën e konsideron në përgjithësi të pafajshme. Mendoj se deri te e vërteta e tillë mund të arrihet vetëm përmes drejtësisë që realizohet nëpërmjet proceseve gjyqësore, qoftë atyre vendore, qoftë të gjykatës ndërkombëtare. Kjo e vërtetë duhet të dalë nga dëshmitarët, nga viktimat, nga familjet, ose ata që kanë mbijetuar represionin dhe krimet. (Vjosa Dobruna, RTK, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Është i nevojshëm debati dhe konsultat e gjera mbi mënyrat dhe nismat për zbardhjen e të vërtetës, që do të zhvilloheshin në suazat e shoqërisë civile, parlamentit dhe institucioneve tjera.

Ne kemi nevojë për debat në nivelin e shoqërisë mbi nevojën e formimit të Komisionit, e pastaj edhe për debat mbi modalitetet, mbi modelet e ndryshme. (Refik Hodžić, Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish Jugosllavi, TNPJ, Programi Outreach, Zyra në BH, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Trupi i tillë [Komisioni] mund të ketë rol pozitiv në BH dhe nëse ai do të vendosej përmes procesit konsultativ, i cili do të mundësojë që atë ta formësojnë vetë qytetarët e Bosnjës dhe Hercegovinës, ky trup do të mund të hartonte një raport më komplet për konfliktin, një analizë më të gjerë, çka nuk mund të arrihet në proceset penale. (Marinko Jurčević, Kryeprokuror i Prokurorisë së BH, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Cila është rëndësia reale e procesit të konsultave? Mendoj se ekzistojnë dy pjesë të rëndësishme. Së pari është përkrahja e opinionit. Një institucion i tillë [Komisioni] nuk është i qëndrueshëm nëse nuk e ka përkrahjen e opinionit sepse ai edhe ushqehet me deklaratat që i merr nga qytetaria. E dyta, po punohet në hartimin e draftit të ligjit në bazë të informatave, çka kuptohet, mund të bëhet edhe në bazë të përvojës të vendeve tjera, por ne po kështu e dimë se kur bëhet fjalë për Komisionet për të vërtetën, nuk ka modele universale që mund të aplikohen në vendet e ndryshme. Andaj, sa më shumë konsulta që bëhen, do të fitohet ndjesia më e mirë çka në të vërtetë opinioni pret nga ky institucion, dhe kjo do të mundësojë Kuvendit që të aprovoj ligjin që i përshtatet Bosnjës dhe Hercegovinës. (Stefan Priesner, zëvendës i përfaqësuesit rezident i UNDP-së për Bosnje dhe Hercegovinë, Forumi i

Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Për mua është, pra, kjo dilemë – a duhet të bëhet drafti dhe pastaj të shkohet në debat publik parlamentar apo të shkohet në debat publik me gjendjen çfarë e kemi, dhe pastaj të hartohet drafti, të shkohet në Parlament dhe pas kësaj në debat publik parlamentar. Për mua është kjo çështje kyçe. (Šefik Džaferović, zëvendësi i parë i kryesuesit të Dhomës së Përfaqësuesve të Kuvendit Parlamentar të Bosnjës dhe Hercegovinës, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Nevoja ekzistenciale e familjeve të të zhdukurve është gjetja e kufomave, varrimi i tyre sipas zakoneve dhe vizita e papenguar me zëre [varrezave].

Kur unë sot shkoj në Potoçare, ndihem sikur... s'di, sikur i shkoj atij mysafirë. Mendoj, kjo nuk mund të shpjegohet. Kjo nuk mund ti thuhet askujt. Por, më vjen mirë që di ku e ka varrin. Që nuk është askund, çka di... nuk ia kanë shpërndarë kufomën në të gjitha anët, ose nuk ka përfunduar në ndonjë lum, ose diçka e ngjashme... Më vjen mirë që edhe sot mund të shkoj në Srebrenicë kur të dua, dhe mund të vizitoj mezarin e tij, t'ia porosisë fatihun, të kujtohem disa gjëra, të përlohem aty dhe t'i tregoj të gjitha atij. (Adisa Tihic nga Skelani, BH, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Për mua do të ishte e vërteta nëse dikush do të më tregonte ku i ka varrë të gjithë anëtarët të mi të vdekur, meshkujt e familjes time, që të mund ti marrë kufomat e tyre, ti varros në mënyrë dinjitoze në një hapësirë, dhe që edhe unë si zonjusha Tihic, ta kam vendin ku mund të shkoj dhe të porosisë fatihën dhe, hajde të themi, për një moment të jam me shpirtrat e atyre të afërmve Kjo është e vërteta për ne. (Amir Kulaglic, Shoqata Gratë e Srebrenicës, BH, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Kur vij atje, shihem me njërin, me një fqj, dhe ai më pyet: "Hajt, ma trego të vërtetën, ashtu si i thotë njeriu njeriut". Kjo do të thotë, hajde t'i harrojmë të gjitha, nëse mund të harrohet ajo çka ka ndodhur, dhe andaj unë i them: "Ma jep vetëm informatën që ta gjej, ta varros, dhe ta mbyll kështu një kapitull të jetës sime"... Dhe kjo do të thotë të mund të shkoj në

varrezat dhe fëmijëve të mi të mund t'i them se kush ka qenë gjyshi i tyre... Do të doja të dihet e vërteta dhe të zbulohen të gjithë të zhdukurit, nuk është me rëndësi a janë serbë, kroatë apo boshnjakë, të gjithë të zhdukurit duhet të gjenden, të varrosën dhe të vihet një herë e përgjithmonë pika në i, të bëhet një e vërtetë e plotë, të thuhet se kush, ku dhe si i ka bërë gjërat. (Slavoljub Pejić nga Vozučë, BH, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Mua do të më vinte mirë të më vije fqiu, nuk është me rëndësi kush, p.sh. Ramo, Ibro, Muhamedi dhe të më thotë: «Zonja Mira, këtu janë burri dhe djali juaj. Unë e di, jam e sigurt se janë aty. Ua bëni varrimin në mënyrë dinjitoze.» Unë do të isha mirënjohëse për tërë jetën. Plagët e mia do të shëroheshin bukur shumë. Do ta kisha ndërgjegjen e pastër. Nuk do të shkoja në Bikoše, te murri, t'ia lehtësoj vetes, por do të dija ku prehen dhe si qëndrojnë gjërat tjera.. (Mira Janković nga Bikoša, BH, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Përfaqësuesit e Kuvendit të BH përkrahin themelimin e Komisionit kombëtar për të vërtetën dhe pajtimin në BH.

Të vërtetën për atë se çka ka ngjarë në Bosnje dhe Hercegovinë në periudhën nga viti 1992 deri më 1995 po e shkruan Tribunali i Hagës, Gjyqi i Drejtësisë Ndërkombëtare në Hagë, e shkruan edhe Gjykata Bosnjës dhe Hercegovinës, e shkruajnë gjykatat anembanë Bosnjës dhe Hercegovinës, por është krejtësisht e sigurt se kjo nuk do të përfshijë të gjitha ngjarjet, nuk do të përfshijë të gjitha faktet dhe është më se domosdoshme që në Bosnje dhe Hercegovinë duhet të nisët edhe një proces tjetër; në mënyrë që të zbardhet e vërteta e plotë për të gjitha çka kanë ndodhur në Bosnje dhe Hercegovinë në mënyrë që të kemi ballafaqimin me të vërtetën e plotë. (Šefik Džaferović, zëvendësi i parë i kryesuesit të Dhomës së Përfaqësuesve të Kuvendit parlamentar të Bosnjës dhe Hercegovinës, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Personalisht mendoj se na duhet procesi i zbardhjes të së vërtetës dhe për këtë nuk janë të mjaftueshëm vetëm organet gjyqësore, edhe pse janë vendimtarë dhe më të rëndësishëm për drejtësinë. Për këtë më kanë bindur edhe më shumë mendimet e përfaqësuesve të prokurorisë dhe të gjykatave, si dhe të Qendrës Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale, të cilët në

fjalët e tyre thanë qartë se për zbardhjen e të vërtetës dhe shëndoshjen e shoqërisë pos proceseve gjyqësore janë të nevojshëm edhe mekanizmat shtesë. (Besima Borić, përfaqësuese e Partisë Social-Demokratike (SDP) në Kuvendin e BH, anëtare e Grupit punues për hartimin e ligjit mbi themelimin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Pjesëmarrësit ftojnë parlamentet e shteteve suksesore të ish RSFJ që të iniciojnë debatin mbi instrumentet e ballafaqimit me të kaluarën, të aprovojnë programin dhe përcaktojnë strategjinë e vendosjes së drejtësisë.

Ne duhet të konceptojmë strategjinë e këtij shteti – çka duhet bërë, në ç'mënyrë duhet të vijmë deri te e vërteta e njëmendtë. (Jasminka Džumhur, Zyra e Komisarit të Lartë për të Drejtat e Njeriut, BH, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Në debat është theksuar rëndësia e qasjes rajonale në zbardhjen e së vërtetës dhe nevoja për forcimin e bashkëpunimit rajonal në procesimin e krimeve të luftës.

Si është e mundshme, p.sh., që të tregohen në Kroaci (...) ngjarjet lidhur me aksionin ushtarak «Oluja» («Stuhia») në rrethanat kur një pjesë e atyre që kanë ikur, sot nuk jetojnë më në Kroaci. Edhe për zbardhjen e së vërtetës për disa ngjarje ku është e nevojshme që të dëgjohen zërat e njerëzve nga anët e ndryshme, të viktimit nga anët e ndryshme të luftës, që sot ndoshta nuk janë në një vend, por jetojnë në shumë vende, është me rëndësi të mendohet për mekanizmat e tregimit të së vërtetës në nivelin rajonal. (Vesna Teršelić, Documenta, Kroaci, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Rastet e shumta tregojnë se, në të vërtetë, pjesëmarrja në planifikimin dhe marrëveshjet, e edhe në realizimin e drejtpërdrejtë të krimeve është aq transparente, gjë që shihet dhe është e provuar në verdiktet e shumta të Hagës, sa që është krejtësisht evidente se e vërteta nuk mund të zbardhet pa këtë faktin e pjesëmarrjes dhe raportit të drejtpërdrejtë, ose zbardhjen e të gjitha atyre gjërave që kanë ardhur nga Serbia, e në disa raste edhe nga Kroacia. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Është nevojë e domosdoshme bashkëpunimi rajonal në hulumtimin e pasojave të luftës në territorin e ish Jugosllavisë së dytë. Në këtë aspekt e kuptoj edhe nevojën e këtyre tubimeve, në mënyrë që të mënjanohej keqpërdorimet e serishme të hulumtimeve të humbjeve në njerëz, duke vendosur kriteret paraprake, bazat e përbashkëta, metodologjinë dhe teknikën e hulumtimit të njëjtë, sikundër edhe këmbimin e informatave për këtë, me qëllimin e fundit të një hulumtimi të përbashkët rezultatet e të cilit nuk do të mund të shfrytëzoheshin për çfarëdo lloji të manipulimeve me viktimat dhe të dëmtuarit. (Igor Graovac, Instituti Kroat për Histori, Kroaci, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Dhe për shkak se nuk ka pas bashkëpunim të tillë, ne nuk i dimë shumë gjëra që do të duhej të ishin fakte elementare. Çka do të dinim ne për deportimin e refugjatëve boshnjak, që janë vendosur në Malin e Zi? Çka do të dinim pa qasjen rajonale për ata 30 veta të vrarë, refugjatë nga Kosova, të cilët ushtria i ekzekutoj në Mal të Zi? Çka do të dinim për një dramë të tërë të spastrimit etnik të një pjese të Malit të Zi, të Bukovicës. (Esad Kočan, Monitor, Mali i Zi, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Pjesëmarrësit kanë kërkuar nga organizatorët e Forumit (FDH, QKD dhe Documenta) që të vazhdojnë me konsultat dhe nismat rajonale mbi perspektivat e zbardhjes të së vërtetës duke i kyçur në debat edhe shoqatat e viktimave, veteranët, të refugjatët dhe personat e zhvendosur, gazetarët, artistët, shkrimtarët, historianët, ekspertët dhe përfaqësuesit e partive politike dhe të institucioneve.

Duhet të kultivojmë këtë forum si një trup për konsulta në lidhje me modelet, strategjinë dhe mënyrat ose mekanizmat e zbardhjes të së vërtetës mbi të kaluarën, që ka të bëjë me të gjithë ne. (Vesna Teršelić, Documenta, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

Duhet të organizohet forumi në të cilin qëndrimet e tyre do të paraqitnin viktimat duke e marrë njëllor praninë të së vërtetës dhe nëse e fitojnë këtë edhe kjo është po kështu, formë e drejtësisë për viktimat, • Mendimi im është se me3 sigurimin e këtij forumi i japim legjitimitet viktimave dhe të drejtës së tyre që të tregojnë përvojën dhe qëndrimet e tyre. Dhe kjo është formë e drejtësisë dhe kjo drejtësi sjell shërim dhe

andaj jam përkrahëse e mbajtjes te këtyre forumeve. (Vjosa Dobruna, RTK, Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Sarajevë, BH, 5-6 maj 2006)

2. Konsultat rajonale me artistët mbi trashëgiminë e së kaluarës

**Beograd, Serbi
Më 6 dhjetor 2006**

Konsultat janë organizuar nga Fondi për të Drejtën Humanitare, regjisori i teatrit dhe profesor në Akademinë e arteve skenike në Sarajevë, BH, Haris Pašović dhe Nenad Prokić, shkrimtar dramash dhe profesor në Fakultetin e arteve dramatike në Beograd, Serbi. Pjesëmarrësit (27) kanë qenë regjisorët, shkrimtarët, aktorët, disenjatorët, dhe një valltare/koreografe nga Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Sllovenia dhe nga Kosova. Fjalën hyrëse e mbajtën Haris Pašović, Nenad Prokić dhe Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi). Për tubimin kanë informuar gazeta «Danas», «Mreža», B92 dhe SEE Cult.

Artistët kanë përgjegjësi ndaj fakteve, ndaj vetes dhe opinionit

Unë mendoj se detyra jonë është që të flasim të vërtetën dhe këtë e pret prej nesh shoqëria edhe kur me këtë të vërtetë nuk pajtohet. (Haris Pašović, regjisor i teatrit nga BH, Konsultat rajonale me artistë, Beograd, Serbi, më 16 dhjetor 2006.)

Ekzistojnë faktet. Për to nuk debatohet. Këtu hapet hapësira e gjerë dhe esenciale e përgjegjësisë. Zbulimi, zbardhja dhe respekti ndaj fakteve është punë serioze dhe për lëvdatë, para së gjithash për shkencën, për hulumtuesit. Artistëve dhe filozofëve i mbetet përgjegjësia tjetër, jo më pak e rëndësishme të bazuar në faktet: zbardhja dhe demaskimi i marifetit dhe mashtrimit. Mua më duket se artisti sipas definicionit është ai që denoncon dhe është mirë që se secili që do me u marrë me artin e angazhuar të pranojë këtë fakt mbi veten dhe punën e tij (Lazar Stojanović, regjisor filmi nga Serbia, Konsultat rajonale me artistë, Beograd, Serbi, më 16 dhjetor 2006.)

Pra, ne mund të rinovojmë fasadën e godinës, mund të ndërtojmë autostrada, ne mund të heqim pasaportat njëri tjetrit etj, por deri sa nuk i rrënojmë këto bllokada mentale, derisa nuk i spastrojmë

dhe mes nesh nuk tregojmë se çka i kemi bërë njëri tjetrit, çfarë kemi punuar, ku e kemi lënduar njëri tjetrin, deri në atë moment ardhmëria nuk është e mundshme. Dhe unë konsideroj se përgjegjësia artistike është para së gjithash në një trimëri artistike të ballafaqimit me të vërtetën, në konfrontimin me atë të kaluarën dhe jo në ikjen nga e kaluara. (Dino Mustafić, regjisor teatri nga BH, Konsultat rajonale me artistë, Beograd, Serbi, më 16 dhjetor 2006.)

Kur flasim për përgjegjësinë e artistit, është çështje në vete për çfarë përgjegjësie flasim. Ndaj kujt është artisti përgjegjës? Unë mendoj se është përgjegjës para së gjithash ndaj vetvetes, e pastaj nëse shikojmë pak më gjerë, pasi që është personalitet publik, është përgjegjës edhe ndaj opinionit, me atë çka bëjnë dhe çka flet. (Filip David, shkrimtar nga Serbia, Konsultat rajonale me artistë, Beograd, Serbi, më 16 dhjetor 2006.)

Artistët nga ish Jugosllavia krijojnë në kontekstin e varrezave masive dhe krimeve të luftës

Në krijojmë në një kontekst në të cilin krimi i luftës është pjesë e përditshmërisë sonë, ku varrezat masive dhe zbulimi i varrezave të reja masive është lajm i përditshëm në televizionet tona, në gazetat. Ne që i kemi mbi 40 vjet e mbajmë në mend një hapësirë kulturore në të cilën kemi jetuar dhe punuar, të cilës ia kemi ditë përparësitë dhe problemet, dhe me të cilin kemi dalë në krye disi, duke qenë shpesh edhe të lumtur në atë hapësirë kulturore. Kemi qenë edhe të palumtur. Ka pas njerëz që kanë qenë nën represion tepër, tepër të madh. (Haris Pašović, regjisor i teatrit nga BH, Konsultat rajonale me artistë, Beograd, Serbi, më 16 dhjetor 2006.)

Mendoj se do të ndodhin shumë gjëra pozitive, pa asnjë shtyrje, nëse ato ekzistojnë natyrshëm. Sepse unë jam artist vetëm përmes veprimtarisë sime dhe madje kam mjaftë vështirësi që të eksplikoj teorikisht edhe gjërat shumë të thjeshta, nëse nuk i realizoj në praktikë. Pra, nevoja ime praktike artistike, si edhe të kolegëve të mi, mund të ringjallë atë hapësirë kulturore. (Pjer Žalica, regjisor filmi nga BH, Konsultat rajonale me artistë, Beograd, Serbi, më 16 dhjetor 2006.)

Për shembull, kur ne shohim nga Bosnja, ndonjëherë e kemi më larg Banja Llukën, fatkeqësisht, sesa Nju Jorku. Beogradi ka qenë shumë, shumë më larg në këto vite, sesa Londra apo Nju Jorku. Tani kjo është zvogëluar. Gjërat megjithatë janë rregulluar, ja ku

jemi, po vijmë, po vizitohemi. (Haris Pašović, regjisor teatri nga BH, Konsultat rajonale me artistë, Beograd, Serbi, më 16 dhjetor 2006.)

Ka ardhur teatri Atelie 212 [nga Beogradi] me tekstin «Art» të Jasmina Rezes. Mund ta paramendoni ironinë. Turneu i parë, teksti i Jasmina Rezes «Art» vjen me ndërmjetësimin e ambasadës së Zvicrës, Tek zjarri i amshuar, afër rrugës së Titos, kanë qenë dy tanke, si sigurim për artistët e Ateliesë 212 që kanë performuar këtë pjesë në Sarajevë. Në këtë performansë kanë qenë shumë pak kolegë të teatrit, nga Sarajeva. Në njëfarë mënyre ne e patëm injoruar këtë. Unë kam qenë kundërshtar i madh i ardhjes dhe nuk e kam konsideruar si ardhje të Ateliesë 212, sepse ka ndodhur mu me atë diktat politik që atëbotë vinte nga bashkësia ndërkom-bëtare. (Dino Mustafić, regjisor teatri nga BH, Konsultat rajonale me artistë, Beograd, Serbi, më 16 dhjetor 2006.)

Rikonstruktimi i hapësirës lokale dhe rajonale në planin kulturor është diçka e pashmangshme nga arsyeja se mjediset lokale, qoftë ajo e Zagrebit, qoftë e Sarajevës, Beogradit ose ndonjë tjetër, thjesht nuk janë të madhësisë së mjaftueshme për realizimin e prodhimit kulturor më intensivë. (Maroje Mrduljaš, artist vizual nga Kroacia, Konsultat rajonale me artistë, Beograd, Serbi, më 16 dhjetor 2006.)

I takoj atyre njerëzve që pranojnë se më ka ardhur shumë keq shkatërrimi i një hapësire kulturore në suazat e të cilit merrnim përshtypje dhe impulse shumë të çmueshme për njëri tjetrin. Unë e kisha të vogël edhe atë shtet të mëparshëm e mos të flas për këtë të cilin mund ta kaloj për disa orë me ndonjë automjet të vjetër. Unë jam adaptuar në mënyrën time, sikundër edhe ju në mënyrën tuaj. Shpresoj se nuk jam shkatërruar, dhe unë tash hap debatin për atë hapësirë, për atë çka ka ndodhur, për ne, për përgjegjësinë tonë njerëzore dhe artistike; shpresoj jo aq në atë çka ka kaluar, se në këtë që kemi sot dhe atë që vjen, sepse nëse kemi dështuar si njerëz ose kemi qenë thjeshtë të pafuqishëm, çfarë është tani përgjegjësia jonë para asaj që po vjen? (Nenad Prokić, profesor në Fakultetin e arteve dramatike, Serbi, Konsultat rajonale me artistë, Beograd, Serbi, më 16 dhjetor 2006.)

Përvoja ima personale është se e kam pas më lehtë të veproj më parë, gjatë luftës, sepse disa gjëra ishin shumë më të qarta dhe gjithçka kishte edhe ngjyrat më të përndezura. Kam pas një ndjenje të misionit

në atë çka kam punuar. (Pjer Žalica, regjisor filmi nga BH, Konsultat rajonale me artistë, Beograd, Serbi, më 16 dhjetor 2006.)

Artistëve të ri në Kroaci i duhet hapësira kulturore e cila respekton nevojat e tyre.

A do të shpenzoj unë tash gjithë energjinë në mënyrën që bëj një reagim ndaj të kaluarës dhe gjithë atë trashëgimi politike, apo në zhvillimin e vallëzimit modern në Kroaci dhe në rajon dhe të veprave që gjithçka të shkoj në këtë drejtim, që të ndërtohen qendrat e baletit, që të lëvizim drejt një ardhmëria çfarëdo që është ajo, e cila do t'i jepte njeriut të ri për ndonjë reagim ndaj të kaluarës. (...) ne duhet sot të reflektojmë trashëgiminë e së kaluarës, e as nuk kemi ardhmëri. Mendoj se mu kjo duhet të jetë tema e parë në listën tonë. (Tamara Curić, valltare, koreografe dhe pedagoge e vallëzimit modern nga Kroacia, Konsultat rajonale me artistë, Beograd, Serbi, më 16 dhjetor 2006.)

Artistët e kanë rolin e tyre në ndërtimin e memories historike që do të garantojë se varrezat masive nuk do të përsëriten më.

Çka nëse na ndodh që në krijimin e memories historike më së shumti do të marrin pjesë elitat politike që në pjesën më të madhe edhe janë përgjegjëse për trashëgiminë që kemi, duke inkuadruar ata që merren me shkrime, interpretime dhe analiza të trashëgimisë në mënyrën që e arsyejnë dhe në të vërtetë e mbrojnë atë trashëgimi; çka do të ndodh nëse ata në krejt këtë do të mbisundojnë dhe a ka mekanizma dhe mënyra që kësaj t'i kundërvihen të gjithë ata, duke përfshirë edhe artistët, që do të krijojnë memorien historike e cila do të bëhet garant se varrezat masive nuk do të përsëriten më. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultat rajonale me artistë, Beograd, Serbi, më 16 dhjetor 2006.)

Personalisht mendoj se e vërteta artistike mund të ndihmojë shumë në krijimin e kujtesës historike që do të mbetet nesër si e vërteta e njëmendtë për vajzën time që sot i ka dy vjet dhe për këtë e kam shumë për zemër që të ndikojë sa më shumë që mundem. (Duško Mazalica, aktor nga BH, Konsultat rajonale me artistë, Beograd, Serbi, më 16 dhjetor 2006.)
Mos më keqkuptoni, por kam frikë se këtu e vetmja trashëgimi thelbësore e së kaluarës do të jetë reparacioni i luftës. Kompensimi për dëmet e luftës mund të ndikojë direkt në industri, industrinë e artit dhe

produksionin në vendin tim. Krejt këto që flasim për të vdekurit, për ligjin, për drejtësinë, për çfarë janë këto? Mendoj, nuk dua të banalizoj, por në fund të fundit, krejt kjo reduktohet në kompensim të dëmeve të luftës dhe ndoshta jemi afër njëfarë drejtësie. (Damir Nikšić, regjisor nga BH, Konsultat rajonale me artistë, Beograd, Serbi, më 16 dhjetor 2006.)

Trupi rajonal për të vërtetën do të ndihmonte më së shumti në krijimin e kujtesës së përbashkët historike.

Unë jam ithtare e asaj që të flitet për këtë trashëgimi dhe këtë histori dhe në lidhje me këtë të shfrytëzohen mënyrat e ndryshme, e njëri prej instrumenteve i cili më duket se mbase do të kontribuonte në zbardhjen më të plotë e asaj të kaluarës është formimi i trupit rajonal për zbardhjen e fakteve mbi të kaluarën. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultat rajonale me artistë, Beograd, Serbi, më 16 dhjetor 2006.)

Nëse flitet për instrumentin që do të na përfaqësojë atij idealit tonë për zgjidhjen e çështjes së kujtesës historike, që nuk është instrument thjesht artistik apo edhe nuk është fare artistik, por është, domethënë, një instrument shoqëror, social dhe politik, dhe mbase edhe antropologjikë, për mua ky është Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin. Edhe unë do të doja që të ekzistojë një Komision i tillë në trevën e ish Jugosllavisë, që do të mundësonte njerëzve që e bartin barrën e krimin në vete, dhe atyre që bartin peshën e viktimës në vete, që ta komunikojnë këtë në një nivel më të gjerë, sepse krimi dhe viktimat janë masive dhe gjyqet vetëm pjesërisht mund ta zgjidhin këtë çështje. (Haris Pašović, regjisor i teatrit nga BH Konsulta rajonale me artistë Beograd, Serbi, B, 16. dhjetor 2006.)

3. Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale:

Zbardhja e të vërtetës mbi krimet e luftës dhe konfliktet

**Zagreb, Kroaci
8-9 shkurt 2007.**

Forum i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale për zbardhjen e të vërtetës mbi krimet e luftës dhe konfliktet është organizuar nga Documenta, Fondi për të Drejtën Humanitare dhe Qendra Kërkimore-Dokumentuese. Debatimi është zhvilluar në sesionet ku janë trajtuar temat e rëndësishme të të

dhënave në zbardhjen e të vërtetës, e rolit të proceseve gjyqësore për krimet e luftës në tregimin e të vërtetës, e qasjes rajonale në tregimin e të vërtetës dhe fakteve, e zbardhjes të së vërtetës nga perspektiva e viktimës, e shprehjes artistike dhe tregimit të së vërtetës, e praktikave të ballafaqimit me të kaluarën në trupat ligjdhënëse dhe e rëndësisë së arkivës së Hagës. Më shumë se 300 pjesëmarrës nga vendet post-jugosllave – përfaqësues të organizatave për të drejtat e njeriut, shoqatave të viktimave dhe të familjeve të të zhdukurve, organizatat e avokatëve, të Tribunalit të Hagës, të Qendrës Ndërkombëtare për drejtësi tranzicionale, gjykatës, prokurorë, artistë dhe gazetarë – kanë debatuar, për të parën herë në Kroaci, mbi instrumentet për zbardhjen e të së vërtetës mbi të kaluarën. Forumin e ka hapur Kryetari i Kroacisë Stjepan Mesić, i cili i dha përkrahje të fuqishme zbardhjes së fakteve në nivelin rajonal. Mbi Forumin kanë informuar këto medime: TV Jadran, Nova TV, HRT1, Globus, Novi list, Jutarnji list, Večernji list, Slobodna Dalmacija.

Organizatave rajonale partnere – Documenta, Fondi për të Drejtën Humanitare dhe Qendra Kërkimore-Dokumentuese – do të vazhdojnë me organizimin e debateve publike dhe konsultave në suazat e shoqërisë civile në mënyrë që të stimulohen më shumë qeveritë dhe parlamentet në rajon për të marrë pjesë në debate mbi procedurat dhe modellet e zbardhjes dhe të tregimit të së vërtetës gjë që siguron respektimin e dinjitetit të viktimave dhe krijon një kulturë të përgjegjësive.

Ekziston nevoja shoqërore për bisedë dhe rishqyrtim kritik të përgjegjësive vetjake për trashëgiminë e rëndë të së kaluarës si dhe për dokumentimin e pësimeve dhe të padrejtësive të bëra ndaj të gjitha viktimave, pa marrë parasysh përkatësinë e tyre etnike, politike dhe sociale.

Duhet të ndërpritet të flitet, më në fund, mbi një mijë e njëqind e ca viktima tona dhe nëntëqind viktima të tyre dhe të thuhet se në Kroaci janë zhdukur dhe ende kërkohen pak më shumë se dy mijë qytetarë të cilët janë zhdukur gjatë konflikteve të armatosura. (Žarko Puhovski, Këshilli Kroat i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Ballafaqimi me faktin se edhe populli i tyre ka bërë krime për disa ka qenë po aq i dhimbshëm sa edhe

ballafaqimi me vetë krimin, të cilin populli i tyre padyshim që e ka përjetuar. Këto tema janë futur nën dysheme, dhe ata që i kanë nxjerr nga aty në shesh janë shpallur tradhtarë kombëtarë. Gjithnjë është shtruar pyetja pse duhet të flitet për viktimat e tyre, kur ne kemi pas më shumë viktima. Në pjesën dërmuese të opinionit assesi nuk kanë mundur që të krahasohen dhe maten viktimat «tona» dhe të «tyre». Përderisa viktimat tona kanë qenë të «shenjta», ato të tyre kanë qenë të merituar. Derisa ne kemi vuajtur, ata e kanë marrë dënimin që i ka takuar. (Drago Hedl, Feral Tribune, Kroaci, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Ne kemi ardhur në një situatë që të jemi një lloj i party breakers-ave, të atyre që i prishin ahengjet. Ua prishim ahengjet nacionalistëve, por njerëzit ato i kanë në qejf. Ne konfrontoheshim me mitet duke folur për të vërtetën, me mitin se serbët gjithnjë e kanë luftuar me guxim imperializmin perëndimor, me mitin e quajtur dinjiteti i luftës atdhetare ose me mitin e dyqind mijë boshnjakë të vrarë në luftë. Dhe askush nuk donte të dëgjonte faktet që tregonin se këto mite nuk kanë mbështetje. (Žarko Puhovski, Këshilli Kroat i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Posaçërisht dua të theksoj se ne jemi të vetëdijshëm se sa është me rëndësi që ne vetë në Kroaci të zhvillojmë procese penale kundër pjesëtarëve të armatës dhe policisë kroate, pra jo që dikush tjetër ta bëjë këtë për ne, por që këtë ta bëjmë vetë ne. Pjesëmarrja e trupave gjyqësore të një shteti në zbardhjen e asaj çka ka ndodhur është e rëndësishme, sepse nuk duhet të harrojmë se këtë e bëjmë për të arritur besueshmërinë vetjake, që të pranohet ajo çka ka ndodhur, dhe kjo është veçanërisht thelbësore kur janë në pyetje pjesëtarët e forcave të armatosura të veta. (Mladen Bajić, avokati shtetëror i Republikës së Kroacisë, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Në vitet '91 dhe '92, p.sh., në qytetet kanë pësuar Serbët, kështu që janë zhdukur ose vrarë 600 civilë në Sisak, më shumë se 120 civilë në Gospić, rreth 200 civilë në Zagreb, dhe janë zhdukur edhe në qytetet tjera. Mirëpo, për këto krime deri më sot askush nuk është akuzuar dhe shtrohet pyetja a janë këto veprime penale të krimin të luftës apo jo? (Luka Šušak, avokat, Kroaci, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Viktimat që i kanë shkaktuar serbët në Kroaci dhe anembanë ish Jugosllavisë, për këto flitet, kurse për viktimat që janë shkaktuar nga kroatët ndaj popullsisë civile të kombësisë serbe ende flitet pak, edhe pse ka filluar të flitet diku pas vitit 2000. (Vjera Solar, Kroaci, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Përfaqësuesit e veteranëve angazhohen që së pari të zbardhet si ka ardhur deri te lufta.

Hajt t'i gjejmë arsyet e luftës, sepse askush nuk flet për arsyet, të gjithë e duan të vërtetën, e nuk e duan arsyet. Në sërish krijojmë kushtet për, siç ju thoni, konflikt, sepse nuk doni të flisni për luftën. Duhet ta dimë pse ka qenë lufta. (...) Pra hajt ta zbardhim të vërtetën që kjo mos të përsëritet më. (Ivan Pandža, HVIDRA, Kroaci, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007.)

Domosdoja e qasjes rajonale në zbardhjen dhe tregimin e të vërtetës në praktikë është vërtetuar përmes vendosjes së bashkëpunimit në rajon, mes prokurorive, gjykatave, organizatave për të drejtat e njeriut dhe shoqatave të viktimave, gjë që ka kontribuar që në gjykimet për krimet e luftës të dëgjohet zëri i viktimave.

Duke vendosur kontaktet e ndërsjella, me nënshkrimin e memorandumit të bashkëpunimit, me këmbimin e shënimeve, duke e bërë të mundur që dëshmitarët e një vendit të vijnë në vendin tjetër, duke mundësuar që të mblidhen deklaratat që shfrytëzohen gjatë proceseve, kemi bërë një hap para në zbardhjen e autorëve, në zbardhjen e së vërtetës. (Mladen Bajić, Kryeavokat i Republikës së Kroacisë, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, 8-9 shkurt 2007, Zagreb, Kroaci)

Prokuroria e Bosnjës dhe Hercegovinës me prokuroritë e vendeve fqinje ka bërë marrëveshjet për bashkëpunim dhe ndihmë të drejtpërdrejtë në procesimin e lëndëve. Këto marrëveshje mundësojnë bashkëpunimin dhe këmbimin e informatave dhe të dëshmimeve mes prokurorive në rajon, gjetjen e dëshmitarëve në territorin e shtetit tjetër si dhe llojet tjera të ndihmës ndërkombëtare në hetimet penale dhe procesimet. (Marinko Jurčević, Kryeprokurori, Prokuroria e Bosnjës dhe Hercegovinës, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Prokuroria për krimet e luftës edhe deri më sot ka

treguar se është e gatshme që përmes bashkëpunimit rajonal të i vë në dispozicion provat materiale që i kemi sepse konsiderojmë se drejtësia duhet të përmbushet nëse jo në Serbi, atëherë në territorin e një vendi tjetër. Kryesore është që të realizohet drejtësia. (Vladimir Vukčević, Kryeprokurori për krimet e luftës i Republikës së Serbisë, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Në lidhje me përgjigjen tonë rreth trashëgimisë [të së kaluarës] më duket se nuk duhet të fillojmë të flasim mbi atë se a ka ndonjë zgjidhje që do të zëvendësonte të gjitha mangësitë, jo mangësitë por në të vërtetë, kufizimet objektive të gjykimeve penale për krimet e luftës. Mendoj për ndonjë trup rajonal për tregimin e të vërtetës i cili do ta kishte kuptohet para së gjithash këtë orientimin drejt viktimave. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Gjykimet kombëtare për krimet e luftës mund të ndihmojnë që të kthehet besimi në institucionet vendore, që të zbardhet e vërteta, por nuk japin pamjen e plote të asaj çka ka ndodhur.

Dhe testi i vërtetë nuk është kur serbi mund të gjykohet në Kroaci për shkak se i ka vrarë kroatët. Testi i vërtetë është kur kroati mund të gjykohet në Kroaci ngase i ka vrarë serbët. Ose kur serbi gjykohet në Beograd për krimet e bëra ndaj boshnjakëve. Ose kur shqiptari gjykohet në Prishtinë për krimet që i ka bërë ndaj serbëve. Ose kur boshnjaku gjykohet në Sarajevë sepse e ka vrarë kroatin. Dhe nuk është që të gjykohe vetëm ushtarët me grada të ulëta. Gjykatat vendore duhet të ndjekin vijën komanduese. Duhet të arrijnë te gradat më të larta që janë përgjegjëse për krimet e bëra... Kur të ndodhë kjo, atëherë ka fituar ligji dhe drejtësia. Kur ta dinë se do të konsiderohen përgjegjës edhe te shpija, në gjykatat e tyre vendore, atëherë të gjithë në rajon dhe ata që shikojnë nga jashtë, do të fitojnë besimin e plotë në sistemin vendor juridik. (Clint Williamson, ambasador i SHBA-ve për çështje të krimeve të luftës, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Përmasa e krimeve të bëra është aq e madhe, mizori aq groteske, sa që është e pamundur që të kuptohen dhe të shërohen të gjitha plagët vetëm përmes gjykatës për krimet e luftës. Megjithatë, është e evidente se rezultatet e proceseve gjyqësore, arki-

va e tyre dhe faktet e zbardhura, paraqesin pjesën kruciale të zbardhjes të së vërtetës dhe të trasimit të rrugës për pajtim. (Carla del Ponte, kryeprokurorja e Gjykatës penale ndërkombëtare për ish Jugosllavi, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Edhe kur reflektojnë të vërtetën e njëmendtë, faktet e zbardhura në lëndën e caktuar nuk mund të paraqesin në plotësi mekanizmin për zbardhjen dhe tregimin e të vërtetës pas konflikteve të armatosura sepse ato janë mbledhur për të plotësuar kriterin e besueshmërisë të provës juridike brenda të drejtës penale, në kuptimin e provës për përgjegjësi personale, individuale për veprat e bëra. (Fausto Pokar, Kryetar i Gjykatës penale ndërkombëtare për ish Jugosllavi, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Rolin shumë të rëndësishëm në procesin e zbardhjes dhe të tregimit të së vërtetës e ka arkiva e Gjykatës Ndërkombëtare Penale për ish Jugosllavinë, që duhet të jetë e disponueshme për të gjithë në rajon dhe të ruhet për brezat e ardhshëm.

Dokumentacioni për krimet e luftës që është mbledhur deri më sot nga të gjitha këto organizata, së bashku me dokumentacionin që ekziston në Tribunal, në njëfarë mënyre është një tërësi edhe pse nuk mendoj se duhet të jetë në një vend, përkundrazi, unë do të thosha se duhet të jetë në më shumë vende... dhe se edhe qeveritë kombëtare do të kuptojnë me sa rëndësi është që kopjet e dokumenteve që janë mbledhur deri më sot, dhe ato që mund të mblidhen nesër, mbi krimet, të ruhen dhe të janë të disponueshme jo vetëm për ata që me këto çështje merren si hetues, dhe që do të vazhdojnë që të merren edhe në të ardhmen, por edhe për ata që do të rriten në këto shoqëri në deceniet e ardhshme dhe do të donin të dinin saktë se çka ka ndodhur me prindërit e tyre, apo me të afërmit dhe bashkëqytetarët e tyre, mu për atë që këto sende të mos përsëriten më. (Goran Svilanović, Pakti i stabilitetit për Evropën juglindore, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Të gjithë pjesëmarrësit e konferencës janë pajtuar se lista me emrat e viktimave është e nevojshme për krijimin e kujtesës historike dhe pengimin e ndryshimit të së kaluarës.

Politikanët dhe gazetarët kanë manipuluar me numra të ndryshëm kur janë në pyetje viktimat e

luftës [në BH]. Këto numra kanë pasur dallime të mëdha dhe shifra më e madhe që kam dëgjuar ka qenë treqind e pesëdhjetëmijë viktimat. (...) Qëllimi ynë ka qenë jo të manipulojmë me numra, çka do të thotë se që nga starti kemi mbledhur vetëm shënimet për çdo person veçanërisht, kështu që çdo viktimitë të ketë emrin, mbiemrin, emrin e babait. (Safer Hukara, Qendra Kërkimore-Dokumentuese, BH, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Sqarimi i fatit të të zhdukurve është prioritet.

Ky është prioriteti ynë – sqarimi i fatit të të gjithë të zhdukurve, dhe kjo te të gjitha palët. (Stjepan Mesić, Kryetar i Republikës së Kroacisë, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Çështja e personave të zhdukur dhe të familjeve të tyre në Republikën e Kroacisë, kjo është sot, zonja dhe zotëri, i nderuari kryetar i Republikës, çështja më e rëndë humanitare që na ka mbetur dhe që ende nuk është zgjidhur. Ju kujtoj se në listën janë, kryesisht nga viti '91, janë 1122 veta, ushtarë kroatë dhe civilë. Edhe 930 persona të zhdokura janë në listën e vitit 1995. (Jadranka Kosor, Nënkrjetare e Qeverisë së Republikës së Kroacisë, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Kur e kam gjetur kufomën e djalit, sa ka qenë e rëndësishme kjo për mua, dhe sa është edhe sot. Ka qenë për mua një rehati. Unë shkoj te varri, e pastroj atë, e ndezi një qiri, sjell lule, dhe ndihem sikur kur shkoj në vizitë te djali tjetër, që është gjallë dhe e ka familjen e tij, ndihem sikur nipave të mijë ua kam sjell çokolletën. Unë e vizitoj dhe ndihem e mbushur, sepse nuk kam zgjedhje tjetër, dhe kjo më sjell kënaqësi të madhe sepse e di që sot a nesër edhe unë do të shkoj te ai. Këtë e dua edhe për të tjerët, dhe i përkrah, ata që ende kërkojnë, dhe vërtet do të isha e lumtur, që edhe ata t'i gjejnë të afërmit e tyre, ashtu siç e gjeta unë. (Štefica Krstić, Shoqata Viktimat e luftës atdhetare, Kroaci, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007.)

Faktet për atë çka ka ndodhur pengojnë relativizmin e krimet.

Ne duhet ta dimë të vërtetën, e vërteta duhet të kërkohet dhe të zbardhet, me të vërtetën duhet të ballafaqohemi me dashje pa marrë parasysh se çfarë është

ajo dhe a do ti pëlqej dikujt apo jo. Dhe e vërteta është vetëm një. Natyrisht, ekzistojnë përjetime të ndryshme të kësaj të vërtete. Ka kënde të ndryshme të shikimit të kësaj të vërtete, dhe ka edhe interpretime të ndryshme të saj. Por e vërteta mbetet ajo që është, aty janë faktet, ajo çka ka ndodhur, dhe për këtë nuk mund të ketë kurrfarë marrëveshesh, pazaresh, nuk ka dhe nuk mund të ketë kurrfarë relativizimesh të saj. (Stjepan Mesić, Kryetar i Republikës së Kroacisë, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Ajo çka është detyra jonë, sërish po e them, është që të arrijmë deri te faktet dhe jo te simbolet. Askush veten, e as tjetrin, nuk duhet ta përjetoj si simbol, por të shihet se si qëndrojnë me faktet. (Žarko Puhovski, Këshilli Kroat i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007.)

Faktet janë të rëndësishme për zbardhjen e së vërtetës, dhe deri te e vërteta arrihet vështirë nëse nuk dihen faktet ose ato injorohen. (Zoran Pusić, Këshilli qytetar për të drejtat e njeriut, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

Artistë padyshim kanë treguar gatishmëri që me veprat e tyre t'i kundërvihen mohimeve, gënjeshtreve, heshtjes dhe tentimeve për ndryshimin e fakteve mbi të kaluarën

Është vështirë të përshkruhet ndjenja që keni kur hyni në atë qytet [Srebrenicë]. Në atë qytet ju shihni se ekziston një jetë normale, shihni se aty jetojnë njerëzit, punojnë, takohen, por ekziston edhe një ndjenje që vetëm arti mund ta tregojë, dhe ta transmetojë, ekziston ajo ndjenja e rrëqethjes metafizike. Unë mendoj se ne si artistë kemi detyrë dhe përgjegjësi ndaj vetes, dhe ndaj brezave që po vijnë, që kur vijmë në disa qytete, në disa vende, të mënjanojmë këtë ndjenje të rrëqethjes që na përcjell nga brezi në brez. (Dino Mustafić, regjisor teatri nga BH, Forumi i Dytë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt 2007)

4. Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi ballafaqimin me të kaluarën

**Sarajevë, Bosnja dhe Hercegovina
Më 27 qershor 2007**

Konsultat i ka organizuar Qendra Kërkimore-Do-

kumentuese. Kanë marrë pjesë 11 përfaqësues të organizatave joqeveritare që merren me të rinjtë, si dhe dy përfaqësues të organizatave të të rinjve të partive politike. Fjalën hyrëse e kanë mbajtur Mirsad Tokača (Qendra Kërkimore-Dokumentuese, BH) dhe Marijana Toma (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi), tubimin e moderoi Dejana Grbić (Nisma rinore për të drejtat e njeriut, BH).

Baza e të dhënave mbi humbjet njerëzore është njëti më i fortë kundër mohimit të viktimave.

A jeni vërtetë të mendimit se njerëzit që janë zhdukur tani diku pushojnë nëpër plazhe dhe lejojnë që familjet e tyre, nënat, baballarët, vëllezërit dhe motrat, t'i kërkojnë edhe më tej? Thjesht, nëse keni një mjet të tillë çfarë është baza e të dhënave për humbjet njerëzore çfarë është kjo e QKD-së, kjo është diçka me të cilën ne duhet të punojmë pa marrë parasysh dyshimet e njerëzve. (Dejana Grbić, Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut në BH, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, 27 qershor 2007)

Ballafaqimi me të kaluarën duhet të ketë qasje rajonale.

Esenca e procesit të ballafaqimit me të kaluarën është që nuk mund ta bëjmë lokalisht, vetëm në njërin shtet si në Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi, Kroaci, Kosovë apo Mal të Zi ndarazi, por duhet të punojmë me të rinjtë që janë moshatar dhe bashkëkohanikë tanë, sepse, ta them pak më vrazhdë, jemi të dënuar që të jemi njëri me tjetrin. Ne mund të aktrojmë se jemi të mbyllur në mjedise shumë të vogla dhe të shikojmë vetëm vendet tona, vetëm problemet tona, mirëpo, kur kështu mbyllemi atëherë nuk e kemi pamjen e pikturën e plotë dhe humbim shumëçka. (Dejana Grbić, Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut në BH, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, 27 qershor 2007.)

Definitivisht, qasja rajonale në këtë aspekt është njëra nga më të suksesshmet. Për arsye se, e para, të gjithë e ndajmë këtë fat, kemi qenë të lidhur në ish shtetin, dhe e dyta, jemi të gërshetuar. Kështu që, me gjasa, përmes disa pikëpamjeve tona personale nga perspektivat e ndryshme do t'i thyejmë edhe bllokadat e caktuara mediale, të cilat i kemi pas që të gjithë. Definitivisht, pra, vetëm tash që ngadalë e

gjithnjë e më shumë po e zgjeroj fushën time, vetëm tash jam në gjendje ta kuptoj se sa informata të gabueshme i kam pas dikur, dhe sa keq jam ndier, dhe sa keq ndihem sot për këtë gjë. (Jelena Kuzmanović, TERCA, BH, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, 27 qershor 2007.)

Procesi i ballafaqimit me të kaluarën nuk guxon të jetë pronë e politikës, por duhet të zhvendoset në hapësirën civile.

Fakt është që kriminelët ecin rrugëve, fakt është se politikanët ende mbajnë fjalime të zjarrra... etj., Pra, si të zhvendoset prona ndaj këtyre proceseve nga pozicioni i politikës, politikës klasike, - e cila zakonisht këtë tematikë e merr për qëllime të politikës së ditës, - në shoqërinë civile... Dhe si të ndërtojmë sistemet e vlera të reja nga mësimet që kemi nga kjo e kaluar e përgjakshme, tragjike, e rëndë? Kjo është për mua gjëja kryesore. (Mirsad Tokača, Qendra Kërkimore-Dokumentuese, BH, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, 27 qershor 2007)

Ndikimi i njerëzve tek të rinjtë duhet të bëhet përmes organizatave rinore por duhet ti qasemi drejtpërdrejtë, sepse pjesa më e madhe e tyre nuk është fare aktive.

Target grupi i juaj, nëse doni që të keni impakt, duhet të jetë niveli më i gjerë, më i ultë, pra njerëzit e ri, që nuk kanë asnjë lidhje me organizatat rinore, që sot, ndoshta edhe nuk janë fare aktive. Por, organizatat rinore mund të janë resurs i mirë në kuptimin që mund të kenë kontakte mu me këto target grupe, nga arsyeja e thjeshtë, që janë mobil dhe udhëtojnë, njihen, etj. (Jan Zlatan Kulenović, Agjencioni informativ rinor BH – OIA, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, 27 qershor 2007)

Duhet të konceptohet mirë qasja ndaj të rinjve në mënyrë që te ata të zgjohet fare interesi për temat lidhur me ballafaqimin me të kaluarën.

Qasja 'Youth friendly' është këtu shumë interesante, sfiduese për arsye se kjo temë është jo e pëlqyeshme për të rinjtë, është diçka që për ata paraqet, po kështu, një kujtesë jo edhe aq të bukur, është teme e politizuar, dhe thjesht a nuk është më e pëlqyesh-

hme të mendosh diçka si «ku do të pimë kafenë?» ose «ku do të studioj pas dy vitesh», sesa të merresh me «çka kam bërë para dhjetë vitesh» ose «çfarë ka ndodhur në komunitetin tim»? Pra, nga kjo anë metodologjia që do të përdorni duhet të zgjoj interes dhe në përgjithësi të jetë mjaft e fuqishme që të bëjë ndryshim të caktuar, dhe unë do të thosha edhe sjell katarsën. (Jan Zlatan Kulenović, Agjencioni informativ rinor BH – OIA, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, 27 qershor 2007)

Problemi më i madh është në atë se ne në atë ballafaqim me të kaluarën kërkojmë nga i riu që të dalë nga rrethi i familjes së tij dhe dikë që me vite e ka konsideruar për hero, ta cilësojë si kriminel të luftës dhe t'ia lëshojë gjykimin të opinionit. Duhet të kihet parasysh se shumica e të rinjve me të cilët kemi punuar, se prindërit e tyre ka qenë, të themi, pjesëmarrës direkt në ato krime, duke nisur nga Bratun-ci, dhe është shumë vështirë të flasësh për këto sende me të rinjtë. (Belma Deljkic, Rrjeti Avokatët publik të drejtësisë, BH, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, më 27 qershor 2007)

Pjesëmarrësit i kanë të ndara mendimet rreth moshës me të cilën duhet të fillohet puna në lidhje me ballafaqimin me të kaluarën

Është mjaft mirë të fokusohesh në moshën e shkollës së mesme, pasi që ata janë tashmë persona të zhvilluara me të cilët mund të zhvillonin biseda të pjekura. (Belma Deljkic, Rrjeti Avokatët publik të drejtësisë, BH, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, më 27 qershor 2007)

Nëse ne nuk i themi të vërtetën dhe nuk i themi se si ka qenë realisht dhe këtë e ilustruam me dokumentacion, me argumente të caktuara, dikush tjetër do të plasojë tek ata një histori tjetër të cilën ata do ta përvetësojnë si të vetën, sidomos nëse ende i nënshtrohen prindërve që ata t'ua servojnë, po kështu, historinë e gabuar, domethënë, ata që nga moshë e vogël do të nisen rrugës së gabuar. Ky është proces më i gjatë se sa të punohet vetëm me shkollën e mesme, por mendoj se ky proces do të jetë më i qëndrueshëm dhe do të ketë më shumë sukses. (Kenan Uštović, Forumi i të rinjve i SDR, BH, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, më 27 qershor 2007)

Kur bëhen 15 ose 16 vjeç ata e kanë ideologjinë e zhvilluar shkencërisht të recituar të kujtëdo qoftë. Ne kemi njerëz që në bazë të disa informatave, në bazë që asaj që ka thënë ndonjë anëtar i familjes, çka kanë parë në rrugë, krijojnë bindje të caktuara. (Ivana Kešić, Civitas, BH, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, më 27 qershor 2007)

Sipas meje, sa më parë duhet filluar me edukimin, sepse unë i takoj brezit që ka qenë në klasën e pestë kur mbaroi lufta dhe më në fund patëm filluar arsimimin normal. Dhe atëherë na patën ardhur në shkollë disa njerëz, që na patën fshirë në librat e historisë të gjitha pjesët që kanë pas lidhje me luftën e fundit. (...) Dhe atëherë ka qenë shumë vështirë që të flitet fare me ne për këtë, të përmendni çka kemi përjetuar në ato katër vite, sepse menjëherë shqetësoheshim, sepse na paraqiteshin ata njerëz që na i patën fshirë librat. (...) E dini, kur me ndonjë marker fshini diçka, sërish mund ti shihni germa, dhe ata markerët nuk kanë qenë aq cilësor, dhe ne e kuptonim si stop, nuk duhet të flitet për ato gjëra të fshira. (Ehlimana Memišević, OJQ Edukimi ndërton BH, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, më 27 qershor 2007)

Rinia e partive politike duhet të kyçet në procesin e edukimit të ballafaqimit me të kaluarën.

Nuk është send i vetëm t'i mësosh politikanët e rinj retorikës, si të mbajnë fjalimet, si të kanë sjellje adekuate dhe të mbajnë raportet, por esenca është se gjatë atij procesi të maturimit dhe rritjes së tyre politike të mësojnë edhe për vlerat, siç janë dijet për të drejtat e njeriut dhe rëndësinë e asaj për çka tani jemi duke folur, dhe kjo është ballafaqimi me të kaluarën, në mënyrë që kur të bëhen politikanë të pjekur dhe na përfaqësojnë në pushtet, të kenë mjaft edukatë dhe aftësi. (Dejana Grbić, Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut në BH, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, 27 qershor 2007)

Faktet e zbardhura duhet të futen në tekstet shkollore e të gjitha shteteve të rajonit që historia të mos përsëritet më.

Të vërteta e zbardhura si mënyrë e zgjidhjes së konflikteve sipas meje do të duhet të futeshin në të gjitha tekstet shkollore në rajon. Pra, në këtë mënyrë të gjithë do të mësojmë të njëjtën dhe për dhjetë vite

nuk do të kemi konflikt rreth asaj se a kanë ndodhur apo jo ato gjëra. (Ehlimana Memišević, OJQ Edukimi ndërton BH, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, më 27 qershor 2007)

Duhet të shfrytëzohet arti si mjet i komunikimit me të rinjtë për temat e të kaluarës.

Arti është tejet i rëndësishëm sepse është i afërt për të rinjtë. Pra, mund të bëni njëqind projekte artistike nga rep këngët deri te ekspozitat e fotografive, shfaqjet, koncertet, ku krejt kjo mund të lidhet, sepse do të jetë tërheqëse për të rinjtë, që në instancën e fundit të marrin pjesë në këtë. (Jan Zlatan Kulenović, Agjencioni informativ rinor BH – OIA, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, më 27 qershor 2007)

Duhet të përcaktohet se cila është pika e përbashkët e të gjithë njerëzve në BH, sepse pa këtë nuk do të mund të flitet për të kaluarën e as për ardhmërinë e përbashkët.

Nëse duam të flasim për të kaluarën dhe për ardhmërinë gjëja më e rëndësishme është të shohim pse ne duam të flasim për këtë. Nëse tentojmë të flasim me njerëzit, të cilët absolutisht nuk kanë pikëtakime, nuk kanë absolutisht asnjë interesim për të ndërtuar shtetin e përbashkët më të mirë, dhe nuk kanë asgjë të përbashkët, por duan që të kanë sa më shumë gjëra të ndryshme, atëherë është e pamundshme, krejt e pamundshme të fillohet të flitet as për të kaluarën, as për ardhmërinë. (Edin Čolić, Liberalët e ri të BH, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, më 27 qershor 2007)

Ekskursionet dhe vizitat vendeve të pësimëve janë mënyra e mirë e ballafaqimit të të rinjve me të kaluarën.

Konsideroj se ekskursionet janë shumë të mira, vizitat qendrave memoriale, vendeve ku janë bërë krimet. (Jelena Kuzmanović, TERCA, BH, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, më 27 qershor 2007)

Debatet rajonale të përfaqësuesve të grupeve të ndryshme shoqërore mund të janë shumë të dobishme në këtë proces.

Kur shtrohet çështja e ballafaqimit me të kaluarën, diçka që konsideroj se mund të jetë shumë e dobishme janë debatet në nivelet rajonale që do të përfshinin debatues të ndryshëm, me background-e të ndryshme. (Jelena Kuzmanović, TERCA, BH, Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e zbardhjes dhe tregimit të së vërtetës, Sarajevë, BH, më 27 qershor 2007)

5. Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e ballafaqimit me të kaluarën

**Beograd, Serbi
Më 8 korrik 2007.**

Konsultat i organizoi Fondi për të Drejtën Humanitare. Morën pjesë 25 aktivistë nga organizatat e të rinjve nga Serbia. Fjalën hyrëse e mbajtën Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi) dhe Andrej Nosov (Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut, Serbi) dhe tubimin e moderoi Marijana Toma (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi). Diskutimi është zhvilluar mbi temat: *Roli i të rinjve në procesin e ballafaqimit me të kaluarën në ish Jugosllavi, Rëndësia e zbardhjes së fakteve mbi krimet nga e kaluara për brezat post-konfliktit dhe Roli i të rinjve në luftën kundër mohimit dhe relativizimit të krimit në zbardhjen dhe tregimin e të vërtetës.*

Është e domosdoshme lidhja rajonale e të rinjve dhe stimulimi i komunikimit të tyre lidhur me të kaluarën dhe krimet e bëra.

Unë mendoj se ndoshta duhet të fillohet nga baza, duhet që të rinjtë brenda organizatave joqeveritare të njihen me të rinjtë nga organizatat e këtilla në rajon, të kanë kontakte direkte, që ata të fillojnë t'i këmbëjnë idetë. Ekziston problemi i madh që nuk ka njohuri jo vetëm për atë çka ka ndodhur, por as si është situata e sotme atje. Ndoshta në këtë nivel duhet të nisët nga fillimi, të ndërtohet komunikimi. (Ana Batoćanin, Nisma ime – Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 8 korrik 2007)

Duhet të zhvillohet ndonjë metodë që njerëzve të rinj t'ua krijojmë idenë e të kaluarës sonë dhe të kaluarës të politikanëve tanë që kanë qenë atëherë në pushtet. Flas për ngjarjet në ish Jugosllavi gjatë viteve të luftës, nga 1991-shi dhe tutje. (Mile Novaković, Shoqata Sigo ando Them, Serbi, Konsultat

kombëtare me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 8 korrik 2007)

Thyerja e bllokadës mediale në temën e krimeve të luftës është kusht për ndryshimin e mendimit

Kështu që është bërë si dukuri e përgjithshme që përgjithësisht temat ekonomike dhe sociale të vihen në planin e parë sepse ato konsiderohen 'tema të rëndësishme' ndërkaq që tema e ballafaqimit me të kaluarën është diçka për të cilën neve që nga starti duhet të luftojmë duke u përpjekur ta vendosim në planin e parë. Kjo është punë e këtyre organizatave, duhet të shfrytëzohet literalisht çdo hapësirë mediatike për këtë. (Hajrie Bogujevci, Qendra për Aksion Qytetar Integra, Kosovë, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 8 korrik 2007.)

Mendoj se vërtet vetëm kur të thuhet bllokada mediale, mund të flitet publikisht për të gjitha gjërat, vetëm atëherë mund të flasim mbi atë se si t'ua ndryshojmë mendjen radikalëve. Deri atëherë duhet të përqendrohemi në grupet më të vogla, të cilat mund të kyçen edhe direkt në mendimin tonë. Çdo organizatë do të duhej të kishte planin strategjik që të ketë kalueshmëri dhe të vërtetë që është duke punuar diçka dhe ka edhe ndonjë rezultat, sepse kjo është mënyra që të gjejnë fonde për planet e ardhshme, gjithnjë e më ambicioze. (Miloš Simić, Qendra për nismën demokratike, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 8 korrik 2007)

Ballafaqimi me të kaluarën duhet të bëhet pjesë e diskursit institucional dhe institucionet duhet t'i japin procesit legjitimitetin.

Si të bëhet kjo që po bisedojmë këtu pjesë e ndonjë diskursi institucional, dhe si të institucionalizohet ballafaqimi me të kaluarën? Duhet të angazhohemi dhe të bëjmë presion që shteti të ofrojë këtë lloj legjitimiteti, të na përkrahin dy apo tri institucione, sepse duhet të krijojmë këtë lloj të legjitimitetit dhe jo të mbetemi gjithnjë me atë përshtypjen e angazhimit 'underground'. Nëse shteti nuk qëndron pas, nëse shteti thotë se diçka nuk duhet të bëhet, atëherë ky është problem i madh. Nismat e shoqërisë civile mbase do të duhej të shkonin më fuqishëm në këtë drejtim. (Darko Soković, regjisor nga Serbia, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 8 korrik 2007)

Roli i shoqërisë civile është vendimtar në krijimin e atmosferës në shoqëri që do të mundësojë ballafaqimin me krimet e bëra.

Mendoj se aty diku është përgjegjësia e shtetit edhe më e madhe dhe duhet të ekzistojë një lloj institucionalizimi thjesht për arsye se deri sa kjo gjithnjë mbetet në nivelin e sektorit të OJQ-ve, sërish kemi atë anën tjetër e cila të gjithë neve që po bisedojmë këtu do të na shpall tradhtarë dhe jo që punojmë për kthesë në Serbi. Mendoj se ky është roli tejet i madh që e ka shoqëria civile që të krijojë atmosferën që do të mundësojë që kur p.sh. Boris Tadić të kërkojë falje nga populli kroat, ose diçka e ngjashme, të mos mendoj ai se çfarë do të janë reagimet në Serbi, sepse ne e kemi përgatitur atmosferën, që njerëzit të mund të presin diçka të tillë. (Maja Stojanović, Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 8 korrik 2007)

Fusha e kulturës ofron mundësi të mëdha për sensibilizimin e shoqërisë ndaj viktimave dhe ballafaqimin me krimet. Të rinjtë duhet të luftojnë në mënyrë aktive kundër mohimit të krimet duke shfrytëzuar çdo rast që të flasin për këtë.

Mendoj se një fushë që është totalisht e palëvruar në Serbi sot është fusha e kulturës (...) Përkatësisht, kultura e cila promovon mu këto vlera për të cilat flasim dhe mendoj se duhet të shohim se si duhet ta shfrytëzojmë atë. (...) Mendoj se njerëzit kanë etje për çfarëdo lloji të përmbajtjeve kulturore dhe se mu përmes kësaj, dhe në këtë fushë duhet të definohet roli i rinisë këtu tek ne. (Maja Stojanović, Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 8 korrik 2007)

Që të gjithë ne bashkërisht të luftojmë kundër harresës si politikë zyrtare, duke insistuar vazhdimisht në krimet që janë bërë në emrin tonë, të flasim për këtë publikisht dhe ti nxjerrim në hapësirat publike të qyteteve, në atë domenin ku diskursi zyrtar i mohan krimet. Më tej, duhet t'i vizitojmë vendet e krimet të bëra në emër tonë dhe të ndërtojmë ura solidariteti me viktimat, të pranojmë krimet të bëra në emër tonë, të kemi respekt për dinjitetin e viktimave dhe të lusim për falje. (Časlav Lazić, Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 8 korrik 2007)

Ndoshta do të ishte mirë që ti kyçim disa personalitete publike, nga pop-kultura, ose të muzikës, siç i përmendet tashmë artistët, që të nisin me bisedat mbi këto tema. Mendoj se ka njerëz që janë të vetëdijshëm për çështjen, por ja se nuk janë

aktivizuar në këtë mënyrë. (Ana Batoćanin, Nisma ime - Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 8 korrik 2007)

6. Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi ballafaqimin me të kaluarën

Zagreb, Kroaci

Më 20 korrik 2007

Organizatorët e këtyre konsultave kanë qenë Documenta dhe Rrjeti i të rinjve i Kroacisë. Kanë marrë pjesë 18 aktivistë të rinj të organizatave për të drejtat e njeriut. Fjalën hyrëse e mbajtën Vesna Teršelić (Documenta, Kroaci), Emina Bužinkić (Rrjeti rinor i Kroacisë, Kroaci), Marijana Toma (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi), Srđan Antić (Qendra Nansen dialog Osijek, Kroaci) dhe Helena Bučko (Grupi i të rinjve për paqe *Dunav [Danub]*, Kroaci). Janë shfaqur filmat *Të gjithë me qejf do ta hidhnin gurin*, e autorit Nenad Vukosavljević, në produksion të Qendrës për aksion jovicent, 2007, dhe video-xhirimi *i kujtimeve vetjake të luftës*, e autorit Davor Konjikušić, në produksion të Documentës, 2006.

Të rinjtë nuk kanë përgjegjësi për krimet e të kaluarës, por kanë përgjegjësi për trashëgiminë që do t'ua lënë brezave të ardhshëm.

Të rinjtë nuk e kanë përgjegjësinë për pësimet e luftës që kanë përjetuar gjatë nëntëdhjetave qindra mijëra njerëz anembanë në tani shtetet post-jugosllave, dhe na duhet në njëfarë mënyrë një bisedë e hapur për atë se cilët do të ishin motivet reale, motivet e njëmendta dhe të vërteta të të rinjve që të marrin përsipër dhe ta zgjedhin përgjegjësinë për ballafaqimin me të kaluarën, për të cilën ata nuk kanë përgjegjësi. (Marina Škrabalo, Qendra për studime të paqes, Kroaci, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Zagreb, Kroaci, më 20 maj 2007)

Mendoj se problemi me të rinjtë është se vërtet e kemi atë fakt se nuk eksiton përgjegjësia e tyre. Ekziston, por problemi është, po flas tash nga pozita e diku që punon më së shumti në Vukovar, ata nuk janë të vetëdijshëm për këtë. (...) Mendoj se detyra e sektorit civil do të jetë që t'ua shpjegojë të rinjve që edhe pse përgjegjësia nuk është e tyre, në të vërtetë është në interesin e tyre që të ballafaqohen

me faktin. (Srđan Antić, Qendra Nansen dialog, Kroaci, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Zagreb, Kroaci, më 20 maj 2007)

Nuk ekziston përgjegjësia për atë çka ka qenë, nuk ka përgjegjësi për të kaluarën dhe historinë që ka ndodhur, por ekziston përgjegjësia për të ardhmen, sepse do të vjen një ditë, po flas këtu për një periudhë që për disa do të vij pas dhjetë vitesh, kur të rritet një brez tjetër i ri, dhe ai do të ju pyet, pse nuk keni kërkuar, pse nuk e keni zbardhur të vërtetën, pse ua keni lënë këtë trashëgimi që edhe më tej të mbetet e tillë, do të kërkojnë nga ju të përgjigjeni pse nuk keni qenë më insistentes, më ngulmues në pyetjet tuaja që të sigurohen faktet e plota. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Zagreb, Kroaci, më 20 maj 2007.)

Përvoja ime flet se të rinjtë, organizatat rinore, nuk e kuptojnë këtë përgjegjësi dhe vështirë e kanë të shohin pse ajo do të duhej të ekzistonte. (...) Pas shtatë vitesh dhe dy muaj ne kemi përjetuar një dështim të plotë në punëtoritë rreth ndërtimit të paqes dhe ballafaqimit me të kaluarën, sepse ndodhte që pjesëmarrësit refuzonin që të flisnin për luftën, sepse e konsideronin si temë tepër të errët dhe mendonin se nuk ka kurrfarë implikime në jetën e tyre të sotme, dhe se nuk duhet të merren fare me te. (Emina Bužinkić, Rrjeti rinor i Kroacisë, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Zagreb, Kroaci, më 20 maj 2007.)

Unë nuk mund të ballafaqohem me të kaluarën e gjyshit tim që ka qenë në [rezistencën] partizane, nuk mundem, thjesht nuk mundem. Por ajo që mundem është që të rinjtë të mësojnë të drejtën për të kaluarën dhe në këtë mënyrë të arrijnë, nuk do të thosha përgjegjësinë, por nevojën për ballafaqimin me të kaluarën. (Marko Turk, Documenta, Kroaci, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Zagreb, Kroaci, më 20 maj 2007.)

Nuk mund të ballafaqohemi me diçka ku ne nuk kemi marrë pjesë, por mund ta pranojmë në një mënyrë, mund të kërkojmë nga shteti, institucionet shtetërore, që të na mësojnë për atë se çka ka ndodhur, mund të kërkojmë ballafaqimin me problemet. (Dan Špicer, Forumi Rinor i Partisë Social-demokratike, Kroaci, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Zagreb, Kroaci, më 20 maj 2007.)

Vetëm arsimimi, udhëtimet dhe takimet me kul-

turat tjera mund t'i ndihmojnë të rinjve që të thyejnë paragjykimet mbi të tjerët dhe fqinjët.

Gjërat e vetme konkrete që mund të kontribuojnë që të rinjtë të thyejnë paragjykimet e caktuara, janë arsimimi real, udhëtimet, takimet me kulturat dhe kombet tjera, dhe në fund të fundit, edhe ashtu gjithçka fillon me edukimin familjar, dhe pastaj edhe atij tjetrit, sistemit arsimor dhe kështu me radhë. (Dan Špicer, Forumi Rinor i Partisë Socialdemokratike, Kroaci, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Zagreb, Kroaci, më 20 maj 2007.)

Ata kanë thënë pothuajse të gjithë në një frymë se nuk duan të flasim për luftën, se nuk u intereson fare, se kjo është një gjë e së kaluarës, e prindërve të tyre, dhe se ata nuk kanë kurrfarë lidhje me këtë, por përkundrazi, donin të flisnin për gjëra tjera, për atë se çfarë muzike dëgjojnë, si vishen, me çka merren, si e kalojnë kohën e tyre dhe unë e kisha ndjenjën se ata të gjithë në parim mendonin se këta që ishin përtej kufirit, janë tmerrësisht të ndryshëm, janë një botë e çuditshme dhe që tani ata duhet të njihen me këta të huaj. (Anamarija Sočo, Qendra vullnetare Zagreb dhe Këshilli rinor i qytetit të Zagrebit, Kroaci, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Zagreb, Kroaci, më 20 maj 2007.)

Brezat e lindur pas luftës në të vërtetë e ka përvojën e traumës së luftës të bartur përmes historive familjare, paragjykimeve, sistemit arsimor, raporteve shoqërore, stereotipave. Mungesë e kontaktit të drejtpërdrejtë me të rinjtë e vendeve tjera, vendeve post-jugosllave. (...) Në takimet të rinjtë kanë së pari nevojën që të kërkojnë ngjashmëritë, (...) një brez më i vjetër nënkupton se të rinjtë e kanë këtë përvojë se janë të ngjashëm, ndërkaq që ata këtë nuk e kanë, por duhet ta fitojnë sepse konteksti në të cilin rriten është i ndryshëm. (Marina Škrabalo, Qendra për studime paqësore, Kroaci, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Zagreb, Kroaci, më 20 maj 2007.)

Të rinjtë e kanë frikën se shtetet [Kroacia dhe suksesoret tjera të ish RFSJ] pa marrë parasysh faktet, nuk do t'i ndryshojnë të vërtetat kombëtare mbi të kaluarën.

A mendoni ju se në dokumentet zyrtare kroate ndonjëherë do të përmendet se Kroaci ka qenë agresore në Bosnje dhe Hercegovinë? Unë them se mund ta kem një qëndrim timin për këtë, o për njërën o për tjetrën, dhe mendoj ky do ishte një qëndrim personal, që për më shumë, edhe mund të konfirmojë

pohimin në fjalë, por sinqerisht, dyshoj se kjo do të pranohet [të bëhet e vërtetë zyrtare] (Dan Špicar, Forumi rinor i Partisë Socialdemokrate, Kroaci, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Zagreb, Kroaci, më 20 maj 2007)

Mësimi mbi të kaluarën është me rëndësi dhe në të vërtetë është themel i ballafaqimit me të kaluarën. (...) Ministria e arsimit para disa kohe ka lançuar një film që titullohet „E vërteta mbi luftën atdhetare “ dhe e ka dërguar në shkollat fillore. Më duhet të pranoj se nuk pajtohem me shumë gjëra që janë në këtë film, që e madhërojnë kroatizmin, dhe minimizojnë viktimat serbe. (...) Para do kohe në Vukovar është hapur, mendoj se quhet Qendra memoriale informative-dokumentuese, ku kam dëgjuar se po ekzistuaa edhe një si simulator, ku mund të marrësh pistoletat plastike dhe të qëllosh mbi serbët. Mendoj se kjo nuk na çon drejt ballafaqimit me të kaluarën dhe se është vërtetë mësim mjaft jo objektiv mbi të kaluarën. (Emina Bužinkić, Rrjeti rinor i Kroacisë, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Zagreb, Kroaci, më 20 maj 2007)

Lidhja rajonale e të rinjve krijon hapësirën për ndërtimin e besimit dhe ballafaqimin me të kaluarën

Mendoj se është e rëndësishme që të rinjtë [nga rajoni] të tubohen në ndonjë vend së bashku dhe, e para, të njihen, për të parë se në themel, janë të njëjtë, me probleme dhe interesime të njëjta, dhe se mbi një themel të këtillë mund të ndërtohet debati ku mund të futet edhe ballafaqimi me të kaluarën. Mund të organizohen më shumë kampe rajonale [për të rinj] në të cilët një pjesë e fokusit do të ishte çështja e Ballafaqimit me të kaluarën ose edukimi paqësorë. (Anamarija Sočo, Qendra vullnetare Zagreb dhe Këshilli rinor i qytetit të Zagrebit, Kroaci, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Zagreb, Kroaci, më 20 maj 2007).

Në kemi organizuar edukimin qytetar dhe kishim dy grupe, dhe aty ku kanë qenë serbët dhe kroatët, thjesht kishim frikë se si do të pranojnë njëri tjetrin, ndërkaq që nga ata rrjedh iniciativa, donin që të ishin me një grup, dhe kjo na entuziazmojë dhe kemi kuptuar përmes këtyre projekteve që, në të vërtetë, nuk duhet t'i shtyjmë që të kuptojnë se nuk kanë shumë dallime mes veti, por ata vetë e kuptonin këtë disi, se mund të janë bashkë. Dhe kishim edhe një projekt tjetër, Vula pa kufij quhej, ku shoqëroheshin të rinjtë nga Baçi dhe Vukovari.

(Helena Bučko, Grupi për paqe Dunav [Danub], Kroaci, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Zagreb, Kroaci, më 20 maj 2007).

Është e nevojshme konferenca rajonale kushtuar projekteve dhe aktiviteteve të të rinjve në ballafaqimin me të kaluarën, që do të mundësonte strategjitë e përbashkëta.

Një konferencë e tipit revyjal, ku do të fitonin hapësirë të rinjtë dhe organizatat rinore që të prezantojnë se çka kanë arritur deri më sot, çfarë filma kanë realizuar, cilat materiale, libra, disa lloje i kam parë në Beograd, si doracakët mbi tolerancën, pra krejt çka është arritur në metodat dhe mjetet e ballafaqimit me të kaluarën, në mënyrë që të kemi njëfarë pasqyre, dhe të njihemi dhe pastaj ndoshta edhe të gjejmë mundësinë për ndonjë strategji të përbashkët në bazë të të gjitha këtyre të arritura-ve. (Srđan Antić, Qendra Nansen dialog, Kroaci, Konsultat kombëtare me të rinjtë, Zagreb, Kroaci, më 20 maj 2007).

7. Konsultat rajonale me gazetarë:

Instrumentet për zbardhjen e fakteve mbi krimet e luftës në ish Jugosllavi

**Sarajevë, Bosnja dhe Hercegovina
Më 29 shtator 2007**

Organizatorët e konsultave ishin Fondi për të Drejtën Humanitare, Qendra Kërkimore-Dokumentuese dhe Documenta, në bashkëpunim me Shoqatën e gazetarëve të BH, Shoqatën e gazetarëve të pavarur të Vojvodinës, Shoqatën e gazetarëve të pavarur të Serbisë, Qendrën Ndërkombëtare për edukimin e gazetarëve (Kroaci) dhe Qendrën ndërkombëtare për drejtësi **tranzicionale** (ICTJ). Kanë marrë pjesë 31 gazetarë, fjalën hyrëse e kanë mbajtur Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi), Vesna Teršelić (Documenta, Kroaci) dhe Mirsad Tokača (Qendra Kërkimore-Dokumentuese, BH), ndërsa moderatorët kanë qenë Nerma Jelačić (BIRN BH) dhe Rade Radovanović (TV Avala, Serbi). Mbi tubimin kanë informuar Beta dhe Agjencioni VranjePress.

Qasja rajonale është posaçërisht e rëndësishme në informimin për krimet e luftës.

Është tejet e rëndësishme që në këtë rajon të përkrahemi mes vetit, dhe është tejet i rëndësishme qasja rajonale në raportimin për këto tema, siç është informimi për krimet e luftës, ngase njerëzit e këtij rajoni kanë qenë njerëzit që kanë luftuar në këto hapësira, kanë qenë pjesë e ushtrive, viktimat e krimeve të luftës, dhe ata kanë edhe familje në atë vend tjetër, ose kanë lidhje gjaku, ose kanë miq. Për këtë arsye është tejet i rëndësishëm solidariteti profesional në rajon. (Borka Rudić, Shoqata e gazetarëve e BH, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007.)

Mund të bëjmë shumë edhe nëse në një mënyrë prej gazetarëve nuk do të pranohen kufijtë mes nesh, por do të shkonim dhe jepnim informatat njëri tjetrit, do të shkruajmë se si janë bërë krimet edhe në këtë, edhe në atë anën tjetër, edhe në një mjedis të tretë. (...) Ndoshta do të mund të bëheshin edhe ekipe, dhe nëse në Beograd janë gjetur kufomat dhe atje janë disa gjeneralë që për këtë e kanë dhënë urdhrin, dhe viktimat janë të Kosovës, atëherë do të mund të bënim në nivelin rajonal ekipet e gazetarëve, që do të hulumtojmë rastin dhe pastaj publikojmë raportin. (Nadira Avdić Vllasi, Radio Televizioni i Kosovës Kosovë, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007.)

Për plasmanin e të drejtës tranzicionale në mediata duhet të sigurohet përkrahja e redaktorëve.

Asnjëherë nuk mund të flasim vetëm për gazetarin dhe nuk mund të ketë asnjë nismë të tyre, sado që ata janë korrekt dhe duan që të zbardhin të vërtetën, nëse nuk e kanë përkrahjen e shefave të tyre. (...) Nëse mediuimi është privat, mund t'ju largojnë menjëherë, pa asnjë problem për ta. (Nadira Avdić Vllasi, Radio Televizioni i Kosovës Kosovë, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007.)

Gazetarët kanë mundësi të hulumtojnë, por nuk kanë mundësi të botimit. Kjo është çështje kyçe këtu, si të transmetohen gjërat. Propozimi im është që të shkohet me letër transmetuesve publikë, të provohet që të fitohet përkrahja nga redaktorët që ata e duan këtë, se do ta transmetojnë dhe pastaj të shkohet edhe te televizionet më të vogla, lokale, sepse ato shikohen mjaft në qytetet e vogla. (Borka Rudić, Shoqata e gazetarëve e BH, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007.)

Shoqatat e gazetarëve duhet t'i lajnë hesapet me

anëtarët e shoqatës që kanë përhapur propagandën luftënxitëse.

Sa i përket dënimit të gazetarëve për propaganda luftënxitëse, është iluzore të pritët që do të ndodh kjo. Nëse nuk ka ndodhur në 15 vitet e fundit, atëherë më parë do të përgjigjet gjenerali Veljko Kadijević për Vukovarin, se sa gazetari. (Hrvoje Zovko, Radio Televizioni Kroat - HRT, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007.)

Është vonë që të gjykohen gazetarët. Ose, a mund të gjykohen gazetarët kur nismëtarët kryesor të krimet dhe kriminelët më të mëdhenj në këto hapësira nuk janë dënuar? (...) Unë kam më shumë prirje që bashkësia e gazetarëve të spastrojë llogaritë me të kaluarën dhe kolegët që kanë bërë propagandë në bazë të parimeve etike (...) Cila shoqatë e gazetarëve e ka përjashtuar ndonjë anëtar të vetin nga shoqata për shkak se ka punuar pandershem gjatë luftës? (Borka Rudić, Shoqata e gazetarëve e BH, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007.)

Gjykimet për krimet e luftës kanë efekt të madh edhe kur dënimi nuk është adekuat me krimin e bërë.

Në gazetarët, para së gjithash, jemi të prirë shumë shpesh që edhe gjykimet për krimet e zakonshme dhe krimet e luftës t'i shohim si garë, ndeshje. Dalli mi është shumë i madh. Tek ndeshjet në fund është i rëndësishëm vetëm rezultati. Në procesin gjyqësor nuk është vetëm pesha e dënimit ajo që matet. Konkretisht, në rastin e Ovčar-ës megjithatë është arri tur diçka, është konstatuar pa dyshim se është bërë një krim tepër i rëndë dhe këtë askush nuk mund ta mohojë, pa marrë parasysh lartësinë e ndëshkimit për Mërksić-in ose Šljivančanin-in, apo lirim in e Radić-it. (Dejan Anastasijević, javorja Vreme, Serbi, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007.)

Pjesëmarrësit kanë qenë të ndarë në mendime se a është opinioni i interesuar për temat e krimeve të luftës.

Mendoj se në Serbi më nuk ka problem që të shkruhet dhe raportohet për krimet e luftës, por këto askush më nuk i përcjell, prandaj mendoj se duhet të gjendet mënyra se si të sensibilizohet opinioni publik. (Bojan Tončić, gazetar i pavarur, Serbi, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007.)

Mendoj se është kyçe që të pajtohemi me kolegët që mendojnë se tema e krimit të luftës thjesht është tejkaluar, se populli nuk do më të dëgjoj mbi këtë temë. Konsideroj se mediat thjesht nuk janë këtu që të përmbushin shijen e popullit, dhe se duhet t'ua ngopin urinë me do tema të reja. Ne jemi ata që thjesht duhet ta imponojmë këtë temë si primare, pa marrë parasysh se ajo në këtë moment dikujt i duket si barrë. (Petar Komnenić, javorja Monitor, Mali i Zi, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007).

Tregu nuk mund t'i shkatërroi këto rrëfime. Mendoj se asnjë treg nuk mund ta shkatërroj një tregim të fortë nga lufta, ose një fakt të fuqishëm nga lufta. Për këtë absolutisht askush nuk mund të më bind. (Mirsad Tokača, Qendra Kërkimore-Dokumentuese, BH, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007).

Është shumë me rëndësi të flasim me gjuhën e fakteve. Problemi më i madh është që opinioni nuk ka qasje në faktet për krimet e as për proceset në Hagë.

Në kemi problem mu për atë se nuk i kemi faktet. Thjesht, deri te opinioni nuk vijnë faktet se çfarë është ndëshkimi, për çfarë është i tillë. (...) Televizioni kroat është televizion publik dhe ai nuk mund të bie aq poshtë deri te qëndrimi se krimet e luftës thjesht nuk na qenkan më në modë. Ju paguheni dhe ju duhet patjetër të paktën thjesht të raportoni për krimet. (Eugen Jakovčić, TV Jadran – emisioni *Cenzura*, Kroaci, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007).

Opinionin merr informatat për krimet e luftës në një mënyrë kur jepen në programet informative dhe në mënyrën tjetër nga programet dokumentare. E ne do të mund të thoshim: „Hajt ta bëjmë një rrëfim të ngrohtë njerëzor.“ Kjo ka më shumë efekt se, të themi, një rrëfim informativ. Dhe kur e kemi fjalën te krimet e luftës, është e rëndësishme vetëm të flasim për fakte dhe me gjuhën e fakteve. (Mira Lolić-Močević, Radio-televizioni i Republika Serbska, BH, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007).

Krimet e luftës nuk janë temë për të cilën duhet të shkruhet duke i konfrontuar qëndrimet, por gazetari duhet t'i dënojë ato pa asnjë dyshim sepse respektimi i të drejtave të njeriut është obligim i tyre.

Pasi që gazetarët e bëjnë historinë, mendoj se duhet të kanë qëndrimin e tyre dhe të përgjigjen për këtë qëndrim. Nëse ky është i gabueshëm, luftënxitës ose nuk di çfarë, duhet të përgjigjen për këtë. (...) Nuk e kemi të drejtën e luftënxitjes, nuk e kemi të drejtën e gjuhës së urrejtjes, nuk e kemi të drejtën të bëjmë ftesë për vrasje. Këto nuk janë standardet e profesionit, por thjesht respekt për të drejtat njerëzore dhe qytetare. (Senka Vlatković, B92, Serbi, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007).

Gjithnjë them se kur kemi të bëjmë me krimin, nuk uxojmë të jemi neutral, sepse e kemi viktimën. Duhet të jemi të anshëm, dhe duhet të jemi me viktimën. Ky është edhe obligim moral, jo vetëm profesional. Nëse do ta shkruaja një tekst ku viktimës së dhunimit dhe dhunuesit i jap hapësirën e njëjtë, dhe ia lë lexuesit ose shikuesit që vetë të nxjerrin përfundimet, një gjë e tillë do të ishte e paimagjineshme. (...) Presupozimi i pafajësisë nuk i obligon pjesëmarrësit në debatin publik. Ky presupozim i obligon pjesëmarrësit në procesin gjyqësor dhe gazetarët që e përcjellin, dhe këtu duhet t'i vihet pika. (Dejan Anastasijević, javorja *Vreme*, Serbi, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007).

Unë mendoj se gjithnjë është me rëndësi të tregohen dy anët e tregimit, të kemi edhe njërin edhe tjetrin bashkëbisedues, të dytë që janë në një konflikt, sepse askush nuk ka monopol ndaj të së vërtetës. Nuk e dimë asnjëherë kur jemi në gabim. (Igor Mekina, *Dnevnik*, Sllovenia, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007).

Duhet të bëhet baza e përbashkët e të dhënave në Internet që do ta lehtësonte punën e gazetarëve.

Po ndoshta nuk është ide e keqe edhe të një internet faqeje, që në fund të fundit të kemi një bazë të përbashkët të të dhënave që do ta lehtësonte punën tonë prej gazetarëve, që të shihen ato njëzet, apo shtatëmbëdhjetë, apo pesëmbëdhjetë, apo sa janë, vite të punës të të gjitha organizatave, edhe të gjithë neve këtu që jemi marrë me këtë temë. (Dinko Gruhonjić, Beta/Radio Deutsche Welle/Shoqata e pavarur e gazetarëve të Vojvodinës, Serbi, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007).

Një gjë për të cilën do të mund të mendoheni është

mbledhja e informatave që i kanë organizatat joqeveritare ose ju në arkivat tuaja individuale. Dhe edhe nëse prokurorët nuk bëjnë diçka me këto materiale, qoftë në Hagë, qoftë në Beograd apo Sarajevë, tubimi i këtij materiali dhe prezantimi i tij përmes raportimit të pavarur në internet faqen, mund të jetë mënyra e inicimit të përgjegjësive për ato krime më pak të prekshme dhe gjërat që prokurorët nuk mund t'ua gjejnë lidhjet e drejtpërdrejta me krimet e luftës. (Caitlin Reiger, Qendra ndërkombëtare për të drejtën tranzicionale, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007).

Gazetarët e të gjitha serviseve publike në rajon mund të organizojnë prodhimin e një emisioni të përbashkët mbi të drejtën tranzicionale që do të transmetohej në të gjitha vendet e rajonit

Të formohet një pull i gazetarëve me qëllimin që të organizojë dhe realizojë të themi një emision në muaj (...) që vetëm paktohet dhe ky do të ishte emision që në kohën e caktuar emitohet nga qendra dhe ne e marrim dhe e transmetojmë. (...) Dhe këtu do të ketë edhe gjëra që lidhen me krimet e luftës, ato tregime që shpesh mbesin anash, nuk arrijmë që ti tregojmë, gjithçka që ka lidhje me krimet e luftës, dhe çka atë muaj ka peshë dhe meriton që të futet në atë spektër të vogël, TV magazinën e përbashkët. (Gordana Petrović, Radio-Televizioni i Serbisë - RTS, Konsultat rajonale me gazetarët, Sarajevë, BH, më 29 shtator 2007).

8. Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi mekanizmat e ballafaqimit me të kaluarën

Osijek, Kroaci
Më 6 tetor 2007

Konsultat i organizoi OJQ Qendra për Paqe, Joviolençë dhe të Drejtat e Njeriut nga Kroacia.

Duhet të krijohet strategjia që të rinjve do t'ua tregonte rëndësinë e ballafaqimit me të kaluarën si për brezin e tyre, ashtu edhe për brazat e ardhshëm dhe pengimin e konflikteve të mundshme të armatosura në të ardhmen.

Bashkëpunimi rajonal në ballafaqimin me të kaluarën është i domosdoshëm sepse në konfliktet e armatosura që janë zhvilluar në këto hapësira kanë qenë të përfshira shumica e shteteve të reja. Pos kësaj, që procesi i ballafaqimit dhe gjetjes së meka-

nizmave për zbardhjen dhe tregimin e së vërtetës të jetë i plotë, është e domosdoshme që në te të përfshihet e tërë hapësira post-jugosllave.

9. Konsultat rajonale me të rinjtë mbi instrumentet dhe iniciativat për zbardhjen dhe tregimin e fakteve mbi krimet e luftës në ish Jugosllavi

Beograd, Serbi
Më 21 tetor 2007

Këto konsultat i organizuan Fondi për të Drejtën Humanitare, Qendra Kërkimore-Dokumentuese dhe Documenta, në bashkëpunim me Nismën rinore për të drejtat e njeriut (Serbi) dhe Rrjetin rinor të Kroacisë. Në diskutime morën pjesë 37 pjesëmarrës të organizatave joqeveritare dhe të organizatave rinore, katër anëtarë të rinisë të partive politike në rajon, si dhe 16 vëzhgues, prej tyre dy të organizatave ndërkombëtare. Fjalët hyrëse i mbajtën Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi) dhe Vesna Teršelić (Documenta, Kroaci), kurse tubimin e moderuan Emina Bužinkić (Rrjeti rinor i Kroacisë, Kroaci) dhe Andrej Nosov (Nisma rinore për të drejtat e njeriut, Serbi). Web portali *H-Alter* me një lajm të shkurtë e ka paralajmëruar tubimin.

Për zbardhjen e së vërtetës për të kaluarën duhet të ketë një trup rajonal anëtarët e të cilit do të ishin ekspertët nga të gjitha vendet e ish RSFJ.

Kur flasim për zbardhjen dhe tregimin e së vërtetës, mendoj se do të ishte e rëndësishme që të krijohet një trup rajonal, dhe po ashtu me rëndësi të madhe do të ishte që në këtë trup të janë anëtarët dhe anëtarët nga të gjitha vendet [e rajonit]. Pse? Sepse është tejet e rëndësishme që të jetë trup rajonal dhe që në te të janë ekspertët nga të gjitha vendet kështu që të rinjtë, e edhe njerëzit në përgjithësi, opinionin publik, të mos i kanë mëdyshjet para rezultateve finale. (Antonela Balić, Forumi të rinjtë dhe edukimi joformal, Kroaci, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Roli më i rëndësishëm i të rinjve është krijimi i kontekstit pozitiv shoqëror për promovimin e trupit rajonal për zbardhjen e fakteve.

Roli më i rëndësishëm i të rinjve është krijimi i kon-

tekstit pozitiv në rajon për ballafaqimin me të kaluarën. Ky rol është parë mu në angazhimin e të rinjve për krijimin e kontekstit pozitiv publik në nivelin rajonalë, për krijimin, promovimin dhe funksionimin e trupit për zbardhjen dhe nxjerrjen në publik të fakteve. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Kanalet e mira të komunikimit janë me rëndësi kyçe për zbardhjen e së vërtetës në nivelin rajonal.

Bartja e informatave dhe kanalet komunikuese janë këtu mbase gjëja më e rëndësishme. Kanalet e derisotme të gabuara komunikuese në esencë edhe na kanë sjell deri te kjo që sot të «kemi», ndër thonjëza, më shumë të vërteta në më shumë rajone. (Kenan Uštović, Forumi Rinor i Partisë Social-demokratike, BH, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Të rinjtë kanë përgjegjësi ndaj të ardhmes dhe duhet të bëjnë presion që faktet për krimet të zbardhen dhe të tregohen.

Nëse të rinjtë nuk kanë përgjegjësi për keqbërjet e së kaluarës ngase në atë kohë nuk kanë mundur të ndikojnë në gjërat, ekziston përgjegjësia e të rinjve ndaj brezave të ardhmërisë në zbardhjen e fakteve. Të rinjtë kanë përgjegjësinë e shtruarjes së pyetjeve, të kërkimit të përgjigjeve dhe të bërjes së presionit të vazhdueshëm në shoqërinë ku jetojnë që faktet të zbardhen dhe tregohen opinionit. (Andrej Nosov, Nisma rinore për të drejtat e njeriut, Serbi, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

A është paqja raport stabil dhe i vazhdueshëm kjo para së gjithash varet nga raporti ndaj të vërtetës dhe në këtë kuptim për të rinjtë është veçanërisht thelbësore që ta pranojnë atë përgjegjësi, sepse deshën apo s' deshën atë e kanë. Sigurisht se nuk e kanë për atë çka është bërë, por e kanë për raportin e tyre ndaj asaj çka është bërë. Ne tani më nuk jemi në moshën adoleshente dhe jetojmë në një mjedis që ende nuk është ballafaquar me të kaluarën, dhe në këtë kuptim e kemi përgjegjësinë. (Marko Veličković, Qendra për zhvillimin e resurseve civile, Serbi, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Kjo ideologji shihet në mohimin e krimeve, në adhurimin e kriminelëve, në atë se nuk ka drejtësi,

nuk e dimë të vërtetën dhe gjithë atë që përbënë të sotmen tonë. Unë në këtë shoh përgjegjësinë tonë, se ne duke mos i pranuar këto gjëra, që edhe sot ekzistojnë, në të vërtetë ia zgjasim jetën krimeve, ua mbajmë krahun atyre. Ne po kështu, me atë çka sot bëjmë ose nuk e bëjmë, mund të krijojmë tokë të plleshme që këto gjëra të përsëriten. Prandaj mendojnë se secili prej nesh duhet ta sheh këtë përgjegjësi. (Maja Stojanović, Nisma rinore për të drejtat e njeriut, Serbi, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Kur sot përdorim termet e luftës dhe krimin, ndër të rinjtë ato janë emocionalisht më pak të mbushura thjesht ngase ata nuk i kanë përjetuar, ose nëse i kanë përjetuar, kjo nuk ka qenë në mënyrën si i kanë përjetuar të moshuarit, që kanë qenë aktiv në luftë. (...) Në kohën e luftës kemi pas manipulim të tmerrshëm medial në të gjitha vendet e rajonit, dhe ne si të rinj, pak a shumë i kemi ikur kësaj. (...) Për këtë mendoj se te rinia ka një dozë më të madhe të objektivitetit kur flitet për këto tema. (Mario Mažić, Grupi rinor i Këshillit Kroat të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Duhet të merremi me ballafaqimin me të kaluarën por edhe me pengimin e zhvillimit të konflikteve potenciale të cilët janë ende të mundshëm, sidomos në Kosovë.

Problemet e Kosovës që kanë ndodhur në të kaluarën ka të ngjarë se janë ende të gjalla në disa mjedise, sidomos p.sh. në Mitrovicën veriore, ku mentaliteti i viteve '90 është më prezent se në vendet tjera ku konfliktet janë kryer para shumë kohe dhe ku, thënë drejtë, lufta dhe krimet e luftës janë e kaluar. Edhe te ne në Kosovë është e kaluar, por potencialisht mund të përsëritet. Pra, pos masave të ballafaqimit, ne duhet të merremi edhe me pengimin. (Agon Maliqi, Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut, Kosovë, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Ballafaqimin me krimet duhet ta bëjmë vetë, dhe jo të presim hyrjen në Bashkimin Evropian. Duhet të jemi përgjegjës për shoqëritë tona.

Zgjidhjen e kësaj ne duhet ta bëjmë para hyrjes në Bashkimin Evropian, sepse pas hyrjes nuk do të kemi më çka për të zgjidhur. Ne duhet t'i bëjmë vetë këto gjëra dhe duhet të jemi më në fund, të paktën një herë nga shekulli i pestë, gjashtë, shtatë, ose

e dhe para Krishtit, përgjegjës për shoqëritë tona. Bashkimi Evropian jep fonde për këto gjëra, por ne vetë duhet ta shfrytëzojmë rastin, ta kapi atë dhe të fillojmë me punën. (Ivan Novosel, Grupi rinor i Këshillit Kroat të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Duhet të kyçen sa më shumë organizata rinore të partive politike në procesin e ballafaqimit me krimet e bëra.

Do të duhej të potencohet kyçja sa më e gjerë e rinisë të partive politike në këto procese. (Ivan Novosel, Grupi rinor i Këshillit Kroat të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Krijimi i një atmosfere ku është e mundshme që të bisedohet për këto gjëra, varet nga partitë politike (...) Në këtë kuptim duhet të orientohemi në punën me partitë politike, përkatësisht me rininë në këto parti.. (Vladimir Milovanović, OJQ BIRO, Serbi, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Temat në lidhje me të drejtat e njeriut duhet të futen urgjentisht në institucionet edukative

Arsimimi është defnitivisht më thelbësori dhe mu këto tema dhe në përgjithësi temat e të drejtave të njeriut urgjentisht duhet të futen në shkolla dhe në mediumet masive, ngase këto janë ato që përkrahë familjes më së shumti ndikojnë në socializimin e njeriut. (Mario Mažić, Grupi rinor i Këshillit Kroat të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Njësitë e caktuara mësimore do të mund të plotësoheshin edhe me shfaqjen e filmave dokumentar ose format dhe metodat tjera të ndryshme që janë atraktive për të rinjtë, ku pra në mënyra të ndryshme do të trajtoheshin këto tema. Dhe kuptohet, duhet të provojmë lobimin e enteve pedagogjike dhe ministritë kompetente që kjo të jetë ose njësi joformale jashtë plan-programit të rregullt, ose praktikisht në shumë shkolla edhe pjesë e programit zyrtar. (Jan Zlatan Kulenović, Agjencia Informativë rinore e BH, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Pasi që ky trup rajonal do të vinte deri te faktet relevante, ato edhe do të prezantoheshin. Mendoj se është e rëndësishme që të sigurohet prezantimi

adekuat të këtyre fakteve rinisë, përmes teksteve shkollore, në shkollat, në formën që për ta do të ishte e kuptueshme. (...) Të bëhet si një shtojcë për tekstet shkollore të historisë, ku do të prezantoheshin këto fakte në mënyrë 'uniforme', të përkthyer edhe në gjuhët e rajonit. (Anamarija Sočo, Qendra vullnetare Zagreb, Kroaci, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Ndër ato gjëra përmes të cilave ne mund të ndihmojmë është, p.sh., stimulimi i mendimit kritik të rinia. Kjo mund të bëhet përmes një forme të lobimit zyrtar për reformën e sistemit shkollor. P.sh. që të futet lënda e të drejtave të njeriut në shkolla... (Agon Maliqi, Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut, Kosovë, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Web portali është mjet i jashtëzakonshëm për informimin e të rinjve për krimet.

Pse nuk të bëhet një hartë interaktive të ish Jugosllavisë e cila p.sh. do të vendosej në një portal të internetit, dhe ku do të ishin shënimet, pasi që të zbardhen, dhe të shtohen aty sipas radhës që vijnë. Dhe që kur vjen në atë domen, të kesh përnjëherë parasysh, si në flashet e spoteve të ndonjë emisio-ni televiziv, emrat e viktimave ose gjërat e tilla si fotografi, filma, dokumente. (Ivan Novosel, Grupi rinor i Këshillit Kroat të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Mua më duket fantastike ideja e internet portalit, një vendi në të cilin do të mund të kesh të gjitha gjërat, regjistrin e viktimave, faktet historike, filma dokumentar, do të thotë të gjitha në një vend që flasin për temën. (Simon Simonović, Serbi, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Nevojitet strategjia e veçantë për informimin e njerëzve në vendet më pak të zhvilluara mbi krimet e bëra.

Hapi i parë që duhet të bëhet do të ishte hulumtimi me qëllim që të identifikohen dhe përcaktohen vendbanimet që janë më pak të informuara. Konsideroj se suksesi do të ishte shumë më i madh se nëse do të ishim sipërfaqësor, duke vizituar vendet që pak a shumë janë më të informuar për këto çështje. P.sh. mjediset urbane janë shumë më të informuara për këto çështje në krahasim me ato rurale.. (Jehona

Serhati, *Integra*, Kosovë, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Target grupi duhet të janë nxënësit e shkollave të mesme, sepse informimi për të kaluarën duhet të fillohet në moshën sa më të re.

Target grupi duhet të janë nxënësit e shkollave të mesme prej klasës së parë deri të katërtën, pasi që ata janë në fazën kur janë duke krijuar mendimet e tyre, fazë kjo kur edhe krijojnë botëkuptimet dhe qëndrimet. (Naim Leo Beširi, Grupi Rinor i Këshillit të Helsinkit për të drejtat e njeriut, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Në informimin e të rinjve mund të ndikojë shumë përcaktimi i të gjitha vendeve të krimeve që mund të vizitohen gjatë ekskursioneve.

Hapi i parë në atë ballafaqim përgjithësisht duhet të jetë përcaktimi publik i të gjitha vendeve të krimeve sepse viktimat ndihen disi të rrezikuara nëse askush nuk flet për ta. (...) Kështu viktimat do të fitonin një satisfaksion në krejt rajonin. Kjo do të ndikonte në informimin në përgjithësi të të rinjve. (Jelena Bubanja, Grupi Rinor i Këshillit të Helsinkit për të drejtat e njeriut, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

Duhet të themelohet çmimi për personat publikë të cilat promovojnë ballafaqimin me të kaluarën.

Në rajonin tonë ka njerëz të rinj që janë shembull, që merren me art, me muzikë, me film, dhe të cilët meritojnë edhe ndonjë çmim sepse e kanë avancuar ballafaqimin me të kaluarën (...) Kjo iniciativë do të mund të bënte një çmim në çdo shtet të rajonit, dhe që të ndahet për çdo vit. Kjo do të mund të ndikoj në motivacionin. (Iva Prpić, Forumi Rinor i SDP, Kroaci, Konsultat rajonale me të rinjtë, Beograd, Serbi, më 21 tetor 2007).

10. Konsultat rajonale me organizatat për të drejtat e njeriut mbi instrumentet për zbardhjen dhe tregimin e fakteve mbi krimet e luftës

Beograd, Serbi
Më 29 tetor 2007

Konsultat i kanë organizuar Fondi për të Drejtën

Humanitare, Documenta dhe Qendra Kërkimore-Dokumentuese. Kanë marrë pjesë 36 përfaqësues të organizatave për të drejtat e njeriut nga rajoni. Fjalët hyrëse mbajtën Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi), Vesna Teršelić (Documenta, Kroaci) dhe Mirsad Tokača (Qendra Kërkimore-Dokumentuese, BH), kurse moderatore e tubimit ishte Sandra Orlović (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi). Mediat që raportuan për konsultat janë Danas, Beta, Pcnen.com, Infobiro.tv, Radio Evropa e Lirë, Crnps.org.rs dhe H-Alter.

Detyra e organizatave për të drejtat e njeriut duhet të jetë avokimi i themelimit të trupi zyrtar rajonal për zbardhjen dhe tregimin e fakteve për krimet e luftës.

Unë e përkrah bërjen e këtij Komisioni, kjo nuk është çështje, por në këtë situatë kur shteti, elita politike dhe shoqëria nuk janë përcaktuar ndaj të kaluarës, kjo është shumë e vështirë [të realizohet]. (Biljana Kovačević-Vučo, Komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut, Serbi, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Na duhet bashkëpunimi rajonal, kjo çështje është par exelance e karakterit rajonal, çka do të thotë se mund të bëjmë presione në mënyra të ndryshme, siç po ndodh tashmë, që të aftësohen sistemet gjyqësore kombëtare që proceset para gjykatave vendore të fitojnë kredibilitet. Por, po kështu mund të bëjmë presion, të llojmë brenda dhe jashtë, që të themelohet një trup zyrtar rajonal për zbardhjen e së vërtetës. (Slobodan Franović, Komiteti i Helsinkit për të drejtat e njeriut i Malit të Zi, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Ky lloj trupi, Komisionet, mund të diskutojmë për terminologjinë, është diçka imperative. Pra, të gjithë kemi fol për atë se si kanë kaluar komisionet kombëtare, se ka qenë debakël i vërtetë, dhe mua më duket që mu për këtë na duhet një Komision i këtyllë (...) Nëse paraqitemi si rajon, atëherë kjo e ka peshën më të madhe. (Aida Ćorović, *Urban In*, Serbi, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007)

Pajtimi ndoshta është për të diskutuar, por Komisionin për të vërtetën sigurisht se është dashur që të krijohet. (...) Qëllimi ynë është që kur të bëhet ky trup rajonal, i cili do të punoj atë që do të punojë,

të pranohet në krejt rajonin, të ketë rezultate që pranohen në rajon. (Jezdimir Milošević, Aksioni paqësor humanist, BH, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Sigurisht se duhet të përkrahet instalimi i mekanizmit rajonal për zbardhjen e fakteve mbi krimet e luftës në hapësirat e ish Jugosllavisë.(...) Mendoj se avokimi i themelimit të një trupi të tillë ndër të tjerave duhet të jetë detyrë e organizatave për të drejtat e njeriut dhe konsideroj se kjo duhet të ketë një paraqitje të organizuar.(Miroslav Živanović, Qendra për të drejtat e njeriut, BH, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Ky trup rajonal duhet të fokusohet në viktimat dhe faktet, por nuk duhet të merret me zbardhjen e përgjegjesisë për krimet e luftës.

Ne, si organizatë për të drejtat e njeriut, duhet të krijojmë një hapësirë publike për viktimat sepse kjo është para së gjithash me qëllimin e krijimit të këtij trupi që duhet të jetë mandati dhe platforma e jonë. (...) Po, Komisioni duhet të jetë ai vend, hapësirë përmes së cilës viktimat do të mund të tregojnë atë çka u ka ndodhur (Andrej Nosov, Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut, Serbi, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Së pari, duhet të përcaktohet periudha e zbardhjes së fakteve. A janë këto vitet 1992-1995, apo 1991-1995, ose kur bëhet fjalë për Kosovën, 1999-2000. Do të thotë, duhet të përcaktohet saktësisht periudha në të cilën do të zbardhe faktet e caktuara. Çështja tjetër është cilat fakte do ti zbardhim. Dhe e treta, cila është kohëzgjatja e punës së këtij trupi. Nuk mund të jetë periudha prej tre apo pesë vjetësh, sepse njerëzit presin rezultatet. (...) Dhe vërtet duhet të reduktohen faktet që do të zbardhen, sepse kam frikë se nëse e marrim kafshatën e madhe, se nuk do ta mund ta përtypim. Është normale se do të merremi me zbardhjen e fakteve, por nuk do të duhej të merrnim përsipër që tani të zbardhim edhe përgjegjësitë. (Vehid Šehić, Forumi qytetarëve të Tuzllës, BH, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Mendoj se kjo është një iniciativë me vlerë dhe e mirë, dhe se duhet ta përkrahim, sidomos pasi që po shoh

se ekziston edhe një energji në këtë drejtim, por kjo është një gjë që kërkon tepër, tepër shumë angazhim. (...) Qasja rajonale në dokumentimin e të gjitha viktimave, e të gjithë të zhdukurve, kjo është diçka që mendoj se nuk guxojmë ta harrojmë, nuk guxojmë ta neglizhojmë, por kjo punë duhet të përfundohet dhe kjo kërkon bashkëpunim me disa vende, bashkëpunim të ndërsjellë. (...) Po kështu, kjo nisme rajonale do të merret me përcjelljen sistematike të gjyqimeve për krimet e luftës, të cilat ndërkaq mund të kontribuojnë me dokumentimin nga gjykimet lokale të shkeljeve që atje tashmë janë konstatuar, e ne nuk i dimë. Mendoj se këto nisime duhen të çohen deri në fund dha pastaj të merren më punën për çka po bëhen. (Katarina Kruhonja, Qendra për paqen, Joviolençë dhe të drejtat e njeriut, Osijek, Kroaci, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Të dhënat për viktimat janë të rëndësishme por po aq të rëndësishme janë edhe të dhënat se çka i ka paraprirë krimeve, pastaj konteksti politik, shkaqet e luftës dhe interpretimi i të dhënave.

Këtu është i rëndësishëm, pasi që po flasim për viktimat, ai niveli në të cilin tashmë me vite të tëra po punojnë disa organizata. Niveli tjetër janë faktet, dhe jo vetëm ato të lidhura me luftën por edhe për atë çka i ka paraprirë luftës. Biljana foli për kontekstin politik, do të thotë për politikën që kanë shkaktuar luftën. Këtu mendoj para së gjithash në Serbinë sepse [politika e saj] ka qenë më komplekse dhe do të thosha më e rëndësishme. Dhe, e treta, është interpretimi që do të ketë format e ndryshme, nga këndvështrimet e ndryshme, dhe kjo është diçka që do të mbetet temë e bisedave edhe në deceniet e ardhshme. Mendoj se një debat i tillë është diçka që ende po na pret. (Sonja Biserko, Këshilli i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Serbi, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Pos zbardhjes të së vërtetës, ajo çka është tejet e rëndësishme është pranimi i të vërtetës. Mirëpo, duke pas parasysh përvojat e deritashme të mbrojtjes të të drejtave të rrezikuara të njeriut nga institucionet e sistemit, kjo nuk na jep të drejtën për ndonjë optimizëm për të qenë, dhe shumë pak njerëz janë të kënaqur. Por zbardhjes të fakteve, është e domosdoshme po kështu, të hulumtohen shkaqet e të keqes, ideologjitë e së keqes (...) dhe duhet të zbardhet edhe përgjegjësia e mediave, të cilat po kështu mund të radhiten në ato shkaqet e

së keqes, duke zbardhur interesat që e deformuan të vërtetën. (Semiha Kaçar, Këshilli për mbrojtjen e të drejtave dhe lirisë së njeriut i Sanxhakut, Serbi, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Nëse dikush mendon se ne do ta prodhojmë raportin dhe ai raport pastaj diku do të mbledh vetëm pluhurin, atëherë ky trup nuk na duhet fare. Pra, nga kjo fazë, nga zbardhja e së vërtetës, duhet të futemi në fazën e truth telling-ut, pra e tregimit të së vërtetës, dhe nëse doni edhe të interpretimit tonë, pra të atij trupi. Pra, ai duhet të interpretojë disa gjëra, pa përfundime të mëdha, në kuptimin që të tregoj, të sqaroj gjërat, që ato të kanë qartësi të plotë. (Mirsad Tokača, Qendra Kërkimore-Dokumentuese, BH, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Të dhënat janë vetëm njëri prej faktorëve më të rëndësishëm, nuk mund të bazosh përfundimin cilësor në të dhënat e rrejtshme, por nuk mund të pretendosh që të formosh Komisionin që do të merit me të vërtetën, pajtimin, përgjegjësinë, - supozoj jo përgjegjësinë në kuptimin e ndëshkimit gjyqësor -, e të mos ke disa konkluzione, sepse ka diçka në raport me të cilin orientohesh. Nuk mund të shtrembërohet realiteti, nuk mund të falsifikohen të dhënat, nuk guxon të mënjanosh të dhënat e pakëndshme, si thotë verbëri, por interpretimi i të dhënave është detyrë e jonë. (Biljana Kovačević-Vučo, Komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut, Serbi, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Duhet të intensifikohet procesi i konsultave dhe të formohet koalicioni për avokimin e trupit rajonal dhe të strategjisë në drejtim të opinionit, shoqatave të viktimave, institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare.

Është me rëndësi të veprojme në drejtim të opinionit, në mënyrë që kjo të bie në një tokë më të plleshme. Dhe këtu është atëherë shumë e çmueshme të kemi këso konsultash kohë pas kohe në njëfarë mënyrë koordinohen aktivitetet e këtilla, kështu kemi një efekt të sinergjisë, që ne si organizata joqeveritare po e bëjmë aq sa është e mundshme në këtë plan. (Aleksandar Popov, Qendra për rajonalizëm, Serbi, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007)

Para se të flasim për trupat rajonal, mendoj se vitin

tjetër ose dy vite, do të duhej të kishim një proces të konsultave intensive. Dhe jo vetëm të konsultohemi, por një numër të caktuar të propozimeve inventive dhe të praktikave pozitive, do të duhej t'i involvonim në punën, e do të thosha edhe në tekstet programatike të këtyre tre organizatave dhe atyre që janë partnere. (Gordan Bodog, IzMir, Kroaci, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Mua më duket se do të ketë më shumë të tillë të cilët e përkrahin vetë procesin e formimit të Komisionit nëse fillon debati i gjerë publik të cilën do të duhej ta prezantonim në njëfarë mënyre në hapësirën publike. Mendoj se disi mund të gjejmë aleatët në ato shoqëri, shoqatat e viktimave, e mbase edhe në disa vende tjera ku ndoshta nuk e kemi pritur, por është problem si të depërtosh në këtë hapësirë dhe të zgjedhësh strategji të mirë për ta bërë atë. (Maja Stojanović, Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut, Serbi, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Unë jam për atë që ky Komision, pa marrë parasysh a do të quhet rajonal apo ndryshe, të zgjerohet dhe jo të bie si barrë e vetëm tre organizatave që tani janë bosht kurrizor për shpresoj aktivitetin e ardhshëm të përbashkët. Të zgjerohet edhe në Maqedoni dhe në Kosovë, e edhe në Preshevë dhe Bujanoc, ku ka punë dhe ku duhet të punohet. Nuk është problem si do ta emërtojmë Komisionin, duhet të krijohet dhe të zgjerohet. (Behxhet Shala, Këshilli për Mbrojtje e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut i Kosovës, Kosovë, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Për themelimin e trupit rajonal është e nevojshme përkrahja dhe bashkëpunimi i shteteve në rajon.

Nuk mundemi neve të bisedojmë për Komisionin alternativ dhe të presim përkrahjen e shtetit. Kjo është në të vërtetë pyetja e pulës dhe vesë. Ne si shoqëri civile, si organizata joqeveritare që merremi me të drejtat e njeriut dhe drejtësinë **tranzicionale**, duhet të bëjmë presion në shtetin që të pranojë rezultatet tona. Nuk mund të marrim paraprakisht përkrahjen e shtetit, sepse atëherë jemi servisë i shtetit e ne nuk duam që të bëhemi ky servis. (Biljana Kovačević-Vučo, Komiteti i juristëve për të drejtat e njeriut, Serbi, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Shtetet tona drejtohen nga elitat politike që na kanë çuar edhe në luftë. (...) Kushdo që ia ofron [Qeverisë së Malit të Zi] që të formojë këtë Komision, ajo do ta formojë menjëherë, vetëm që ky Komision, si edhe krejt Mali i Zi, do të shërbejnë si fasadë, si makijazh demokratik për t'u laritur institucioneve. (Sabina Talović, Qendra e hapur informative qytetare Bona Fide, Mali i Zi, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Personalisht jam absolutist kundër Komisionit shtetëror por, si e përmendi Natasha, më duket se është qenësore të krijohet Komisioni i pavarur që do të kishte përkrahjen dhe legjitimitetin e shteteve kombëtare, sipas modelit të Gjykatës së Hagës. (Gordan Bosanac, Qendra për studime paqësore, Kroaci, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Strategjia jonë si organizata të shoqërisë civile duhet të jetë që ky Komision të marrë përkrahjen e shteteve. Nëse ajo nuk do të jetë shtetërore, ajo duhet të fitoj këtë status, dhe për këtë kam dy argumente. I pari është se kemi arkivat shtetërore, ushtarake dhe civile. (...) Çështja e dytë e rëndësishme është se çka do të bëhet me rezultatin e Komisionit. Nëse është nismë jozyrtare, kam frikë se do të përfundojë si tekstet e historisë që i përmendi Sonja [Biserko]. Ne sot kemi një tekst alternativë të historisë, të cilin asnjë shtet i rajonit nuk e ka fut në planprogramet, vetëm për arsye se kemi të bëjmë me një nismë jozyrtare të historianëve. (Andrej Nosov, Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut, Serbi, Konsultat rajonale me organizatat për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, 29 tetor 2007.)

Ne jemi më parë në gjendjen e luftës së papërfunduar, se sa në prag të ndërtimit të paqes, kështu që kjo situatë nuk shkon në favor të kësaj, por sigurisht se nuk ka gjasa që tre qeveri në tre shtete të merren vesh rreth formimit të një Komisioni Rajonal. (Aleksandar Popov, Qendra për rajonalizëm Serbi, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Që ku aspekti rajonal të përmbysët paradoksalisht në favor të asaj që duam të bëjmë, duhet, pra, t'i harrojmë institucionet, t'i harrojmë komisionet kombëtare dhe rajonale me legjitimitet jo vetëm të qeverive kombëtare por edhe të shoqërisë. Te ne si duket shumica e shkeljeve të të drejtave të njeriut kanë ndodhur me pajtimin e shumicës dhe ekziston edhe pajtimi i

shumicës që kjo të fshehët. Mund të bëjmë diçka tjetër, dhe ko është që me forca të përbashkëta ta kryejmë komplet këtë punë. (Srđan Dvornik, Këshilli i HelsinKIT Kroat për të drejtat e njeriut, Kroaci, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Absolutisht nuk besoj në këto komisione zyrtare, shtetërore. Në të vërtetë në këto komisione, në këta trupa, ka njerëz që janë përgjegjës për luftën dhe të gjitha pasojat e luftës, kështu që ata nuk janë të interesuar që të zbardhet e vërteta dhe bëjnë gjithçka që ajo mos të zbardhet. Pra, këtyre nuk u besoj, por nuk e përjashtoj aleancën me ta sepse duhet të bashkëpunojmë me ta deri në një kufi. (Behxhet Shala, Këshilli për Mbrojtjen e Lirive dhe të Drejtave të Njeriut Kosovë, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Organizatat joqeveritare mund të organizojnë debat publik mbi nismën e formimit të trupit rajonal por nuk mund ta krijojnë Komisionin që do të kishte fuqinë e zbardhjes dhe të njohjes të fakteve.

Le të kishin qenë në Serbi 70 ose 80 për qind të atyre që e kanë përkrahur politikën e Milosheviqit por nuk ka mënyrë tjetër në hapësirën çfarë është Ballkani Perëndimor pos që të gjejmë ndonjë model që qeveritë të cilat nuk e kanë vullnetin politik, t'i detyrojmë që pranojnë zbardhjen e fakteve. Pa këtë betejë kundër trashëgimisë është e humbur krejtësisht, mbetemi te interpretimet të cilat i kemi sot dhe nuk e kemi absolutisht asnjë shpresë se do t'i lëvizim gjërat për brezat e ardhshëm, betejë është e humbur nëse mbesin në këtë nivelin alternativ, nëse mbesin dhe jemi të kënaqur me këtë çka punojmë sot. Ne vetëm mund të ndihmojmë, nuk jemi akterë politikë. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Qasja rajonale nuk është imponim i pikëpamjeve të përbashkëta, por e vetmja mënyrë që të zbardhet në tërësi ajo çka ka ndodhur.

Bashkëpunimi rajonal nuk është ndonjë imponim i pikëpamjeve të përbashkëta, por është e vetmja mënyrë që në këtë rastin kompleks gjërat të zbardhen në tërësi dhe kjo është gjëja e vetme ku as nacionalistët në të vërtetë nuk kanë çka të thonë sepse

në vepër demonstron se çka do të thotë pranimi i përgjegjësisë nga ana e jonë, edhe pse nuk jemi aspak fajtor, pra pranimi i përgjegjësisë që krimet që janë bërë në emër të kombeve tona, të zbardhen. (Srdan Dvornik, Këshilli i Helsinkit Kroat për të drejtat e njeriut, Kroaci, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Ka nevojë për krijimin e një portali në të cilin do të ruheshin të dhënat dhe faktet e disponueshme që kanë të bëjnë me ballafaqimin me të kaluarën.

... Një lloj portali ose web site, në të cilin do të ishim të linkuar të gjithë ne me arkivat tona, me dokumentacionin që kemi. Mendoj se kjo është e domosdoshme në mënyrë që prej tash e në çdo moment, pasi që i kemi arkivat, dokumentacionet, librat, filmat e caktuar, ato të bëhen të disponueshme për të gjithë që merrem me këto çështje. Duhet të vendoset komunikimi me ato institucione shtetërore në secilin prej vendeve që në këtë mënyrë merrem me këtë temë, që edhe ata të mos janë të përjashtuar. (Sonja Biserko, Këshilli i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Serbi, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

Ky portal për të cilin ka fol Sonja e edhe dikush tjetër, që do të duhej të vendosej, do të ishte shumë i rëndësishëm, ndër të tjerat edhe ngase jemi shumë veta, individë, ose edhe organizata të vogla, që punojmë shumë në mjediset tona lokale. E ky portal, ky bashkëpunim me ju do të ishte një përkrahje shumë, shumë e madhe kur është në pyetje siguria e vetë aktivisteve dhe aktivistëve që merren me këto çështje në mjediset e tyre. (Sabina Talović, Qendra e Hapur Qytetare e Informimit Bona Fide, Mali i Zi, Konsultat rajonale me organizata për të drejtat e njeriut, Beograd, Serbi, më 29 tetor 2007).

11. Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale: Mekanizmat për zbardhjen e fakteve mbi krimet e luftës në ish Jugosllavi

**Beograd, Serbi
11-12 shkurt 2008**

Forumit e Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale

onale e organizuan Fondi për të drejtën humanitare (Serbi), Documenta (Kroaci) dhe Qendra Kërkimore-dokumentuese (BH). Në punën e Forumit të Tretë Rajonal me temën *Mekanizmat e zbardhjes së fakteve mbi krimet e luftës në ish Jugosllavi* kanë marrë pjesë 300 përfaqësues të shoqatave të viktimave, viktimat që nuk janë anëtarë të shoqatave, veteranë, aktivistë të organizatave për të drejtat e njeriut dhe të organizatave rinore, gazetarë, gjykatës, prokurorë, avokatë, deputetë, juristë, historianë, artistë, studentë dhe nxënës të shkollave të mesme. Forumin e hapën kryetari i Kuvendit Popullor të Republikës së Serbisë Oliver Dulić dhe raportuesi special i parlamentit Evropian për Serbinë Jelko Kacin, të cilët i dhanë përkrahje të fuqishëm qasjes rajonale në ballafaqimin me të kaluarën. Për Forumin raportuan: Politika, Dnevni avaz, SRNA, Tanjug, Danas, Blic, Tribune, INA, RTS, TV FOX, Radio Evropa e Lirë, ZaMirZINE.net.

Në lumin e supozimeve, përshtypjeve dhe të ndjenjave, faktet janë të vetmit fanarë tanë. (...) Duke ua dhënë viktimave mundësinë që të flasin dhe neve që ti dëgjojmë, ju kontribuoni në shëndoshjen e shoqërisë sonë dhe mendoj se shoqëritë tona, shoqëritë post-konflikte, edhe më tej janë në procesin e kurimit dhe unë shpresoj, për hir të të ardhmes së përbashkët, të ardhmes të rajonit, që ky kurim do të jetë i shpejtë. Zonja dhe zotërinj, dënimi i krimit dhe të kriminelëve është obligim i yni por edhe nevojë e thellë e brendshme e çdo individit (...) Krimet duhet të ndëshkohen jo për hir të integriteteve evropiane, por para së gjithash sepse këtë i kemi borxh viktimave të krimeve e edhe i kemi borxh edhe ardhmërisë sonë të cilën nuk guxojmë ta ndërtojmë në themelet e brishta të mohimit, harresës dhe shtypjes të së vërtetës. Ky është borxhi ndaj të kaluarës e edhe të ardhmes të cilin e ka çdo funksionar, çdo person publik, çdo intelektual dhe çdo qytetar që jeton në këto hapësira. (Oliver Dulić, kryetar i Kuvendit të Republikës së Serbisë, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Madeleine Fullard, hulumtuese në Komisionin për të vërtetën dhe pajtimin e Afrikës së Jugut, dhe Sofia Macher, anëtare e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin e Perusë, kanë folur për themelimin dhe strukturën dhe përbërjen, si dhe për efektet e komisioneve të këtyre vendeve në zbardhjen e fakteve për të kaluarën.

11.1. Punëtorja: Nevojat dhe pritjet e viktimave

Pjesëmarrësit (viktimat, përfaqësuesit e shoqatave të viktimave dhe të veteranëve dhe aktivistët për të drejtat e njeriut) i kanë dhënë prioritet zbardhjes të së vërtetës, ndëshkimi të autorëve direkt dhe të përgjegjësve për krimet e luftës, kërkimit të të zhdukurve, zbulimit të varrezave masive, identifikimit të kufomave, dhe njohjes të të gjitha viktimave.

Të gjitha viktimat, pa marrë parasysh kombësinë, duhet të njihen si viktime.

Mendoj se edhe te ne në Kroaci duhet të njihen të gjitha viktimat sepse të viktimat e palës serbe shumica i sheh si kriminelë potencialë të cilët edhe e kanë merituar atë çka u ka ndodhur. (Ružica Spasić, Shoqata e familjeve të të zhdukurve dhe kidnapuarve, Kroaci, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008)

Viktimat presin që të zbardhet e vërteta për atë çka ka ndodhur, dhe të gjykojnë autorët e drejtpërdrejtë si dhe ata që kanë dhënë urdhra për krime.

Duhet, pra, të zbulohen kriminelët, autorët e krimeve dhe ata që kanë dhënë urdhrat. Shumica thonë... e ndoshta edhe unë shpesh e pyes vetën, pse kjo, nëse nuk mund të ma kthej babin, apo vëllain, por kjo duhet, sepse mund të ndalojë vazhdimin e krimeve. Do të thotë, duhet të ndodh kjo që krime si këto të mos përsëriten më... (Snežana Zdravković, Shoqata e të kidnapuarve dhe të vrarëve në Kosovë, Kosovë, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Ekzistojnë pritjet e atyre që kanë mbetur pas atyre që kanë pësuar. Dhe në rastin konkret, ja kur jam edhe unë vetë në pyetje, është pritja që të dëgjohet e vërteta. (Sudbin Musić, Shoqata Prijedor 92, BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Pyetjen që shtrohet sot, se çka presin viktimat, unë do ta përkufizoj me një fjalë, e presin të vërtetën. Sepse asnjë kompensim i asnjë lloji nuk mund t'i kthejë ata që janë shkatërruar. Fatkeqësisht nga përvoja personale, dhe përvoja e njerëzve që jetojnë në rrethim tim, mund të them se nuk jemi as një hap më afër të vërtetës se para dhjetë vjetëve, dhe kam frikë që edhe pas dhjetë vjetëve do ta themi të njëjtin konstatim. Sepse e vërteta në këto hapësira është ende pronë e elitave politike. (Jusuf Trbić, Bashkësia

kulturore boshnjake *Preporod*, BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Dhe nëse duhet të thuhet diçka për pritjet që kam, ajo është para së gjithash të zbardhet se kush e ka vrarë nënën time, kjo më intereson shumë, jo që ai të kalbet në burg apo çka di çfarë dënimi tjetër, por më intereson se cili është. Dhe të gjithë na intereson kjo. Më tutje, më intereson fort distancimi i shtetit kroat nga krimi që ka ndodhur aty. Kjo do të thotë se nuk mund të bëhet hero dikush që është kriminel dhe kam kureshtje të madhe që kjo të thuhet qartë. Unë atëherë do të kam satisfacionin që të them, ky është kriminel. Dhe pastaj më intereson fortë dhe do të doja shumë që të mos gënjejhet për këtë, nuk e dua rrenën, mua nuk më duhet që pohohet se në fshatin tim kanë vdekur 50 civilë, kur kanë vdekur 19, por nuk dua as të thuhet se kanë vdekur 2, kur unë di se kanë vdekur 19, sepse i kam njohur, ua di vëllezërit, motrat, unë kam pas bisedë me ta. (Dragan Pjevač, refugjat nga Kroacia, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Procesimi i krimeve të luftës, pra ky është prioritet i të gjitha prioritetëve, posaçërisht që vjen nga komuna ku sigurisht në këtë moment, në atë zonë, është komuna ku më së shumti gërshetohen njerëzit që kanë qenë viktime, me njerëz që kanë bërë krime të luftës. (Edin Ramulić, Shoqata e grave të Prijedorit Izvor, BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Unë e pres të vërtetën, pres që krimet të ndëshkohen sepse ende kemi kriminel që shëtisin të lirë, ndër ta edhe ata më të kërkuarit. Një vjet e gjysmë kam përcjell gjykimin e Shkorpionëve, kam prit se do të përmbushët një pjesë e drejtësisë, edhe pse kjo nuk do të ma kthente babin dhe vëllain tim. Në fund verdikti ka qenë i turpshëm. (Safeta Muhić nga Srebrenica, BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Përvoja ima nga bisedat me viktimat është se, si edhe shumicës prej juve, hatrin e kanë më së shumti te e vërteta, por besoni, të paktën kjo është përvoja ime, jo e vërteta se kush e ka filluar luftën, por çka ka ndodhur me më të dashurit e tyre dhe pse i ka ndodhur kjo. Pse ata janë burgosur jashtë çdo ligji pa armë, si refugjatë me gratë me barrë dhe me fëmijë të vegjël, janë marrë dhe dërguar në kampet e përqendrimin në Bosnje ku janë torturuar, vrarë, zhdukur.

(Tea Gorjanc-Prelević, Aksioni për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Pres që bota në të ardhmen do të jetë ndryshe. Të gjitha kombësive tona, a janë boshnjakë, a janë serbë, a janë kroatë, të mos u ndodhi kjo e keqe, të mos përjetojnë çka ka përjetuar burri im 21 vjeçar kur ma dha në krah vajzën që kishe vetëm 11 ditë dhe më tha: 'Merre Refije, ruaje, unë nuk di a do të kaloj dhe çka do të ndodh me mua dhe a do ta shoh më ndonjëherë'; dhe kurrë më nuk e ka parë dhe asnjëherë asnjë lajm për te nuk është dëgjuar për 12 vjet e gjysmë. (Refija Alić nga Srebrenica, BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Për familjet e të zhdukurve prioritet ka zbulimi i varrezave masive, ekshumacioni, dhe varrimi i kufomave.

Ajo çka është tejet e rëndësishme për familjet në atë moment është që të marrin mbetjet mortore të më të dashurve por është shumë vështirë të kuptohet, ja edhe pas 16 vjetëve, që ne në komunën Zvornik, kërkojmë 500 kufoma. (Mevludin Lupić, Shoqata e familjeve të zënëve rob dhe të zhdukurve të komunës Zvornik, BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008)

Është nevoja që të gjithë ata që kanë dijeni se ku janë varrezat, të tregojnë që ata njerëz të gjinden, që ata mijëra meshkuj dhe fëmijë të vvarë, nuk kanë qenë vetëm burrat në moshë, që të gjinden, dhe të varrosën me respekt dhe ta kanë vendin e tyre ku prehen dhe ne të jemi të qetë. Nëse nuk kanë pas të drejtën për jetë, ta kanë të paktën të drejtën në një vend për varrë, një mezar të vetin, nuk di se si ta them këtë. (Refija Alić nga Srebrenicë, BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Unë menjëherë që nga fillimi, kur filluam të flasim se cilat janë nevojat e viktimave, unë e kam definuar si e vërteta, drejtësia, siguria, siguria gjithësesi ekonomike, sociale, juridike dhe shëndetësore. (Branka Antić Štauber, Shoqata Fuqia e gruas, BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Viktimat kanë të drejtë që të dëgjohen nga të tjerët, të shohin bashkëndjesinë dhe përkrahjen për ta.

Është nevojë dhe fuqi e madhe nëse e ndjeni fjalën e dikujt ose dorën e përkrahjes. Neve na duhet kjo. Dhe mendoj se këtu jemi mbledhur për këtë. Që të gjithë të themi çka ndiejmë dhe për çka kemi nevojë. Të vërtetën tonë ta themi dhe të shohim pastaj, ose të nesërmen pas gjumit, nëse takohemi dhe njëhemi, të dëgjojmë fjalët, dëgjo, më ka prekur ajo çka ke treguar, unë dua të të ndihmoj në këtë mënyrë, mbase mund të ndihmojë (Štefica Krstić, Shoqata Viktimat e luftës atdhetare, Kroaci, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008)

Shoqata e familjeve të serbëve të zhdukur në Kosovë kërkojnë tubim të përbashkët dhe shfaqjen e pietetit ndaj të gjithë viktimave në Ditën ndërkombëtare e të zhdukurve.

Familjet tona kanë një nismë dhe kërkesë që të krijohet një qendër momoriale për të gjitha viktimat në këtë rajon. Mendoj se do të ishte shumë e rëndësishme që në ditën e të zhdukurve që shënohet me 30 gusht, që të gjitha familjet tona fatkeq nga këto hapësirat, të tubohemi në një vend dhe të shfaqim respekt dhe pietet të duhur të gjithë atyre që kanë pësuar. (Verica Tomanović, Shoqata e familjeve të të kidnapuarve dhe të zhdukurve në Kosovë dhe Metohi, Serbi, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Të rinjve duhet t'u lihet trashëgimi e vërteta.

Të rinjtë dhe ajo që sipas meje ka dalë nga dëshmitë e tyre këtu, është se ne jemi përgjegjës që tua lëmë atyre të vërtetën. Ata duhet ta dinë të vërtetën dhe ata vetëm me të vërtetën duhet të vazhdojnë të jetojnë. (Srpanjana Rosandić, Shoqata e viktimave të luftës atdhetare, Kroaci, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Do të thotë se askush nuk mund të ma kthej babin tim. Asnjë kompensim e asgjë tjetër asnjëherë nuk ma kthen babin por vetëm e vërteta dhe drejtësia, sa ka rëndësi për mua po aq edhe për të gjitha viktimat, mund të na kthejnë besimin në të ardhmen, sepse edhe shumica e politikanëve, na thotë neve të rinjve, mendoj, se ardhmëria është e jona. Unë nuk e shoh asnjë të ardhme as për veten as për kolegët e mi të rinj nëse mu ne të rinjtë nuk do të punojmë së bashku me ju në të sotmen, që e ardhmja të na bëhet më e mirë. (Kenan Keserović, delegat në Dhomën e Kombeve të Federatës së BH dhe depu-

tet në Kuvendin e Kantonit të Sanski, BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Dëshmitë publike janë të nevojshme, duhet t'i transmetojnë mediat, dhe t'i dëgjojnë politikanët dhe opinionin.

Sa i përket dëshmimeve publike mbi tragjeditë personale unë mendoj se janë shumë të rëndësishme dhe se te na i kemi shumë pak të dëshmimeve të këtuilla mediale dhe publike, por i kemi nëpër konferenca, seminare, nuk e di pse vetëm të këtyre llojeve, ku në rrethet më të ngushta mund të shihet se si viktimat e shohin njëra tjetrën. Mendoj se dëshmitë publike na duhen dhe se mediat duhet t'i transmetojnë, dhe se ato do të duhej t'i dëgjonin politikanët në postet më të larta në të gjitha vendet e rajonit, ata që drejtojnë këto shtete. (Ružica Spasić, Shoqata e familjeve të Serbëve të zhdukur dhe të kidnapuar, Kroaci, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Pjesëmarrësit kanë propozuar që kushti për integrimet evropiane të jetë procesimi i krimeve të luftës, gjetja e kufomave të të zhdukurve, kërkimi i faljes dhe dialogu shoqëror në të gjitha shtetet e ish Jugosllavisë.

Pra ata këtë kusht për qasje në shoqërinë evropiane duhet të lidhet me procesimin e krimeve të luftës, gjetjen e fakteve të të zhdukurve... - të gjinden më të dashurit e tyre që ende mbahen të zhdukur - që ata të varrosen, në mënyrë që familjarët e tyre të vazhdojnë disi jetën, kurse për ata [viktimat] shumë e rëndësishme është edhe t'u kërkohet falja. (Tea Gorjanc-Prelević, Aksioni për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Dhe ne kemi ardhur deri te një konstatim që përmes bashkësisë ndërkombëtare t'i mohohet qasja integrale euro-atlantike secilit shtet që nuk i ka zgjidhur çështjet e të zënëve rob dhe personave të zhdukur. (Ivan Pšenica, Lidhja e shoqatave të familjeve të mbrojtësve kroat të zënë rob dhe të zhdukur, Kroaci, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Ka veteranë që duan të pranojnë përgjegjësinë e tyre dhe të solidarizohen me viktimat.

Pjesëmarrësit në luftë janë po kështu viktimat dhe

ata do të mbesin disi në margjina, familjet janë nën ndikimin e madh, puna me të rinjtë etërit e të cilëve janë të traumatizuar shumë është tepër e vështirë, dhe mu për këtë edhe këta njerëz duhet të kyçen në dialog.. (Amela Suljić, Nisma rinore për të drejtat e njeriut, BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Desha të them vetëm se ka veteranë që duan të pranojnë përgjegjësinë dhe të punojnë, të kyçen në ndërtimin e paqes dhe ata do të ishin gjithësi të dobishëm Këta veteranë janë diku të gatshëm që të ballafaqohen me të kaluarën, të pranojnë përgjegjësinë e tyre dhe të solidarizohen me viktimat, gjë që e ka rëndësinë e vet. (Novica Kostić, Shoqata Veteranët për paqe, Serbi, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

11.2. Punëtorja: Qasja rajonale zbardhjes së fakteve mbi krimet e luftës

Pjesëmarrësit, shumica gjykatës, prokurorë dhe avokatë të të drejtave të njeriut, vendosmërisht kanë përkrahur gjykimet për krimet e luftës si instrument juridik më i rëndësishëm për përcaktimin e përgjegjësisë individuale penale, por me vetëdijen se ato nuk e sigurojnë të vërtetën e plotë për atë çka ka ndodhur.

Pjesëmarrësit përkrahën qasjen rajonale dhe krijimin e trupit rajonal për faktet e të kaluarës

E para, unë jam për qasje rajonale dhe formimin e një trupi rajonal nga një arsye e thjeshtë. Ajo çka ka ndodhur në hapësirat e ish Jugosllavisë ka qenë në parimin e enëve të lidhura. Sepse kemi shumë të tillë (...) Që kanë ardhë... në Bosnje ose Srebrenicë nga anët e ndryshme dhe kanë bërë krime. Ata janë tani gjeografikisht të ndarë dhe është vështirë që të sigurohen informatat se kush dhe çka ka bërë dhe në cilin vend. Për këtë dhe për hir të së vërtetës dhe pajtimit, është shumë esenciale kjo qasje rajonale. (Amir Kulaglic, Shoqata Gratë e Srebrenicës, BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Dhe kjo është diçka që vetëm mund të na ndihmojë neve përballë përgjegjësisë që kemi për brezat e ardhshëm. Dhe nëse dikush na ndihmon neve, do të doja që të janë këta të rinj me atë porosinë e tyre në këto konsulta kur na thanë: «Ne nuk

kemi përgjegjësi për atë çka është bërë, por duam që të jemi përgjegjës për raportin ndaj asaj që është bërë», dhe në këtë kuptim unë po ju lus që të mendoni për këtë proces, për instrumentin për zbardhjen e fakteve dhe në lidhje me këtë duhet të gjejmë, të kemi mjetin që na ndihmon, të përkrahim gjykimet për krimet e luftës por edhe për të sjellë pak më shumë fakte dhe dritë në atë trashëgimi. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Kam thënë se ekziston bashkëpunimi rajonal mes shoqatave të atyre që kërkojnë zgjidhje për të zënë rob dhe të zhdukurit. Kjo prej kohësh funksionon mirë. Pra, këtu vijmë te barriera e vullnetit politik. Megjithatë, edhe këtu ka disa përparime në krahasim me punën e mëparshme. Sot komisionet për kërkimin në Serbi, Bosnje e Hercegovinë dhe Kroaci, po takohen në Brčko dhe po e kritikojnë punën e shoqatave. Dëgjoni pak, kritikojnë edhe në Serbi, edhe në Kroaci, edhe në Bosnje. Pse? Sepse presioni është drejtuar ndaj tyre. Dhe tani presioni është jo vetëm nga brenda kombit, por është i përbashkët ndaj të gjithëve që e kanë detyra të zgjidhin këtë. (Ivan Pšenica, Lidhja e shoqatave të familjeve të të zënëve rob dhe të zhdukurve, Kroaci, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Gjykimet për krimet e luftës janë instrumenti më i rëndësishëm juridik për përcaktimin e përgjegjësive individuale penale por kanë kufizime serioze (kapacitetet e gjykatave, koha që duhet për hetime dhe procesin, vdekja e dëshmitarëve, frika e dëshmitarëve), që mund të kompensohen me krijimin e trupit rajonal për zbardhjen dhe tregimin e fakteve.

Nevoja për krijimin e një trupi rajonal që do të krijonte ambientin e pajtimit, të klimës në të cilën do të jetë e mundur të gjenden më shumë prova, më shumë dëshmitarë, do të avanconte me siguri edhe gjykimet që po procesohen aktualisht. Nëse kjo nuk ndodh do të kemi për pasojë gjykimet e ngadalësuara dhe shumë pak kriminelë që do të dënohen, ndonëse janë në pyetje komandantët e lartë dhe zyrtarët në funksionet civile dhe politike. Është e sigurt që trupi rajonal do të ofronte shumë prova që do të ishin ndihmesë për gjykatat, gjykatat e rregullta që zhvillojnë proceset, përkatësisht për prokurorët. (Ibro Bulić, Prokuroria e BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Gjithsesi mendoj që është mirë të ekzistojë një trup hetues në nivelin rajonal, që do të ishte servisë së bashku me organizatat joqeveritare që në pjesën më të madhe merren me këto probleme, sepse të gjithë në atë rast do të ishim servis i institucioneve juridike. (Mevludin Lupić, Shoqata e familjeve të zënëve rob dhe të zhdukurve të komunës Zvornik, BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Shoqata e viktimave nga Srebrenica konsideron se pasojat janë të rëndësishme, por më parë duhet të zbardhen shkaqet e luftës dhe të krimeve.

Ne po flasim pak për shkaqet e këtij krimi që ka ndodhur këtu. Për shkakun e krimit deri më sot askush nuk është akuzuar e as dënuar, çka do të thotë se viktima mbetet viktimë, nuk është realizuar drejtësia. Kush e ka marrë të drejtën që ta vras fëmijën tim? Dhe kush e ka marrë të drejtën të më dëboj nga qyteti im, nga banesa ime? Të më dëboj që ai të hyjë në banesën time, që ajo të bëhet e tija. Ku e morri këtë të drejtë? Dhe e kanë marrë këtë të drejtë, që nga fillimi, vetëm një grusht burrash, nuk kanë qenë masat, as shtetet nuk e kanë filluar. Ky grusht burrash ka filluar gjithçka, e kanë sjellë këtë ide, këtë ideologji kriminele..., idenë që kjo të bëhet. Dhe kjo nga askush dhe askund nuk përmendet në këto tubime. Gjithnjë merremi me pasojat dhe flasim për pasojat. Kuptohet se pasojat janë me rëndësi dhe shquhen, që njerëzit të dinë për to, ta dinë ata që nuk kanë përjetuar tragjedinë, se çka mund të prodhojë një e keqe e tillë. Dhe kjo është thelbësore. Por unë e kam thelbësore që në ndonjë mënyrë të gjej edhe satisfacionin. Të vdekurit e mi nuk mund të mi kthej askush. Mua nuk mundet askush të ma kthej as qytetin tim, që ma kanë marrë, rrëmbyer. Ai është tashti i huaj. Është i imi, dhe nuk është i imi. (Kada Hotić, Shoqata Lëvizja e nënave të enklavave të Srebrenicës dhe Zhepës, BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Çështja e amnistimit duhet të merret seriozisht në kërkimin e zgjidhjes për gjetjen e varrezave masive.

Ndoshta metoda do të mund të ishte amnistimi për ata që kanë qenë vetëm realizues të urdhrave, apo jo, ose ata që në çfarëdo mënyrë u janë kundërvënë urdhrat që ka qenë vritni, masakroni, dhunoni, ose edhe, të themi, që kufomat të barten nga një varrezë në tjetrën duke shkatërruar, të themi, edhe

ato pak që kishte mbetur nga kurmet e tyre. (Amir Kulaglic, Shoqata Gratë e Srebrenicës, BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008)

Trupi rajonal për zbardhjen e fakteve mbi krimet e luftës nuk është zëvendësim për gjykatat por është mjet për mbledhjen më efikase të fakteve të reja që mund të shfrytëzohen nga organet gjyqësore, policia dhe prokuroria.

Nuk e duam ne trupin rajonal që do t'i zëvendëson te gjykatat. Asgjë nuk mund t'i zëvendësojë gjykatat. Ato duhet të mbeten si instrument më i rëndësishëm, por ne mendojmë në atë se gjykatat nuk mund t'i ndëshkojnë mijëra e mijëra autorë të krimeve. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008). Formimi i tillë i një trupi që do të zbardhte faktet mund të jetë vetëm me dobi për organet gjyqësore. Kjo mund të bëhet bazë dhe pikënisje për hetimet e organeve gjyqësore, policore dhe të prokurorisë. Është fakt se e vërteta gjyqësore është e orientuar për së tepërmi në faktografi, pa emocione të mjaftueshme, pa ndonjë qasje të ndjesisë ndaj viktimave. Këto janë disa nga mangësitë e së vërtetës të tillë gjyqësore. Nga ana tjetër, këto dëshmi që i kemi dëgjuar para komisioneve për pajtim, janë shumë më të sigurt. Unë jam i sigurt se ka para këtyre komisioneve ka më pak dëshmitarë që nuk e kanë thënë të vërtetën, se sa para gjyqeve. Mu për shkak të situatës që deklarata është dhënë para opinionit në mënyrën direkte, dhe jo në ndonjë segment, siç ndodh në gjyq. (Miroslav Alimpić, Gjyqi i qarkut i Novi Sadit, Serbi, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Trupi rajonal duhet të organizojë dëgjime publike të viktimave, dhe duhet të kërkohet edhe modusi i kyçjes të autorëve të krimeve.

Për mua si një njeri që e ka humbur një pjesë të madhe të familjes dhe të miqve, do të ishte me rëndësi dëshmia publike e atyre që i kanë vrarë më të dashur e mi, që thjesht ta shikoj në sy, që ta shoh, dhe ta pyes: Pse? Unë jam për qasje rajonale dhe formimin të një trupi rajonale edhe për një arsye tjetër të thjeshtë. Ajo çka ka ndodhur në hapësirat e ish Jugosllavisë ka qenë mbi bazën e parimit të enëve të lidhura. Sepse kemi shumë të tillë që kanë ardhur... Kemi shumë të tillë që kanë ardhur në

Bosnje ose në Srebrenicë nga anët e ndryshme dhe kanë bërë krime. Ata janë tani të ndarë gjeografikisht dhe është vështirë që të sigurohen informatat se kush ka bërë çka, dhe ku e ka bërë këtë. Kështu, për hir të vërtetës dhe pajtimit është shumë qenësore kjo qasje rajonale. (Amir Kulaglic, Shoqata Gratë e Srebrenicës, BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Zbardhja e identitetit të viktimave, evidentimi i çdo emri i të vrarëve, të atyre që kanë pësuar dhe të zhdukurve, pengon manipulimin dhe keqpërdorimin e viktimave.

Është fakt se numërimi i viktimave, që secili të ketë një karton personal me emrin, mbiemrin, përshkrimin e mënyrës si ka pësuar etj., është një obligim i vërtetë, para së gjithash ndaj viktimave dhe një gjë tejet e rëndësishme, për atë që zoti Tokaça përmendi dhe me çka unë plotësisht pajtohem, që me këtë të pengohet manipulimi me numra, që është i pranishëm në këto hapësira edhe shumë decenie më parë. (Ljiljana Palibrk, Këshilli i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Serbi, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Trupi rajonal duhet të fokusohet në viktimat e keqbërjeve nga e kaluara por me obligim që të rinjtë të lirohen nga përgjegjësia për trashëgiminë e së kaluarës.

Dhe kjo është diçka që neve vetëm mund të na ndihmojë përballë përgjegjësisë që kemi për brezat e ardhshëm. Dhe nëse dikush na punon neve, do të doja që të janë këta të rinj me atë porosinë e tyre në këto konsulta kur na thanë: «Ne nuk kemi përgjegjësi për atë çka është bërë, por duam që të jemi përgjegjës për raportin ndaj asaj që është bërë», dhe në këtë kuptim unë po ju lus që të mendoni për këtë proces, për instrumentin për zbardhjen e fakteve dhe në lidhje me këtë duhet të gjejmë, të kemi mjetin që na ndihmon, të përkrahim gjykimet për krimet e luftës por edhe për të sjellë pak më shumë fakte dhe dritë në atë trashëgimi. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Pra, deri te një forum rajonal që të krijojë klimën që të mund të thuhet në çdo bashkësi se çka ka

ndodhë dhe që ky person atëherë të marrë kup-timin dhe ne të gjithë të dimë dhe jo të themi se nuk e kemi ditë, sepse e kemi ditë. (Zdenka Pantić, Qendra ndërkombëtare për rehabilitime e viktimave të torturave, Kroaci, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

11.3. Punëtorja: Roli i mediave në krijimin e klimës pozitive për zbardhjen e fakteve

Është nxjerrë konkludimi se shoqëria civile, OJQ-të dhe mediat duhet të janë akterët kryesor në krijimin e klimës pozitive për promovimin e nevojës dhe të detyrimit për zbardhjen dhe tregimin e fakteve mbi krimet e luftës. Mediat duhet të përkrahin integrimin e veteranëve dhe rolin e tyre në demistifikimin e stereotipave mbi ushtarët e armikut si kriminelë.

Mediat mund të kontribuojnë në krijimin e pikturës më të plotë mbi krimet e luftës, solidaritetin dhe bashkëndjesinë me viktimat nga shoqëritë tjera .

Shembulli i Latinicës, e cila foli për krimet që i ka bërë ushtria kroate në Bosnje e Hercegovinë, mua më bind se është e mundshme që të plasohet në serviset publike një tregim i hapur, objektivi dhe i ndriçuar nga të gjitha anët. (Borka Rudić, Shoqata Gazetarët e BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Niveli kombëtar është i rëndësishëm, por qasja rajonale mundëson që të shihen dhe të dëgohen edhe viktimat tjera.

Unë mendoj, ju keni plotësisht të drejtë, që gjëja e parë që unë mendoj se duhet të jetë pikënisja në nivelin kombëtar, por ajo çka është e pamundur, në të vërtetë çka e pamundësinë që ky lloj i punës të kryhet në nivelin kombëtar, është mu ky mosekzistim i trupit rajonal. Sepse mu ky mundëson që të krijoni pikturën për atë se çka keni bërë dhe si merreni me këtë. (Milica Tomić, artiste pamore nga Beogradi, Serbi, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Mirëpo, pse na duhet neve sërish bashkëpunimi dhe mirëkuptimi rajonal? Nuk mundemi ne, p.sh.

në Mal të Zi, të ndërtojmë klimën, klimën pozitive për zbardhjen dhe tregimin e krimeve të luftës, nëse fqinji ynë është në pozicionet e vitit 1992, ose kur e kemi agresorin në pozitat e vitit 1992, dhe për këtë mendoj që vërtet duhet të bëhet diçka në këtë aspekt. (Šeki Radončić, javorja Monitor, Mali i Zi, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Mediat në një pjesë të vendit raportojnë vetëm për krimet në pjesën tjetër të vendit dhe vrasësit dhe kriminelët janë gjithnjë një anën tjetër. Për këtë mendoj se është shumë e rëndësishme që t'i kalojmë kufijtë pa marrë parasysht se a janë ato shtetërore, të entiteteve, rajonale, komunale, etj. (Borka Rudić, Shoqata e gazetarëve BH, Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Beograd, Serbi, 11–12 shkurt 2008).

Dëgjimi publik i viktimave

Në këtë sesion, viktimat dhe anëtarët e familjeve të viktimave nga Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Serbia, Mali i Zi dhe Kosova, dëshmuar për padrejtësitë që kanë përjetuar gjatë luftës ndërkaq dy miq, Jusuf Trbić dhe Đorđe Krstić, treguan se si kanë lidhur miqësi të përhershme në ditët kur Arkani sundonte në Bijelinë (prill 1992).¹

12. Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave, viktimat dhe veteranët mbi mekanizmat e zbardhjes së fakteve për krimet e luftës

**Podgorica, Mali i Zi
9 maj 2008**

Konsultat i organizuan FDH, Documenta dhe QKD në bashkëpunim me Shoqatën e banorëve të Bukovicës dhe të Plevles dhe Shoqatën e familjeve të të kidnapuarve, të zhdukurve dhe të vrarëve nga viti 1998 deri në vitin 1999 në Kosovë, *Crveni božur*. Fjalën hyrëse e mbajtën Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi), Vesna Teršelić (Documenta, Kroaci), Mirsad Tokača (Qendra Kërkimore-Dokumentuese, BH), Jakub Durgut (Shoqata e banorëve të Bukovicës dhe Plevles, Mali i Zi) dhe Ljubiša Filipović (Shoqata e familjeve të të kidnapuarve dhe të vrarëve në Kosovë *Crveni božur*, Mali i Zi). Tubimin e shënoi lancimi i nismës për krijimin e Komisionit rajonal për zbardhjen dhe

¹ Video regjistrimi i dëshmitë të viktimave në: www.korekom.org

tregimin e fakteve mbi krimet e luftës (KOMRA) të cilën nismëtarët FDH, Documenta dhe QKD e prezantuan si konkretizim të përkrahjes që pjesëmarrësit e konsultave i dhanë qasjes rajonale si metodës më të besueshme për zbardhjen dhe tregimin e fakteve për krimet e luftës. Pjesëmarrësit (44), përfaqësuesit e shoqatave të viktimave, viktimat që nuk janë anëtarë të shoqatave, dhe veteranët nga Mali i Zi, Kroacia, BH, Serbia, Maqedonia, Sllovenia dhe Kosova, e kanë përkrahur nismën për themelimin e KOMRA, me bindjen e thellë se nisma do të marrë përkrahje të fuqishme nga shoqatat e familjeve të të zhdukurve në të gjitha vendet post-jugosllave, por të vetëdijshëm se pa vullnetin politikë të qeverive kombëtare dhe përkrahjen e fuqishme të bashkësisë ndërkombëtare nuk do të ketë jetësim të nismës. Tubimin e paralajmëroi gazeta Dan e Podgoricës.

Komisioni Rajonal është komplementar me gjykimet për krimet e luftës.

Komisioni Rajonal për zbardhjen e fakteve për krimet e luftës është i vetmi institucion që mund të sigurojë zbardhjen e fakteve, respektin dhe njohjen e viktimave në kornizën rajonale. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Drejtësia gjyqësore është e rëndësishme, ajo është e pashmangshme, ndërkaq ajo që neve propozojmë është komplementare me procesin gjyqësor. (Mirsad Tokača, Qendra Kërkimore-Dokumentuese, BH, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Gjykatat në vendet tona, në Kroaci, Bosnje dhe Hercegovinë, Serbi, në Kosovë, shikuar veç e veç gjatë një vit zhvillojnë nga 25 deri 30 procese. Çka paraqet kjo në krahasim me numrin tepër të madhe të të vrarëve, të zhdukurve, të torturuarve, të zënë rob dhe të dëbuarve me dhunë? (...) Andaj na duhet një mekanizëm që do të jetë komplementar me atë që bëjnë gjykatat. (Vesna Teršelić, Documenta, Kroaci, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Sa i përket formimit të Komisionit Rajonal kjo është më e mira çka mund të ndodh, garanton suksesin dhe mendoj se të gjithë do të kyçemi në këtë komision dhe me garanci do të arrijmë që ti gjejmë shumicën dhe t'i varrosim si i ka hije njeriut. (Ljubiša Filipović, Shoqata Crveni božur, Mali i Zi,

Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Komisioni Rajonal i fokusuar në viktimat mund të zvogëlojë hapësirën për gënjeshtër dhe manipulime.

Është iluzore dhe ne nuk duhet të bimë në këtë grackë, se cilido komision apo trup do të jetë në gjendje ta zbardhë të vërtetën absolute, kjo është thjesht e pamundshme. Por, çka do bëjmë, Mund të zvogëlojmë hapësirën për gënjeshtër si dhe hapësirën për manipulime të llojeve të ndryshme. (Mirsad Tokača, IDC, BH, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Ky Komision do të jetë institucion të cilit duhet ti besohet, dhe nëse ai realizohet disi shkel e shko, e vërteta do të zbardhet, dhe ndoshta për dikë do të jetë e dhimbshme... dhe ne jemi të vetëdijshëm se ajo duhet të jetë shumë më cilësore dhe nuk del e tillë, a do të jetë rrezik që ta pranojmë të tillë, mos ndoshta është herët për këtë? (Kada Hotić, Shoqata Lëvizja e nënave të enklavave Srebrenica dhe Zhepa, BH, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Unë mendoj se puna bazë është zbardhja e fakteve, duhet të bëhet regjistri i të vrarëve dhe i të zhdukurve dhe të vihet pika në këtë. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Mendoj se është me rëndësi që viktimat të fillojnë tregimin e dëshmimeve të tyre, dhe më pak të flasim për kriminelët, ata herë a vonë do të vijnë në rend sepse ata askush nuk mund t'i mënjanojë dhe nuk kanë ku të ikin, krimet dihen dhe nuk ka si fshihen. (Miroslav Varga, veteran nga Kroacia, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Vetëm Komisioni Rajonal mundet me i mbledh të gjitha viktimat.

E përkrah këtë Komision, mendoj se është dashur qëmoti ta kemi, shumë dëshmitarë për fat të keq nuk janë më gjallë. Disa janë zhvendosur. Më vjen mirë që jemi mbledhur nga viset e ndryshme. Këtë vërtet nuk do ta besoj se do të mund të mblidheshim kështu në një vend. Propozoj që sa më parë të

fillojmë me punën e Komisionit, të japim sot propozimet tona dhe për mënyrën se si do të organizohet. Është shumë me rëndësi që njerëzit të arrijnë deri te e vërteta për të afërmit që kanë pësuar. (Zdravka Karlica, Organizata komunale e familjeve të luftëtarëve të zënë rob dhe të vrarë dhe të civilëve të zhdukur nga Prijedori, BH, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Është nevoja për rrjetin e fuqishëm dhe të gjerë dhe përkrahjen e shoqatave të familjeve të viktimave dhe të OJQ-ve në rajon, për të bërë presion që qeveritë e tyre ta pranojnë nismën.

Kemi vendosur [FDH, QKD dhe Documenta] të fillojmë me krijimin e koalicionit rajonal në lidhje me nevojën e zbardhjes së fakteve dhe së vërtetës për krimet e luftës dhe që ky koalicion të punojë mbi parimin e punës së drejtpërdrejtë në nivelet e ndryshme: nivelet lokale, kombëtare dhe rajonale. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Kjo është shumë mirë që na keni mbledh të gjithë ne të themi mendimin tonë dhe konsideroj se do ta keni përkrahjen edhe nga anëtarët e familjeve tona kur t'ua përcjell informatën se çka u morëm vesh në këtu dhe sipas të gjitha gjasave të gjithë përfaqësuesit do të pajtohen me krijimin e Komisioni Rajonal. Sepse vetëm kështu do të arrijmë rezultatet. (Olgica Božanić, Shoqata e familjeve të të kidnapuarve dhe të zhdukurve në Kosovë, Serbi, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Unë plotësisht përkrah këtë aksion të Fondit për të Drejtën Humanitare, Qendrës Kërkimore-Dokumentuese dhe Documenta, por besoni që ju nuk mund të keni sukses nëse nuk e fitoni, ose nuk e fitojmë, përkrahjen, së pari nga të gjitha shoqatat në hapësirat e ish Jugosllavisë, e sidomos nga qeveritë dhe burrat e shtetit. Ata do të detyrohen të pranojnë vetëm nëse neve ndërmjet veti do të jemi solidarë dhe në harmoni. Neve do t'i detyrojmë ata që kjo nismë të jetësohet. (Simo Spasić, Shoqata e familjeve të të kidnapuarve dhe të vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Mendoj se ky trup rajonal, pos zbardhjes së fakteve si prioritet do të duhej të kishte edhe pranimin e

fakteve të zbardhura në komunitetet ku janë bërë krimet e luftës. (Edin Ramulić, Shoqata Burimi / Izvor e grave nga Prijedori, BH, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Mendoj se të gjithë së bashku, neve në këtë tubim, duhet të jemi të bashkuar në ndjekjen e të gjithë atyre [kriminelëve] pa marrë parasysh racën, kombësinë apo gjininë e tyre. (Ahmed Graiçevci, Shoqata Shpresa dhe Kujtimi, Kosovë, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Kur bëhet fjalë për Komisionin në nivel rajonal, mendoj se është nisme shumë e mirë, që do të përfshihen të gjitha palët, pa marrë parasysh fenë apo kombin, dhe të gjitha palët do të mund të tregojnë sa mund t'i ndihmojnë njëra tjetrës. (Shoqata e familjeve të të kidnapuarve dhe të zhdukurve në Kosovë, Serbi – zyra në Hoçë të Madhe, Kosovë, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008)

Kur e mora ftesën nga Nataša Kandić që të marrë pjesë jo vetëm në këtë mbledhje, por edhe ato mbledhjet e para që janë mbajtur, ne e kemi përkrahur dhe e përkrahim këtë nismë, dhe unë gjithnjë i them vetes se nuk ka alternativë tjetër pos që të ndriçohet e vërteta mbi atë se çka ka ndodhur. (Hysni Berisha, Shoqata Shpresimi, Kosovë, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Ne këtu sot me rend siç po lajmërohem për fjalën, të gjithë e japim përkrahjen. Kam frikë se në fund do të vijmë deri te ajo që shpesh ndodh me tubime të tilla, se çka ndodh pas tyre. Është e kotë që sot të çojmë dorën dhe të deklarohe mi, nëse edhe në vetëdijen tonë nuk ndryshojmë dhe bëhemi ajo forcë motorike që atë trup, çfarëdo që do ta emërojmë, e shtyjmë që të jetë në nivelin e funksionit dhe misionit që duhet ta ketë. (Čedomir Marić, Shoqata e familjeve të personave të vrarë dhe të zhdukur në Krajinë të Kroacisë, Serbi, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008)

Të gjithë e kanë të vërtetën e tyre por faktet janë e vërteta më e fortë.

Kroatët do ta thonë të vërtetën e tyre, me këtë pajtohem, urdhëroni, e keni të drejtën për te. Serbët

do ta thonë të vetën, unë tash nuk do ta them këtu, unë jam serb. Unë nuk do ta them këtu që të mos i ofendoj kroatët, kam konsiderata. Por, që kanë ikur 250.000 apo 130.000, ose nuk di sa, këtë do ta konstatojë dikush, ky është fakt. Shembulli i dytë, në fshatin tim kroatët do të thonë – nga ky fshat, Çitluku, e kanë granatuar Gospiqin, dhe është dashur që të zgjidhet kjo. Serbët do të thonë, jo, për një vjet, dhe unë e kam vërtetuar këtë, askush nuk e hedhur asnjë granatë drejt Gospiqit. Dhe këtu nuk do të pajtohem dhe kjo është në rregull, nëse ju insistoni, secili e ka të vetën. Por nuk mund të mohohet se 13 mijë veta janë masakruar, kjo nuk mund të mohohet, unë nuk dua tash ta ngarkoj këtë tubim, aty ka qenë nëna ime, dhe kjo tani po hetohet edhe në Zagreb. Për këtë të vërtetë nuk kemi çka të flasim, ky është fakt. Edhe diçka, ta përfundoj, në Lovincë gjithashtu, edhe në Lovincë para kësaj po kështu, por fatkeqësisht nuk di saktë sa, janë vvarë pesë ose gjashtë kroat, gjyshe, plakushë. Janë vvarë dhe unë kam dëgjuar, sepse edhe ajo e paska pas pushkën nën fund. Edhe ky është fakt dhe e edhe kjo është e vërtetë. (Dragan Pjevač, refugjat nga Kroacia, Serbi, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008)

Pjesëmarrësit nga Kroacia dhe BH propozojnë kyçjen e veteranëve dhe të autorëve të krimeve në procesion e zbardhjes dhe të tregimit të fakteve mbi krimet e luftës.

Unë kam qenë pjesë e Armatës së Republikës së Bosnje-Hercegovinës dhe nuk turpërohem për këtë por dua ta ndaj grurin nga bari i keq, dua që të mbetet e shënuar qartë në histori, se kush ka qenë ai që ka bërë krime duke u thirr në emrin tim ose në emër të kujtdo tjetër. (Amir Kulagić, Shoqata Gratë e Srebrenicës, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Unë mendoj se brenda organizatave të veteranëve ka hapësirë, në tërë rajonin, por unë do të flas për Kroacinë, ku do të ishe mirë që të organizoheshin njoftimet e krejt popullatës për kontekstin e kësaj nisme rajonale dhe vazhdimin e punës deri te paraqitja e trupit zyrtar rajonal. (Gordan Bodog, Shoqata iZmiR, Kroaci, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Unë do të kërkoja nga të gjithë të pranishmit që të kemi bashkëpunim të mirë dhe veçanërisht nga shoqatat e veteranëve të luftës, që ato të japin

maksimumin dhe ndihmën më të madhe që të zbulohen autorët e krimeve, të gjenden eshtrat e të zhdukurve kudo që i kanë fshehur. Po kështu, kërkoj nga të gjitha shoqatat që të bëjnë presion te qeveritë e tyre, te gjykatat, te prokuroritë që të punojnë sa më shumë në zbulimin e autorëve të krimeve dhe të atyre që kanë dhënë urdhra. Për zbulimin e krimeve mund të kontribuojmë të gjithë, por veçanërisht ata që kanë marrë pjesë në luftë. (Nazmi Veseli nga Podujeva, Kosovë, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Në të vërtetë, ka veteranë që janë të gatshëm t'i dënojnë krimet që janë bërë në emër të tyre. (Novica Kostić, Shoqata Veteranët për paqe, Serbi, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Viktimat kanë nevojë për bashkëndjesinë dhe solidaritetin e viktimave nga komunitetet tjera. Viktimat kanë nevojë që të flasin për vuajtjet e tyre, padrejtësinë dhe kërkimin e të afërmeve.

Edhe pse e kam humbur djalin unë jam në gjendje që t'ia shtrij dorën çdo serbi të cilit i ka ndodhur ajo çka më ka ndodhur mua. (Osman Jashari nga Hallaqi i Vogël, Kosovë, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

E kam dëgjuar këtu një gjë të bukur: na duhet bashkëndjesia me viktimat e popullit tjetër. Bashkëndjesia, kjo është vetëm një ndjenje, por neve na duhet edhe solidariteti. Kam dëgjuar këtë me vite dhe e dëgjoj edhe këtu, por unë e kam kryesore që të kuptoj ku gjendet trupi i të afërme të mi. Solidariteti shihet mu në këtë që asociacionet ku unë jam anëtar të bëjnë diçka për gjetjen e dikujt që dikush tjetër këtu e kërkon në hapësirat e mia. Ja, ky është solidariteti, jo vetëm që të kërkoj timin, por të kërkoj edhe atë tjetrin, që t'i ndihmoj tjerëve që kërkojnë t'i gjejnë eshtrat e të afërmeve; nëse unë nuk i gjej, le të gjej ai të vetin që ka vdekur ose është zhdukur. (Amir Kulagić, Shoqata Gratë e Srebrenicës, BH, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Zbulimi i të zhdukurve është e vërteta për të cilën luftojnë familjet e tyre.

E përkrah... Jam nga ato familjet që kanë arritur për fat, po e përdori fjalën fat edhe pse e kam humbur të vetmin djalë që kisha më 1995. Është vvarë në

Knin, dhe pas tetë vjetësh të pasigurisë kisha fatin që të marrë kufomën e tij dhe ta varrosi. Unë kam vazhduar të luftoj me familjet tjera që edhe ato të përjetojnë këtë fat. E përdori fjalën fat, edhe pse për ata që nuk e kanë përjetuar këtë mund të duket e pavend dhe e pakuptueshme. Fat është të dalësh nga pritja, nga ankthi, dhe të gjesh atë që e ke pritur me vite, ta dish se ku e ke gdhend emrin e tij dhe ta ndezësh një qiri. Ja, kjo është për familjet dhe shoqatat tona qëllimi kryesor, kjo është e vërteta për të cilën po luftojmë. (Čedomir Marić, Shoqata e familjeve të personave të zhdukur dhe të vrarë nga Krajina në Kroaci, Serbi, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Ne tërë kohën pyesim ku janë trupat. Nuk kemi marrë përgjigje në këtë dhe andaj kërkojmë nga shoqatat serbe, që e kanë hallin e njëjtë si ne, të afrohen dhe të bashkëpunojnë, të këmbëjnë informatat, sepse ne jemi ata që procesin mund ta shtyjmë përpara për të arritur qëllimin që po na mundon. (Hysni Berisha, Shoqata Shpresimi, Kosovë, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Unë këtë Komision e shikoj në këtë mënyrë: ky Komision duhet të ketë dy ekipe, ekipin për zbardhjen e së vërtetës, dhe ekipin për kërkimin e të zhdukurve. (Narcis Mišanović, Organizata unike e luftëtarëve të BH, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Është me rëndësi që Komisioni të jetë shtetëror por edhe i pavarur.

Kryesorja është që në këtë Komision fjalën ta kanë viktimat, përkatësisht familjet e tyre. Kryesore është të ketë rregulloren cilësore, rregulloren e punës, orientimet dhe programin e punës, të dihet se cili është qëllimi, misioni i Komisionit, që mos të ecën vërdallë. Kryesore është që nga shteti t'i nxjerrim, përkatësisht t'i fitojmë me presione, kompetencat e plota që nga bashkësia lokale e deri te ministrinë. Kur Komisioni kërkon ndonjë informatë, ajo duhet të sigurohet shpejt dhe të jetë cilësore. Pra, të jemi shtetëror, por edhe të mos jemi shtetëror, vetëm të na financojë shteti. (Narcis Mišanović, Organizata unike e luftëtarëve të BH, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit duhet ta bëjë një trup i veçantë për emërimet, që do të përbëhet nga përfaqësuesit e viktimave, të organizatave për të drejtat e njeriut, të rinjve, pastaj edhe me përfaqësues të qeverive kombëtare, të Sekretarit gjeneral të OKB dhe të UE.

Propozimi im është që në këtë Komision të jenë patjetër viktimat, përkatësisht njerëzit ndaj familjeve e të cilëve janë bërë krimet. Kuptohet, nëse në këto Komisione nuk do të kemi edhe përfaqësuesit e qeverive, nuk di a do të mund të mbijetonim financiarisht, apo të kryhen proceset gjyqësore që duhet të zhvillohen. Sepse qeveritë janë ato që edhe sot e gjithë ditën pengojnë ndriçimin e fateve dhe kyçjen e organeve hetuese në hetimet e ndryshme për krimet e bëra ndaj njerëzve të pafajshëm. (Milorad Trifunović, Shoqata e familjeve të personave të kidnapuara dhe të zhdukura në Kosovë, Serbi – Zyra në Mitrovicën Veriore, Kosovë, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Propozoj përbërjen e këtij Komisioni Rajonal: të ketë trupin koordinues operativ me në krye këto tri organizata joqeveritare, dhe që përfaqësuesit e të gjitha shoqatave që janë aktive në zbardhjen e së vërtetës dhe zgjidhjen e të gjitha këtyre problemeve tona kryesore, të delegohen në të ashtuquajturin forum, pra forumin e Komisionit Rajonal, i cili do të takohej kohë pas kohe dhe do të vendoste për disa gjëra të caktuara, esenciale. (Dragan Sekulović, Qendra për komunikim Pravda [Drejtësi] – Shoqata e refugjatëve dhe të dëbuarve nga Kroacia, Serbi, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Pjesëmarrësit propozojnë krijimin e portalit të Koalicionit për Komision rajonal.

Propozoj që të formohet, si e tha dikush më parë, portali i koalicionit rajonal, që do të ishte në katër gjuhë, në mënyrë që në atë portal secili mund të gjejë faktet që i interesojnë. Propozoj që të themelohet buletini mujor ku do të botoheshin të dhënat më interesante dhe më të mira. (Dragan Sekulović, Qendra për komunikim Drejtësia- Shoqata e të shpërngulurve dhe të dëbuarve nga Kroacia, Serbi, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

Idea ime është që të bëhet një web portal rajonal në të cilin do të prezantohej çdo viktimë. (Miroslav

Varga, veteran nga Kroacia, Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave dhe veteranët, Podgoricë, më 9 maj 2008).

13. Konsultat kombëtare me shoqërinë civile mbi nismën KOMRA

Mitrovicë, Kosovë
26 qershor 2008

Konsultat kombëtare me shoqërinë civile i organizuan Fondi për të drejtën humanitare i Kosovës dhe Community Building Mitrovicë (Kosovë). Diskutimet e pjesëmarrësve [40], nga organizatat për të drejtat e njeriut, shoqatat e të burgosurve politikë dhe shoqatave të familjeve të të zhdukurve janë zhvilluar në një atmosferë shumë të emocionuar. Fjalën hyrëse e mbajtën Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi), Vesna Teršelić (Documenta, Kroaci) dhe Valdete Idrizi (Community Building Mitrovicë, Kosovë).

Viktimat kanë nevojë të fuqishme për të treguar çka u ka ndodhur dhe të tregojnë me emër autorët. Përfaqësuesit e shoqatave të viktimave dhe Këshilli për të drejtat e njeriut nga Prishtina konsiderojnë se autorëve të krimeve të luftës duhet të gjykohej aty ku janë bërë krimet.

Ata që kanë bërë këtë, ata duhet të ekstradohen këtu, në vendin ku e kanë kryer krimin, ngase nuk mund të dënohen në Serbi për krimet që kanë kryer në Kosovë, dhe nëse shkohet me këtë dinamikë si ka shkuar deri tani, edhe 1000 vjet nuk do të përfundojnë gjykimet për krime ndaj shqiptarëve në Kosovë. Pra, unë fuqishëm e mbroj qëndrimin që të gjithë ata që kanë kryer krime në Kosovë, të përgjigjen në Kosovë, ata që kanë kryer krime në Serbi në Serbi, ata të Kroacisë në Kroaci. Pra krimet duhet të kthehen në vendin e origjinës së krimit. (Behxhet Shala, Këshilli për të drejtat e njeriut, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, më 26 qershor 2008).

Përfaqësuesit e organizatave serbe nga Mitrovica veriore janë angazhuar për regjistrimin me emër e të gjitha viktimave dhe për rishqyrtimin vetëkritikë të përgjegjësive vetjake.

Çdo komunitet së pari duhet të ketë qëndrim kritik ndaj vetvetes. Këtu kryesisht flitet për komunitetin tjetër me një dozë të mosbesimit që është, hajt të

themi, deri diku e arsyeshme ngase njerëzit që kanë bërë krime të luftës duhet të dënohen, por para së gjithash secili duhet të filloj pastrimin në oborrin e vet duke e kryer obligimin që ka. (Aleksandar Stojanović, Qendra për zhvillimin e shoqërisë civile, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, më 26 qershor 2008)

Viktimat që nuk janë anëtarë të shoqatave të viktimave e kanë përkrahur nismën rajonale dhe gjykimet për krimet e luftës pa marrë parasysh a gjykohej në Serbi apo Kosovë.

Komision Rajonal i së drejtës apo së vërtetës, kjo me siguri në fund do të emërtohet, por si kuptim Komision Rajonal, pra kur lexojmë këtë emërtim, nënkuptojmë se ky duhet të shtrihet jashtë kufijve shtetërorë, sepse me një bllokadë të tillë të shteteve që kanë qenë në luftë të armatosur nuk mund të arrihet tek e vërteta. Vetëm thyerja e këtij muri ose këtij kufiri dhe përfshirja rajonale e të gjithë atyre që luftojnë për të vërtetën dhe të drejtën mund të arrihet sado pak një sukses. (Lush Krasniqi nga Korenica, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, më 26 qershor 2008).

Aktivistët e organizatave të të rinjve dhe juristët që kanë marrë pjesë në konsulta ia dhënë përkrahje të madhe zbardhjes së fakteve. Kanë propozuar që edhe në konsultat e ardhshme të bisedohet për amnistinë si mënyrë që të arrihet deri te e vërteta. KOMRA duhet të ketë mandatin e kufizuar kohor.

Mendoj që ndoshta për të nxjerrë diçka ndoshta amnistia do të ishte e nevojshme, se është më mirë me pas të vërtetën sesa me pas gjykimin. E dyta, kisha dëshiruar që ky Komisioni të ketë jetëgjatësi sa më të shkurtër, në kuptimin që ta kryejë mandatin e vet sa më shpejt, sa më shpejt të vijë tek e vërteta, dhe gjitha ato që duhet të dalin nga ky Komision. Faleminderit. (Milot Berisha, Nisma për të drejtat e njeriut, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Mitrovicë, Kosovë, më 26 qershor 2008)

14. Konsultat kombëtare me shoqatat e viktimave mbi KOMRA

Beograd, Serbi
15 korrik 2008.

Konsultat kombëtare me shoqatat e viktimave i orga-

nizoi Fondi për të Drejtën Humanitare (Serbi). Këto konsulta kanë qenë tubimi i parë përgatitor me shoqatat e viktimave në Beograd, kur pjesëmarrësve u është prezantuar Deklarata mbi themelimin e koalicionit rajonal për zbardhjen e fakteve mbi krimet e luftës (KOMRA), e cila do të udhëheq në të ardhmen procesin e konsultave. Është shfaqur video regjistrimi nga konsultat rajonale në Podgoricë më 9 maj 2008, në të cilat është zyrtarizuar nisma për themelimin e KOMRA. Në tubim kanë marrë pjesë 16 përfaqësues të shoqatave të viktimave dhe 5 vëzhgues, kurse fjalën e hyrjes e kishin Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi) dhe Lidija Škaro (Komisioni ndërkombëtarë për personat e zhdukur, BH).

Përkrahet nisma për formimin e Komisionit Rajonal dhe është vlerësuar që ajo do të jetë ndihmesë më e madhe për viktimat.

Përsëritës nismën për themelimin e Komisionit Rajonal. Dëshiroj që të themelohet sa më parë dhe që të filloi me punët, që të kryhen gjërat konkrete dhe kjo në afatet sa më të shkurta. (Olgica Božanić, Shoqata e familjeve të personave të kidnapuara dhe të zhdukura në Kosovë, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008)

Përkrah në tërësi aksionet e këtij Komisioni që në hapësirat e ish RFSJ më në fund të kuptohet e vërteta mbi të gjitha viktimat pa marrë parasysh besimin apo kombin. Unë garantoj me jetën time që shumë veta në Serbi do ta kritikojnë këtë ide, ose këtë nismë, por kur ne e mbështesim atë Komision, nuk do të ketë nevojë që askush në Serbi të ngritë zërin sepse askush nuk është humbës pos familjeve tona. Garantoj se ne do të mbledhim në territoret e Serbisë dhe të malit të Zi 400.000 nënshkrime për këtë Komision. (Simo Spasić, Shoqata e familjeve të personave të kidnapuara dhe të zhdukura në Kosovë dhe Metohi, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008)

Unë mu në këtë angazhimin të sotëm për themelimin e Komisionit rajonal, shoh një lloj të komunikimit më të qëndrueshëm, lidhjen e shoqatave të viktimave nga ish Jugosllavia, dhe më duket se në praktikë kjo lidhje rajonale, kërkimi i përbashkët i të zhdukurve, po tregohet si nevojë. Asnjë konsultim tjetër, asnjë tubim tjetër, pa marrë parasysh a bëhet fjalë për gazetaret, organizatat për të drejtat

e njeriut, të rinjtë, artistët, apo shkrimtarët, nuk ka qenë kaq i qartë dhe me kaq shumë përkrahje për zbardhjen e fakteve mbi krimet e luftës dhe sqarimin e fatit të personave të zhdukur, sikur që kanë qenë konsultat me shoqatat e viktimave dhe viktimat. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008)

Të gjithë njëzëri e përkrahëm krijimin e këtij Komisioni Rajonal, dhe gjithë atë çka do të bëhet në zbardhjen e krimeve, në nxjerrjen e kriminelëve para gjyqit të drejtësisë, të gjitha këto neve familjarëve të viktimave na konvenojnë dhe jemi përkrahës të gjithë kësaj. (Milorad Trifunović, Shoqata e familjeve të personave të kidnapuara dhe të zhdukura në Kosovë, Serbi – Zyra në Mitrovicën Veriore, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008).

Konsideroj se vetëm ky Komisioni Rajonal mund të vijë deri te numri i madh i dokumenteve për të cilët ne këtu sot flasim shumë dhe i kërkojmë, por nuk mund të vijmë deri te ato informata dhe te ky dokumentacion. (Negovan Mavrić, Shoqata e familjeve të personave të kidnapuara dhe të zhdukura në Kosovë dhe Metohi, Serbi, Zyra në Hoçë të Madhe, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008).

Duhet të përgatiten mekanizmat për ndikim në qeveritë në rajon që të pranohet themelimi i Komisionit. Duhet të definohet edhe se çfarë do të jetë raporti i Komisionit me institucionet.

Mendoj se kjo është nismë shumë e mirë dhe mendoj se kjo qasje rajonale mund të sjell rezultate, por duhet të jemi të vetëdijshëm për kohën në të cilën jetojmë dhe po kështu të jemi të vetëdijshëm që te shumë qeveri në rajon edhe më tej interesat kombëtare mbi sundimin e ligjit. Unë nuk e di se çfarë parashihni rreth problemeve me të cilët do të ballafaqohemi në të ardhmen, dhe se po kështu duhet të përgatiten paraprakisht edhe mekanizmat në çfarë mënyre do të ndikojmë në qeveritë të cilat thjesht nuk do ta pranojnë Komisionin si një organizatë që këtu është vërtet për të zgjidhur, përkatësisht për të zbardhur faktet. (Srđan Popović, Fraktal, Serbi, Konsulta kombëtare me

shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008)

Ne kemi në këtë hapësirë mjaft sende të pazgjidhura, dhe ato nuk janë zgjidhur ngase edhe sot e gjithë ditën nuk ekziston vullneti politik dhe pikëmbështetja jonë duhet të jetë mu në këtë drejtim të respektimit të të gjitha nismave pozitive. (...) Pse shkon ngadalë? Për shkak të mosekzistimit të vullnetit politik dhe për shkak të ndikimi të madh të Qeverisë. Andaj edhe shtrohet pyetja (...) si do të ndërtohet raporti me këtë komision të ri, sigurisht se me te duhet të bashkëpunojë ngushtë, si dhe me të gjitha institucionet që kanë në disponim shënime të caktuara... (Čedomir Marić, Shoqata e familjeve të të vrarëve dhe të zhdukurve në Krajlinën e Kroacisë, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008).

Kriteret për anëtarët e Komisionit duhet të definohen qartë. Anëtarë duhet të janë njerëz të guximshëm, të aftë që të kundërvihen të gjithë atyre që do të tentojnë të bëjnë obstrukcion punës së tij.

Është shumë me rëndësi që të definohen kriteret për njerëzit që do të punojnë në vetë Komisionin, se a do të janë juristë apo njerëz që kanë përvojë në punën e deritanishme me asociacionet e të kidnapuarve dhe të vrarëve. (Srđan Popović, Fraktal, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008).

Këtu [në komision] duhet të janë njerëz të fuqishëm, që në zbardhjen e të drejtës për ne që jemi viktima të kriminit, do ta kenë guximin t'i kundërvihen të gjithë atyre forcave dhe të arrijnë deri te arkivat, arkivat e tyre (...) Ushtarët kanë xhiruar, komandantët e tyre, nuk di kush, me video kamera, me foto aparate, ata i kanë arkivat complete për të gjithë njerëzit që janë gjetur të vdekur atje poshtë. Dhe garantoj që ata këto arkiva i kanë në vendet e tyre, sepse i kanë marrë andej dhe çka bëjnë tash dhe çka do të bëjnë më vonë me to, vetëm ata dinë. (Milorad Trifunović, Shoqata e familjeve të personave të kidnapuara dhe të zhdukura në Kosovë, Serbi, Zyra në Mitrovicën veriore, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008).

Duhet sa më parë të fillohet me zgjidhjen e problemit të personave të zhdukur, sepse dëshmi-

tarët dhe anëtarët e familjeve të të rrëmbyerve ngadalë po vdesin

Duhet sa më parë të fillohet me zgjidhjen e problemit të personave të zhdukur. Të gjithë kemi fituar përshtypjen se ky problem i yni disi po zgjatet pa kufij dhe shumicës sikur i konvenon që kjo të zgjasë sa më shumë. E dini, njerëzit vdesin, ne po plake mi, është e pamundur që në mileniumin e tretë ku problem i yni të zgjidhet në afate të shkurta. (Olgica Božanić, Shoqata e familjeve të personave të kidnapuara dhe të zhdukura në Kosovë dhe Metohi, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008).

Janë shfaqur qëndrime të kundërta nëse Komisioni Rajonal duhet të bashkëpunojë me pjesëmarrësit e luftës.

Rreth punës së këtij Komisioni nuk duhet të janë të kycur veteranët, sepse kjo do të kishte jehonë të keqe ndër familjet. Unë e di se ju thatë se ata të gjithë nuk kanë bërë krime. Pa gjykimin nuk ka prova se a ka bërë apo jo dikush krime. (...) e them me përgjegjësi se ky Komision nuk mund të jetësohet, nuk mund t'i mbledh ato nënshkrime, sidomos në Serbi dhe në Mal të Zi, nëse nuk eliminohen veteranët e luftës. (Simo Spasić, Shoqata e familjeve të personave të kidnapuara dhe të zhdukura në Kosovë, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008).

Ndër ta ka njerëz që me natë të tëra nuk kanë fjetur dhe i ka munduar ankthi për atë që kanë qenë të detyruar ta bëjnë me dhunë, që të marrin pjesë në krimet e luftës. Jo me vullnetin e tyre por me forcë dhe detyrimin e shtetit dhe sistemit juridik, kështu që unë i kuptoj emocionet, por logjika e gjërave thotë se ne nuk duhet të mbetemi pa shënime të vlefshme nga njerëzit që drejtpërsëdrejti kanë marrë pjesë në djegien e shtëpive ku kanë qenë të ngujuara qindra viktima të pafajshme. (Dragan Sekulović, Qendra për komunikime Drejtësia - Shoqata e të shpërngulurve dhe të dëbuarve nga Kroacia, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008).

Duke i zbardhur faktet Komisioni do të ndihmojë që të mbrohet brezi i ri duke ua hequr bregën për të kaluarën.

Në atë luftë, duke e shkaktuar atë, ata na morën

jetët tona. Por jo këtyre të rinjve. dhe ne duke zbuluar kush e filloi luftën, dhe kush na mori jetët, kush na vrau bijtë tanë, nënat dhe të tjerët, ne duhet të bëjmë çmos që nga kjo t'i mbrojmë këta të rinj që vërtet nuk duhet të janë të ngarkuar me këto. (Dragan Pjevač, Shoqata e familjeve të personave të vrarë dhe të zhdukur në Krajinë e Kroacisë, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008).

Patjetër duhet të krijohet një ekip për marrëdhënie me opinionin, me qëllim që në opinion të depërtojë e vërteta mbi viktimat. Zbulimet e Komisionit mund të prezantohen në komitetin e caktuar të kuvend.

E theksoj posaçërisht, se duhet të organizohet sekcioni për marrëdhënie me opinionin, me një ekip të fuqishëm dhe kreativë që sipas kalendarit të ngjarjeve do të publikojë të vërtetën për viktimat dhe autorët e krimeve. Ju lutem... mua më duket se ne këtu flasim me vetveten. Opinioni duhet të jetë çdo herë i informuar për këtë çka po bëjmë dhe të prezantohet të paktën një storie nga këtu. Dhe gjëja vijuese është, nuk e di, ju lutem le ta në shpjegojnë këtë juristët, a duhet që të gjitha këto të prezantohen pra një komisioni të kuvendit. (Žanka Stojanović, Prindërit në të zezë, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008).

Komisioni duhet të krijojë ekipin për gjetjen e dëshmitarëve.

Duhet të krijohet komisioni për gjetjen e dëshmitarëve. Ata duan të flasin. Ta dini, kur të takoheni me shumicën e tyre, unë kam pas rastin me dy çuna nga Kraveva, që më kanë treguar çka kanë përjetuar dhe se edhe sot nuk flenë qetë sepse kanë qenë atje ku nuk është dashur të ishin. (Žanka Stojanović, Prindërit në të zeza, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008).

Pajtim mes kombeve në rajon nuk mund të ketë përderisa të gjitha viktimat nuk e gjejnë satisfaksionin e drejtësisë.

Përgjegjësit sipas linjës komanduese, dhe autorët e drejtpërdrejtë të krimeve te luftës do të gjykoohen para Tribunalit ndërkombëtar penal, përkatësisht Tribunalit të Hagës, si dhe para gjykatësve

ndërkombëtarë në Kosovë, para gjykatës së Bosnje Hercegovinës, para gjykatave kombëtare në Serbi, Kroaci dhe Mal të Zi. (...) Për dallim nga viktimat kroate, boshnjake dhe shqiptar, që e kanë pak më lehtë sepse të gjithë ata të kombësisë serbe, të cilët familjet i kanë konsideruar me të drejtë përgjegjës për krime sipas përgjegjësisë komanduese, duke filluar nga kapëdanët e deri te gjeneralët, dhe përfshirë këtu edhe ish drejtuesit e shtetit, janë gjykuar në Hagë ose janë ende aty, e disa tashmë i ka mbuluar dheu. Po tani, e them këtë me përgjegjësi të plotë në emër të familjeve të viktimave serbe, rome, gorane, turke dhe shqiptare që ne i kemi në evidencat e shoqatës sonë, askujt nuk mund ti shkojë as mendja për pajtim, ose për ndonjë falje, siç thuhet, apo për ndonjë bashkëjetesë, përderisa familjet e viktimave [e këtyre kombësive, serbe etj] nuk do të trajtohen në mënyrën e njëjtë. (Simo Spasić, Shoqata e familjeve të të kidnapuarve dhe të vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008).

Shoqatat e viktimave mund të ndihmojnë shumë në punën e Komisionit duke mbledhur informata dhe dëshmi për krimet. Ato duhet të ndihmohen në këtë me pajisje dhe trajnime.

Pasi që ne si shoqatë kemi shumë dokumente, por nuk jemi gjitha të aftësuar, ndoshta dikush mund t'i ndihmojë shoqatave që informatat e mbledhura të janë sa më cilësore. Që të jemi të ushtruar, si të them, ashtu që ato të dhëna që disponojmë të pranohen nga gjykatat, të bëhen dokumente valide dhe cilësore, të kemi dobi nga ato. Do të thotë, shoqatat më mirë do të ndihmonin Komisionin, që gjërat të jetësohen, sepse e kemi problemin e vdekjeve, dhe që shume familje i përsërisin gjithnjë të njëjtat tregime, derisa më se kanë as fuqinë që ta bëjnë këtë. Dhe nëse një herë e bëjnë këtë, atëherë pse kjo nuk dokumentohet dhe regjistrohet, sepse vetëm kështu e dimë se do të mbeten si dëshmi të përhershme. (Dragana Đukić, Shoqata e personave të vrarë dhe të zhdukur nga Krajina e Kroacisë, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008)

Është folur për njerëzit që tani janë në liri, ata që kanë bërë krime të luftës dhe nuk janë dënuar në masën a mjaftueshme, të paktën ashtu është përshtypja. Proceset gjyqësore edhe do të kryhen nëse ne çojmë duart nga to. Fuqia më e madhe e kësaj ndërmarrjeje qëndron mu në organizatat tuaja, që ju i përfaqësoni. Ju jeni ata që mund ta kryeni

këtë proces deri në fund. (Aleksandar Stojanović, Qendra për zhvillimin e shoqërisë civile, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008)

Duhet të definohet qartë me të cilat krime do të merret Komisioni.

A janë krime kidnapimet, vrasjet, nxjerrja e organeve, për këto s'ka asnjë dyshim; por a janë krime të luftës edhe mohimi i të drejtës për shtëpi, të drejtës për liri të lëvizjes, abrogimi i të drejtave statutores, i së drejtës në pronësi private që duhet të jetë e pakontestueshme. Unë do të sugjeroja që sa më mirë që është e mundshme t'i kristalizojmë këto, të shohim në cilin vëllim, me të cilat cilësi të krimeve të luftës mund të merremi, përkatësisht në çka duhet të përqendrohemi, ose të fokusohemi më shumë. (Dragan Sekulović, Qendra për komunikim Drejtësia – Shoqata e të shpërngulurve dhe të dëbuarve nga Kroacia, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008).

Komisioni duhet të promovohet në opinion sa më parë që është e mundshme. Të kërkohet përkrahja e bashkësisë ndërkombëtare për themelimin e tij.

Me Komisionin [prezantimin publik] të shkohet menjëherë. Duhet t'i shtrojmë rrugën, të arrijmë deri ta ai, duhet ta përgatisim opinionin që të thotë «Po, na duhet Komisioni». Nuk mund të dalim tash sepse na duhet përkrahja e qeverive, duhet me vendosmëri dhe bindje të shkojmë nga njëra te tjetra. (Dragan Pjevač, Shoqata e familjeve të personave të vrarë dhe të zhdukur në Krajinën e Kroacisë, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008).

Pra, Komisioni duhet të formohet sa më parë, duhet ta ketë përkrahjen e Bashkimit Evropian dhe të Parlamentit Evropian, si dhe të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Nëse nuk i ka këto Komisioni nuk do të ketë kurrfarë ndikimi, nuk do të ketë fuqi që të punojë. (Milorad Trifunović, Shoqata e personave të kidnapuar dhe të zhdukur në Kosovë, Serbi – Zyra në Mitrovicë, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008).

Duhet të përgatitet filmi dokumentar për të gjithë viktimat në rajon.

Propozoj që të përgatitet një film dokumentar që do të bashkonte të gjitha viktimat në rajon, që nga një përfaqësues i familjeve të viktimave të flet, dhe kjo të ilustruhet me video xhirimet nga terreni, nga vendngjarjet për të cilat flitet. Ky dokumentar të shfaqet në të gjitha televizionet kështu që opinioni të njoftohet se cili është qëllimi ynë. (Olgica Božanić, Shoqata e personave të kidnapuar dhe të zhdukur në Kosovë dhe Metohi, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave dhe viktimat, Beograd, Serbi, më 15 korrik 2008).

15. Konsultat kombëtare me shoqërinë civile për nismën KOMRA

**Zagreb, Kroaci
16 maj 2008**

Konsultat i organizoi Documenta. Në tubim morën pjesë 29 përfaqësues të shoqërisë civile në Kroaci. Vesna Teršelić (Documenta) dhe Eugen Jakovčić (TV Jadran – emisioni *Cenzura*) informuan pjesëmarrësit mbi rrjedhën e konsultave, instrumentet për zbardhjen e së vërtetës, nismën për themelimin e Komisionit Rajonal, si dhe për formimin e Koalicionit mbështetës për KOMRA. Është paralajmëruar se koalicioni do të prezantohet formalisht në Forumin e katërt rajonal në Prishtinë, që mbahet në tetor të vitit 2008.

Të gjithë pjesëmarrësit i dhanë përkrahje qasjes rajonale duke konsideruar se vetëm kështu mund të konstatohen të gjitha faktet mbi krimet e luftës dhe fati i personave të zhdukur.

Është theksuar rëndësia e mbledhjes së shënimeve për të gjitha viktimat e luftës si dhe rëndësia e gjykimit të krimeve të luftës. Por, është shprehur edhe brengosja për shkak të ngadalësisë së hetimeve dhe animet etnik që është prezent në procesimin e krimeve të luftës.

Është konkluduar se nisma duhet të përfshijë spektrin sa më të gjerë të organizatave të shoqërisë civile dhe se përkrahja për nismën duhet kërkohet edhe në nivelin lokal. Për këtë qëllim, duhet të organizohet prezantimi, promovimi dhe avokimi i nismën ku do duhej të kyçen organizatat e nivelit lokal.

Është shtruar edhe pyetja se a duhet nisma të vendoset në një kontekst më të gjerë dhe a duhet të

kyçen BE, OSBE dhe Tribunali ndërkombëtarë për ish Jugosllavi.

16. Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi nismën KOMRA

Serbi, Ivanjica
21 shtator 2008

Konsultat i organizoi Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut (Serbi). Të rinjtë e përkrahin nismën rajonale për zbardhjen e fakteve mbi krimet e luftës dhe konsiderojnë se duhet të themelohet KOMRA si komision zyrtar.

Komisioni Rajonal duhet të jetë i paanshëm dhe tmerrsisht objektiv në punën e tij, dhe vetë procesi i themelimit duhet të planifikohet mirë.

Të rinjtë konsiderojnë se është e domosdoshme fushata për krijimin e klimës pozitive në shoqëritë e ish RFSJ dhe se ajo duhet të përfshijë target grupet e ndryshme me qasje të përshtatur secilës prej tyre. Fushata duhet të jetë e shkallëzuar, duhet të përfshijë viktimat, familjet e tyre dhe duhet të theksohet nevoja për të vërtetën.

Në fushatë duhet të kyçen personalitetet publike nga fushat e ndryshme.

Edukimi ka rol të rëndësishëm në krijimin e klimës pozitive, si dhe bashkëpunimi rajonal dhe posaçërisht këmbimi i vizitave të të rinjëve.

Është e domosdoshme që të krijohet lidhje mes brezave, ndërmjet viktimave dhe të rinjëve, në mënyrë që tek të rinjtë të zhvillohet empatia. Është me rëndësi që të organizohen vizitat përmendore dhe vendeve të krimeve.

Të rinjtë e shohin rolin e tyre në angazhimin në terren, së bashku me viktimat. Të rinjtë duhet ta ndërrojnë rrethin e tyre nga përditshmëria.

Është e domosdoshme që të kyçen bashkësitë fetare – paria e kishës duhet të prcjellë dëshmitë publike dhe të kyçet maksimalisht në procesin.

Për anëtarë të Komisionit nuk do të duhej të zgjedheshin njerëzit që janë të lidhur me pushtetin ose që kanë qenë në pushtet në kohën e konflikteve të armatosur në ish RFSJ.

Të rinjtë përkrahin viktimat dhe anëtarët e familjeve që të bëjnë dëshmi publike dhe konsiderojnë se përgatitja, dëgjimi dhe bartja e dëshmimeve të viktimave duhet të bëhet me kujdes të madh duke pasur konsiderata për dinjitetin dhe dëshirat e viktimave.

Të rinjtë si anëtarë të komisionit shohin personalitetet publike dhe qytetarët akademikë, dhe sidomos përfaqësuesit e viktimave dhe të familjeve të tyre. KOMRA duhet të ketë kompetencat e definuara qartë për hetime. Organet shtetërore, duke përfshirë shërbimet e sigurimit, duhet të bashkëpunojnë me KOMRA.

17. Konsultat kombëtare me shoqatat e viktimave në Kosovë mbi nismën KOMRA

Prishtinë, Kosovë
4 tetor 2008

Konsultat i organizoi Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë. Në konsultat morën pjesë 22 përfaqësues kryesisht të shoqatave të familjeve të viktimave dhe të zhdukurve, si dhe 6 përfaqësues të organizatave ndërkombëtare në cilësinë e vëzhguesve. Me fjalët hyrës u paraqiten Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi), Vesna Teršelić (Documenta, Kroaci) dhe Bekim Blakaj (Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë), kurse tubim e moderoi Valdete Idriizi (Community Building Mitrovica, Kosovë).

Ekziston nevoja në nivelin rajonal për të vërtetën e plotë mbi atë çka ka ndodhur

Na duhet një trup që dokumentacionin që e ka mbledhur Tribunali i Hagës do ta shfrytëzojë në mënyrë shumë të organizuar, duke organizuar edhe hulumtime shtesë për rastet e shumta me të cilat Tribunali i Hagës dhe gjykatat vendore nuk janë marrë, duke e bërë hartën e krimeve të luftës, me pasqyrën se çka ka ndodhur, dhe duke ndihmuar njëkohësisht në këtë mënyrë prokuroritë dhe, çka është më e rëndësishme, duke krijuar një tablo të plotë mbi krimet e luftës, që krijon klimën në secilën shoqëri, klimën që e zhvillon solidaritetin dhe bashkëndjesinë për viktimat dhe krijon edhe një platformë publike cila viktimave u mundëson që të flasin për atë çka kanë përjetuar. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Ser-

bi, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008)

Mendoj se është shumë e rëndësishme, edhe për shkak të përgjegjësisë që kemi ndaj të mbijetuarve dhe ndaj të gjithëve në shoqëritë tona, që të zbardhen faktet, dhe këto fakte janë aq komplekse sa që mund të kapen vetëm në kontekstin rajonal. Ne në Kroaci thjesht nuk mund të shohim dhe të kuptojmë krejt çka u ka ndodhur atyre që kanë ikur pas aksionit ushtarak Oluja (Stuhia) në gusht të vitit 1995, nëse ata sot nuk jetojnë në Kroaci, por në shumicë janë në BH dhe në Serbi. (Vesna Teršelič, Dokumenta, Kroaci, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008)

Nisma për KOMRA është në interes të viktimave kosovare.

Në Kosovë vlerësohet se janë vlarë 13 mijë veta, janë shpërngulur 800.000 veta, janë djegur dhe shkatërruar 127.000 objekte ekonomike dhe individuale. Ne sot nuk e kemi asnjë institucion që mund të na jep të dhënat mbi atë se ku dhe si kanë ndodh krimet, kush i ka bërë këto krime dhe në cilën periudhë kohore (...) Andaj konsideroj se formimi i këtij komisioni, sipas mendimit tim, është diçka që duhet të përkrahet. (Teki Bokshi, avokat nga Kosova, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008).

Dua të them se më keni bindur se duhet të krijohet komisioni, edhe pse asgjë nuk është në duart tona. Le të krijohet komisioni. (Bajram Çerkini, Shoqata Kujtimi, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008).

Krijimi i këtij komisioni do të ishte, mixha Bajram, tejkallim dhe plotësim i punës së mangët i të gjitha qeverive dhe një presion direkt në ta. (Arsim Gërshaliu, shef i zyrës së UNMIK-ut për persona të zhdukur - OMPE, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008).

Unë e shpreh mendimin tim se çdo nismë që si pikënisje e ka humanizmin, dhe që si bazë e ka nxjerrjen në dritë të një realiteti, ndriçimin e të gjitha ndodhive në Kosovë, është në interes të përpjekjeve tona, të punës sonë, të Këshillit tonë [i shoqatës së familjeve të të zhdukurve], të shoqatave, dhe veçanërisht është në dobi dhe interes tonin. (Haki Kasumi, Këshilli për koordinimin e shoqatave të

familjeve të të zhdukurve në Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008).

Shfrytëzoj rastin me e përshëndet këtë nismë për formimin e komisionit, një trupi rajonal, që do të jetë ndihmesë për procesin në tërësi, jo vetëm për zbardhjen e fatit të pagjeturve, të zhdukurve, por edhe në paraqitjen dhe përhapjen e së vërtetës, në sensibilizimin e opinionit për këtë çështje. (Prenk Gjetaj, Kryetari i Komisionit të Qeverisë së Kosovës për personat e pagjetur, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008).

Ne duhet të mendojmë mirë dhe të kuptojmë se na duhet një nismë e krijimit të komisionit për të vërtetën, de unë mendoj se duhet të ekzistojë edhe pa ndonjë debat, kështu siç jemi të bashkuar këtu sot, kështu duhet të jemi edhe në Beograd, Zagreb, Sarajevë dhe gjetiu. Kriminelit duhet ti thuhet në sy se krimi ekziston, se e ka bërë dhe se fytyrën e ka të nxirë nga gjenocidi. Dhe ky komision, unë mendoj, duhet të ekzistojë dhe secili prej jush këtu duhet ta jap mendimin e vet për këtë, pasi që kemi edhe kohë për ta menduar. (Ahmet Graiçevci, Shoqata Shpresa dhe Kujtimi, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008).

Personalisht jemi udhëtarë që ta zbulojmë të vërtetën por të vërtetës i dalin shumë armiq dhe pengesa përpara, unë kam identifikuar nga Batajnica 05 dy vëllezërit dhe axhën e tani edhe më shumë më mundon ta di të vërtetën se kush i masakroi ata? Pra nuk më mjaftojnë vetëm eshtrat e varri i tyre, tani gati edhe më shumë më intereson e vërteta, ne duhet ta bëjmë këtë gjë, u kemi borxh atyre që në minutat e fundit nuk mendonin për vete por luteshin që ne të shpëtonim nga vdekja e pamëshirshme. (Lush Krasniqi nga Korenica Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008).

Kërkojmë që të del e vërteta në shesh, të dihet si janë bërë ato krime dhe kush i ka kryer ato krime. Pa një iniciativë të tillë unë besoj që nuk do të ia dilnim. (...) Ne na ngel edhe si familjarë edhe si qytetar të Kosovës, qoftë edhe organizatat tjera joqeveritare që janë këtu, që edhe në këto momente na janë bashkëngjitur e do të na bashkëngjiten edhe më tepër se të vetmit ne jemi ata që mundemi me shty procesin përpara, të vetmit jemi ata

që mundemi me e nxjerrë të vërtetën. Unë e di që e vërteta përmes organeve të drejtësisë nuk ka me dal e tëra mirëpo ne nuk duhet të dorëzohemi (Hysni Berisha, Shoqata e familjeve të të zhdukurve Shpresimi, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008).

Mendoj se gjithë së bashku se secila dorë që na ofrohet për bashkëpunim duhet me e marrë, duhet me e respektua sepse vetëm në atë mënyrë koordinohemi mirë nëse bashkëpunojmë mirë, nëse informohemi mirë, vetëm në atë mënyrë mund t'i plotësojmë ato boshllëqe të cilat kanë mbetur tërë këto vite. (Valdete Idrizi, Community Building Mitrovica, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008).

Një pjesë e përfaqësuesve të shoqatave të të zhdukurve dyshon se mund të formohet Komisioni Rajonal me Serbinë, deri sa ku shtet nuk kërkon falje dhe nuk i pranon viktimat shqiptare.

Mua më vjen keq, iniciativa është e mirë por nuk është në kohën e duhur.(...) çfarë Komisioni Rajonal po doni me e formua me Serbinë, me qatë që nuk të njeh, me atë që nuk të flet, me atë që të hap për çdo ditë luftë?. (Bajram Qerkini, Shoqata Kujtimi, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008).

Nuk e di si mund të formojmë këto komisione kur ata, kur vetë populli serb nuk e njeh Kosovën, nuk ka kërkuar falje deri tani asnjëherë, edhe ky popull, ende nuk është Serbia e demokratizuar e unë nuk e di që ende asnjë politikan serb ende nuk erdh të përkulet nëpër këto varre që janë 900 varreza masive në Kosovë të zbuluara, asnjëherë nuk erdh me i vizituar asnjëherë. Ky popull është i lidhur edhe me kishën e vet, asnjë pop i popullit serb nuk erdh ta vizitohet asnjë varrezë diku në Kosovë dhe të kërkon falje. Këto janë ato çështje që ne jemi shumë larg me këtë popull, këta së pari duhet të ndërrohen, të kërkojnë falje por njëkohësisht edhe të përgjigjen për veprat e bëme. Ne dimë fort mirë që në Serbi janë ende ato struktura komanduese, ushtarake, policore të cilët i kanë bërë ato krime në Kosovë.. (Ymer Merlaku, Shoqata e familjeve të të zhdukurve nga Klina, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008).

Çdo anëtar i familjes, pa marrë parasysh çka sjell ky komision, do të di të vërtetën. Serbia duhet të kërkojë falje nga shqiptarët, duhet të emëroj kriminelët e vet që kanë bërë krimet në Kosovë, duhet të kompensojë dëmet e krimeve dhe të luftës. (Xhafer Veliu, Shoqata Pengu i lirise, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008).

Shumica e përfaqësuesve të shoqatave të viktimave nuk kanë besim në gjykatat e Serbisë. Disa pjesëmarrës konsiderojnë se gjykimet janë të rëndësishme pa marrë parasysh se ku mbahen.

Me aktivitetet e gjykatave në Serbi që marrin vendime, rasti konkret është për familjen Bogujevci nga Podujeva, ne nuk pajtohemi. Seps , Nataša e di shumë mirë që krimet e rënda dhe genocidi dënohen në nivelin ndërkombëtarë, dhe jo në këtë intern, të brendshëm, në Serbi. Këto gjykata janë betuar para Kushtetutës së Serbisë, që edhe sot është në fuqi, Serbisë që edhe i ka bërë ato krime në atë kohë. (Artan Selimi, Shoqata Loti dhe kujtimi, Kosovë, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008).

Unë e konsideroj që është më e dobishme ta zëmë rasti i këtij kriminel Sasha Cvjetan, i cili është gjykua me dënim maksimal për dhembjet dhe për krimet që i ka bërë në Podujevë, që të gjykohej në Beograd për shkak se në rrethanat aktuale ballkanike absolutisht është e pamundshme që ky të sillet dhe të gjykohej në Kosovë, kur ajo mundësi nuk ekziston, objektivist, absolutisht është e pamundur që tashti Kosova ta kërkon nga Serbia ekstradimin e një shtetasi të saj. (Teki Bokshi sa Kosova, Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008).

Shumicës absolute të shqiptarëve, ndikimet e krimeve të bëra në Kosovë që organizohen dhe mbahen në Serbi ato janë farsa dhe për ne të papranueshme si pjesë dërmuese e shqiptarëve dhe familjarëve por edhe e aktivistëve shoqatave, lus Natasha Kandiqin dhe aktivistët tjerë që ta përfshijnë në program të komisionit gjithsesi ngritjen e gjykatës speciale e cila do të kishte zhvilluar gjykime së paku të drejta. (Haki Kasumi, Këshilli për koordinim të shoqatave të familjeve të të zhdukurve në Kosovë, Kosovë Konsulta kombëtare me shoqatat e viktimave, Prishtinë, Kosovë, më 4 tetor 2008).

18. Konsultat kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut mbi nismën KOMRA

**Frushka Gora, Serbi
10 tetor 2008**

Konsultat i organizoi *Impunity Watch* i Fondit për të Drejtën Humanitare. Pjesëmarrës (21) ishin aktivistët për të drejtat e njeriut. Fjalën hyrëse e mbajtën Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi), Ljiljana Hellman (*Impunity Watch*, Serbi) dhe Marijana Toma (*Impunity Watch*, Serbi).

Na duhet KOMRA që mund të krijojë pamjen faktike të së kaluarës sonë e cila do të pranohet si e tillë.

Ne më në fund duhet të kemi pamjen faktike e cila do të jetë e pranuar si e tillë mu për shkak të fuqisë së fakteve. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Vetëm trupi rajonal mund të sigurojë të vërtetën më të afërt me atë çka na ka ndodhur

E vetmja mundësi është që të bëhet në nivelin rajonal, dhe që ato konkluzat, dhe ato rekomandime të janë sa më të afërta me të vërtetën, duke lëvizur drejt asaj që këta fëmijë këtu nesër të mund të shohin për afërsisht se ky ka qenë çështja... Por ajo që këtu është vërtetë arma me të cilën mund të bëhet diçka, janë faktet, faktet e pamohueshme... të bëhet bilanci, do të thotë ajo çka ka ndodhur. Ky bilanc, dhe bilanc nga aspekti i viktimave, duhet të jetë i pakontestueshëm. Ai mbase nuk do të sjellë të gjitha gjërat, por do të sjellë një rezultat. (Drago Kovačević, Forumi demokratik serb, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Komisioni Rajonal mund të ketë sukses vetëm si projekt shtetëror.

Kili është, p.sh., në shembull fantastik i pranimit zyrtar ku kryetari i shteti në një audiencë raporton dhe u kërkon falje viktimave për të gjitha vuajtjet dhe dhimbjet, ku ai e merr përsipër, si kryetar i shtetit, përgjegjësinë për të gjitha krimet që i ka bërë paraardhësi i tij. Pra, këtë gjë nuk mund ta

bëjnë organizatat joqeveritare. Kjo është arsyeja pse komisioni duhet të jetë një lloj projekti shtetëror. (Marijana Toma, *Impunity Watch*, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Fokusimi në viktimat në kontekstin rajonal barazon dhe shlyen kufijtë mes viktimave.

Viktimat njëfarëdore, për sa kam dëgjuar këtu, dhe çka më shkakton një si huti, janë paraqitur si një entitet. Disi ekziston një rrezik që edhe Komisioni Rajonal t'i fshijë kufijtë dhe të thotë se në të vërtetë nuk janë të rëndësishëm kufijtë për zbardhjen e krimit dhe viktimave. Dhe kjo në njëfarë mënyre e relativizon tregimin mbi atë se kush janë ekzekutorët. Sepse unë këtu nuk dëgjoj tregimin për atë se kush janë viktimat. ... Nëse flasim për viktimat si një entitet ne atëherë relativizojmë krimet dhe njëfarëdore e mbyllim këtë kontekst politik të tregimit. (Marija Radoman, Këshilli i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Qëllimi i KOMRA është ngushtimi i hapësirës për gënjeshtër dhe manipulime në nivelin rajonal.

Të themi se ky është një obligim moral që të dimë se çka ka ndodhur. Dhe nëse ndodh kështu atëherë edhe ajo pamje e dëshiruar dhe e kërkuar në opinionin tonë mbi simetrinë e krimit sigurisht se do të humbet. Pra, nuk mund të flitet për simetrinë e krimit. Për këtë, mendoj, jemi absolutisht të pajtimit dhe secili që futet në këtë proces duhet ta ketë të qartë se nuk është qëllimi që të tregohet se të gjithë i kanë vrarë të tjerët, dhe se të gjithë edhe janë fajtor dhe përgjegjës në mënyrë të barabartë. Dhe nëse viktimat dhe shoqatat e viktimave dalin disi nga ai rrethi etnik dhe nisën në kornizën rajonale, dhe nëse viktimat e kërkojnë të vërtetën, të drejtën e tyre që të duhet se çka u ka ndodhur, ngushtohet absolutisht edhe ajo hapësira e manipulimit. (Marko Veličković, Qendra për zhvillimin e resurseve civile, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Duhet të sqarohet çka është më e rëndësishme për KOMRA : faktet mbi përgjegjësinë (pafajësinë) e të akuzuarve apo faktet mbi krimet konkrete të luftës.

A do të janë faktet e gjyqit që janë zbardhur deri

më sot baza... nga e cila do të niset, dhe pastaj do të shkohet më tej dhe më gjerë, dhe do të përfshihen gjërat që tashmë kanë qenë objekt i gjykimeve. (Jelena Cakić, Gratë për paqe, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Vendimet e Hagës për treshen e Vukovarit askush në Kroaci nuk i pranon. Por, ajo që nuk duhet të harrohet, në të gjitha këto vendime, madje edhe vendimin për lirimin e Haradinajt, gjyqi nuk e ka mohuar se krimet nuk kanë ndodhur. Kjo është ajo çka është e rëndësishme për ne. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Në debat le të sqarohet nëse KOMRA duhet të merret me shkaqet e luftës.

Kur e keni këtë lloj të prezantimit, të fakteve të zhveshura dhe të pakontestueshme, ju e keni edhe hartën e shkaqeve. (Marko Veličković, Qendra për zhvillimin e resurseve civile, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Kurrë nuk do të arrihet konsensusi për shkaqet [e luftës]. (Drago Kovačević, Forumi demokratik serb, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Rreth shkaqeve, mendoj se këtu nuk mund të arrihet asnjë lloj konsensusi. Një komision për këtë do të ishte i dënuar për dështim. Mua më duket kështu.. (Bogdan Ivanišević, Qendra ndërkombëtare për drejtësi tranzicionale, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Duhet të definohen detyrat e zyrove kombëtare: marrja e deklaratave dhe dëgjimi i viktimave ose edhe aktivitete tjera.

Zyrat kombëtare... a do të organizohen ato me ndonjë kriter tjetër; a do të merren vetëm me dëgjime dhe marrjen e deklaratave apo këto misione kombëtare do të kryejnë aktivitete të ndryshme?. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Në nivelin e çdo shteti mund të krijojmë ato nënkomisione apo komisione kombëtare, të ciklat do të përcaktonin se çka është bërë, procesuar në nivelin e atij shteti, cili lloj i të dhënave ekziston dhe atëherë të kryqëzohen dhe të shihet cilat të dhëna përputhen dhe cilat jo dhe ku janë zbrazëtirat në hapësirën ku mund të veprojmë së bashku. (Marija Gajicki, shoqata Nisma rajonale e grave Vojvodinase, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Periudha kohore me të cilën do të merret KOMRA?

Momenti i parë është kur ka ndodhur konflikti i parë i armatosur, pra që nga viti 1991. Dhe fundi është më vitin 2001. (Marija Gajicki, shoqata Nisma rajonale e grave Vojvodinase, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Në konsultat duhet të përcaktohet cilat janë pritjet e viktimave që do të dëshmohen para Komisionit.

Mendoj se në këtë kuptim do të duhej të kishim parasysh dhe të artikulonim me kujdes cilat janë pritjet të njerëzve që do të flasin para komisionit. Çka presin ata, dhe pos kësaj të dëgjohen dhe respektohen si njerëz që e kanë përjetuar të keqën. Çka presin ata nga shoqëria, përkatësisht nga shteti, sepse nga s'përputhja, p.sh. e komisioneve në Amerikën Jugore dhe në Afrike... më këtë është matur suksesi ose dështimi i komisionit. (Mirjana Vojvodić, Këshilli për iniciativën qytetare, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Koalicioni për themelimin e KOMRA duhet të ketë të drejtën e propozimit të 50 për qind të anëtarëve të KOMRA.

A do të ketë koalicioni të drejtën që të propozojë, p.sh. 50 për qind të anëtarëve, çka nuk nënkupton që edhe t'i emëroj ata. (Jelena Nešić, Instituti për transicion demokratik, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Partitë politike duhet të kyçen në konsulta, por pyetja është kur duhet të bëhet kjo?

Kur të bëhet koalicioni duhet të kihet parasysh se si të përfshihen edhe përfaqësuesit e partive politike. Mendoj kur ne, të them ashtu, kur mes veti të gjitha i absollojmë, i përtypim mirë, e dimë si dhe çka duam, hapat, atëherë do të mund të fillojmë lobimin në parlamentet dhe qeveritë, çka do të thotë edhe partitë politike. (Marja Gajicki, Shoqata Vojvodanka – Iniciative rajonale e grave, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Të shfrytëzohen kapacitetet ekzistuese për promovimin e nismës.

Në cilën mënyrë festivali për të drejtat e njeriut Viviseqfest, edicioni i ri të cilit do të mbahet nga fundi i tetorit, fillimi i nëntorit, do të mund të ofronte hapësirë për promovimin e kësaj nisme në territorin e Novi Sadit dhe në cilën mënyrë do të mund të konceptonit, së bashku me ne, ku do të shfrytëzonim këtë hapësirë, pasi që festivali do të ketë turne në pesë gjashtë qytete, jo vetëm në Serbi dhe Vojvodinë, por edhe në Bosnje dhe Hercegovinë dhe në Kosovë, dhe po kështu të shfrytëzojmë këtë mundësi që atje të promovojmë edhe disa gjëra tjera. (Marja Gajicki, Shoqata Vojvodanka – Iniciativa rajonale e grave, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Në procesin e konsultave duhet të kyçen bashkësitë fetare.

Do të ishte e dobishme që në komision të kyçen përfaqësuesit e bashkësive fetare, pasi që është i njohur roli i tyre në proceset që kanë ndodhur në territorin e ish Jugosllavisë. (Jelena Cakić, Gratë për paqe, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Për krijimin e KOMRA nevojitet përkrahja e bashkësisë.

Duke pas parasysh se ne nuk mund të marrim përkrahjen e politikanëve, duhet gjetur mënyrën që të kërkojmë përkrahjen e bashkësisë ndërkombe-tare. (Ilda Habota, Këshilli i Sanxhakut për të drejtat e njeriut, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Do të doja të besoja pak më shumë se mund të marrim përkrahjen e elitës politike dhe të mediave.

(Marko Veličković, Qendra për zhvillimin e resurseve civile, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008)

Pse serbët nga Kosova dhe përfaqësuesit e tyre politikë dhe pushteti në Serbi do të kishin gjë kundër një komisioni të tillë? Mendoj se ata do të mund të kishin ca probleme, sepse do të flitet për pësimet e tjerëve që ua kanë shkaktuar serbët por... unë nuk do ta thosha këtë që në fillim, se të gjithë politikanët do të janë kundër. Megjithatë, në pushtet nuk është Slobodan Milošević-i, dhe çka do që ne mendojmë, edhe për vendet tjera do mund të thuhet njëjtë. Kështu që duhet të kemi pak më shumë besim. (Bogdan Ivanišević, Qendra ndërkombe-tare për drejtësi Tranzicionale, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Të organizohen trajnime të organizatave joqeveritare për promovimin e nismës në nivelin lokal.

Propozimi im është që, nëse kjo është e mundshme, për ne që e pranojmë se na mungojnë këto dije, të na mundësohet fuqizimi shtesë përmes trajnimeve dhe edukimit që këtë tregim ta zbresim në nivelin lokal. Do të thotë, t'i vejmë në lëvizje këto tregime në nivelin e bashkësive lokale. (Dženeta Agović, Impuls, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Të organizohen takimet e shoqatave të viktimave në nivelin lokal.

Mendoj se do të ishte mirë të organizohen takimet e shoqatave, p.sh. të nënave nga Srebrenica dhe disa grave nga Serbia të cilat po kështu kanë përjetuar tragjedi personale. Ato të lidhen dhe t'u jepet hapësira në medime, kjo do të ishte mjaft efikase në kuptimin e sensibilizimit të shoqërisë për një tregim të tillë. (Jelena Cakić, Gratë për paqe, Serbi, Konsulta kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

Në mandatin e KOMRA duhet të jetë vepra penale e dhunimit.

Propozimi që KOMRA të merret posaçërisht më krimin e dhunimit, do të thotë me dhunimin e grave. (Dženeta Agović, Impuls, Serbi, Konsulta

kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut, Frushka Gora, Serbi, më 10 tetor 2008).

19. Konsultat kombëtare me gazetarët për nismën KOMRA

**Frushka Gora, Serbi
11 tetor 2008**

Konsultat i organizuan Impunity Watch dhe Shoqata e gazetarëve të pavarur të Vojvodinës, ku morën pjesë 24 gazetarë nga Serbia. Në pjesën hyrëse është prezantuar Raporti i *Impunity Watch* për shkaqet e mosndëshkimeve. Fjalët hyrëse mbi nismën KOMRA i mbajtën Dinko Gruhonjić (Shoqata e gazetarëve të pavarur të Vojvodinës, Vojvodinë, Serbi), Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi) dhe Marijana Toma (*Impunity Watch*, Serbi).

Gazetarët përkrahin nismën për themelimin e KOMRA.

Redaksia e jonë i jep përkrahje kësaj nisme. (Gizella Stanyo Tot, Magjar Szo, Serbi, Konsulta kombëtare me gazetarët, Frushka Gora, Serbi, më 11 tetor 2008).

A nuk mjafton, a nuk është i mjaftueshëm, si të them, e dhëna, përkatësisht a nuk mjafton fakti se nga harta janë zhdukur shumë fshatra, vendbanime, janë ekzekutuar familje të tëra, si arsye për themelimin e këtij komisioni. Duhet të dihet çka ka ndodhur me ata njerëz, patjetër duhet të dihet. (Ivana Jovanović, Agjencioni Beta, Serbi, Konsulta kombëtare me gazetarët, Frushka Gora, Serbi, më 11 tetor 2008).

Ekziston nevoja që në nivelin rajonal të përcaktohet minimumi i fakteve të cilat askush nuk mund t'i mohojë.

Të ballafaquar me atë se secila shoqëri e ka të vërtetën e vet, neve kemi nisur të mendojmë si të arrijmë në atë situatë që në nivelin rajonal të pranohet minimumi i fakteve të zbardhura, që nuk mund të kontestohen, për të krijuar kështu shënimin zyrtar, kompetent, të saktë dhe objektiv, gjë që do të ndihmonte që edhe tekstet shkollorë të shkruhen në mënyrë tjetër, pra larg qasjes politike, dhe në bazë të fakteve. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsulta kombëtare me

gazetarët, Frushka Gora, Serbi, më 11 tetor 2008).

I jap përkrahje nismës për formimin e Komisionit për zbardhjen e fakteve sepse është forma e vetme e sigurt institucionale që mund të na sjell fakte relevante. Pa këtë të fillohet një tregim mendoj se është me rrezik për mediat. Do të thitë, duhet të ketë një vend, dhe ky është ky Komision, që do të jetë burim i informatave të sigurta në bazë të cilave mediat mund të hulumtojnë. (Jelena Perković, Rusko slovo, Serbi, Konsulta kombëtare me gazetarët, Frushka Gora, Serbi, më 11 tetor 2008).

KOMRA duhet të merret me shkaqet e luftës.

Kam frikë se pa shkaqe nuk ka pasoja, dhe pa fakte as për shkaqet e as për pasojat nuk do të ketë të vërtetë të plotë, dhe krejt puna do të shkoj huq. (Boro Lazukić, TV Panonija, Serbi, Konsulta kombëtare me gazetarët, Frushka Gora, Serbi, më 11 tetor 2008).

Për mediat KOMRA do të jetë temë nëse bëhet ngjarje.

Ne si njerëz të mediave duhet ta kemi qartë që të kujdesemi në çfarë mënyre KOMRA mund të bëhet ngjarje. Pra si të bëhet KOMRA ngjarje, si të bëhet KOMRA lajm. (Dinko Gruhonjić, Shoqata e gazetarëve të pavarur të Vojvodinës, Serbi, Konsulta kombëtare me gazetarët, Frushka Gora, Serbi, më 11 tetor 2008).

Transmetuesit publik e kanë obligim që të raportojnë për nismën KOMRA por të rëndësishëm janë edhe mediat lokale.

Transmetuesi publik e ka obligimin e caktuar sepse ne paguajmë parapagimin dhe e ka përgjegjësinë më të madhe për këtë lloj të interpretimit. Mediumet private nuk e kanë obligimin as më të vogël që të tregojnë për krimet e luftës. (Aleksandar Trifunović, Projekti medial Buka, BH, Konsulta kombëtare me gazetarët, Frushka Gora, Serbi, më 11 tetor 2008).

Unë nuk do të harroja as mediat lokale, këtu pak a shumë u fol për mediat më të fuqishme. (Larisa Inić, Radio Subotica, Serbi, Konsulta kombëtare me gazetarët, Frushka Gora, Serbi, më 11 tetor 2008).

Kur reagoval në idenë që këtë tregim në të shumtën duhet të bartin transmetuesit publik, nuk kam qenë

kundër idesë por thjesht vetëm nga droja prej atij konstatimi që u tha krejt në fillim se në këtë punë duhet të futemi pa asnjë përkrahje dhe logjistike të shtetit, dhe më falni, por transmetuesit publik janë edhe më tej si pjesë e nomenklaturës shtetërore, të mos them politike dhe partiake. Pra, këtu diku qëndron droja ime na transmetuesi publik. (Boro Lazukić, TV Panonija, Serbi, Konsulta kombëtare me gazetarët, Frushka Gora, Serbi, më 11 tetor 2008).

Gjykimet kombëtare për krimet e luftës duhet të janë publike.

Nuk e shoh arsyen pse nuk i kemi gjykimet publike, të hapura për krimet e luftës dhe krimin e organizuar. Prokurori Vukčević tha se nuk ka asgjë kundër kësaj, për më shumë ai angazhohet që gjykimet të bëhen publike. Siniša Vazić, kryetari i Gjyqit të rrethit në Beograd, në sa e sa seminare dhe tubime ka thënë se «nuk ka asnjë pengesë që gjykimet të bëhen publike». Dhe hajde të shohim tash se ku është pengesa. Nëse dikush konsideron se duhet të gjykoj larg syve të opinionit, atëherë ai nuk është gjykatës që i del zot detyrës së tij. Të vendosim disa njerëz tjerë që do të qëndrojnë pas asaj që është puna e tyre dhe që do t'ua mundësojnë edhe gazetarëve që ta kryejnë punën e tyre (...) Opinioni në Serbi duhet të sheh kush janë këta njerëz për shkak të cilëve nuk mund të transmetojmë drejtpërsëdrejti fjalën e gjallë të tyre nga gjykimet, njerëz që edhe më tej nëpër disa mediume anësore edhe më tej plasohen si heronj. (Gordana Petrović, Radio televizionin i Serbisë- RTS, Konsulta kombëtare me gazetarët, Frushka Gora, Serbi, më 11 tetor 2008).

Mohimi i krimeve të veta është metoda se si mediumet raportojnë për krimet e luftës.

Kur filloni të hulumtoni se në ç'mënyrë mediumet perceptojnë krimet e luftës, do të shihni se në esencë kryesisht flasim për krimet që janë bërë ndaj nesh, e shumë pak për krimet që i kemi bërë ne, pra nuk e kemi atë thënien e Brehtit, le të flet secili për turpin e vet. Përkundrazi, edhe më tej mohimi është metodë kryesor, të them ashtu, i punës mediale. (Aleksandar Trifunović, Projekti medial Buka, BH, Konsulta kombëtare me gazetarët, Frushka Gora, Serbi, më 11 tetor 2008).

Të bëhet harta e krimeve të luftës si përkujtues për gazetarët.

Të përgatitet planeri, për shembull për vitin 2009,

ku në vend të festave të rëndësishme, si datat më të rëndësishme do të shënoheshin ato që lidhen me krimet e luftës dhe t'i shpërndahen gazetarëve si një lloj përkujtuesi. (Larisa Inić, Radio Subotica, Serbi, Konsulta kombëtare me gazetarët, Frushka Gora, Serbi, më 11 tetor 2008).

Anëtarët e Komisionit duhet të kanë respekt në opinion dhe mes tyre duhet të janë edhe përfaqësuesit e pushtetit.

Ky komision... do të ketë peshën e vet për mediumet vetëm nëse në këtë trup do të janë njerëzit të rëndësishëm për opinionin, që e kanë peshën e tyre, qoftë për shkak të funksioneve, qoftë si persona me integritet, karrierë; dhe nuk është fare e rëndësishme a janë artistë apo nga qeveria, sektori qeveritar, s'di, politikanët këta apo ata, por gjithsesi konsideroj që në këtë komision duhet të ulën edhe të parët edhe të dytit, mendoj pa e përfill profesionin, vetëm se përfaqësuesit e pushtetit duhet të janë aty pa dyshim. (Ivana Jovanović, Agjencioni Beta, Serbi, Konsulta kombëtare me gazetarët, Frushka Gora, Serbi, më 11 tetor 2008).

Tregimet pozitive duhet të inkuadrohen në dëgjimet publike dhe të bëhen të disponueshme mediave.

Srdan Aleksić-i nuk do të bëhej lajm nëse Vojvodina Qytetare nuk do të niste aksionin që një rrugë e qytetit të mbajë emrin e tij, dhe pushteti i atëhershëm këtë e ndaloi dhe krejt tregimi nga këtu edhe vazhdoi. Duhet të ketë një nismë, diçka që ndodh konkretisht. (...) E përmendët se kanë qenë tregimet pozitive. Gazetarët nuk kanë shkruar për to, por ama na jepni neve gazetarëve këtë mundësi, të paktën njërit, të dytit, tretit, ia krijoni mundësinë e kontaktit me disa persona. (Smiljana Milinkov, Radio 021, Serbi, Konsulta kombëtare me gazetarët, Frushka Gora, Serbi, më 11 tetor 2008).

20. Konsultat kombëtare me shoqatat e familjeve të mbrojtësve të zhdukur mbi nismën KOMRA

Vukovar, Kroaci
24 tetor 2008

Konsultat i organizuan Documenta, Lidhje e shoqatave të familjeve të mbrojtësve kroat të zënë

rob dhe të zhdukur dhe Shoqata *Nënat e Vukovarit*. Pjesëmarrësit [30] kanë qenë viktimat, përfaqësuesit e shoqatave të viktimave, përfaqësuesit e veteranëve dhe aktivistët e organizatave jo qeveritare për të drejtat e njeriut. Iniciativën për themelimin e KOMRA e paraqiten Vesna Teršelić (Documenta, Kroaci), Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi), Katarina Kruhonja (Qendra për paqe, Joviolençë dhe të drejtat e njeriut nga Osjeku, Kroaci) dhe Mirko Kovačić (Shoqata *Nënat e Vukovarit*, Kroaci). Për tubimin kanë raportuar Radio kroat Vukovari, B92 dhe Vukovarske novine.

Disa pjesëmarrës kanë shfaqur frikën se KOMRA do të formohet nga organizatat joqeveritare dhe se dokumentacioni që e kanë mbledhur shoqatat viteve të fundit do të tjetërsohet nëse del nga Kroacia.

Në debat është sqaruar se organizatat joqeveritare e iniciojnë krijimin e koalicionit për përkrahjen e nismës për themelimin e KOMRA, ndërsa komisionin mund ta themelojnë e vetëm shtetet.

Pjesëmarrësit në konsultimin propozuan kyçjen më intensive të veteranëve dhe të shoqatave të veteranëve në procesin e konsultave.

Veteranët janë të interesuar që të kyçen në debat sepse kjo mund t'i ndihmojë që ta ndryshojnë imazhin e veteranëve si kriminel të luftës. Pjesëmarrësit kanë theksuar se të gjitha viktimat duhet të janë aktivë dhe të barabartë në konsultat.

Nismës për themelimin e Komisionit rajonal për zbardhjen e fakteve mbi krimet e luftës i duhet përkrahja e shoqatave të viktimave dhe të mbrojtësve.

*Tri shtyllat [FHP, Documenta dhe Qendra Kërkimore-Dokumentuese] nuk janë të mjaftueshme, na duhet përkrahja shumë më e madhe dhe më e gjerë për një nismë të tillë dhe këtu zoti Ivan Pšenica [Lidhje e shoqatave të familjeve të ushtarëve kroat të zënë rob dhe të zhdukur] si dhe zoti Mirko Kovačić [Shoqata *Nënat e Vukovarit*], që janë me ne këtu, na kanë folur për domosdonë që viktimat dhe përfaqësuesit e viktimave, dhe shprejoj edhe organizatat e mbrojtësve, si dhe organizatat tjera të shoqërisë civile, do të bëhen përkrahës të nismës. (Katarina Kruhonja, Qendra për paqe, Joviolençë dhe të drejtat e njeriut, Kroaci, Konsul-*

ta kombëtare me shoqatat e familjeve të zhdukurve dhe organizatat e mbrojtësve, Vukovar, Kroaci, më 24 tetor 2008).

Komisioni Rajonal duhet ta ketë nga një zyre në secilin shtet. Secila zyre do të ketë për detyrë që të kryej punët që i përcakton Komisioni Rajonal.

Komisioni Rajonal duhet të ketë zyrën qendrore, por edhe në secilin shtet do të duhej të kishte zyre që do të mbledhnin shënime, dhe nga ato do të dërgoheshin në Komisionin rajonal. Ai do të ishte në gjendje që me anë të fakteve të renditura kronologjikisht, të ndërtoj pamjen e saktë e asaj që ka ndodhur. Ndërsa ku do të jetë selia e Komisionit Rajonal, kjo do të duhej të dal si rezultat i konsultave dhe marrëveshjes. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqatat e familjeve të zhdukurve dhe organizatat e mbrojtësve, Vukovar, Kroaci, më 24 tetor 2008).

Anëtarët e shoqatave të familjeve të mbrojtësve të zhdukur i japin përkrahje nismës për themelimin e Komisionit Rajonal për zbardhjen e krimeve të luftës.

Mua më duket kjo një nismë e mirë, dhe ne do ti bashkohemi kësaj nisme, duke u inkuadruar nga një arsye që dihet shumë mirë se cila është: kudo që flitet për persona të zhdukur, kudo që tentohet të zgjidhet çështja e fatit e të zhdukurit, ne e kemi, të them ashtu, obligimin moral ndaj atyre që nuk i kemi më, që t'i dorëzojmë familjeve të tyre, sepse, duke shikuar objektivist, pas gjithë këtyre viteve vetëm anëtarët e familjeve durojnë gjithë këto ankthe, ndërsa politika qëmoti i ka la duart nga kjo (...) Përkundër faktit që shoqatat e mbrojtësve gati qind për qind janë kundër një nisme të tillë, unë mendoj se nuk kanë të drejtë. (Ivan Pšenica, Lidhja e shoqatave të familjeve të mbrojtësve kroat të zënë rob dhe të zhdukur, Kroaci, Konsulta kombëtare me shoqatat e familjeve të të zhdukurve dhe organizatat e mbrojtësve, Vukovar, Kroaci, më 24 tetor 2008).

Unë e përkrah nismën dhe thash, unë kam dëshirë që ju të punoni në këtë, ndonëse në rajonin e ish Jugosllavisë është punuar dhe punohet edhe sot, por dua që ju të punoni më mirë seç është punuar deri më sot, dhe që vërtetë të ketë rezultate... mendoj se ky është prioriteti më i madh. Dhe të gjitha nga këto familjet, të gjitha ato do t'ju pranojnë dhe kuptojnë

sepse ato e kanë nevojën, ndërkaq shoqatat tjera të mbrojtësve, ato kanë qëllime tjera, e kanë jetën ndryshe, dhe mënyrën e punës ndryshe, si dhe nevojat. (Štefica Krstić, Shoqata Viktimat e luftës atdhetare, Kroaci, Konsulta kombëtare me shoqatat e familjeve të të zhdukurve dhe organizatat e mbrojtësve, Vukovar, Kroaci, më 24 tetor 2008).

Unë së pari do ta theksoja pëlqimin tim të singertë me krijimin një trupi të tillë; ne e përkrahim këtë nismë sepse mendojmë se shteti me masat nga lartë nuk mund të bëjë asgjë pa nisma dhe përkrahje nga poshtë, nga ne qytetarët. (...) Mendoj se pa një nismë të tillë, pa animimin e qytetarëve, nuk mund të shkojmë larg. Te qytetarët sot dukshëm është zhdukur empatija, disi të gjithë jemi ende të frikësuar, shikojmë punët tona dhe nuk na brengos vuajtja e fqinjëve tanë. (Ljiljana Gehrecke nga Kroacia, Konsulta kombëtare me shoqatat e familjeve të zhdukurve dhe organizatat e mbrojtësve, Vukovar, Kroaci, më 24 tetor 2008).

Anëtarët e familjeve të të zhdukurve përkrahin gjykimet për krimet e luftës pa marrë parasysht se cilës kombësi i përkasin autorët.

Qëndrimi ynë në Qendër është se autori i krimit është autori, se viktima është viktime dhe se për ne ata nuk kanë identitet. Dhe nuk duam që njerëzit të ndajmë sipas përkatësisë etnike etj. Sepse krimet janë të njëjta, pa marrë parasysht se a kanë ndodhur në Srebrenicë, Ovčar, Pakrac, apo Poljan – autori mbetet kriminel. Jemi që të gjitha të dënohen dhe kërkojmë që të gjithë të dalin para drejtësisë. (Ankica Mikić, Qendra për paqe dhe këshilla juridike, Kroaci, Konsulta kombëtare me shoqatat e familjeve të të zhdukurve dhe organizatat e mbrojtësve, Vukovar, Kroaci, më 24 tetor 2008).

Shoqatat e mbrojtësve nuk e përkrahin nismën për formimin e Komisionit Rajonal.

E që ne tani t'ua dorëzojmë juve në dijeni të gjitha dokumentet, të gjitha që ekzistojnë te ne, të gjitha dijet tona, që ju ato t'i çoni atje përtej, në Serbi dhe të dispononi me to në çdo kohë dhe sipas dëshirës, kjo neve nuk na pëlqen. (Vesna Katić, Shoqata Vejushat, Kroaci, Konsulta kombëtare me shoqatat e familjeve të të zhdukurve dhe organizatat e mbrojtësve, Vukovar, Kroaci, më 24 tetor 2008).

Koordinimi i shoqatave, jemi gjithsej 13 shoqata, në bazë të kësaj tribune të juaj e ka marrë vendimin,

- ne jemi dëgjuar, nuk kemi mbajtur mbledhje, - se nuk do të ishte me vend që kjo qendër të bëhet në Vukovar. Nuk do të përkrahet nga shumica. (Slavko Jurić, Koordinimi i shoqatave të mbrojtësve, Kroaci, Konsulta kombëtare me shoqatat e familjeve të zhdukurve dhe organizatat e mbrojtësve, Vukovar, Kroaci, më 24 tetor 2008).

Bashkimi Evropian nuk duhet të lejojë asnjë shteti nga rajoni qasjen në BE përderisa nuk e zgjidhin problemin e të zhdukurve.

Në i kemi adresuar letra Bashkimit Evropian dhe Brukselit që asnjë shtet, cili do që të jetë, nuk do të duhej të pranohet në BE. Njëra nga pyetjet për hyrje në BE duhet të jetë zgjidhja e problemit të të zhdukurve. (Ivan Pšenica, Lidhja e shoqatave të familjeve të mbrojtësve kroat të zënë rob dhe të zhdukur, Kroaci, Konsulta kombëtare me shoqatat e familjeve të zhdukurve dhe organizatat e mbrojtësve, Vukovar, Kroaci, më 24 tetor 2008).

21. Konsultimi kombëtare me shoqërinë civile mbi nismën KOMRA

**Podgoricë, Mali i Zi
25 tetor 2008**

Konsultat i organizoi Aksioni për të drejtat e njeriut, dhe në to morën pjesë 33 përfaqësues të shoqërisë civile, mediat dhe politikanët e Malit të Zi. Fjalën hyrëse e kishin Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi) dhe Tea Gorjanc-Prelević (Aksioni për të drejtat e njeriut, Mali i Zi). Kanë raportuar gazetaret ditore *Dan* dhe *Vijesti*.

Pjesëmarrësit përkrahin nismën për themelimin e KOMRA.

Pas kaq vitesh dhe aq shumë ngjarjesh në këto hapësira nga aspekti i aktivitetit dhe punës së sektorit civil, s'ka mundur me ndodh asgjë me e fortë dhe me e rëndësishme se sa që është lancuar nisma për formimin e Komisionit për hetimin e të kaluarës dhe për ballafaqimin me të kaluarën. (Velija Murić, Komiteti malazet i juristëve për të drejtat e njeriut, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

KOMRA mund të jetë vetëm projekt shtetëror. Mund të jetë vetëm projekt shtetëror, përndryshe

do të mbetet projekt i organizatave joqeveritare... dhe kurrë nuk do të ketë sukses... Kjo do të thotë se duhet të kemi bindje, gatishmëri, vendosmëri që të ndërtojmë diçka, dhe kjo diçka në këtë moment është Koalicioni, i cili duhet ta ketë atë fuqinë që në një moment të organizojë presione në institucionet që ne të fitojmë atë që dëshirojmë, që ky proces të bëhet projekt shtetëror, që KOMRA, ky Komision rajonal të bëhet projekt shtetëror, e atëherë ne në bazë të rekomandimeve tona ne do të përcjellim me kujdes çdo hap që ndërmarrin institucionet në raport me themelimin dhe funksionimin e atij trupi. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

Elitat politike nuk janë të interesuara për temën e së kaluarës sepse janë përgjegjëse për trashëgimin e rëndë.

Ballafaqimi me të kaluarën e luftës te na nënkupton në këtë moment ballafaqim me elitën politike e cila është tani në pushtet kështu unë i kuptoj plotësisht institucionet shtetërore që do të duhej të bënin atë, por nuk e bëjnë aspak me dëshirë. (Koča Pavlović, deputet në Parlamentin e Malit të Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

Karakteri rajonal i nismës dhe përkrahja ndërkombëtare do të janë ndihmesë që elitat politike të pranojnë nismën.

Komisioni Rajonal në Ballkan do të mund të ishte si një garanci për Bashkimin Evropian se ne diçka të tillë nuk do të provojmë të bëjmë në të ardhmen. (Tea Gorjanc-Prelević, Aksioni për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

Mendoj se këtu aspekt i rëndësishëm është fakti se ky është komision rajonal, dhe se të qenit rajonal mund të jetë bazë që të tejkalohen këto barrierat tona të brendshme lokale. (Koča Pavlović, deputet në Parlamentin e Malit të Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

Do të thotë, sado që këtu kemi dëgjuar për kufizimet mjaft cilësore që do të kemi gjatë promovimit të kësaj ideje, dhe në përgjithësi gjatë avokimit tek ata që në instancën e fundit duhet të marrin vendimin për këtë, mendoj se një aleat tejet i rëndësishëm në këtë pjesë është mu procesi i integrimeve evropiane

dhe konteksti i bashkëpunimit rajonal. (Saša Zeković, hulumtuese e shkeljes e të drejtave të njeriut, Mali i Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

KOMRA duhet të jetë instrument shtetëror për shkarkimin e të rinjve nga përgjegjësia për të kaluarën.

Mua më duket se nëse themelojmë komisionin rajonal që është shumë e rëndësishme të mendojmë për atë se si do t'i kyçim të rinjtë edhe në themelimin, pastaj në zbatimin dhe në fund edhe në punën e Komisionit. Dhe ajo që mbase është më e rëndësishmja, çka atëherë sjellin konstatimet e Komisionit? Mendimi im është se gjithnjë duhet identifikuar problemet. Njëra prej mënyrave është informimi, është opinioni dhe këto konsultat. Kjo është diçka që absolutisht do të ishte rekomandim që të gjithë do ta mund të shfrytëzoni momentet e mundshme, që kjo të lidhet edhe me momentin shoqëror, në të cilin ne duam të hyjmë në Evropë, që të hyjmë lirshëm, hapur, pa ndonjë ngarkesë dhe ku duam që, sërish, të rinjtë t'i lirojmë nga barra me të cilën përndryshe do të hynim pa spastrimin e këtyre fakteve mbi të kaluarën. (Ajša Hadžibegović, Forumi të rinjtë dhe edukimi joformal, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

Ne sot jemi në tregimin kur të rinjtë në lëkurën e tyre nuk e ndiejnë krejt atë çka ka ndodhur në kohërat e tmerrshme; ata nuk i kanë përjetuar keqbërjet pos përmes prindërve të tyre. Por, në momentin e sotëm, kjo nuk i bën më pak të përgjegjshëm në qasjen që kanë gjërave që kanë ndodhur. Nëse ne jemi, edhe vetën e numëroj këtu, njerëz të rinj e të ardhmes, madje 'bota do të na mbetet neve', siç kanë merak ta flasin gjithë zëdhënësit e njohur, ndërkaq që kjo mbetet vetëm fjalë, dhe nëse ne jemi përgjegjës për të nesërmen, atëherë duhet të informohemi sa më shumë me këtë ide dhe është çështje e jonë, edhe inja, që së bashku të punojmë në masivizimin e kësaj ideje. (Sandra Mitrović, Partia liberale e Malit të Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

Për suksesin e nismës duhet të përgatitet opinioni përmes mediave dhe programeve speciale për edukim.

Njëri prej qëllimeve operative do të ishte që në

njëfarë mënyre të përgatitet opinioni, në këtë rast në nivelin kombëtar opinioni në Mal të Zi, që të përkraket një nismë e tillë dhe që pastaj të ndikojë në vendimmarrësit, pra politikanë, që të përkrakin një nismë të tillë, dhe ky ndikim si presion i opinionit, që rrjedhe përmes mediave. (Duško Vuković, PCNE/Vijesti, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

Zgjidhja e fatit të të zhdukurve duhet të jetë në mandatin e KOMRA.

Sa i përket Komisionit, komisioneve shtetërore të rajonit, unë mendoj që shtetet kanë punuar pak në çështjen e të zhdukurve, të vrarëve, dhe veçanërisht rreth zbardhjes së krimeve të luftës dhe të kriminelëve në territorin e ish Jugosllavisë. Kemi pas presione të mos shkojmë në Forumin që u majtë në Prishtinë. Ne vendosëm që të shkojmë, sepse ishte nevoja të ishim atje. Nevoja për treguar të gjitha problemet tona, problemet e të zhdukurve dhe vrarëve, problemet e familjeve. (Ljubiša Filipović, Shoqata e familjeve të vrarëve dhe të zhdukurve në Kosovë Crveni Božur, Mali i Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

Më të dashurit e tyre janë zhdukur, disa as sot nuk dinë çka ka ndodhur me vëllezër dhe motra apo kushërinjtë më të afërt dhe kjo ju kthehet atyre praktikisht si një bumerang, sepse ata edhe nëse kanë fituar ndonjë pronë nuk mund ta bëjnë procedurën e trashëgimisë pa ndonjërin e anëtarëve të familjes që nuk është gjetur dhe nuk dihet çka ka ndodhur me te, dhe nuk mund të dëshmojnë se janë të gjallë, po as që janë vrarë, o të vdekur, a janë varrosur etj. (Ljiljana Raičević, Shtëpia e sigurt për gruan, Mali i Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

Pjesëmarrësit mbështesin gjykimet për krimet e luftës.

Pra, me rëndësi janë viktimat, mirëpo për mua janë po aq të rëndësishëm keqbërësit sepse zbardhjen e të vërtetës nuk do ta bëjmë vetëm përmes viktimitave por edhe përmes proceseve gjyqësore sepse, më sa di unë, deri në ditën e sotme proceset gjyqësore kanë ndihmuar në zbardhjen e asaj që ka ndodhur realisht. (Mira Asović, Liga e grave votuese e Malit të Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

Unë pajtohem se gjykimet e kriminelëve të luftës janë shumë të rëndësishëm por është me rëndësi të dihet kush po nxirret para gjyqit. A po gjykohet ai që ka urdhëruar, ai që ka asistuar, apo ekzekutori, i fundi në këtë zinxhirë. Kuptohet se asnjëri prej tyre nuk mund të lirohet nga përgjegjësia, por ai që është i pari në list është i pari edhe i përgjegjës dhe dihet se duhet të gjykohet ashtu si meriton. Unë flas për Malin e Zi, për gjykatat dhe prokuroritë, organet e drejtësisë, dhe shtroj pyetjen a ka në Mal të Zi gjykime të drejta? Unë mendoj se jo dhe se nuk do ti kemi në një kohë të afërt. (Aida Petrović, Lobi i grave malazeze, Mali i Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

Pjesëmarrësit janë kundër që themelues i KOMRA të jetë kryetari i shtetit.

Absolutisht jam kundër që një komision të tillë të formohet me dekretin e kryetarit të shtetit. Me këtë të gjitha kompetencat rreth themelimit dhe përbërjes së komisionit do të barteshin te ai person... kjo nismë duhet të procesohet drejt parlamentit. (Branislav Radulović, Shoqata e juristëve të Malit të Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

Mendoj se pushteti aktual ose zyrtar, po flas për Malin e Zi, nuk ka treguar raport të duhur ndaj kohës kur kanë ndodhur krimet dhe lidhur me këtë kam frikë se iniciativa që kryetari i shtetit me dekret ose në ndonjë mënyrë tjetër të jetë themelues i komisionit, do t'ia humbë rëndësinë vetë komisionit sepse jemi dëshmitarë se paria dhe funksionarët e shtetit edhe më tej në mënyrë tjetër përcjellin, presin dhe llojnë për njerëzit që pjesa dërmuese e popullsisë i përjeton krejtësisht ndryshe. Kjo ndjenje është e sikletshme dhe e rëndë dhe mendoj se në këtë mënyrë mbase do të devalvohen edhe përbërja, efikasiteti dhe frytshmëria e komisionit. (Velija Murić, Komiteti i juristëve i Malit të Zi për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

Debati për themelimin e KOMRA të zhvillohet nën moton Kurrë më! (Nunca mas).

Andaj më pëlqen kjo «Kurrë më!» (Mirjana Kuljak, Fakulteti Ekonomik, Mali i Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

Nisma KOMRA ka aleatë në disa parti politike.

Partia Socialdemokrate, nëse nuk e kam gabim, ende bënë pjesë në strukturën e etabluar sunduese, por është edhe subjekt që nuk ka background problematik nga fillimi i viteve '90 kështu që shpresoj se në momentet e caktuara dhe kur janë në pyetje projektet e caktuara, mund të llogariten si aleatë, përkatësisht sektori civil mund t'i llogarisë si aleatë. (Duško Vuković, PCNE/Vijesti, Mali i Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

Sa i përket raportit të Partisë liberale ndaj nismës së Komisionit Rajonal ju e keni përkrahjen e plotë nga ana jonë në parlament, edhe pse nuk është shumë e madhe, ajo është megjithatë e rëndësishme përderisa është e sigurtë. (Sandra Mitrović, Partia Liberale e Malit të Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

Arkivi i Hagës duhet të jetë në disponim të KOMRA.

Arkivi që ekziston në Tribunalin e Hagës, për këtë ka shkruar edhe Carla del Ponte, do të ishte tejet e rëndësishme që të jetë në disponim të gazetarëve, hulumtuesve, madje edhe qytetarët, që të studiojnë atë dhe kuptojnë esencën e ngjarjeve në hapësirat tona. Mendoj se ky material do të ishte i mirëseardhur dhe se shënimet që gjenden aty do të ishin ndihmesë Komisionit. Sepse kur përmes mediave plasoni informata të reja dhe të panjohura, besoni se kjo e vë në lëvizje atë proces. (Sonja Radošević, gazetarë e lirë, Mali i Zi, Konsulta kombëtare me shoqërinë civile, Podgoricë, Mali i Zi, më 25 tetor 2008).

22. Forumi i Katërt Rajonal për drejtësi tranzicionale: Nisma KOMRA

**Prishtinë, Kosovë
28 - 29 tetor 2008**

Forum i katërt rajonal, i mbajtur në Prishtinë më 28-29 tetor të vitit 2008, është tubimi më masiv mbi mekanizmat e zbardhjes së fakteve mbi krimet e luftës i mbajtur në hapësirat e ish Jugosllavisë. E organizuan Fondi për të Drejtën Humanitare, Documenta, Qendra Kërkimore-Dokumentuese, Shoqata *Shpresimi* dhe Community Building e Mitrovicës. Ndër 325 pjesëmarrës nga Kosova, Kroacia, Serbia, BH, Mali i Zi, Sllovenia dhe Maqedonia më së shumti ka pas viktimat dhe përfaqësues

es të shoqatave të viktimave (mbi 200), pastaj rreth 100 të rinj, përfaqësues të organizatave rinore, të rinj nga shkollat e mesme dhe studentë që nuk janë anëtarësuar në organizatat rinore, dhe mbi 100 aktivistë të të drejtave të njeriut dhe OJQ-ve tjera nga rajoni. Në punën e Forumit morën pjesë edhe 20 përfaqësues të familjeve të civilëve dhe policëve të kidnapuar, të vrarë dhe të zhdukur në Kosovë, ndërkaq që shoqatat tjera të serbëve nga Serbia dhe Republika Serbska, kanë refuzuar pjesëmarrjen në shenjë të protestës për shkak të shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Për Forumin kanë informuar: Beta, Danas, Politika, Koha Ditore, Zëri, Novi list, Slobodna Bosna, Republika, Tolerancija, BIRN, RTK 1 (Info), RTK 1 (Ditari), Radio Evropa e Lirë, B92, Domovinskirat.hr.

22.1. Përkrahja zyrtare

Përfaqësuesit e institucioneve të Republikës së Kosovës i japin përkrahja bashkëpunimit rajonal për zbardhjen e fakteve mbi fatin e të zhdukurve pa marrë parasysh kombësinë.

Siç e dini edhe Kosova ka pasur përjetimet e saja jashtëzakonisht të tmerrshme, atë që mund të them është se është përkushtim i institucioneve të Kosovës, i qytetarëve të Kosovës që kjo histori s'mund të harrohet asnjëherë por jemi shumë të përkushtuar ta mbylлим në kaptinën e kujtesës për të pas një lëvizje të fuqishme në ecjen përpara, në qasjen e trajtimit të barabartë të të gjithë qytetarëve të Kosovës. (Fatmir Sejdiu, Kryetar i Kosovës, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë Tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Qasja rajonale ndaj këtij problemi mendoj se është shumë e rëndësishme edhe për një fakt sepse të gjithë së bashku do të ia dalim ti vërtetojmë të gjitha ato fakte, të cilat deri më sot nuk janë zbardhur. Për mendimin tim, si një fakt më i rëndësishëm, është fakti që të dihet apo të zbardhet fati i të zhdukurve i cilitdo nacionaliteti. Unë nuk e mohoj se ka të zhdukur edhe në radhët e komuniteteve tjera në Kosovë, por nuk dua ta mohoj as faktin se numri më i madh i të zhdukurve i përket komunitetit shumicë. (Nekibe Kelmendi, Ministresh e drejtësisë e Kosovës, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Konsideroj se qasja rajonale në përcaktimin e argumenteve dhe përgjegjësi është e domosdoshme dhe kjo argumenton nevojën për forcimin

e bashkëpunimit rajonal në të gjitha sferat e në veçanti lidhur me gjykimet për krimet e luftës në njërën anë si dhe për rehabilitimin sa më efikas të të gjitha viktimave në anën tjetër. Të mos e harrojmë të kaluarën jo për hakmarrje, jo për revansh dhe jo për armiqësi por për të mos e lejuar kthimin e saj dhe për të krijuar një botë më të mirë në paqe, mirëqenie e prosperitet njerëzor. (Ramë Manaj, zëvendëskryeministër i Kosovës, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës mendojnë se zbardhja e ngjarjeve dhe fakteve duhet të përfshijë periudhën nga vitit 1990 deri në vitin 1999.

Ju e dini fare mirë se rëndësia e zbulimit të së vërtetës e ndihmon edhe sjelljen drejtësisë në vend edhe ballafaqimin e akterëve të krimeve m e të bëmat, me krimet, me ndihmat e të gjitha llojet tjera që kanë qua deri te vrasja, zhdukja, torturimi, burgosja e tjera e tjera për periudhën prej vitit 1990 deri në vitin 1999. (Nekibe Kelmendi, Ministresh e Drejtësisë e Kosovës, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008)

OESB përkrah vendosjen e mekanizmave jashtëgjyqësor për zbardhjen e fakteve.

Proceset jashtëgjyqësore mund të bëhen të domosdoshëm në rastet kur dëshmitarët, provat dhe të akuzuarit nuk janë të disponueshëm. Kujtesat ndryshojnë dhe me kohë. Trupat jashtëgjyqësor, megjithatë, mund të janë ndihmesë në vendosjen e fakteve bazike ndërmjet komuniteteve përmes shpalljes publike të lëndimeve, dhe rehabilitimit dhe kompensimit të viktimave. (Werner Almhoffer, shefi i Misionit të OSBE në Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

22.2. Përkrahja e gjykimeve për krimet e luftës

Të gjithë pjesëmarrësit përkrahin gjykimet për krimet e luftës por i kanë të ndara mendimet se ku duhet të mbahen gjykimet.

Unë personalisht angazhohem që gjykimet të mbahen aty ku ka ndodhur krimi sepse edhe opinioni dëshiron një satisfaksion, jo vetëm familjarët që kanë humbur më të dashurit e tyre dhe që nuk i dinë se ku i kanë. (Nekibe Kelmendi, Ministresh e Drejtësisë e Kosovës, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Viktimat e dhunës në Kosovë janë të privuara nga dija se cilët janë vrasësit e më të dashurve të tyre, cila dorë i bëri krimet, dhe kjo do të thotë se janë të privuar nga drejtësia, çka do të thotë nga dënimet e merituar që është dashtë t'i marrin ata që ata. Ne do ti dënojmë kriminelët tanë në Kosovë, serbët le ti dënojnë kriminelët e tyre në Beograd, bashkësia ndërkombëtare duhet të na ndihmojë për këtë. (Numan Balić, deputet në parlamentin e Kosovës, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Nëse kriminelët nuk i nxjerrim para gjyqit, është e pamundur që të ecim drejt ardhmërisë, dhe është e pamundur të bëjmë hapa të ri drejt integriteteve dhe pajtimit të vërtetë dhe afatgjatë mes kombeve që jetojnë në këto hapësira të përvuajtura, dhe për këtë arsye duhet të ndiejmë një frikë të arsyeshme. (Aleksandar Stojanović, Qendra për zhvillimin e shoqërisë civile, Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Pastaj ekziston një mendim shumë i qartë që në të vërtetë për krimet që janë bërë në Kosovë, të bëhen gjykimet në Kosovë. Ka siguri të plotë që mund të bëhen gjykimet aty ku është bë krimi, vetëm atëherë mund të qetësohemi dhe të mendojmë për ndërtimin e të ardhmes. (Prenk Gjetaj, Komisioni i Qeverisë së Kosovës për personat e zhdukur, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Gjykimi i kryesve të kimit duhet të bëhet në vendin ku është kryer krimi dhe marrja e çuarja e viktimave në Beograd, flas për rastin e familjes Bogujevci, për të dëshmuar në një gjykatë ku nuk ka drejtësi, është edhe një shkelje e rëndë e të drejtës së asaj viktime. (Sheremet Ademi, Shoqata Kujtimi, Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Gjithmonë ngelemi para asaj që e vërteta duhet të zbardhet edhe të gjithë ata kryesit të kimit duhet

të nxirren para organeve të drejtësisë dhe ti marrin dënimet e merituar sepse pa e zbardhur të vërtetën nuk ka kuptim as bashkëjetesa, as afërsia; e për të ndërtuar një afërsi, një bashkëpunim reciprok, atëherë duhet që të zbardhet e vërteta dhe në bazë të asaj të shohim se ku qëndron ajo. Duhet dikush që dikujt ti kërkojë falje për të gjitha ato krime që janë bërë. (Hysni Berisha, Shoqata Shpresimi, Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

22.3. Nevojat e viktimave.

Shoqatat e familjeve të shqiptarëve të zhdukur dhe shoqatat e familjeve të serbëve të zhdukur pajtohen se prioritet është zgjidhja e fatit e të zhdukurve.

Problemi të pagjeturve në Kosovë, flas për numrin më të madh të tyre, flas për ata të cilët gjurmët i adresojnë në Serbi, është krijuar dhe mbetet problem politik. Qeveria serbe mund të kontribuojë drejtpërdrejtë në zbulimin e fatit të të pagjeturve, ta kapërcejë një anatemë, ta kapërcejë një barrierë fortë të madhe në rrugën riafrimit, të bashkëpunimit edhe të koekzistencës paqësore në këtë rajon (Ramë Manaj, zëvendës-kryeministër i Kosovës, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Ndër pasojat më të rënda që vazhdojnë ta preokupojnë shoqërinë kosovare gjithë këto vite të pasluftës, siç u theksua tanimë disa herë, është moszbulimi i fatit të të kidnapuarve, ende të pagjetur, mbase edhe të zhdukur. Dhe padrejtësia më e madhe është ajo që vazhdon, është ajo që nuk ka fund, sikur një dhembje e pafundme. (Ramë Manaj, zëvendës-kryeministër i Kosovës, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Publikisht u drejtohem përfaqësuesve të viktimave shqiptare, na ndihmoni që më të dashurit tonë të lirohen dhe të kthehen te familjet e tyre, nëse janë ende gjallë. Përgjigjen e kërkojmë nga dëshmitarët okularë të këtyre kidnapimeve, që janë në institucionet e Kosovës. Familjet shqiptare e dinë çka do të thotë lirimi i 2.108 të zënëve rob të tyre, ku shumica kanë qenë me dënime juridikisht valide të gjykatave. Prandaj edhe e shtrojmë pyetjen pse nuk ka drejtësi për viktimat serbe, pse për pësimet e tyre të gjithë heshtin, pse grupet punuese për personat e zhdukur takohen pas dyerve të mbyllura. (Snežana

Zdravković, Shoqata e familjeve të personave të kidnapuara dhe të vrara në Kosovës, Serbi, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Ju lutem, bëj thirrje, apel që bashkërisht të bëjmë përpjekje dhe të kërkojmë ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare që të ushtrojnë trysinë e duhur në qeverinë aktuale të Beogradit, ngase ajo mban të vërtetën, ajo mban realitetin dhe gjithë atë çka u ka ndodhur edhe serbëve edhe shqiptarëve në Kosovë gjatë periudhës së luftës. (Haki Kasumi, Këshilli për koordinimin e shoqatave të familjeve të personave të zhdukur në Kosovë, Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Dhjetë vjet pas luftës problemi i personave të kidnapuar dhe të zhdukur në Kosovë, që ka filluar para luftës me kidnapimin e civilëve, ka vazhduar edhe pas lufte me gjithë praninë e bashkësisë ndërkombëtare dhe ende nuk është zgjidhur. (Aleksandar Stojanović, Qendra për zhvillimin e shoqërisë civile, Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Viktimat kanë nevojë për bashkëndjesi, që të dëgjohej zëri i tyre, dhe që të identifikohen dhe dënohen autorët e krimeve.

Konsideroj që nevojë imediate, më se e domosdoshme është krijimi i hapësirës kredibile për familjarët, që ata të mund të rrëfohen, që ata ta kenë të drejtën, të vetmen mundësi që ata të shfryhen, të rrëfohen, ta thonë atë që e kanë në shpirt dhe të mos ju merret asnjë sekondë, asnjë sekondë. [Nëse ata nuk do të mund ti kthejnë familjarët, anëtarët e familjes të cilët i humbën, bile le të iu krijohet një mundësi e tillë. Tjetra nevojë është që kryesit e akteve kriminale të dënohen; të identifikohen dhe të dënohen, në mënyrë që shpirtat e atyre që u zhdukën të qetësohen e gjithashtu të gjejnë prehje shpirtërore edhe familjarët e tyre. Nevojë tjetër shumë e rëndësishme është që të gjithë pa dallim, familjarët nga krejt vendet e ish Jugosllavisë, të përpiqen që të tregojnë empati ose bashkëndjesi për atë çka u ndodhi atyre, gjithë atyre pa dallim, për arsye e se kudoqoftë që të jetë krimi është njësoj krim dhe e ka peshën e njëjtë. (Shukrije Gashi, Partners Kosova-Center for Conflict Management, Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008)

22.4. Formimi i Koalicionit për KOMRA

Nisma për KOMRA është pozitive, por për shoqatat e familjeve të shqiptarëve të zhdukur është herët që të kyçen në koalicion.

Qëndrimi i parë i Këshillit Koordinues është se ideja apo iniciativa e FDH, e përkrahur nga shoqëria civile dhe individët, shihet si ide pozitive e cila vlerësohet dhe është plotësisht e pranueshme. Nëse e marrim parasysh situatën specifike e cila dominon në shoqërinë civile të Kosovës, me një shqyrtim të veçantë në shumicën e popullatës së Kosovës, me gjithë respektin ndaj kësaj iniciative me ndikim, me karakter human dhe me qëllime të mira, ne mendojmë se ende është herët për te. Deri më sot asnjë shoqatë, me përjashtim të disa individëve, nga të cilët shoqata është distancuar, nuk i është bashkangjitur koalicionit. (Haki Kasumi, Këshilli për koordinim i familjeve të të zhdukurve në Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, 28-29 tetor 2008).

Këshilli Koordinues ka vendosur që mos ta pengojë këtë iniciativë, dhe në një far mënyre të kësaj dhe ta përshëndes, por në këtë moment assesi nuk mund të bëhet pjesë e saj. Është e nevojshme që në mënyrë të pjekur të shtjellojmë dhe analizojmë. Duhet të kemi edhe pëlqimin e anëtarëve të familjarëve të viktimave, të cilët janë të lënduara dhe janë kryesorët që duhet të japin vizën, pëlqimin, nëse është koha ti bashkohemi iniciativës të cilës nëse jo sot, nesër do ti bashkohemi. (Haki Kasumi, Këshilli për koordinim i familjeve të të zhdukurve në Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, 28-29 tetor 2008).

Leni kohë dhe hapësirë të mjaftueshme që ne ta analizojmë, ta studiojmë dhe mos mendoni që ad hoc me një nënshkrim keni arritur që të krijoni një koalicion sepse ai koalicion faktikisht do të injorohet nga viktimat e luftës, nga shoqatat; e nëse juve këtu, nëse për juve këto nuk kanë peshë atëherë urdhëroni pa neve gjeni faktet, krimet, mbronin vetveten edhe vazhdoni avazin e vjetër. (Sheremet Ademi, Shoqata Kujtimi, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Plagët janë ende të freskëta, ende ekziston frika, presionet nga jashtë, mospranimi dhe mohimi i realitetit, të gjitha këto janë pengesë që njerëzit të

pranojnë dhe ta bëjnë një hap përpara. Prandaj bëj apel se do të ishte mirë ti jepet pak kohë grupeve nga ish Jugosllavia që secila veç e veç apo me përfaqësues tjerë të shoqërisë civile në vendet e tyre, të bisedojnë, të studiojnë mirë këto çështje dhe që t'i bashkohen kësaj nisme. (Shukrije Gashi, Partners Kosova-Center for Conflict Management, Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Këshilli i Institutit për të zhdukurit në BH ka marrë vendimin që askush të mos bashkohet me Koalicionin, por disa nga shoqatat nuk pranojnë që të vendoset në emër të tyre.

Këshilli i Institutit për personat e zhdukur në BH nuk e përkrahë këtë Koalicion për persona të zhdukur në këtë mënyrë dhe askush nuk ka mandat, asnjë shoqatë nga Bosnja dhe Hercegovina, këtë po ju them publikisht dhe me përgjegjësi, që të nënshkruaj anëtarësimin. (Zvonimir Kubinek, Këshilli i Institutit për personat e zhdukur në BH, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Një deklaratë e tillë është paralajmëruar në mediat boshnjake, për këtë jam i informuar, dhe mund të them se ka ardhur nga njerëzit e Institutit, kolegji-umit të drejtorëve... Ata, pra, kanë dhënë udhëzime që kjo çështje të prezantohet në këtë formë këtu, sikur nisma nuk e ka përkrahjen në Bosnje dhe Hercegovinë. Por, nisma e ka përkrahjen në Bosnje. Unë mendoj se nuk ka asnjë familje, dhe nuk ka asnjë shoqatë që, nëse kjo i shpjegohet në mënyrë të duhur, çfarë janë efektet e kësaj, do të jetë kundër Koalicionit. (Edin Ramulić, Shoqata e grave të Prijedorit Izvor, BH, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Mendoj se është shumë e dobishme që të organizohet Koalicioni i cili do të ndihmonte në themelimin e Komisionit për gjetjen dhe, në të vërtetë, përcaktimin e të vërtetës mbi ngjarjet në ish Jugosllavi. Mendoj se këto fakte, kjo gjendja faktike, mund të shfrytëzohet jo vetëm për zbulimin e kriminelëve të luftës, të krimeve dhe gjithçka që është bërë gjatë asaj kohe, por mendoj se mund të jetë shumë e dobishme për tekstet shkollore të ardhshme në shkollat tona, kështu që të mos kemi disa të vërteta. (Emsuda Mujagić, Shoqata Me zemër te paqja, BH, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Thelbësore është që të kyçen sa më shumë shoqata të viktimave, por edhe shoqata të mbrojtësve dhe unë do të thosha edhe institutet shkencore, medimet e të ngjashme. Sa më e gjerë është, sa më e madhe forca, aq më e madhe është mundësia që përmes presioneve, një ditë, dhe neve jemi të vetëdijshëm se kjo ditë është afër, qeveritë dhe ndoshta edhe kuvendet të marrin në konsiderim themelimin e Komisionit Rajonal. (Tin Gazivoda, Qendra për të drejtat e njeriut, Kroaci, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Lidhja e shoqatave të të zhdukurve dhe të izoluarve me dhunë e para në Kroaci i është bashkangjitur [Koalicioni]. (Mirko Kovačić, Shoqata Nënati e Vukovarit, Kroaci, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Në Forumin e Katërt Rajonal është themeluar Koalicioni KOMRA i cili ka për detyrë që të organizojë debatin për mandatin, qëllimet dhe elementet tjera të KOMRA.

Nga ky moment, nga zyrtarizimi i Koalicioni për KOMRA, ne e hapim debatin mbi karakterin dhe mandatin e Komisionit Rajonal, dhe kemi për qëllim që krejt ky proces konsultues të shërbejë asaj që ne nga shoqëria civile duhet ta definojmë karakterin dhe mandatin e Komisionit Rajonal, t'i përcaktojmë të gjitha elementet e duhur që mund të janë ndihmesë propozimit tonë për qeveritë, përkatësisht për adresat tona parlamenteve, që të merret vendimi për themelimin Komisioni Rajonal. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

22.5. Përkrahja nismës për themelimin e KOMRA

KOMRA shpreh interesin e përbashkët që të zbulohet e vërteta për atë çka ka ndodhur.

Të gjithëve sot në një numër kaq të madh na ka lidh një interes i përbashkët. Ky interes është zbulimi i të vërtetës. Nuk ka dyshim, do me thënë në askënd prej neve këtu, të gjendet e vërteta për të gjitha ato gjëra që kanë ndodhur në vendet tona dhe besoj që e vetmja mënyrë që të gjendet kjo e vërtetë është që të gjithë të punojmë bashkë. (Valdete Idrizi, Community Building Mitrovica, Forumi i Katërt

Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Unë e përshëndes këtë iniciativë rajonale për zbulimin e të vërtetës. (Shaban Terziu, Shoqata Lansdowne, Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Është mirë të bisedohet për këtë Komision, sepse është i nevojshëm një Komision për të vërtetën, për të gjitha që kanë ndodhur. (Ahmet Graiçevci, Shoqata Shpresa dhe Kujtimi, Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

E përshëndes këtë iniciativë si dhe çdo iniciativë tutër e cila për qëllim do të ketë zbulimin dhe zbardhjen e fatit e të zhdukurve. (Prenk Gjetaj, Komisioni i Qeverisë së Kosovës për persona të zhdukur, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Së pari duhet të përkrahet absolutisht kjo nismë e guximshme dhe punën e madhe të zonjës Kandić, të Valdete Idrizit, të zotëri Kulaglicit dhe të gjithë tjerëve, nga republikat tjera të ish shtetit të përbashkët, dhe kuptohet ata duhet të përkrahen në përpjekjet që kanë për qëllim që ky aktivitet të drejtohet nga rezultatet konkrete. Pra, nga njëra anë duhet të kemi informata çka ka qenë dhe si ka ndodhur, dhe duhet të synojmë që të kemi një të vërtetë. (Numan Balić, deputet në Kuvendin e Kosovës, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Nëse duam që të debatojmë për pajtimin, me besoni, këtë nuk do të kemi në afatet e gjata. Ajo me çka duhet të merremi, çka edhe është thënë këtu, është zbardhja e fakteve... Kemi nevojë për fakte, nevojë për raportin e njëjtë ndaj viktimave që do të duhej të fillonte në shtetet në të cilat sot jetojmë. Me vite mendoj për atë se si në Kroaci të nxitet themelimi i një Komisioni për zbardhjen e fakteve. (Ivan Zvonimir Čičak, Këshilli Kroat i Helsinkit për të drejtat e njeriut, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008)

Nëse të gjithë që përfaqësojmë familjet e viktimave, pa marrë parasysh fenë dhe kombin, e duam të vërtetën, sa kanë pësuar, sa janë vrarë, sa janë dëbuar, sa kriminelë janë nëpër burgje, sa janë nën dhe, dhe fatkeqësisht sa janë në liri, ky Komision

duhet të jetësohet. (...) Prandaj bëj apel, ne si shoqatë e familjeve do të japim përkrahjen dhe propozoj edhe përfaqësuesve të shoqatave të familjeve të kombeve tjera që ta pranohet këtë Komision, por me kushtin që shoqatat që do të kyçen të janë aktive në pjesëmarrje, së bashku me shoqatat tjera. (Simo Spasić, Shoqata e familjeve të të kidnapuarve dhe të vrarëve në Kosovë dhe Metohi, Serbi, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Përkrah krejt këto që Komisioni duhet të bëjë, por kuptohet deri në atë moment duhet të vazhdojmë bisedimet. (Ahmet Talić, Shoqata e kampit Sanski Most, BH, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Të përkrahet kjo iniciativë që shkon në drejtimin e duhur, e cila pa mbështetjen institucionale nuk do të bëjë shumë, por gjërat mund t'i lëvizë Koalicioni i shoqërisë civile (Miroslav Varga, veteran nga Kroacia, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Do ta forcojmë këtë lëvizje nëse e shkrijmë atë dhimbje, që të mos e kemi vetëm për viktimat tona, por në përgjithësi për të gjitha viktimat. (Ana Kvesić, Shtëpia Evropiane në Vukovar, Kroaci, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Unë ju pyes nga çka keni frikë, ju që keni pësuar. Keni frikë se që qeveritë tuaja, ose qeveritë tona, nuk do të themelojnë Komisionin që do të tentojë të zbardh faktet mbi krimet, dhunimet, mbi zhdukjet, mbi vrasjet, mbi shkatërrimet, mbi djegiet, mbi dëbimet dhe të gjitha shëmtitë tjera që kanë ndodhur. Unë nuk kam frikë që Kroacia, ose Serbia ta bëjnë këtë. Dikush e ka vrarë djalin tim.... Mendoj se askush nuk ka të drejtë ta merr të drejtën që të ndalojë nismën dhe themelimin e diçkaje që është në interes të njerëzve të vegjël. Nuk do të debatojmë ne zotërinj për themelimin e Komisionit, këtë do ta bëjnë parlamentet, dhe as qeveritë nuk do të na pyesin neve a e duam apo jo Komisionin. (Ružica Spasić, Shoqata e serbëve të zhdukur në Kroaci, Kroaci, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Unë quhem Bekim Gashi, dhe vijë nga komuna e Suva Rekës. Unë jam anëtar i shoqatës „Shpresimi”, gjithashtu jam anëtar i familjes me 22 viktima të

vrara. Mbështes iniciativën për formimin e Komisionit Rajonal për zbardhjen e fakteve në lidhje me krimet e luftës. Ata njerëz që flasin në emrin tim dhe emrin e familjes sime që është herët, ata mund ta përfaqësojnë vetëm veten dhe jo mua dhe familjen time. (Bekim Gashi, Shoqata Shpresimi, Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Është shumë më lehtë të thuhet jo për një punë se sa të thuhet. Kur thua po, merr angazhim, merr përgjegjësi. Jam në gjendje të fal, nëse ai kriminel që i ka vra më vjen ballë për ballë dhe më thotë i kam vra dhe kërkoj falje, këtë mund ta bëj sepse nuk i frikohem të vërtetës sepse është dikush më i madh që dënon se sa ne duke u munduar ta dënojmë njeriu njeriun. (Lush Krasniqi nga Korenica, Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008)

Në shoqëritë tona edhe më tej vlejnë të vërtetat dhe prezantimet e ndryshme të së kaluarës. Dhe mendoj se ajo që na duhet si buka, është që të zbardhen faktet në mënyrë që të zvogëlohet hapësira për manipulime me faktet si dhe hapësira për interpretime që janë ofenduese për shumicën, e posaçërisht për viktimat. (Vesna Teršelić, Documenta, Kroaci. Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Drejtësia institucionale në Mal të Zi ka nevojë për ndihmë dhe jo çfarëdo ndihme, por për ndihmën e një trupi të këtyllë rajonal. (Tea Gorjanc-Prelević, Aksioni për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Të rinjtë e kanë përgjegjësinë personale dhe morale që raportin ndaj krimeve ta ndërtojnë mbi faktet. Pra, ata duhet të kërkojnë të vërtetën. Me këtë marrin edhe përgjegjësinë që kanë ndaj viktimave por edhe ndaj ardhmërisë së tyre vetanake, sepse kjo shoqëri me raportin që ka ndaj krimeve nuk ua garanton as viktimave e as të rinjve, dhe as qytetarëve të tjerë, se krimet nuk do të përsëriten në të ardhmen. Të rinjtë e përkrahin qasjen rajonale në procesin e ballafaqimit sepse me këtë zvogëlohet mundësia që faktet të interpretohen nga perspektivat kombëtare, përkatësisht të interpretohen në mënyrë subjektive. (Marko Veličković, Qendra për zhvillimin e resurseve civile, Serbi, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Ti lëmë tragjeditë tona personale për të cilat do të mund të flisja shumë si i burgosuri i kampit dhe me pësime në familjen time që nga viti 1945 e këndeje. Këto i mbaj për vete, unë i kam fal të gjitha, të gjithë janë të falur, dhe tani dua që me këtë lëvizje, me këtë KOMRA, me tubimet, të forcohemi, të bashkohemi, të punojmë së bashku. (Mirko Kovačić, Shoqata Nënata e Vukovarit, Kroaci, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Unë dua të theksoj se për të nisë Kosova e jap përkrahjen e plotë këtij forumi dhe dëshiroj që të jemi pjesë përbërëse e kësaj iniciative dhe të ndihmojmë me të gjitha veprimtaritë që ne i bëjmë në qendër. (Shukrije Gashi, Partners Kosova-Center for Conflict Management, Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Paraprakisht, për të ardhur te iniciativat konkrete duhet të bëhen debate brenda shoqërore, do të thotë brenda një shteti, debate të cilat do të përfshinin të gjitha zërat e viktimave, debate që do të përfshinin akademikët, shoqërinë civile, artistët, qeveritarët, dhe këto debate pastaj të dilnin me një strategji konkrete që do të adresoheshin iniciativës rajonale. (Feride Rushiti, Qendra për rehabilitimin e viktimave të torturës, Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Ky Komision rajonal, mendoj se realisht mund të kontribuojë, të bëhet një lëvizje përpara, dhe për këtë shkak duhet t'i jepet përkrahja, thjesht pasardhësve tanë duhet t'i lëmë raportet e spastruara në mënyrë që ata ta zhvillojnë një jetë më të lumtur dhe më bukur seç e kemi ne. (Aleksandar Stojanović, Qendra për zhvillimin e shoqërisë civile Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Për shoqatat e familjeve të shqiptarëve të zhdukur është herët që të bashkohen me nismën KOMRA.

Iniciativa është në rregull, por mendoj se është ende herët, ndërsa në anën tjetër po frikohem se Komisioni Rajonal..., unë me të vërtetë jam skeptik, sepse me serbet nuk mund të flasim, nuk mund të arrijmë asgjë, nuk mund të gjejmë gjuhë të përbashkët. Në çdo minutë ata mund të ndryshojnë çdo gjë, çdo aspekt, dhe rezultati do të jetë zero.(...) Sepse në Kosovë ka

ndodhur lufta, gjenocidi, janë të vrarë më shumë se 12.000 njerëz, më shumë se 1.000.000 njerëz janë dëbuar nga Kosova, shumë prej tyre ende të pagjetur, diku më shumë se 4000. Unë mendoj se është ende herët për arsye se duhet ende të diskutojmë, secili prej nesh veçmas nëpër shoqata, në komuna, në bashkëpunim me qeverinë tonë, secili me qeverinë e vet. (Ymer Merlaku, Shoqata e familjeve të të zhdukurve nga Klina, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Ne të shtunën kemi pas mbledhje, aty kanë qenë 19 shoqata, dhe kemi ardhur në përfundim se është herët formimi i një Komisioni Rajonal me ata të cilët kanë kryer krime mbi ne. (Bajram Qerkini, Shoqata Kujtimi, Kosovë, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Nëse KOMRA vetëm do ti dokumentojë faktet, nuk do ti kontribuojë drejtësisë.

Nëse ky Komision ndalet vetëm në dokumentimin e fakteve, ne do të shndërrohemi në atë çka ka thënë Heinrich Bell, në protokolues të se keqes, dhe nuk do ti kontribuojmë drejtësisë, e viktimat këtë e kërkojnë. Viktimat kërkojnë autorët e krimeve, të ndëshkohen kriminelët. (Marija Radoman, Këshilli i Helsinkit për të drejtat e njeriut në Serbi, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Pajtimi nuk është qëllim i KOMRA.

Do të ishte mrekulli nëse arrihet pajtimi, por pajtimi mendoj se nuk duhet të jetë në mandatin e Komisionit Rajonal. (Tea Gorjanc-Prelević, Aksioni për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

KOMRA nuk është zëvendësim për gjykatat por kontribuon në procesimin e krimeve të luftës.

Nuk do t'i mbyllim gjykatat dhe prokuroritë, e as t'i zëvendësojmë ato; dhe kjo vlen edhe për institucionet siç është Komisioni shtetëror për gjetjen e të zhdukurve. Askujt nuk i shkon mendja që ky institut dhe komisionet shtetërore që tashmë ekzistojnë në këto vende të mbyllën, por përkundrazi Komisioni Rajonal duhet të bashkëpunojë me këto institucione. Prandaj mendoj që frika se kemi të

bëjmë me një nismë konfrontuese është krejtësisht e paarsyeshme. (Tea Gorjanc-Prelević, Aksioni për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Nëse në zbulojmë faktet që do t'i shfrytëzojnë gjykatat, atëherë do të kontribuojmë edhe në zbulimin e së vërtetës edhe në realizimin e drejtësisë. Përderisa kujtimet janë të freskëta, deri sa janë dëshmitarët, deri sa ekziston vendosmëria dhe dëshira që të thuhet e vërteta, ne duhet të punojmë në këtë. (Vehid Šehić, Forum i qytetarëve të Tuzllës, BH, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Përvoja e sistemit të përbashkët juridik në ish Jugosllavi mund të ndihmojë në unifikimin e metodologjisë së mbledhjes dhe të prezantimit të fakteve.

Ne në të vërtetë trashëgojmë sistemin e njëjtë juridik të ish Jugosllavisë dhe deshëm s'deshëm ne kuptohemi shumë mirë, të paktën ne juristët, në aspektin e terminologjisë, në aspektin e institutit dhe të procedurës, dhe mendoj se këto përvoja mund të aplikohen në unifikimin e metodologjisë së prezantimit të fakteve... Dhe ja tani është Koalicioni ose nisma, e mund të ngritët, përkatësisht mund të ndikojë në themelimin e Komisionit. (Zoran Pajić profesor i drejtësisë ndërkombëtare nga Bosnja dhe Hercegovina, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

Amnistimi ose zbutja e dënimit janë temë për debat mbi mandatin e KOMRA

Zbutja e dënimit për njerëzit që do të tregonin sinqerisht se ku janë varrosur këta njerëz, etj. Kjo është temë për të biseduar. Nëse shumica thonë se nuk jemi për zbutje, OK, por kjo është temë për debat. (Tea Gorjanc-Prelević, Aksioni për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i Katërt Rajonal mbi drejtësinë tranzicionale, Prishtinë, Kosovë, më 28 – 29 tetor 2008).

23. Konsulta rajonale me shkencëtarët për nismën KOMRA

Zagreb, Kroaci
10 janar 2009

Konsultat i organizoi organizata joqeveritare Documenta (Zagreb). Morën pjesë 34 shkencëtarë

dhe shkencëtarë nga i gjithë rajoni, si dhe një gazetar nga Beogradi. Fjalët hyrëse i mbajtën Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi) dhe Vesna Teršelić (Documenta, Kroaci), kurse debatin e moderuan Aleksandar Trifunović (Projekti medial *Buka / Zhurma*, BH), Jelena Simić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi) dhe Eugen Jakovčić (Documenta, Kroaci). Mediumet që kanë informuar për tubimin janë Republika, Slobodna Dalmacija, Glas Istre, Novi list, Gazeta Express, Nova TV dhe E-Novine.

Nisma KOMRA është pozitive dhe e mirëseardhur si thirrje e organizatave joqeveritare për ballafaqim të përbashkët me të kaluarën në bazë të fakteve

Çdo nismë është e mirëseardhur dhe është kënaqësi dhe në të vërtetë edhe mirë, që shoqatat joqeveritare marrin iniciativat që do të duhej ti inicinin shkenca ose shteti. Sepse Kroacia në hulumtimet e derisotme të humbjeve njerëzore në kohën e luftës atdhetare nuk ka qenë aspak e prirë që të hulumtojë një segment të atyre që kanë pësuar, sepse i konsideronte për viktima jo edhe aq të mëdha. (Igor Graovac, Instituti kroat për histori, Kroaci, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Nuk duhet gjithnjë të shikojmë të gjitha te shteti. Do të thotë, mendoj, se e gjithë shoqëria duhet të marrë flamurin, duhet të thuhet «pas meje». Për këtë bëhet fjalë. Dhe atëherë pas një kohe gjithnjë e më shumë akterë në shoqëri, qytetarë, posaçërisht ata që janë të interesuar edhe nga kjo edhe nga ana tjetër, do të shkonin pas tërë shoqërisë, dhe të bashkëngjitet edhe [kryeministri] Sanader, dhe të bashkohen edhe këta të tjerët. (Dražen Lalić, Fakulteti i shkencave politike në Zagreb, Kroaci, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Sendi bazik pse ky Komision rajonal është i mirë, sipas të gjitha gjasave. ka të bëjë me atë se shoqëria civile merr rolin e vet në zgjidhjen e kësaj çështjeje. (...) Roli i dytë i rëndësishëm i këtij komisioni është krijimi i një ambienti në ballafaqimin me të kaluarën. (...) Detyra e komisionit është që të krijojë atë nevojën organike që njerëzit të ballafaqohen me të kaluarën, dhe jo që kjo nevojë t'u imponohet. (Srđan Vukadinović, Qendra për hulumtime shoqërore, Mali i Zi, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Mendoj se është mirë që kjo nismë është e definuar

në mënyrë kaq precize. Ajo i shmanget kategorive morale ideologjike, të cilat gjithnjë mund të janë të kontestueshme në hulumtimet e këtilla dhe, kup-tohet, në proceset që do të pasojnë e për të cilat shoqëritë tona nuk janë sa duhet të përgatitura. Pra, mendoj se është ide e shkëlqyer që nocionet e të vërtetës dhe të pajtimit janë vënë në planin e dytë, dhe që faktet janë nxjerr në planin e parë. (Nikola Samardžić, Fakulteti filozofik në Beograd, Serbi, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Arsyeja kryesore për themelimin e KOMRA është nevoja për rishqyrtimin kritik të interpretimit të së kaluarës së afërt.

Ka më shumë interpretime të kaluarës së afërt. Pra, interpretime të së kaluarës së afërt, jo të së vërtetës. Dhe problemi nuk është vetëm në atë, por edhe në mjediset kombëtare që interpretimet i pranojnë si të vërteta, pa asnjë shqyrtim kritik. Me këtë do të duhej të merrej komisioni. Dhe kjo është në të vërtetë arsyeja pse duhet të themelohet Komisioni Rajonal. (Enes Milak, Muzeu i Kuvendit të dytë të AVNOJ-it, BH, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Iniciativa do të realizohet shumë vështirë për shkak të raporteve mes Serbisë dhe Kosovës.

Kjo nismë është shumë e mirë dhe pozitive, por nuk e ka përkrahjen në Kosovë, këtë mund t'ju përcjellë. Do të jetë shumë e vështirë të marrë përkrahjen në Kosovë për shkak të situatës së rëndë që vazhdon nga viti 1999, kur ka përfunduar lufta e armatosur në Kosovë. Pra, gjendja është ende shumë e rëndë, me shumë tensione dhe ende po zhvillohet një luftë e rëndë dhe e ashpër politike dhe diplomatike në Kosovë dhe për Kosovën. (...) Unë dhe kolegët e mi historianët do të kryejmë punën tonë dhe kuptohet se do të ju përkrahim në çdo aspekt, e përkrahim këtë nismë dhe këtë komision ngase mendojmë se do të përfaqësojë edhe interesat tona, (Haki Kasumi, Instituti për historinë e Kosovës, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Unë jam ndër ata skeptikët që mendojnë se nisma nuk mund të realizohet në këtë formë. Ndoshta mund të bëhen komisionet shtetërore në disa prej vendeve, shteteve post-jugosllave, por jo të jetësohet edhe koncepti rajonal në parimin për të cilin Jasminka tha se duhet të ekzistojnë bisedimet inter-parlamentare, apo si u shpreh... Unë mendoj

se politikisht situata është e tillë që në dy tre vitet e ardhshme, e ndoshta edhe tetë vite, nuk do të mund të realizohet ideja në tërësi para së gjithash për shkak të raporteve mes Serbisë dhe Kosovës; do të thotë do të «përrjashtoni» o Kosovën, o Serbinë. (Shkëlzen Maliqi, Qendra për studime humanistike Gani Bobi, Kosovë, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Nisma KOMRA është imponim i një të vërtete për të gjithë. Nuk duhet të ofrohet ajo që është shembur – rajonit i duhet një komision evropian.

Derisa i ofroni rajonit, ofroni atë që është shembur, që ka shkaktuar shumë krime etj., kështu që unë propozoj që kjo KOMRA të shkurtrohet pak, dhe njëkohësisht edhe të zgjerohet, dhe të quhet KOMEV, të quhet Komision evropian, nëse jo edhe botërore, duke u formuar në atë nivel që në aspektin e akterëve të ballafaqohemi edhe me akterët e bashkësisë ndërkombëtare, të cilët po kështu janë përgjegjës për krimet e bëra në rajon. (Josip Jurčević, Instituti i shkencave shoqërore Ivo Pilar, Kroaci, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Duke folur për nismën konstatoj se në shoqëritë post-jugosllave vlejnë të vërtetat e ndryshme. Inicimatorët thonë: «Në shumicën e rasteve këto të vërteta bazohen në mendimet dhe interpretimet politike, dhe jo në faktet. Edhe më tej mbisundon mohimi i krimit ndaj të tjerëve, pranimi vetëm i viktimave të veta dhe ndjenja e afërsisë me të akuzuarit nga komuniteti etnik i veti.» Kjo sigurisht se nuk është e kontestueshme. Por, është pyetje nëse mund të zgjidhet në paket në nivelin rajonal. Kjo është përpjekje e imponimit të një të vërtete për të gjithë. (...) Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia dhe Serbia i kanë rolet e ndryshme në këtë luftë, e kanë kaluar në mënyra të ndryshme atë dhe i kanë edhe shikimet e ndryshme të saj. Secili prej këtyre shteteve ka të paktën dy shikime të ndryshme të luftës. Si të pajtohet e papajtueshmja, a është kjo e mundshme, dha a duhet të përpiqemi rreth kësaj fare? (Davor Marijan, Instituti kroat i historisë, Kroaci, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Çka do të duhej të ishte kjo qasje rajonale? (...) Mendoj se kjo qasje nuk është adekuate për një komision i së vërtetës, sepse komisionet për të vërtetën duhet të shkojnë më tutje nga kjo dhe komisionet për të vërtetën duhet të koketojnë vazhdimisht me pyetjen

e kuptimit dhe të vlerës. (Kruno Kardov, Fakultetit Filozofik në Zagreb, Kroaci, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

E përkrah bashkëpunimin e të gjitha institucioneve, shkencore dhe joqeveritare, dhe besoj se qëllimi i përbashkët i yni është të arrihet prezantimi objektiv i historisë së viteve nëntëdhjetë në hapësirën e ish Jugosllavisë, dhe posaçërisht bërja e regjistrit të viktimave dhe ndëshkimi i të gjithë krimeve të luftës. Por vërtetë nuk e përkrah themelimin e komisionit rajonal sepse konsideroj se puna e zbardhjes së fakteve është para së gjithash detyrë e institucioneve shkencore, dhe se kjo punë mund të kryhet vetëm me qasje shkencore serioze, shumë precize. (Ante Nazor, Qendra memoriale-dokumentuese kroate e luftës atdhetare, Kroaci, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Faktet nuk mund të zbardhen në nivelin e një shteti. Qasja rajonale është e nevojshme sepse edhe lufta, viktimat dhe kriminelët kanë qenë të lidhur rajonalisht. Qasja jo-kombëtare është çështje e objektivitetit.

Njerëzit e kanë esenciale atë kuptimin, sinqeritetin, pranimin, ndonëse janë vërtet të frikësuar nga manipulimi që zgjat aq shumë.(...) Ndoshta ne nuk mund ta shërojmë çrregullimin post-traumtik por mund t'i ndihmojmë disi njerëzve që me këtë të vazhdojnë jetën, të shkojnë tutje. Prandaj mendoj se një komision është shumë i rëndësishëm, që njerëzit të dëgjohen. (Zdenka Pantić, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Faktet do të pengojnë ideologjizimin, faktet do t'i mbrojnë viktimat, dhe faktet, ky është mesazhi im i fundit, nuk mund t'i zbardhim në nivelin e një shteti, që ka qenë i përfshirë në luftë. Duhet të kemi formën e përbashkët. Mendoj se nuk është në pyetje nëse na duhet qasja rajonale. Është evidente se kjo luftë, ose luftërat, kanë qenë shumë shtresore; mund të shikohen si një luftë, ose si disa luftëra. Ato janë të lidhura. Edhe viktimat janë me vetë këtë faktin të lidhura. Edhe kriminelët janë të lidhur, edhe dorasit. Të mos themi se i njëjti doras ka bërë krime, kjo është shumë e mundshme, ka shumë raste të tilla, edhe në Kosovë, edhe në Bosnje, edhe në Kroaci. (Dražen Lalić, Fakulteti i shkencave politike në Zagreb, Kroaci, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Do të ishte me rëndësi që pos zbardhjes dhe tregimit

të së vërtetës mbi krimet e luftës, puna e KOMRA-së të përcillet me përpjekjet e gjithë neve që të krijohet një memorie kredibile politike në këto hapësira, që nuk do të bazohet në mite, por mu në ato fakte që do të arrijmë t'i mbledhim gjatë punës tonë. (Dali-borka Uljarević, Qendra për edukim qytetar, Mali i Zi, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Çdo popull këtu tregon dhe flet se është viktimë, se si kanë përjetuar dëbimin, se si kanë përjetuar krimet e luftës etj. Pra, këto janë disa të vërteta. Unë mendoj se duhet të jetë një e vërtetë që nuk ka fare përcaktuese kombëtare. Ekzistojnë të dhënat në terren dhe ato duhet të sistematizohen, klasifikohen. Dhe këso të dhënash mund të na japin edhe komisionet kombëtare duke kontribuar kësaj nisme rajonale, duke sistematizuar të paktën të dhënat e tyre lokale. (Jusuf Osmani, Arkivi i Kosovës, Kosovë, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Niveli rajonal nuk do të thotë se rezultatet e Komisionit Rajonal do të mbisundojnë atë çka kanë arritur komisionet kombëtare, ose, njëjtë, komisionet kombëtare apo organizatat joqeveritare brenda shteteve të caktuara kombëtare. Pse? Sepse vlerësimi që pason duhet të mbështetet në argumentet e caktuara dhe shqyrtimin kritik të metodologjisë së caktuar që përdoret. (Jasminka Hasanbegović, Fakulteti juridik në Beograd, Serbi, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Mendoj se nisma rajonale me qasje jokombëtare mund të jetë ndihmesë për shumë arsye. Para së gjithash, është çështje e objektivitetit, pastaj vetë karakteri i konfliktit ish vendet jugosllave njëfarëdore jep shtytje për nismën në këtë mënyrë. Dhe, natyrisht, këtu kemi diçka që sërish krijon kontekstin rajonal të lidhjeve dhe bashkëpunimit, çka do të mund të jetë argument i mirë tek ata që, megjithatë, përfundimisht do ta marrin vendimin për këtë. (Aleksandar Zeković, hulumtues i shkeljes të të drejtave të njeriut, Mali i Zi, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Për themelimin e KOMRA nuk mjafton presioni i organizatave joqeveritare. Duhet edhe vullneti dhe përkrahja e shteteve .

Një komision i tillë, nëse nuk e ka përkrahjen e shtetit dhe të institucioneve shtetërore, natyrisht se nuk do të mund të funksionojë, sidomos nëse nuk e ka

mbështetjen e parlamenteve, sepse parlamentet e kanë përgjegjësinë dhe fjalën publike të fuqishme. Shkencëtarët, kur merren me këto gjëra, dhe nuk i kanë shënimet e sakta, ose nuk i kanë zbardhur faktet, nuk do të kenë sukses në këtë punë dhe gjithë ato fakte nuk do të janë efikase. (Jusuf Osmani, Arkivi i Kosovës, Kosovë, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Ne këtu jemi grup për presion. Gjithnjë kemi qenë të tillë, dhe gjithnjë pakicë. Dhe jemi këtu bashkë sepse është ashiqare se duhet t'i lidhim energjitë mes veti, sepse të gjithë në mjediset tona i kemi pak a shumë problemet e ngjashme, dhe këto janë se elitat politike, përkatësisht shteti, nuk e kryejnë punën që duhet ta kryejnë. Komisionet nuk do ti krijojë sektori joqeveritar, duhet ti krijojë shteti dhe më e mira do të ishte ti krijojë parlamenti. Komisioni Rajonal [na duhet] për këmbimin e informatave, mundësisë që të krahasohen mes veti, dhe që të mundësohet veprimi i prokurorive kombëtare në proceset ku mund të flasin vetëm gjykatat. Të jeni të sigurt që shteti do të jetë më pak i interesuar për këtë punë. Prandaj i nevojitemi njëri tjetrit. (Branislav Radulović, Shoqata e juristëve e Malit të Zi, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Ideja jonë është që konsultat ti zhvillojmë brenda shoqërisë civile në shtetet e ish Jugosllavisë, që në vitin 2010 të kemi modelin e Komisionit Rajonal, i cili do të ketë në tërësi imazhin e karakteristikave bazike të modelit, të mënyrës së zgjedhjeve të anëtarëve, të trupave të caktuar që do të nevojiten për realizimin e mandatit të komisionit, pastaj të autorizimeve, programit të mbrojtjes së dëshmitarëve, dhe pastaj me këtë model duhet të shkojmë te parlamentet kombëtare me propozimin dhe kërkesën që kjo nismë i modeluar si është dhe me rekomandimet, të vihet në rend të ditës të parlamenteve dhe të hapen debatet parlamentare. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Themelues të KOMRA duhet të janë parlamentet.

Pra, nuk duhet të janë themelues shefat, kryetarët e shtetit, e as kryeministrat, ose dikush tjetër, por parlamenti. Andaj mënyra se si do të themelohet komisioni mund të jetë vetëm ajo e marrëveshjes ndërkombëtare. Pra, një marrëveshje interparlamentare si akt themelues i Komisionit Rajonal.

(Jasminka Hasanbegović, Fakulteti Juridik në Beograd, Serbi, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009)

Spektori civil duhet të bëjë presion që të themelohet KOMRA. Për këtë është i rëndësishëm dimensionin rajonal i nismës.

Opinionin i gjerë në njëfarë mënyre krejt procesin duhet ta kuptojë si të vetin, si përgjegjësi ndaj vetes dhe ndaj shoqërisë. Të ketë atë ndjenje të ownership-it, siç quhet në gjuhën angleze, ose të pronës ndaj asaj që ka ndodhur. (Neira Čengić, Fakulteti Juridik në Sarajevë – Qendra për studime interdisciplinare, BH, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009)

KOMRA në afatin prej dy, tre, katër vjetësh, - mund të zgjas edhe më shumë, - përmes marrëveshjes ndërshtetërore në nivelin e parlamenteve, ose edhe ndonjë formë tjetër, duhet të realizojë qëllimet që i ka, por kjo nuk është dobia e vetme nga proceset e tilla. Qëllimi më i madh është, e unë do të thosha edhe fenomen anësor, ndihmesa tejet e madhe kyçjen e organizatave të ndryshme dhe të individëve në diskursin rajonal, në vendosjen e raporteve bashkëpunuese dhe të partneritetit dhe, në të vërtetë, ndihmesa në restaurimin e shoqërive. Vetë restaurimi i shoqërisë ka ndikim terapeutik. (Gordan Bodog, Izmir, Kroaci, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009)

Komisionet [për të vërtetën] mund të janë vetëm nismë e organizatave joqeveritare kurse interpretimet duhet t'i lihen historianëve.

Unë e konsideroj të pranueshme idenë që organizatat joqeveritare të themelojnë komisionin, këtë e përkrah. (...) Komisionet duhet të merren ekskluzivisht me autorët e krimeve dhe viktimat, kurse interpretimi duhet t'i lihet historianëve, të cilët sipas profesionit që kanë çdo ditë ballafaqohen me të kaluarën. Unë, ndërkaq, konsideroj se Republika e Kroacisë i ka institucionet për këtë punë dhe kjo është gjithsesi një punë për institucionet. (Davor Marijan, Instituti kroat për histori, Kroaci, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009)

KOMRA duhet t'i ketë tri nivele: i pari, shkaqet dhe shpjegimet se çka ka ndodhur [narracioni për atë që ka ndodhur]; i dyti, dokumentimi i krimin; i treti, regjistri i viktimave.

Puna e vërtetë duhet të zhvillohet në tri nivele: të parin e shoh si shkaqe dhe shpjegime, pra një narracion për atë se çka ka ndodhur; i dyti është regjistri i krimeve, përkatësisht dokumentimi i krimin; dhe i treti është regjistri i viktimave. Unë, pra, e kuptoj këtë punë si një lloj bashkëpunimi rajonal. (Ivo Goldstein, Fakultetit Filozofik në Zagreb, Kroaci, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

Shkenca duhet të merret me analizën e natyrës së krimeve dhe jo të numërojë të vdekurit. Të gjitha duhet të unifikohen, të këmbëhen të dhënat mbi humbjet në njerëz në rajonin.

Shkenca do të duhej të merret vetëm me analiza, dhe këto viktimologjike, sociologjike, psikologjike, që të shihet natyra e krimin, dhe jo që shkencëtarët të bëhen roje të vdekurve, duke i numëruar viktimat ngase shtetet nuk i kanë numëruar. Neve kemi menduar se duke u marrë me viktimat dhe të lënduarit, do të merremi para së gjithash me interpretimin e pësimeve, me karakterin e luftës, dhe se kështu do të marrim përgjigjet në pyetjet pse te ne ndodhën krimet e të tilla, në ato përmasa, dhe jo që në fund të bëhemi vetëm numërues të të vdekurve. (...) Të gjithë faktorët që merren dhe punojnë me humbjet në njerëz në hapësirat e Jugosllavisë së Dytë, të gjithë duhet të bashkohen, t'i këmbëjnë të dhënat. (Igor Graovac, Instituti kroat i historisë, Kroaci, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009)

Nevojitet regjistri i saktë i viktimave të të gjitha palëve që kanë qenë në luftë.

Në Kroaci si dhe në vendet tjera duhet të bëhen regjistrat, të viktimave para së gjithash, të të gjitha palëve që kanë qenë në luftë, e jo që edhe sot e gjithë ditën të themi «më duket se kanë qenë 18.000 e diçka më shumë viktima» (Dražen Lalić, Fakulteti shkencave politike në Zagreb, Kroaci, Konsultat rajonale me shkencëtarët, Zagreb, Kroaci, më 10 janar 2009).

24. Konsultat kombëtare me shoqërinë civile për nismën KOMRA

**Pançevë, Serbi
28 mars 2009**

Konsultat e para me shoqërinë civile në Vojvodinë i organizoi Aksioni qytetar i Pançevës. Në kon-

sultat morën pjesë 27 veta, prej të cilëve shumica ishin përfaqësues të organizatave joqeveritare, disa gazetarë, dy përfaqësues të Komunës Hebreje të Pançevës, dhe tri përfaqësues të partive politike. Fjalën hyrëse e mbajtën Marijana Toma (*Impunity Watch*, Serbi), Dinko Gruhonjić (Shoqata e Pavarur e Gazetarëve të Vojvodinës, Serbi), Andrej Nosov (Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut, Serbi) dhe Abdullah Ferizi (Forumi ZFD, Kosovë). Mediumet që kanë shkruar për tubimin ishin Kurir, Liberta-tea, Pançevac, RTV Pançevo, Radio Vojvodina.

Pjesëmarrësit në konsulta pozitivisht vlerësuan nismën për themelimin e KOMRA, dhe ajo u përkrah nga një numri i konsiderueshëm të tyre.

Pse KOMRA ka nevojë për hapësirën e ish Jugosllavisë është që të sigurohet se mosbesimi dhe urrejtja që kanë ekzistuar deri vonë dhe i kanë shkaktuar luftërat, të mos përcjellën te brezat e rinj. Dhe që këta breza të rinj të kanë mundësinë, jo thjesht që të harrojnë të kaluarën dhe historinë, por ta njohin sa më mirë historinë duke krijuar në një bazë solide për zhvillim dhe krijimin e të ardhmes së tyre, në mënyrën që atyre u përshtatet, duke u siguruar që urrejtja dhe luftërat të mos përsëriten në të ardhmen. (Abdullah Ferizi, Forumi ZFD, Kosovë, Konsultat kombëtare me shoqërinë civile, Pançevë, Serbi, më 28 mars 2009).

Mendoj se këtu nuk ka fare nevojë që të shtrohet pyetja pse KOMRA. Kjo është sikur të shtrojmë pyetjen pse pimë ujë. (Hrvoje Zovko, Radio Televizioni i Kroacisë -HRT, Konsultat kombëtare me shoqërinë civile, Pançevë, Serbi, më 28 mars 2009).

Në koalicionin KOMRA duhet të kyçen sa më shumë organizata joqeveritare për të fuqizuar kapacitetet e Koalicionit.

Çka më brengos mua është ajo që dikush e tha pak më parë, se në të vërtetë as brenda vetë sektorit joqeveritar nuk ekziston një opinion kritik i artikulluar në mënyrë të mjaftueshme. Mendoj se vërtet shumë pak organizata të shoqërisë civile merren me këtë çështje. (...) Dhe pasi që tani po flasim për metodat se si do të organizohemi, mendoj se njëri prej hapave të parë është që ky tregim, tregimi ynë, të zgjerohet edhe në organizatat tjera joqeveritare dhe të bëjmë presionin, fatkeqësisht jo vetëm në parlamentet dhe spektrin politik, por mendoj edhe në sektorin joqeveritar. (Virdžinija Marina Guzina, Parlamenti qytetar i Vërshacit, Serbi, Konsultat

kombëtare me shoqërinë civile, Pançevë, Serbi, më 28 mars 2009).

Ju do të shihni se nuk është lehtë të hysh në tregime të tilla. Unë nuk shoh fare se si do ta zbresim këtë tregim në mjediset tona lokale, si do t'i rregjizojmë organizatat joqeveritare që tregimi të instrumentalizohet, dhe mbase ta afrojmë edhe parlamenteve lokale. Do të thotë, duhet të na ndihmoni në krejt këtë, sepse unë mendoj se në sektorin joqeveritar nuk ka fare, si të them, një qëndrim unik rreth asaj se duhet të futemi në këtë proces. (Snežana Baralić-Bošnjak, Grupi i grave për paqe, Serbi, Konsultat kombëtare me shoqërinë civile, Pançevë, Serbi, më 28 mars 2009).

KOMRA duhet të shfrytëzojë faktet që i ka zbardhur Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish Jugosllavi si dhe Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur.

Duhet të shmangen gabimet trashanike. Dhe duhet të mësohemi në gabimet e të tjerëve, ata që kanë qenë para nesh. Dhe duhet të shfrytëzohen faktet tashmë të zbardhura, siç janë ato të Tribunali i Hagës, apo të Komisionit Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur, i cili ka punuar tejet suksesshëm për tërë rajonin. (Janja Beč Neumann, sociologe dhe shkrintare nga Serbia, Konsultat kombëtare me shoqërinë civile, Pançevë, Serbi, më 28 mars 2009)

Mendoj se KOMRA e së ardhmes duhet të përcaktohet se cilat fakte të zbardhura do t'i merr në konsiderim, në kuptimin e një pikënisjeje, sepse KOMRA do të duhej të ishte specifike edhe për atë se para tij tashmë janë disa raste dhe ndëshkime të procesuar, ca nga Gjykata Ndërkombëtare Penale [për ish Jugosllavinë], ca nga gjykatat kombëtare, çka nuk është tipike për komisionet tjera, dhe po kështu kemi edhe një lloj pajtimi. Unë personalisht, ja tash po e shpalos mendimin tim, se duhet të kihet një bazë e pakontestueshme, çka do të thotë se nuk duhet të vihen në pyetje vendimet e gjykatave që janë marrë deri më sot. (Marinika Čobanu, Aksioni qytetar i Pançevës, Konsultat kombëtare me shoqërinë civile, Pançevë, Serbi, më 28 mars 2009)

Dëgjimi publik i viktimave dhe anëtarëve të familjeve të viktimave duhet të mbahet edhe në nivelin lokal. Kjo hap mundësitë që viktimat dhe komuniteti lokal të dëgjojnë njëri tjetrin më mirë dhe të punojnë së bashku në tejkalimin e trashëgimisë negative nga e kaluara.

Do t'ju lusja që të përshkruhen pak këto dëgjime publike, se a mund të fitojmë kështu një përkrahje më të gjerë, t'i animojmë njerëzit, dhe këtë ta realizojmë edhe në nivelin lokal; do të thotë, të kemi mini forume edhe në mjediset më të vogla, të regjistrohen dhe dokumentohen në ndonjë pëllhurë materialet që janë, kuptohet, autentikë, por që thjesht të shihen dhe dëgjoen nga sa më shumë veta, sepse për ne është i rëndësishëm çdo individ. (Marinika Čobanu, Aksioni qytetar i Pançevës, Serbi, Konsultat kombëtare me shoqërinë civile, Pançevë, Serbi, më 28 mars 2009)

Në procesin konsultues të kyçen në mënyrë më aktive shoqatat e veteranëve. Të konsiderohet edhe dëgjimi publik i veteranëve që janë të gatshëm të flasin për pjesëmarrjen e tyre në ngjarjet e caktuara.

Mendoj se krejt rajoni është specifik, secili në mënyrën e vet do ta njej këtë nismë dhe sigurisht se secili edhe do të futet në këtë tregim nga përvoja e vet. Por mbase është mirë që mu Vojvodina të jetë hapësira ku nuk kemi të ashtuquajturat shoqata të tipit «zoti im, po Serbia nuk ka marrë pjesë në luftë». Ajo e ka mohuar tërë kohën, apo jo, këtë, por tani i shohim gjithë ata vullnetarët dhe të gjerët që kanë marrë pjesë në luftë dhe po i kërkojnë mëditjet që nuk ua kanë paguar. Do të thotë, ndoshta do të ishte mirë që t'i gërshetojmë ata që kanë marrë pjesë në luftë dhe e pranojnë këtë, dhe ata që kanë qenë kundër luftës, për të dëshmuar dhe treguar storiet e ndryshme të tyre. (Snežana Baralić-Bošnjak, Grupi i grave për paqe, Serbi, Konsultat kombëtare me shoqërinë civile, Pançevë, Serbi, më 28 mars 2009)

Mendoj se do të ishte po kështu interesant të dëgjoen publikisht edhe ata që kanë maceë pjesë në krime, kuptohet ata që pranojnë një gjë të tillë (Branislav Ramjanc, Aksioni qytetar i Pançevës, Serbi, Konsultat kombëtare me shoqërinë civile, Pançevë, Serbi, më 28 mars 2009)

Është një numër i madh i atyre që në kasaphanën e ish-Jugosllavisë kanë marrë pjesë me detyrim. Këta janë para së gjithash njerëzit e ri që janë zaturur në uniforma, si p.sh. pjesëtarët e APJ-së fatkeqe, dhe pastaj janë transportuar si valixhe në vendet e pësimeve më të mëdha. Ata janë, më duket, eshaloni i parë që kërkon të njihen si pjesëmarrës të padyshimtë, por edhe si viktima të luftës. (Gojko Mišković, Liceu i Hapur, Serbi, Konsultat kom-

bëtare me shoqërinë civile, Pançevë, Serbi, më 28 mars 2009)

Anëtarë të KOMRA duhet të janë individët që gëzojnë besimin e të gjithë komuniteteve në rajon. Gjatë konsultave duhet të mbliidhen kandidaturat për komisarët e KOMRA dhe të krijohet lista e komisarëve potencialë.

Edhe mënyra dhe kriteri për zgjedhjen e anëtarëve të komisionit, duhet të sigurojnë që këta të janë njerëz që në këto dhjetë e më shumë vite kanë qenë aktivë në proceset e ballafaqimit me të kaluarën, pra ata që me shembullin dhe angazhimin personal kanë bërë që procesi i pajtimit të bëhet i kapshëm edhe në mikro hapësirat edhe më gjerë. (Snežana Baralić-Bošnjak, Grupi i grave për paqe, Serbi, Konsultat kombëtare me shoqërinë civile, Pançevë, Serbi, më 28 mars 2009)

Do të duhej të ishin njerëz më të mirë, të ndjeshëm për vuajtjet e të tjerëve, të përgjegjshëm, personalisht të ndershëm dhe që e kanë vullnetin për t'u marr me këtë problematikë kaq të rëndë dhe të pakëndshme. (Gordana Perunović-Fijat, Klubi i Kikindës, Serbi, Konsultat kombëtare me shoqërinë civile, Pançevë, Serbi, më 28 mars 2009).

KOMRA duhet t'i emërojë autorët e krimeve.

Raporti ndaj autorëve të krimeve mendoj se duhet të jetë i tillë që ata të emërohen, por të gjitha të tjerat duhet t'i lihen institucioneve shtetërore, organeve gjyqësore që të ndërmarrin ose të mos ndërmarrin hapat. (Gordana Perunović-Fijat, Klubi i Kikindës, Serbi, Konsultat kombëtare me shoqërinë civile, Pançevë, Serbi, më 28 mars 2009)

Para fillimit të punës së KOMRA duhet të definohet nocioni i viktimës. Definicioni duhet të kumtojë qartë dhe saktë kush mund të konsiderohet si viktimë.

Këtu po shoh se po flitet për viktima, por nuk po shoh askund se cilat janë kriteret për nocionin viktimë. E dimë se popullsia civile sigurisht se janë viktima, por për këtë kemi nga anët e ndryshme pikëpamje të ndryshme, kështu që duhet të vendosen kriteret kush janë viktimat. (David Montijas, Komuna hebreje e Pançevës, Serbi, Konsultat kombëtare me shoqërinë civile, Pançevë, Serbi, më 28 mars 2009)

KOMRA duhet të prezantojë edhe përvo-

jat pozitive të solidaritetit dhe miqësisë mes pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme gjatë konflikteve të armatosura.

Në përvojën hebreje i jepet shumë vëmendje shembujve të atyre që kanë ndihmuar, dhe kjo ndihmon në procesin e shërimit. Mendoj se ka shembuj të tillë dhe se në këtë kontekst është me rëndësi të theksohet shembulli i Vojvodinës me dyqind mijë dezertorë dhe individët që vërtetë edhe duke e rrezikuar jetën e tyre, i kanë ndihmuar të tjerët, dhe duhet të shihet se kush janë këta që janë ndihmuar. (Janja Beć Neumann, sociologe dhe shkrimtare nga Serbia, Konsultat kombëtare me shoqërinë civile, Pançevë, Serbi, më 28 mars 2009).

Është kjo ide që diku, gjatë punës së KOMRA, të dëgjohen edhe tregimet pozitive, sepse gjithnjë kur flasim për konfliktet e armatosura në hapësirat e ish Jugosllavisë, po harrojmë se ka shumë njerëz që i lëmë larg këtyre bisedave, por që në mënyrën më të denjë e kanë treguar humanizmin e tyre, kanë mbetur ata që janë, pra njerëz, në ato rrethana të rënda. (Andrej Nosov, Nisma rinore për të drejtat e njeriut, Serbi, Konsultat kombëtare me shoqërinë civile, Pançevë, Serbi, më 28 mars 2009).

25. Konsultat lokale me shoqatat e viktimave mbi nismën KOMRA.

**Bijelinë, BH
11 prill 2009**

Konsultat e para lokale në Bosnje dhe Hercegovinë i organizoi organizata joqeveritare *Kthimi dhe mbijetesa e qëndrueshme*. Në konsultat morën pjesë 26 përfaqësues të organizatave joqeveritare, kryesisht të shoqatave të viktimave dhe të shoqatave tjera të qytetarëve. Tre nga të pranishmit kanë qenë gazetarë dhe njëkohësisht aktivistë të organizatave joqeveritare. Në konsultat mori pjesë edhe përfaqësuesi i Bashkësisë Islame në Bijelinë. Konsultat i ka vëzhguar përfaqësuesi i Misionit të Organizatës Evropiane për Siguri dhe Bashkëpunim (OSBE), zyra në Bijelinë. Fjalët hyrëse mbajtën Vehid Šehić (Forumi qytetarëve i Tuzllës, BH), Salem Čorbo (*Kthimi dhe mbijetesa e qëndrueshme*, BH), Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi), dhe Bogdan Ivanišević

(Qendra ndërkombëtare për drejtësi tranzicionale). Lajme për konsultat kanë botuar gazeta ditore Avaz, EuroBlic, RTRS, RTV BN.

Pjesëmarrësit përkrahin themelimin e KOMRA dhe theksojnë nevojën që ai të jetë i karakterit rajonal.

Si dikushi që në kornizat e punës time publike kam vendosur arritjen e tolerancës në këto hapësira, po mendoj për këtë ide se ndoshta është rrugë e vetme që kjo të arrihet, pasi që në nivelet kombëtare këtu edhe në Serbi, e mendoj madje edhe në Kroaci dhe në vendet tjera, nuk është bërë shumë në procesin e arritjes, e vendosjes së tolerancës, përkatësisht në procesin e ardhjes deri te e vërteta. (Radmila Žigić, Pan radio, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, më 11 prill 2009).

Sa i përket koalicionit për KOMRA, unë e përkrah plotësisht themelimin e tij. Më e rëndësishmja është, sipas meje, që në atë koalicion të janë njerëzit që e duan të vërtetën e plotë, dhe të cilët nuk do të anojnë në njërin anë, përkatësisht të janë njerëz me autoritet. (Admir Karić, Grupi rinor i Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republika Serbska, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, më 11 prill 2009).

KOMRA duhet të merret me të gjitha viktimat e krimeve pa marrë parasysh cilit komunitet etnik i përkasin. Është i nevojshëm regjistri i saktë i të gjitha viktimave dhe të gjithë kriminelëve, me emër e mbiemër.

Nuk do të ketë të vërtetë përderisa nuk do të respektohen dhe të janë të barabarta të gjitha viktimat në këtë hapësirë të Bosnjës dhe Hercegovinës. (Smilja Mitrović, Shoqata e luftëtarëve të zhdukur të ushtrisë së Republika Serbska / Organizata komunale e familjeve të të zhdukurve në Bijelinë, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, më 11 prill 2009)

Ky komision duhet të rishqyrtojë në tërësi të vërtetën në ish Jugosllavi. Kjo do të thotë se duhet të rishqyrtohen edhe krimet që janë bërë në Luftën e Dytë Botërore dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Në emër të viktimave unë këtë e përkrah, të gjithë e dëshirojnë zbardhjen e krimeve dhe ndëshkimin e tyre. (Blagoje Josipović, Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin i komunës Bijelina, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, më 11 prill 2009)

Ideja e KOMRA është mu kjo që të regjistrohen të gjitha pësimet, që të flitet për to, të bëhet regjistri i të gjitha viktimave, pa marrë parasysh kombësinë. (Bogdan Ivanišević, Qendra ndërkombëtare për drejtësi tranzicionale, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, më 11 prill 2009)

Këtu keni folur të gjithë, boshnjakët, serbët, kroatët, ndërkaq unë angazhohem për një kategori tjetër, të katërt, të cilën këtu askush nuk e përmendi; prandaj për mua nuk është aspak e rëndësishme kombësia, me rëndësi është viktima. Në këtë shtet ka edhe të tillë që nuk i përkasim ekskluziviteteve kombëtare, e që nuk jemi as pakicë kombëtare, por jemi vetëm ca eks, dhe sot jemi diçka për çka nuk flitet fare. Nuk ka frikë se këtu do të punohet sipas atyre pikëvështrimeve kombëtare, por na intereson vetëm viktima me emër dhe mbiemër. (Vehid Šehić, Forumi i qytetarëve të Tuzllës, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, më 11 prill 2009)

Komunitetet lokale duhet ta bëjnë rikonstruktimin e ngjarjeve në komunitetet e tyre në prag të konfliktit. Duhet të organizohen dëgjimet publike të qytetarëve në të cilat duhet të emërohen autorët lokalë të krimeve dhe në mënyrë të saktë të përshkruhen krimet që kanë ndodhur në territorin e këtij komuniteti.

Unë e di, personalisht e di bukur shumë, kush ka jetuar këtu në Bijelinë, dhe çka kam parë nuk do ta tregoj tani. Nuk është tani koha që të tregoj dëshminë time. Ne tani po flasim për Bijelinën, zonjë, dhe nuk po flasim për komunat tjera. Këtu po flasim, këtu duhet të jepen deklaratat, dhe kush ka dëshirë le të urdhërojë të thotë se çka ka ndodhur këtu. Këtu kanë kaluar, tre ditë luftë ka qenë, dhe 134 shtëpi të romëve janë rrënuar. Kush i rrënoi ato? Unë? Sigurisht se isha unë. (Pašaga Beganović, Shoqata e romëve në Republika Serbska, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, 11 prill 2009).

Vendi quhet Lokanj dhe aty jemi komshi, dhe nëse e duam të vërtetën, e unë jam për të vërtetën, sepse pa te nuk ka asgjë. Por, përse kaluan 17 vjet, që nga viti '92, prejse 68 veta ishin zënë rob dhe janë ekzekutuar në mënyrën më mizore të mundshme, me sharra motorike. Kjo është e vërtetë, dhe koha do të vjen edhe për këtë proces, ai tani po zhvillohet, që kurrë më të mos kemi të flasim për këso gjëra, të jemi lojtarë fer, që marrëdhëniet mes fqinjëve të bëhen të mira, që brezave që po vijnë t'ua themi të

vërtetën se ka qenë kështu si ka qenë. Këtë gjë e ka bërë ai grup, filani e ka dhënë urdhrin, dhe ai grup e ka bërë një krim kaq të tmerrshëm. (Fahrudin Hasanović, Shoqata e luftëtarëve të vdekur shehid, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, më 11 prill 2009).

Komisioni Rajonal me mandat të qartë mund të ndihmojë që sërish të vihen në fokus problemet e viktimave dhe para së gjithash çështja e të zhdukurve.

Shpresoj në këtë komision, dhe jam thellësisht i bindur që këtu do të ketë, se do ta kryej punën e tij, dhe se të gjitha viktimat do të zbulohen, do t'i dorëzojnë familjeve të tyre që ti varrosin, secili me zakone të veta. (Mato Ežegović, i kthyer në Pelagiqevë, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, më 11 prill 2009).

Po shohim se ka shumë iniciativa rreth të zhdukurve, dhe është e sigurt se [Komisioni] do të merret me këtë në mënyrën e vet. Ndoshta është ky rasti që të bëhet presion në institucionet për të zhdukurit në Bosnje dhe Hercegovinë. (Vehid Šehić, Forumi i qytetarëve të Tuzllës, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, më 11 prill 2009).

Përshtypja që kam nga tubimi i sotëm dhe tubimet tjera, është se njerëzit që kanë viktimat kanë edhe nevojën që të flasim për atë çka u ka ndodhur atyre personalisht dhe çka ata e mbajnë në kujtesën e tyre. Dhe ky është një tregues relevant çka duhet të bëhet. Duhet të krijohet një platformë publike për zërin e viktimave. Natyrisht, kjo nënkupton edhe procedurat e caktuara për tregimin publik të këtyre të dhënave, ose të them të këtyre rrëfimeve personale. Por definitivisht ideja se KOMRA të organizojë dëgjime publike të viktimave, dëshkohet si nevojë në të gjitha këto konsultat, sepse shumë lehtë po i shmangemi temës në vend që të flasim se çka do të ishte mirë të bëhet dhe me cilat krime duhet të merret komisioni. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, më 11 prill 2009).

KOMRA mund t'i ndihmojë sektorit civil, që është gjithnjë e më i pafuqishëm në shumë çështje që lidhen me krimet e luftës dhe shkeljet e rënda të së drejtës humanitare, si dhe familjeve të viktimave që gjithnjë e më vështirë po i realizojnë të drejtat e tyre edhe ashtu minimale.

Mendoj se një nisme e tillë për krijimin e një komi-

sioni të tillë rajonal (...) ka alamet kuptimi. Mendoj po kështu se veprimi i organizatave joqeveritare dhe ato qytetare me ngadalë po e humbin frymën. Koha po kalon, nga pak humbet edhe interesi, ka një sërë rrethanash objektive dhe subjektive që çojnë tek kjo, dhe më duket se një trajtim i këtillë i zmadhuar, do ta quaja krijim i një qendre e cila do t'i koordinonte punët, ndoshta do të sjell lëvizjen, e ky është mbase edhe rasti i fundit që kemi kur është në pyetje kjo çështje. (Sead Zahirović, hulumtues i pavarur i krimeve të luftës, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, më 11 prill 2009).

Qasja rajonale në zbardhjen e fakteve për krimet e luftës ka më shumë arsyetim dhe shanse për sukses se sa veprimi në nivelin kombëtar (shtetëror).

Viktimat janë të detyruara, pas manipulimit të gjatë, që të shikojnë njëri tjetrin shtrembët, dhe ne s'kemi zgjedhje tjetër pos që të provojmë që bashkërisht të vijmë deri te ndonjë e vërtetë. Komisioni Rajonal është mu për arsye që është rajonal, një gjë jashtëzakonisht e rëndësishme. (Jusuf Trbić, Komuniteti kulturor boshnjak Rilindja [Preporod], BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, më 11 prill 2009).

Një komunitet më i gjerë shoqëror ka për obligim që t'i përgjigjet ngjarjeve të tmerrshme që kanë ndodhur në historinë tonë të afërt. Kam frikë se deri më sot në këtë fushë nuk kemi arritur suksese të rëndësishme (...) as në nivelin lokal, as në atë shtetëror, as tek entitetet, e as në nivelin rajonal. Formimi i këtij Komisioni Rajonal mund të jetë një mënyrë për të arritur një përcaktim të tillë të komunitetit. (Sead Zahirović, hulumtues i pavarur i krimeve të luftës, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, më 11 prill 2009).

Secili e ka një plagë, një gjë, përvojën e vete, ndërkaq që të gjithë së bashku kemi interesin e përbashkët, dhe ky është formimi i këtij Komisioni Rajonal, sepse sipas bindjes time të thellë vetëm viktimat mund të gjejnë të vërtetën, pasi që viktimat i takojnë një kombi, kombit fatkeq. Ta dini se të gjithë ne jemi dëshmitarë të shkatërrimit të ish shtetit tonë, të gjithë jemi dëshmitarë të copëtimit të së vërtetës. Secili pastaj morri nga një pjesë, secili shtet i ri, secila parti e re, secila elitë politike e re, dhe jemi dëshmitarë po kështu se ata që kanë planifikuar krimet, ata që i kanë përkrahur krimet, dhe ata që i kanë organizuar krimet, mes veti sot kuptohen mjaft mirë dhe nuk i

kanë problemet që ne tani i kemi mes veti. Ne këtu jemi të gatshëm që duke i shpalosur të vërtetat tona edhe të konfrontohemi mes veti, ndërkaq që ata nuk e bëjnë këtë. (Jusuf Trbić, Komuniteti kulturor bosnjak Rilindja / Preporod, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, më 11 prill 2009).

Është propozuar që në debat të kyçen edhe përfaqësuesit e komuniteteve fetare.

Ju lutemi, elitat fetare janë pjesë e realitetit tonë dhe ato ndikojnë shumë në krijimin e shoqërisë në tërësi, si dhe në ballafaqimin me të kaluarën mu për atë se kanë ndikim të konsiderueshëm në shoqëri. Për këtë arsye mendoj se pjesë e procesit të konsultave patjetër duhet të janë edhe elitat fetare. (Amir Kulagić nga Srebrenica, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, Bijelina, BH, më 11 prill 2009)

26. Konsultat kombëtare me studentë për iniciativën KOMRA

**Prishtinë
15 prill 2009**

Konsultat i organizoi organizata joqeveritare e të rinjve *Integra*. Në to morën pjesë 40 studentë, ndërkaq diskutimin e përcollën tre monitorues nga shoqata e viktimave. Katër parafolësit, Kushtrim Koliqi (*Integra*, Kosovë), Shukrije Gashi (Partners Kosova-Center for Conflict Management, Kosovë), Bekim Blakaj (Fondi për të Drejtën Humanitare, Kosovë) dhe Ivan Novosel (Legalis, Kroaci), në pajtim me rendin e ditës, bënë një hyrje të shkurtër në temë. Tekstin e vetëm e publikoi KosovaPress.

Pjesëmarrësit e mbështetën iniciativën e KOMRA dhe bashkëpunimin rajonal gjatë atij procesi.

Ne shpresojmë shumë tek *Koalicioni për KOMRA*, prandaj edhe shpresojmë se ai do t'i krijojë dhe mobilizojë të gjitha strukturat e veta që i disponon, sa më parë që të jetë e mundur. (...) Desha që edhe njëherë të kërkoj nga ju një seriozitet në punë, që të jeni më konkret dhe që, nëse keni fat, të vazhdoni me këtë *Koalicion*. (Besart Metaj, student, Fakulteti Juridik, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

Duhet të ekzistojë një bashkëpunim më i thellë dhe ai duhet të jetë ndërshtetëror, sepse është në intere-

sin tonë që t'i gjejmë kryesit e krimeve të luftës dhe që ata t'i sjellim para drejtësisë. (Ylber Maxhuni, *Youth Step*, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

Deri më tani, 10 vjet pas luftës, tek ne në Kosovë pati vetëm dy gjykime që përfunduan me vendime përfundimtare, dhe atë nga ana e gjykatësve ndërkombëtarë, e kam fjalën këtu për gjykimin e krimeve të luftës. Dënimet janë të ulëta, e cila gjë fare nuk i kënaqë anëtarët e familjeve. Në fakt, pikërisht për këtë shkak komisioni vërtet është i domosdoshëm. (Bekim Blakaj, Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

Të gjithë ne e kemi një kriminel të përbashkët, e ata janë të gjithë që morën pjesë në krimet në Kroaci, Bosnje, dhe pastaj në Kosovë. Prandaj është e domosdoshme që të bashkëpunojmë bashkërisht, sepse edhe ndihma më e vogël e mundshme që vjen nga cilido vend është shumë e rëndësishme. (Edmir Sejdiu, student, Fakulteti i Shkencave Politike, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

Është e nevojshme të konstatohen faktet për krimet e kryera në Kosovë. Gjatë këtij procesi duhet të nisemi nga viktimat dhe rrëfimet e tyre, ndërkaq organet kompetente të Serbisë dhe Kosovës duhet t'i procedojnë kryesit e veprave penale.

Kemi shumë krime dhe masakra të ndryshme të kryera në Kosovë, por për këto masakra duhet pasur dhe fakte, është e nevojshme të gjenden ata që i kryen ato krime, ndonëse jo gjithëherë duke i balancuar kryesit e krimeve me ata që pësuan nga krimet. Ata nuk mund të barazohen në mënyrë të njëjtë me ta. (Lavdim Rizani, student, Fakulteti Shkencave Politike, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

Shumë kryes të krimeve, qofshin ato të mëdha apo të vogla, të vrasjeve, dhunës dhe të llojeve të ndryshme të krimit, janë ende në liri dhe ata bëjnë një jetë normale, të lirë. Ata duhet të identifikohen në çfarëdo mënyre të mundur, prandaj edhe duhet të gjenden faktet kundër tyre. Viktimat janë faktet kryesore kundër tyre, gjë që pak a shumë edhe është ideja kryesore e këtij komisioni. Duhet të dihet se çfarë duhet bërë, të dihen emrat, dësh-

mitë, të dihen ngjarjet, çka ka ndodhur... (Kushtrim Koliqi, *Integra*, Kosovë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

Detyra jonë është që të mbledhim fakte dhe ato t'i përçojmë, ndërkaq i mbetet shoqërisë serbe, qeverisë serbe dhe qeverisë tonë që t'i evidentojnë grupet të cilat vepruan në këto hapësira, dhe që t'i identifikojnë ata që kryen vepra kriminale. (Ylber Maxhuni, *Youth Step*, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

Viktimat hezitojnë të deklarohen sepse shoqëria distancohet nga ky problem dhe nuk kërkon një mënyrë adekuate që viktimat të përfshihen në këtë proces. Komisioni duhet ta dijë se ku të shkojë, kujt t'i drejtohet, e jo, siç thotë populli, të shkelë nëpër dërrasa të kalbura. Më mirë të shkohet me hapa të sigurt, të dihet se çka të hulumtohet, të mësohet se cilat janë problemet e drejtpërdrejta të viktimave, sepse ato kanë një pasqyrë të qartë se çfarë ka ndodhur. (Shukrije Gashi, Partners Kosova-Center for Conflict Management, Kosova, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

Të gjitha viktimat duhet të regjistrohen dhe KOMRA duhet të vërtetojë numrin e saktë të tyre.

Secila viktimë ka emrin dhe mbiemrin e vet, secila viktimë ka krenarinë e vet dhe secila viktimë, qoftë ky edhe një numër i vogël, fshih individualitetin e vet. Dhe, s'mund të thuhet 100 ose dyqind mijë, s'mund të thuhet njëqind ose dyqind njerëz, s'mund të thuhet njëqind ose njëqind e një njeri. Thjesht, të gjitha viktimat duhet të kenë emrin dhe mbiemrin e tyre. Duhet të jenë aty, që do të thotë se duhet të njihen. (Ivan Novosel, Legalis, Kroaci, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

Është e nevojshme që viktimave dhe dëshmitarëve që janë më në moshë t'iu jepet prioritet, sepse faktet harrohen ose zhduken me vdekjen tyre.

Çfarë do të ndodhë me viktimat ose me dëshmitarët të cilët i panë masakrat, e të cilët tani janë plakur, duke pasur parasysh se ata për çdo ditë e më tepër kanë probleme psikike ose mentale, e disa edhe vdesin. A mendoni se me shkuarjen e tyre humbin edhe faktet. (Besart Metaj, student, Fakulteti Juridik, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

Kur jemi tek personat që janë të plakur, kanë propozuar që t'ju jepet prioritet këtyre lëndëve, që të merren përsëri deklaratat e tyre, nëse janë në gjendje që t'i përsërisin deklaratat që i kanë dhënë më parë. Pse jo, kjo mund të jetë një dëshmi e evidentuar si video-xhirim, që do të mund të ndihmojë në të ardhmen. (Naser Lajqi, Syri i Vizionit, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

KOMRA duhet të merret edhe me të burgosur politikë.

Disa nga viktimat që mund të japin dëshmi të drejtpërdrejta për secilin gjykim ose kundër shtetit që ka kryer veprime kriminale, të cilat nuk janë të përfshira me Konventën Ndërkombëtare, janë të burgosurit politikë. (...) Mendimi im është se pika e parë do të ishte që ne si komision ose kushdo që formon komisionin, të merret me të burgosur politikë. (Liridon Jetishi, student, Fakulteti i Shkencave Politike dhe Fakulteti Juridik, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

KOMRA duhet të publikojë rezultatet e veta pavarësisht presioneve të mundshme politike.

Sa do të jetë funksional Komisioni Rajonal në zbardhjen e të vërtetës në një kohë që ende është jostabile, kur ende vazhdohet me të vjetrën, ushqehen ndjenjat e fuqishme kombëtare nga të gjitha partitë, qoftë nga ana e viktimave, e atyre që e pësuajnë, apo nga kryesit e këtyre krimeve, kur dihet se për zbardhjen e fakteve duhet të kemi një bashkëpunim të përbashkët të të gjitha partive. (Kristijan Hasani, student, Fakulteti i Shkencave Politike, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

Spektori civil duhet të bashkëpunojë me gjykatat në Kosovë dhe me EULEX'in, i cili mund të ndikojë tek pushteti.

Kemi shumë fakte të marra nga viktimat e luftës, por çfarë ka ndodhur me to dhe sa është bërë për këtë çështje nga ana e gjykatësve të UNMIK'ut, të cilët bashkëpunonin deri tani me gjykatësit tanë? Ajo që ne duhet të kërkojmë, si koalicion, është që gjyqësori, tani EULEX, të formojë një gjyqësor që do të merret me këto fakte. Edhe që ne, si shoqëri civile, t'i marrim ato fakte, fakte këto që janë marrë nga viktimat e luftës, t'i bashkojmë dhe t'i shqyr-

tojmë nëse janë përfshirë të gjitha. (Naser Lajqi, Syri i Vizionit, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

Memorialët që aktualisht po ndërtohen larg vendeve të krimit janë ofendim për viktimat.

Po e marrë si shembull Dubravën. Kur shkuam në burg, gjysma e tyre ankoheshin se përse ai ishte nisur fare atje. Masakra ishte kryer brenda burgut, ndërsa ata memorialin e ndërtuan në një livadh. Çka ju nevojitet ajo përmendore, kujt ia kanë bërë? Le të ndërtohet në vendin e ngjarjes, nëse kemi nevojë për një metër katrorë vend, ndoshta do të mund ta gjejmë në mes të mijëra metrave katrorë. (Liridon Jetishi, student, Fakulteti Juridik, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

Është i domosdoshëm informimi i viktimave dhe i shoqërisë civile për iniciativën KOMRA dhe më vonë për punën e Komisionit Rajonal. Bashkëpunimi me media gjatë këtij procesi do të jetë shumë i rëndësishëm.

Faktet dhe argumente ekzistojnë, por ato në njëfarë forme vazhdojnë të mbeten në qetësi, assesi s'mund të dalin. Familjet e viktimave të luftës janë determinanta kryesore në lidhje me mbledhjen e këtyre fakteve, dhe ata nuk e dinë se ky proces po vazhdon, se është në vazhdim e sipër. Në njëfarë mënyre, [mundësia] që të flasim haptas dhe të kemi hapësirë për këtë lloje debatesh paraqet një hap përpara, por bashkëpunimi me media është një prej faktorëve kryesor, sepse familjet konsiderojnë se zëri i tyre ka mbetur vetëm jehonë. (Florentina Hajdari, student, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

[Mediat] Më shumë vëmendje i kushtojnë gjërave tjera, më pak të rëndësishme, sesa përkrahjes së idesë dhe të kuptuarit të shumë gjërave që kanë ndodhur te ne, dhe që për to ta informojnë opinionin e gjerë publik. Konkretisht, unë mendoj, e jam i sigurt se edhe kolegët e tjerë e ndajnë mendimin me mua, se problem kryesor janë mediat. (Naim Maxhuni, student, Fakulteti i Shkencave Politike, Prishtinë, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

Është e nevojshme të eliminohet armiqësia mes popujve në rajon. Duhet të parandalohet përgjithësimi i krimeve dhe fajësimi i një populli

për shkak të veprave kriminale individuale.

Nëse ne popullit serb i themi, ju jeni kriminelë, ose ata neve, si popull shqiptar, se ne jemi kriminelë, atëherë mendoj se gjeneratat e ardhshme do të vazhdojnë të kultivojnë urrejtjen ndaj armiqve. Ajo që duhet të bëjmë është që t'i precizojmë gjërat dhe t'i gjejmë individët që kanë kryer krime. (Naser Lajqi, Syri i Vizionit, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

Si mund të arrihet diçka e këtillë kur duhet të kemi parasysh se jemi rritur në bindje se kemi armiq, se armiq të tanë, pra serbët, kanë ushqyer urrejtjen brenda nesh ndaj tyre. Edhe diçka, si mund të arrihet ajo që ne të mendojmë se nuk kemi armiq kur t'i keni parasysh rrethanat në të cilat rritemi ne. (Lirie Avdiu, student, Fakulteti i Shkencave Politike, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

Për ta shkullur në rrënjë revanshizmin dhe për të lënë hapësirë që të mbjellim miqësi, ndaj urrejtjes në mjedisin tonë duhet të reagojmë krejtësisht ndryshe. Ne tani duhet që ta harrojmë të kaluarën me qëllim që ajo të mos përsëritet më dhe t'i kthehemi të ardhmes, e cila krijon kushtet për gjetjen e një terreni të përshtatshëm për zhvillimin e idesë për themelimin e KOMRA. (Shukrije Gashi, Partners Kosova-Center for Conflict Management, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Studentë, Prishtinë, Kosovë, 15 prill 2009).

27. Konsultat kombëtare me të rinjtë për iniciativën KOMRA

**Beograd, Serbi
16 prill 2009**

Konsultat i organizoi organizata joqeveritare *Fraktal*. Pjesëmarrësit (31) – studentë dhe nxënës të shkollave të mesme – aktivistë të *Fraktal*, nga iniciativat qytetare dhe të Iniciativës së të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, debatuan në kuadër të katër grupeve punuese, të cilat i formuan propozimet, përfundimet dhe sugjerimet e përbashkëta. Fjalët hyrëse i mbajtën Shukrije Gashi (Partners Kosova-Center for Conflict Management, Kosovë), Andrej Nosov (Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut, Serbi) dhe Filip Pavlovic (Fraktal, Serbi).

Pjesëmarrësit në konsulta e mbështetën theme-

limin e KOMRA. Studentët, nxënësit e shkollave të mesme dhe aktivistët (veçanërisht ata më të rinjtë) të organizatave joqeveritare, duhet të kenë një rol aktiv në lobim për themelimin e KOMRA, dhe që të ndihmojnë në realizimin e aktiviteteve të ndryshme të komisionit

Mendojmë se kjo iniciativë është jashtëzakonisht e rëndësishme, prandaj ne, si organizatë por edhe si individë të mbledhur në kuadër të organizatës, do të mundohemi maksimalisht që të japim kontributin tonë edhe në arritjen e rezultateve konkrete dhe në suksesin e iniciativës. Në këtë kontekst, absolutisht mund të llogaritni në ne. (Srđan Vezmar, Programi për Dialog të të Rinjve, Serbi, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, 16 prill 2009).

KOMRA duhet të parandalojë mohimin e mëtutjeshëm të krimeve dhe manipulimin me viktimat, dhe të zgjidhë problemin e viktimave

Dëshirojmë të arrijmë, gjegjësisht, të parandalojmë mohimin e krimeve, të cilat duhet të pranohet se kanë ndodhur, duhet të pranohet ekzistimi i shkeljeve të të drejtave të njeriut gjatë viteve të kaluara, dëshirojmë të parandalojmë manipulimin me viktimat e shumta, dëshirojmë të zgjidhim fatin e të zhdukurve, pra, të mbi gjashtëmbëdhjetëmijë njerëzve për të cilët nuk dihet nëse janë të gjallë apo të vdekur, pra, dëshirojmë që ta kuptojmë këtë. (Grupi Punues Maroko, Serbi, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, 16 prill 2009).

KOMRA do të kontribuojë në krijimin e bashkëpunimit dhe të miqësisë ndërmjet të rinjve në rajon dhe në kthimin e besimit në institucionet e shteteve

Dëshirojmë të krijojmë bashkëpunim dhe miqësi ndërmjet të rinjve nga të gjitha këto shtatë shtete që këtij rajoni, nëpërmjet, le të themi, shkëmbimit kulturor, udhëtimeve studimore, shkëmbimit të studentëve, shkëmbimit të nxënësve, dëshirojmë të krijojmë kulturën e sundimit të ligjit dhe të gjithë asaj që lidhet me demokratizimin e shtetit, pra, të dëshirës për respektimin e ligjit, përfshirjen më të madhe të njerëzve dhe të popujve në proceset politike. (Grupi Punues Maroko, Serbi, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, 16 prill 2009).

Për promovimin e KOMRA të shfrytëzohen aksionet nëpër rrugë, fushatat mediale dhe të përfshihen figura publike

Gjithashtu, për ngritjen e vetëdijes publike janë të domosdoshme edhe mediat, dhe fushata mediale tejet të organizuara, madje dhe agresive. (Grupi Punues Maroko, Serbi, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, 16 prill 2009).

Pse jo edhe figurat mediale, sepse kemi parë se amerikanët kanë një fushatë shumë të fuqishme sa i përket çështjes së mbështetjes së kandidatëve nga figurat mediale, andaj kjo sigurisht se do të kishte jehonë të mirë. (Grupi Punues Maroko, Serbi, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, 16 prill 2009).

Duhet të organizohen fushata për mobilizimin e të rinjve përmes fushatave mediale dhe aksioneve nëpër rrugë. Në fushatat mediale duhet të përfshihen të rinjtë, figura të njohura dhe aktive, të cilat do të promovojnë – përgjithësisht - se çështje KOMRA dhe përse është e rëndësishme KOMRA. Gjithashtu, duhet të organizohen diskutime televizive, debate ose pjesëmarrje të të rinjve në emisione televizive. (Grupi Punues Peru, Serbi, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, 16 prill 2009).

Për forcimin e përkrahjes në themelimin e KOMRA të shfrytëzohet edukimi i bashkëmoshatarëve: aktivitetet e organizatave të të rinjve, grupet në internet, muzika, stripi, filmi

Ajo që quhet qasje 'face to face' ose edukimi i bashkëmoshatarëve. Gjatë bisedës në kuadër të grupit tonë pati propozime që, për shembull, të ekzistojnë orë edukative të cilat do të mbaheshin nëpër shkollë. Se a do të gëzonte përkrahje kjo gjë apo jo, nuk është e rëndësishme, megjithëse edhe kjo është një prej mënyrave. (...)

Pastaj, të angazhohen të rinjtë që do të punojnë në mbledhjen e nënshkrimeve. Këtë mund ta bëjmë edhe ne, pjesëmarrësit e konsultave në KOMRA, duke biseduar me miq face-to-face, duke u treguar se ku kemi qenë, çfarë kemi bërë, dhe në këtë mënyrë t'i nxisim edhe ata që të përfshihen në mbledhjen e nënshkrimeve. Po ashtu, është shumë me rëndësi të përfshihen edhe organizatat studentore dhe të të rinjve, siç janë zyrat për të rinj, numri i të cilave është në rritje në gjithë Serbinë. (Grupi Punues Peru, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, Serbi, 16 prill 2009).

Pjesëmarrësit propozojnë themelimin e Forumit të të Rinjve për propagandimin e KOMRA.

Do të ishte mirë që në kuadër të këtij koalicioni të formohej një forum i veçantë i të rinjve, i cili me aktivitetet e veta do të përcillte aktivitetet e komisionit. (Grupi Punues Afrika Jugore, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, Serbi, 16 prill 2009).

Të organizohet një konsultë rajonale me të rinjtë, e cila do të përmblihte propozimet e konsultave kombëtare.

Kemi një propozim, që pas këtyre konsultave rajonale dhe lokale me të rinjtë, të organizohet një konferencë që do të mblihte të gjithë pjesëmarrësit e konsultave të deritanishme dhe ku do të aprovohehin propozimet e përbashkëta. Pra, do të mundoheshim që t'i përmblihdhim të gjitha propozimet nga konsultat rajonale dhe lokale me të rinjtë dhe atëherë do të mundoheshim që ta aprovonim një listë të përbashkët të propozimeve të grupeve të të rinjve. (Grupi Punues Afrika Jugore, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, Serbi, 16 prill 2009).

Organizata për të drejtat e njeriut, juristë, psikologë, punëtorë social, nëpunës të bashkësive fetare dhe të rinjtë, duhet të jenë të përfshirë në aktivitetet e KOMRA

Pra, ne nuk deshëm të merreshim me atë se sa anëtarë do të duhej t'i kishte KOMRA, e as me mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve, por në realitet me atë se kush duhet të marrë pjesë në punën e tij. Pra, të rinjtë, studentët, aktivistët e organizatave joqeveritare, pastaj përfaqësuesit e organizatave joqeveritare që merren me të drejtat e njeriut, si dhe njerëzit që kanë mjaft përvojë në punën me grupet pakicë, dhe që në fakt luftojnë për të drejtat e njeriut. Mandej, është tejet me rëndësi që të përfshihen juristët, psikologët dhe sociologët. Gjithashtu, biseduam edhe për rëndësinë e përfshirjes së kishës, gjegjësisht të përfaqësuesve të bashkësive fetare. Ndikimi i tyre do të duhej të ishte i limituar dhe i kontrolluar ashpër, edhe pse ndoshta nuk do të duhej të përfshiheshin në vetë punën e komisionit, por vetëm gjatë konsultave. (Grupi Punues Peru, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, Serbi, 16 prill 2009).

Të përfshihen bashkësitë fetare në programin e përkrahjes së viktimave

Nga marrja në pyetje e viktimave e dimë se në Ballkan ekziston një numër i madh i zonave rurale, dhe njerëzit që jetojnë atje zakonisht kanë një nivel më

të ulët të arsimimit. Në ato zona kisha ka ndikim të madh në njerëz, prandaj edhe mendoj se viktimat do të kishin mjaft besim pikërisht në kishë, dhe se përfaqësuesit e bashkësive fetare do të mund t'i nxitnin viktimat që të flasin, që të tregojnë për atë që iu ka ndodhur atyre. (Grupi Punues Peru, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, Serbi, 16 prill 2009).

KOMRA duhet të përbëhet prej shtatë anëtarëve, nga një anëtarë prej secilit shtet. Zgjedhjen e anëtarëve duhet ta konfirmojnë parlamentet kombëtare.

Një nga propozimet është që komisioni të ketë shtatë anëtarë, bazuar në numrin e shteteve që do t'i mbulojë komisioni. (...) Iu mbetet parlamenteve të shteteve të rajonit që ta konfirmojnë emërimin e atyre personave. Pra, në përputhje me procedurat e caktuara, të konfirmohet në kuvend zgjedhja e tyre, sepse mendojmë që në këtë mënyrë do të kishim dhe do t'i jepnim një fuqi shtesë gjithë këtij procesi. (Grupi Punues Afrika Jugore, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, Serbi, 16 prill 2009).

Duhet të krijohet kriteri për përzgjedhjen e anëtarëve, i cili do të jetë universal për të gjitha shtetet, përveç që secili shtet do të ketë të drejtë që t'i zgjedhë anëtarët e vetë të komisionit. (Grupi Punues Maroko, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, Serbi, 16 prill 2009).

Anëtarët e komisionit duhet të jenë persona jopartiak, që kanë kredibilitet dhe besim në gjithë rajonin.

Kredibiliteti, besimi dhe neutraliteti janë më të rëndësishmet. Pra, duhet të zgjidhen njerëzit në rajon të cilëve njerëzit do të mund t'iu besonin dhe në të cilët ata kanë besim. Ata do t' duhej të jenë individ që... si të them... nuk janë... nuk kanë... si të shprehem.. që nuk mbretëron ndonjë mendim negativ për ta dhe që nuk ishin të përfshirë... që janë persona jopartiak... edhe pse, natyrisht se kurrë një njeri s'mund të jetë i përkryer. (Grupi Punues Peru, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, Serbi, 16 prill 2009).

Zgjidheni një përfaqësues nga Serbia, dhe do të shihni se do ta dojë gjithë rajoni, kurse ne s'do ta duam. Për këtë arsye mendoj se duhet që ata të jenë njerëz akademik, njerëz të rinj në ndonjë skenë, dhe që nuk janë korruptuar deri më tani. (Grupi Punu-

es *Argjentina*, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, Serbi, 16 prill 2009).

Mandat i KOMRA duhet të jetë periudha prej viti 1991 deri në vitin 2008, kur me shpalljen e pavarësisë së Kosovës edhe përfundoi shpërbërja e ish-RSFJ.

Kjo periudhë që do ta mbulojë komisioni, duhet të jetë prej vitit 1991, pra që nga ndarja... shpallja e pavarësisë së Sllovenisë e deri në vitin 2008, kur u shpall pavarësia e Kosovës. Pra, ne mendojmë se brenda kësaj periudhe kohore, parimisht, edhe kanë ndodhur më së tepërmi ngjarje që lidhen me punën e komisionit. (Grupi Punues Afrika Jugore, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, Serbi, 16 prill 2009).

KOMRA duhet të fokusohet në vërtetimin e fakteve, të cilat i kontribuojnë sqarimit të asaj se për se ndodhën krimet.

Duhet të vërtetohen faktet objektive për krimet e luftës dhe përgjegjësitë e kryesve të tyre, përfshirë edhe përgjegjësinë e bashkësisë ndërkombëtare. Pra, duhet shqyrtuar objektivisht rolin e të gjitha grupeve etnike që morën pjesë dhe rolin e bashkësisë ndërkombëtare në parandalimin apo në përkrahjen e atyre konflikteve. (Grupi Punues Maroko, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, Serbi, 16 prill 2009).

Në të vërtetë, komisioni nuk do të duhej të merrej me shkaqet e disa ngjarjeve, por me tepër me faktet, sepse faktet janë më të rëndësishmet. E kur i dimë faktet atëherë edhe vetë mund të vijmë deri te disa përfundime dhe të shohim se përse ka ndodhur diçka. (Grupi Punues Peru, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, Serbi, 16 prill 2009).

Është i domosdoshëm programi për mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve, i cili mundëson mbrojtjen e identitetit.

Do të duhej të organizoheshin dëshmime publike, bashkë me mbrojtjen eventuale të identitetit. Pra, dëshmitarët që nuk dëshirojnë ta zbulojnë identitetin e vet do të duhej të kenë mundësinë për mbrojtjen e identitetit të tyre. (Grupi Punues Maroko, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, Serbi, 16 prill 2009).

KOMRA duhet të themelojë Ditën e Kujtimit

për të gjitha viktimat, dhe të iniciojë që në secilin vend të vrasjeve të ngrihet nga një përmendore me emrat e viktimave.

[Duhet që] të jetë një ditë e përbashkët e kujtimit në të gjitha viktimat, pavarësisht shtetit. Kjo do të duhej të jetë datë neutrale, le të themi, data e themelimit të KOMRA, ose ndonjë datë krejtësisht tjetër. Do të duhej të vendoseshin përmendore në vendet e vrasjeve, dhe në ato përmendore të shkruheshin emrat e viktimave. (Grupi Punues Maroko, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, Serbi, 16 prill 2009).

Të themelohet një fond i përbashkët ndër-shtetëror për stipendimin e fëmijëve të të vrarëve dhe të të zhdukurve.

Themelimi i fondit të përbashkët për stipendimin e të rinjve do të ishte një ide e mirë. Por problemi në rajonin tonë është se shtetet nuk kanë para për diçka të tillë, por do të duhej që të krijohet një fond i tillë, me ndihmën e njerëzve të vullnetit të mirë, të ndonjë donacioni, ndoshta edhe nga Bashkimi Evropian, në mënyrë që viktimat dhe familjet e tyre të ndihmohen financiarisht. (Grupi Punues Maroko, Konsultat Kombëtare me të Rinjtë, Beograd, Serbi, 16 prill 2009).

28. Konsultat Kombëtare me shoqatat e viktimave për iniciativën KOMRA

**Beograd, Serbi
25 prill 2009**

Konsultat i organizoi Shoqata e Familjeve të të Vrarëve dhe të të Zhdukurve në Kosovë. Në takim morën pjesë 29 pjesëmarrës, kryesisht anëtarë të shoqatave të familjeve të viktimave nga Kosova, dhe disa anëtarë të shoqatave të viktimave nga Kroacia. Pjesëmarrësit në takimin në Beograd vinin nga Mali i Zi (11), nga Kosova (3) dhe nga pjesë të ndryshme të Serbisë (14). Fjalën hyrëse e mbajtën, Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi), Milošav Stojković (Shoqata e Familjeve të të Vrarëve, Kidnapuarve dhe të Zhdukurve në Kosovë, Serbi) dhe Maja Stojanović (Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut, Serbi). Njohtoi FoNet.

Pjesëmarrësit në konsultë përkrahën iniciativën për themelimin e KOMRA.

Kam menduar shumë, natyrisht duke llogaritur peshën e problematikës dhe duke e përjetuar atë për dhjetë vjet. E përkrah plotësisht këtë iniciativë dhe i jam shumë mirënjohëse zonjës Nataša Kandić, që e ndjeu këtë dhe që do të japë gjithçka nga vetja që megjithatë të bëhet diçka. (Desanka Pejčinović, Shoqata e Familjeve të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, Serbi, 25 prill 2009).

Përse KOMRA? Për shkak se opinionit në rajon po i plasohen gënjeshttra. Gënjeshttrat që janë plasuar mund të demantohen, por gjithsesi që ky është njëri prej qëllimeve... Prandaj do të ndërtojmë një platformë publike për zërin e viktimave dhe me ndihmën e dëgjimit të viktimave do të krijojmë keqardhjen, respektin dhe solidaritetin e opinionit, jo vetëm me viktimat, me të cilat tashmë bashkëndjëm, por edhe me viktimat që në të kaluarën s'mund të shiheshin si viktimat... Për shkak se do të krijojmë një regjistër të viktimave dhe të humbjeve njerëzore, do të pengojmë manipulimin me shifra të të vdekurve dhe të të vrarëve... Për shkak se do t'i ndihmojmë Serbisë që të zbulojë fshehtësitë dhe që të gjurmtojë edhe më tutje për varrezat e fshehta masive, dhe posaçërisht në zgjidhjen e çështjeve sonë të dhembshme, të zgjidhjes së fatit të të zhdukurve. Për shkak se do të krijojmë një mirëkuptim dhe tolerancë, dhe në veçanti, sepse do t'ua kthejmë dinjitetin viktimave dhe familjeve të tyre. (Milosav Stojković, Shoqata e Familjeve të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, Serbi, 25 prill 2009)

Vërtet ishte koha që të themelohej një komision i tillë, që të mos harrohen krimet tona, të mos harrohen kriminelët që i kryen ato, pra, që të ndiqen deri në gjykatat e drejtësisë. Unë bashkëndiej me të gjitha viktimat, qofshin ato myslimane, kroate, por edhe me ato tonat. Por, tani këtu duhet të flasim për viktimat tona, sepse ne edhe jemi mbledhur këtu që, para së gjithash, ta mbështesim formimin e komisionit, duke shpresuar se të gjithë kriminelët do të përfundojnë para drejtësisë. (Saša Ristanović, Shoqata e Familjeve të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Zyra në Shtërpçë, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, Serbi, 25 prill 2009).

Më duhet të pranoj se edhe unë isha nga ata që ndoshta kishin dyshime në këtë, por fakt është që shoqatat ekzistuese e kanë humbur paksa mprehtësinë

e tyre. Prandaj, problemi i viktimave dalëngadalë po shkon drejt harresës. Por tani një iniciativë, në formë të Nataša Kandić, sikur po fillon të fitojë një mprehtësi të re, dhe unë do ta përkrahja këtë iniciativë, sepse jam përpjekur që të sqaroj se Nataša Kandić më shumë vëmendje i kushton argumenteve të vlerësimeve paushall të atyre që e kritikojnë, dhe që janë të pakënaqur megjithëse s'kanë bërë asgjë që t'ia sigurojnë dëshmitë, dhe të shihnim nëse pastaj do të ndihmonte apo do të refuzonte që të kërkonte të vërtetën. (Marinko Đurić, Shoqata e Familjeve të të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Shoqatat fatkeqësisht po e humbin mprehtësinë e tyre. Sepse, shoqatat ndoshta janë baza më e besueshme e të dhënave, meqë ne në ato shoqata jemi edhe dëshmitarë edhe viktimat të drejtpërdrejta edhe familje të viktimave. Kjo është edhe një arsye më shumë për përkrahjen e themelimit të KOMRA. Për shembull në secilën qeveri ekziston ndonjë komision i caktuar për të zhdukurit, po flas konkretisht për qeverinë tonë, gjegjësisht, për Komisionin për të Zhdukur. Më besoni se nuk ka asnjë komision të tillë për të vrarët. Do të thotë, nuk ka. Ata po distancohen në këtë gjë. Në rregull është ajo: u zhduk, pastaj u gjet, e mandej u vra, apo diçka ngjashëm, por, për të vrarët nuk ka asnjë komision. Pra, përveç kur shoqata merret aktivisht me të vrarët, këtu mbaron gjithçka, dhe pikë, pas kësaj s'ka asgjë. Pra, ja edhe një arsye më shumë që të përkrahim themelimi i një komisioni të tillë. (Snežana Zdravković, Shoqata e Familjeve të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Nëse ky koalicion për KOMRA mund t'i lëvizë ato institucione që deri më tani sigurisht se nuk deshën që në Kosovë të hetonin dhe të punonin në cilindro rast, atëherë mua më pëlqen kjo ide, sepse unë personalisht e di se kush ma ka vrarë babanë, ndërsa unë as sot e kësaj dite për shkak të atij njeriu s'mund ta punoj tokën tim, e as të kthehem e të jetoj në shtëpinë time. (Nenad Popović, Shoqata e Familjeve të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Serbi, Beograd, Serbi, 25 prill 2009).

KOMRA duhet të sigurojë reparacionin për të gjitha viktimat, dhe të zgjidhë çështjen e statusit dhe të të drejtave të viktimave civile të luftës.

Shpresoj se të gjithë do të kemi dobi nga themelimi i këtij komisioni. E para, për t'u gjetur shkaktarët e vërtetë të tragjedisë tonë, ashtu që të zbulohet e vërteta për humbjen e më të dashurve tanë. E dyta, që familjet tona, të cilat përjetuan atë që e përjetuan, të paktën pjesërisht të shfrytëzojnë pjesën e dëmshpërblimit material të paraparë për atë qëllim. (Saša Ristanović, Shoqata e Familjeve të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Zyra në Shtërpcë, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Mendoj se këto janë çështje të mëdha të cilat KOMRA e ardhshme nuk guxon t'i kapërcejë. Që të jem më i qartë, do të jap shembullin e banesave dhe të drejtës së banimit në Kroaci. Ky është një rrëmbim i pastër i pronave. Unë nuk e di se si është në Kosovë, supozoj se është diçka ngjashëm, por për çështjet e tilla duhet të deklarohet [KOMRA]. (Dragan Pjevač, Shoqata e Familjeve të Vrarëve dhe të Zhdukurve në Krajinë, Kroaci, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, Serbi, 25 prill 2009).

Do të ishte mirë që komisioni të merret me ndonjë lloj dëmshpërblimi për dhembjen shpirtërore (...) për humbjen e më të dashurve, dhe të shqyrtojë se në cilën mënyrë... Gjithsesi duhet të merret edhe me pronat e plaçkitura dhe të uzurpuara. Ai që ka plaçkitur nuk guxon të mbetet i padënuar, nuk ka rëndësi fare se pjesëtar i cilit komb është. (Nataša Šćepanović, Shoqata e Familjeve të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Ne jemi tejet të pakënaqur. Dhjetë vjet familjet tona dhe të gjithë ne individualisht pandërprerë pyesim përse, përse, përse... Kryesit e veprave i dimë, por hetime nuk ka. Përse janë privuar nga drejtësia viktimat tona, viktimat civile? Shteti ynë nuk i trajton si viktimat të luftës. Për qeverinë tonë, për pushtetin tonë, ata nuk kanë vdekur, por mungojnë apo ende kërkohen (...) Dhjetë vjet shteti ynë nuk është në gjendje që të zgjidhë statusin e familjeve tona, por jemi të detyruar që çështjet jetësore të familjeve tona t'i zgjidhim vetë. Na duhet që të kidnapuarin apo të vrrarin tonë ta shpallim të vdekur! (Desanka Pejić-nović, Shoqata e Familjeve të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Nuk mund ta kuptoj që as pas dhjetë vitesh të këtij

statusi që e kemi tani... na është thënë se është i i përkohshëm – statusi i personave të zhvendosur – mirëpo, kjo po zgjat ende... Nuk kemi as kushtet elementare që të disponojmë me pronën tonë të luajtshme apo të paluajtshme, (që të mos e kemi) të drejtën e lëvizjes së lirë, që të mos mund të kthehemi në vendin ku ne jemi lindur dhe të parët tanë, që të shkojmë, të lëvizim lirshëm dhe të vizitojm atë që është kjo një e drejtë e jona e pacenueshme. (Zoran Petrović, Shoqata e familjeve të Kidnapuarve, të Zhdukurve dhe të Vrarëve në Kosovë, Crveni božur, Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, Serbi, 25 prill 2009).

Nga familjet tona në Mal të Zi po dëgjoj se ata, përkundër të gjitha problemeve që po i theksojmë këtu, e kanë edhe një problem shtesë, sepse pushteti i Malit të Zi i drejton ata për në Serbi. Iu thonë se "ju jeni shoqata që ekzistojnë në Kosovë, dhe për këtë gjë duhet të kujdeset pushteti në Serbi". Ndërkaq këtu, sa herë që e hapim çështjen e financimit dhe ndihmës së familjeve, na thonë se nuk janë kompetentë, sepse shoqatat evidentohen në Mal të Zi. (Milosav Stojković, Shoqata e Familjeve të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

KOMRA duhet të zgjerojë kornizën kohore me të cilën merret, sepse vrasjet ndodhën edhe pas vitit 2001.

Pra, le të jetë që deri në vitin 2005 të përfshihet 17 marsi. Atë përndjekje nuk guxojmë ta harrojmë kurrë, sepse viti 1999 ishte më i keqi, e pastaj vjen 17 marsi i vitit 2004. (Saša Ristanović, Shoqata e Familjeve të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Zyra në Shtërpcë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Anëtarët e KOMRA duhet të jenë individë që do të jenë të pranueshëm për gjithë rajonin.

E gjithë kjo është e mirë, vetëm se unë do të dëshiroja që ky të jetë një komision që do të ishte plotësisht neutral, objektiv, i drejtë dhe i ndershëm, që ai të përbëhej nga njerëz që vërtetë kanë parime morale dhe të ndershme (...) që në asnjë moment nuk u shkoi mendja për të keq, ose që nuk kanë kryer asnjë mëkat. Kjo për ne është me shumë rëndësi. Mos lejoni që në atë komision të gjendet dikush që nuk do t'i pëlqejë dikujt nga ne. (Nataša Šćepanović, Shoqata

e Familjeve të të Kidnapuarve dhe të të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

KOMRA do të duhej të ketë nënkomisione apo zyra në të gjitha shtetet e pas-Jugosllavisë.

A mos ndoshta do të formohen edhe disa nënkomisione (...) në kuadër të këtyre komisioneve rajonale. Për shembull, në Serbi për Beogradin, për viktimat tona, le të themi, në Kroaci, në Bosnje, e kështu me radhë. Mendoj se kjo do ta bënte edhe më të mirë dhe më të fuqishëm funksionimin e vetë komisionit, pra atij kryesorit. (Nataša Šćepanović, Shoqata e Familjeve të të Kidnapuarve dhe të të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Të krijohen nënkomisionet, por jo që ato të merren për shembull në Kroaci vetëm me kroatë, por të merren edhe me ata njerëz që u vranë në atë territor. Do të thotë, me të gjitha viktimat dhe krimet që ndodhën në atë territor. (Snežana Zdravković, Shoqata e Familjeve të të Kidnapuarve dhe të të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Në punën e KOMRA duhet të marrin pjesë edhe pjesëtarët e ushtrisë dhe policisë, të cilët nuk kanë kryer krime, por që mund të ndihmojnë shumë në zbardhjen e krimeve.

Ata dëshirojnë të ndihmojnë në zbardhjen e fakteve. Nuk janë ata të gjithë, le të them kështu, negativ. Tek ne ka gjithashtu edhe pjesëmarrës të luftës, ka aty pjesëtarë të policisë e ushtrisë, madje mendoj se dy ishin edhe në Mal të Zi, në maj të viti 2008, dhe ata po ashtu mendojnë se edhe atyre duhet t'iu jepet mundësia që të ndihmojnë në zbardhjen e krimeve. Pra, ata janë njerëz që nuk kanë kryer krime lufte. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, Serbi, 25 prill 2009).

Unë jam kolonel në pension. Isha në ushtri dhe mora pjesë në luftën në Kosovë, si pjesëtar i ushtrisë. Unë absolutisht e di se si, në ç'mënyrë dhe nën çfarë rrethanash ishte e rëndësishme që të mbeteshe njeri, e pastaj ushtar, dhe e di se në ç'mënyrë i kam trajtuar të gjithë njerëzit përveç atyre lartë, meqenëse me profesion jam raketahedhës, oficer, dhe se si i e përmbushja detyrat për mbrojtjen e vendit tim.

Por, raporti ynë ndaj njerëzve të kombeve tjera, fesë tjetër asnjëherë nuk është vënë në dyshim, respektivisht që të shikohet në ta me sy tjetër. Të mos flas për mendjen e sëmure, timen apo të vartësve të mi, për të bërë krime ndaj njerëzve të religjionit tjetër, të kombit tjetër, apo të besimit tjetër. Prandaj, shikuar nga ky aspekt, ka njerëz që, le të ta themi me fjalorin tonë, nuk i kanë përlyer duart, ose në venat e të cilëve nuk qarkullon gjak i keq, dhe që mund të japin kontribut. (Milosav Stojković, Shoqata e Familjeve të të Kidnapuarve dhe të të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Veteranët nuk duhet të jenë anëtarë të KOMRA.

Ndërkaq, për sa u përket veteranëve, unë vërtet mendoj se këtu veteranët nuk duhet të jenë të përfshirë. (...) Ndoshta, të paktën jo para se veteranët të pajtohen me vetveten, dhe me njëri-tjetrin. (Lozanka Radoičić, Shoqata E Prindërve Vera, nada, ljubav, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, Serbi, 25 prill 2009).

Prandaj po ju lus edhe njëherë që të keni kujdes. Unë nuk e di, nëse veteranët e luftës ishin pjesëtarë të UÇK, ata s'munden të jenë veteranë edhe për ne. Ju lus që të keni kujdes dhe të përdorni arshinë të njëjtë për të gjithë, sepse sigurisht që edhe pala e kundërt do të reagoonte ashpër dhe do të protestonin nëse nga ana tjetër do të gjendeshin njerëz të ngjashëm. (Nataša Šćepanović, Shoqata e Familjeve të të Kidnapuarve dhe të të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Ushtarëve të vranë, të cilët ishin dërguar në zonat e luftës pa stërvitje, duhet t'iu sigurohet e njëjti respekt sikurse edhe të gjitha viktimave tjera.

Dërgimi i të gjithë ushtarëve me dy, tre muaj përvojë në vitin 1998 në Koshare, Morinë dhe ku ta di unë ku tjetër, ishte po ashtu krim. Fatkeqësisht, dhe ne kemi shkruar, shkohej me kallëzime penale kundër gjeneralëve të atëhershëm, mirëpo në këtë shtet nuk ka viktimat, e as përgjegjësi. Kështu që, na ndihmoni që fillimisht të fillohet të flitet për këto viktimat. (...) Ne flasim nëpër takime, por në opinion kjo nuk dihet, e as vetë Serbia nuk e din si duhet se sa ushtarë janë vranë në të vërtetë, e për civilë as të mos flasim, këtë nuk e dinë saktësisht as njerëzit nga Kosova. Se sa viktimat ka pasur e

dinë vetëm disa persona me të cilët shoqërohem. (Lozanka Radoičić, Shoqata E Prindërve Vera, nada, ljubav, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, Serbi, 25 prill 2009).

Të gjitha viktimat duhet të jenë të barabarta, dhe të gjitha duhet të jenë pjesë e kujtimit të përbashkët kolektiv.

Më duket se në Serbi, e të mos i përmendi shtetet tjera përreth, nuk janë të gjitha viktimat të barabarta. Dikujt i kushtohet rëndësi e madhe. (...) Me gjithë respektin ndaj viktimave civile, por disa prej viktimave tona janë lënë anash dhe janë harruar. Dhe, më duket rast i mirë që KOMRA të fillojë, jo vetëm në hapësirën e ish-Jugosllavisë, por edhe në atë të Serbisë, të filloj punën në këtë drejtim, që të ndihmojë që të gjitha viktimat të fitojnë një status të barabartë. (Marinko Đurić, Shoqata e Familjeve të të Kidnapuarve dhe të të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Unë dua të përpiqem me bashkëpunëtorët e mi, dhe këtë e kërkoj edhe nga ju, nuk ju lus por vërtetë e kërkojë, që të më ndihmoni që Serbia të mos i vret edhe njëherë viktimat dhe të vrarët tanë. Unë po ju them, shqiptarët i vranë të gjallë. Ligji i të fortit, i Zotit, apo se di as vetë se si. Këtë edhe mund ta pranoj, por që dikë ta vret shteti i vetë, që dikë ta vret përmes heshtjes, kjo atëherë është edhe një vrasje, ky është një mëkat edhe më i madh edhe ndaj viktimës edhe para Zotit edhe para ligjit, i cili fatkeqësisht këtu nuk funksionon. (Lozanka Radoičić, Shoqata e Prindërve Vera, nada, ljubav, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, Serbi, 25 prill 2009).

Konsideroj se ata që do të përfshihen në punën e këtij Komisioni, pa marrë parasysh përkatësinë kombëtare apo fetare, duhet të llogarisin në atë që të mos i japin prioritet njëres viktimë ndaj tjetrës, pavarësisht asaj se cilit komb apo religjion i përkasin. (Zoran Petrović, Shoqata e Familjeve të të Kidnapuarve, të të Zhdukurve dhe të Vrarëve në Kosovë dhe Crveni božur (bozhuri i kuq), Mal i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, Serbi, 25 prill 2009).

Udhëheqësitë e shoqatave të viktimave duhet të përhapin lajmet për iniciativën KOMRA në mbledhjet me anëtarët e tyre. Viktimat duhet të

përfshihen aktivisht në forcimin e mbështetjes së KOMRA.

Ne kryesisht shoqërohem me njerëz që kanë të njëjtin problem sikurse ne. Zakonisht familjet mbyllen për të biseduar, nëse janë vërtet të bindur në idenë e mirë dhe në qëllimin e ndershëm për themelimin e KOMRA. Pra, se duhet ta bëjnë këtë ashtu që sa më shumë njerëz ta kuptojnë se çka është ajo për të cilën angazhohet një pjesë e madhe e shoqatave të familjeve të të vrarëve dhe kidnapuarve (...) Ky komunikim do të duhej që disi të jetë më i mirë dhe më i fuqishëm, ashtu që njerëzit thjesht ta kuptonin se për çka po angazhohemi ne këtu. (Gordana Đikanović, Shoqata e Familjeve të të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, revista Kosmetske žrtve, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Pres që KOMRA t'ia dalë, natyrisht jo brenda natës, sepse kjo është e pamundur, por pjesë-pjesë, dhe pyetje pas pyetjes, dhe se diçka do të zgjidhet (...) E kjo tani varet nga përfshirja e të gjithë neve, pra, ne jemi tani luftëtarët që duhet të tregohemi se sa njerëz do t'i mbledhim për t'iu përveshur kësaj iniciative dhe që ta përkrahin atë. (Desanka Pejćinović, Shoqata e Familjeve të të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Nevojitet një regjistër i saktë i viktimave, i vrasjeve dhe i të gjitha krimeve. KOMRA duhet të kërkojë hapjen e arkivave të UNMIK-ut dhe EULEX-it .

[Gjithsesi të kërkohet] edhe hapja e arkivit që e posedon UNMIK'u, tani EULEX'. (Snežana Zdravković, Shoqata e Familjeve të të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Bazat e dhënave më duket se në Serbi as që ekzistojnë, kurse organet përgjegjëse që janë të obliguara të merren me këtë punë, këtë nuk e bëjnë si duhet (...) Neve kjo na pengon shumë, dhe, nëse kjo gjë iu ka mbetur vetëm shoqatave të cilat i quajnë ashtu apo kështu, atëherë kjo kurrë s'do të jetë një punë siç do të duhej të ishte. (Dragan Pjevač, Shoqata e Familjeve të të Vrarëve dhe të të Zhdukurve në Krajina, Kroaci, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Serbi, Beograd, 25 prill 2009).

Më duhet ta përsëris që themelimi i këtij Komisioni për personat e vrarë është i rëndësishëm, sepse duhet të vërtetohet data e saktë e vrasjeve të personave, pastaj e kidnapimit, pësimit, në çfarë mënyre janë vrarë, shkaku, pra të gjitha deri në detaje. Këtë mund ta bëjnë ekspertët. Nuk dua të besoj që kjo s'mund të bëhet deri në fund ashtu si duhet. Prandaj, mendoj se vetëm pasi të formohet ky Komision, atëherë Komisioni edhe do ta kryejë punën deri në fund. (Nataša Šćepanović, Shoqata e Familjeve të të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

KOMRA duhet t'i zgjidhë problemet e dokumentimit të vrasjes së personave të zhdukur

Mua më pyesin, gjegjësisht fëmijët më pyesin se çfarë date të vdekjes të vendosin. E unë i mbledh krahët, dhe nuk e di... E kemi vënë datën kur është kidnapuar. E pse gjurmohet që shtatë vjet? (...) Shkaku i vdekjes nuk përputhet, shkaku i vdekjes në dokumentin që e lëshon UNMIK-u dhe në dokumentacionin që e lëshon Instituti për Mjekësi Ligjore në Mitrovicë. Pra, ka dallime, dallime në datë. D.m.th, ai është zhdukur në vitin 2000, data e gjetjes para vitit 2004. Pra, kjo është shumë një periudhë e gjatë, e unë e kuptova se ka vdekur më 8 shkurt të vitit 2007. Ndoshta në nënvetëdije e dija se s'është gjallë, por nuk kisha asgjë të dokumentuar, s'kisha fakte. (Snežana Zdravković, Shoqata e Familjeve të të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Babai im është kidnapuar, pastaj është gjetur, identifikuar dhe varrosur. Mua, le të themi, në Istog më kanë lëshuar certifikatën, më është dashur certifikata nga libri i të vdekurve dhe e kam marrë...Në atë letër shkruan se kinse ka vdekur nga shkaqe(vdekja) natyrore. A më besoni ju mua? Çfarë mund të bëjë unë me atë letër? Shkakun e vdekjes nuk e kam marrë as sot e kësaj dite, as që është bërë identifikimi, dhe as kush e ka bërë. (Nataša Šćepanović Shoqata e Familjeve të të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Pjesë përbërëse e punës së KOMRA duhet të jetë dëgjimi publik i viktimave. Duhet përkujdesur për sigurinë dhe mirëqenien e atyre që dëshmojnë

Kam pasur rast të dëgjoj deklaratat e të mbajturëve në kampe(llogorashëve) të Bosnjës, kurse e fundit është kjo poshtë në Kosovë. Mund të them se kjo ka lënë përshtypjen më të fortë në mua. Ata që nuk e kanë dëgjuar këtë mendoj se janë më të varfër për një njohuri se si kanë mbijetuar kombet tjera dhe të tjerët. (...) Të gjithë ne vuajmë për më të dashurit, por kur të dëgjoni se ka situata të tilla edhe më të vështira, atëherë jo që e kemi më lehtë, por i kuptojmë më mirë. Kështu që, për atë arsye unë nuk kam dilemë aspak se a duhet. (Marinko Đurić, Shoqata e Familjeve të të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Është një dallim i madh mes dëgjimit publik dhe dëgjimit të viktimave, sikurse që ishte organizuar në kuadër të komisionit dhe forumit.(...) Atmosfera disi është e dhimbshme, por është relaksuese. Është një dallim i madh mes asaj në gjykatë dhe asaj publikisht, sepse publikisht nuk ka qenë vetëm serb apo një shqiptar si dëshmitar, por edhe shqiptarët, edhe serbët, edhe kroatët, edhe myslimanët, dhe të gjithë. Nëse dikush është viktimë, përkatësisht nëse edhe ne si dëshmitarë jemi të përgatitur për një dëshmim të tillë publik, dhe ndoshta as nuk jemi të vetëdijshëm nëse jemi të sigurt në atë moment apo jo, por e përmbushim ndonjë qëllim tonin. (Snežana Zdravković, Šćepanović Shoqata e Familjeve të të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Dhe mendoj se çdokush prej nesh e ka për obligim, unë ja kam borxh këtë djalit tim, por edhe gjithkush nga ne ia ka borxh viktimës së vet, prindit, nënës, vëllait, motrës, apo nuk e di se kujt, që duhet të tregojmë... Problemi ynë më i madh nuk është frika, për mua problem janë media, të cilat janë të ngurta, të cilat nuk duan, ose thjesht nuk guxojnë që, nuk e di përse dhe si, por thjesht nuk duan të shkruajnë për këtë. (Lozanka Radoičić, Shoqata e Prindërve Vera, nada, ljubav, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

Mendoj se iu mbetet obligim shoqatave dhe njerëzve që i udhëheqin ato shoqata që t'i nxisin dëshmitë. Përkisht ne duhet ta thyejmë frikën e tyre dhe ta zhvillojmë vetëdijen për atë se synim i tyre është që kriminelit të paditet dhe dënohet për krimin e kryer ndaj më të dashurve të tyre, sepse këtë s'mund ta bëjë dikush tjetër në vend të tyre, por duhet ta bëjnë

ata vetë. (Gordana Đikanović, Shoqata e Familjeve të të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, revista *Kosmetske žrtve*, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave, Beograd, 25 prill 2009).

29. Konsultat lokale me shoqërinë civile për iniciativën KOMRA

Nish, Serbi

25 prill 2009

Konsultat i organizoi Këshilli për Iniciativë Qytetare nga Nishi. Pjesëmarrësit (30) ishin aktivistë të organizatave joqeveritare, avokatë, profesorë universitarë, gjykatës dhe gazetarë nga rajoni i Nishit. Konsultat i udhëhoqi Danijela Gavrilović (Këshilli për Iniciativë Qytetare, Serbi), kurse fjalën hyrëse e patën Andrej Nosov (Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut, Serbi) dhe Vehid Šehić (Forumi i Qytetarëve të Tuzllës, BH). Raportuan mediat: Danas, TV Nish, Radio Nish, TV5, TV Zona.

Pjesëmarrësit në konsulta e përkrahën iniciativën për themelimin e KOMRA dhe përkushtimet e Koalicionit KOMRA

Dhe, mbase kuptimi i kësaj iniciative edhe është që institucionet ta marrin përgjegjësinë për atë për çka edhe ekzistojnë ato institucione. Pra, filluar që nga pushteti ligjvënës, ai ekzekutiv, gjyqësor, mediat... Si është gjendja në ushtri dhe polici? Kush në fakt e ka fjalën kryesore? Pra, te ata që me gjasë si institucione edhe janë keqpërdorur dhe manipuluar më së shumti gjatë të gjitha luftërave. Nëse ndjejnë brejtje të ndërgjegjes, atëherë duhet që pikërisht prej atje të presim ndonjë lloj iniciative dhe ballafaqimi me të vërtetën dhe drejtësinë. Si është gjendja në Akademi? Si është gjendja nëpër universitete? Cilat janë temat dominuese nëpër tribunat e shumta në fakultete, të cilat organizohen kinse nga studentët dhe mentorët e tyre? Dhe kjo nuk është gjendja vetëm në Fakultetin Juridik në Beograd dhe në Fakultetin Filozofik në Novi Sad, por merreni cilindo universitet. Unë nuk posedoj ndonjë përcjellje sistematike, nuk jam ai lloj i hulumtuesit, por në bazë të këtyre pak të dhënave që i kam, e shoh se cilat janë temat dominuese në Fakultetin Filozofik dhe kush janë pjesëmarrësit. Temat dominuese janë ato kleronacionaliste dhe fashiste, e më dominuesja është mbrojtja e krimeve dhe e kriminelëve. Nga këto per-

spektiva shoh që kjo iniciativë është vërtet brilante, dhe vetëm pyetem se çka cili prej nesh mund të bëjë. Çka mund të bëjë unë? (Draško Bjelica, Fakulteti Filozofik në Nish, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

Unë këtë iniciativë e kuptoj si përgjigje ndaj një nevoje, një nevoje që t'i dalim në fund një lëndimi të tmerrshëm që e kemi përjetuar, një dëmi të llahtarshëm që na është bërë gjatë këtyre 15 apo 20 vjetëve, që nga fillimi i viteve të 90-a e deri në fillimin e viteve të 2000-a. (Nenad Popović, Këshilli për Iniciativë Qytetare, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

Të përgatitet mirë opinionimi për formimin e KOMRA, dhe në këtë gjë duhet të punojnë edhe mediat dhe organizatat joqeveritare

Sido që ta ktheni, mendoj se kusht që kjo të ketë sukses është që të pritët, nëse është e mundur sa më pak, sa të përgatitet opinionimi, shkallë-shkallë, nëse kjo është fare e mundur... (...) dhe atëherë, ajo që është më e rëndësishmja është që kjo të prezantohet si duhet në media, e tek pastaj të formohet ndonjë komision... gjegjësisht, jo ndonjë por ky Komision. (Dragan Vesić, Al Kanal, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, Serbi, 25 prill 2009).

Një gjë është mbledhja e fakteve për viktimat dhe animimi i Prokurorisë dhe i organeve gjyqësore që, eventualisht, të nisin disa procese kundër kryerësve të krimeve ndaj atyre viktimave dhe nëse ky është caku i vetëm atëherë më duket se opinionimi, në njëfarë mënyre, edhe s'është i domosdoshëm. Mendoj se caku i Komisionit është vendosur dhe është kthyer, para së gjithash, kah e ardhmja (...) [Nëse e kemi si cak] që vetëm ta kemi më mirë atë që e dëshirojmë në të ardhmen (...) atëherë mendoj se ekziston problemi i përfitimit të opinionit (...) Ne atë opinion duhet ta përfitojmë në njëfarë mënyre, prandaj mendoj se, në përputhje me një opinion të tillë duhet të definohej të gjitha këto procedura,, edhe të zgjedhjes, edhe të participimit, edhe mandati, edhe kumtesat, edhe se kush do të jetë bartës i gjithë kësaj pune. (Gordana Đorić, Këshilli për Iniciativë Qytetare, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

Ai që do të ishte roli i organizatave joqeveritare është që ato të rrjetëzohen edhe më tepër në fushat e animimit të opinionit, për formimin e Komisionit Rajonal. (Semih Kačar, Këshilli i Sanxhakut për

Mbrojtjen e të Drejtave dhe lirive të Njeriut, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, Serbi, 25 prill 2009).

Këtu, parimish,t jemi pajtuar të gjithë se dikush duhet të qëndrojë prapa këtij Komisioni, dhe kjo është ajo që është tejet e rëndësishme. Mirëpo, gjëja e dytë sipas meje, si gazetar, është se Komisioni duhet ta fitojë edhe kredibilitetin në opinion. Kot i keni të gjitha nëse nuk e animoni opinionin që në numër të madh ta përkrahë atë që po bën ai Komision, dhe që do të bëjë në të ardhmen (Bratislav Ilić, Televizioni Leskovac dhe B92, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, Serbi, 25 prill 2009).

Karakterit i konflikteve të armatosura në ish-Jugosllavi është specifik dhe ai kërkon që KOMRA të ketë një model unik, por të bazuar në përvojën e organeve tjera të ngjashme. KOMRA duhet të vërtetojë fatin e personave të zhdukur

Në ish-Jugosllavi kemi pasur konflikte të disa vijave të ndryshme përnjëherësh. Ato, sipas meje, nuk ishin, në fakt nuk ishin pothuajse fare, konflikte etnike. Ato ishin, konflikte mes ish-jugosllavëve dhe nacionalistëve. Ato ishin konflikte, nëse dëshironi, mes qytetarëve dhe fshatarëve, e keni edhe këtë teze po ashtu. Sreten Vujović konsideron se lufta ishte një urbocid. Njëkohësisht, e keni edhe atë konfliktin e liberalëve dhe totalitarëve, pra mund ta quani edhe kështu. Dhe, njerëzit që morën pjesë në ato konflikte dhe të cilët merrnin këtë apo atë anë nuk vepronin ashtu në bazë të një dileme të thjeshtë, këtu apo atje, por vendosnin, gjegjësisht përcaktoheshin në bazë të kriterëve shumë të ndryshme, sistemeve të vlerësimit, interesave, dhe ku ta di unë çka tjetër. Kështu që është tejet e vështirë të shpaloset ky lëmsh, është shumë e vështirë të jepen vlerësime qofshin ato morale apo fajësuese, apo çfarëdo qofshin tjera, e të mos flas për ato politike apo historike. Pikërisht për këtë shkak më duket se këtij Komisioni nuk duhet t'i jepen detyra të mëdha. Dhe, pikërisht për këtë shkak më duket se detyrën e këtij Komisioni duhet ngushtuar në atë që, le të themi, është minimumi njerëzor. (Nenad Popović, Këshilli për Iniciativë Qytetare, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, Serbi, 25 prill 2009).

Ai konflikt ka qenë shumë kompleks. E tani ju thoni këtu Komisioni për përcaktimin dhe tregimin e të vërtetës. Frikohem se ajo e vërtetë, nëse bëhet fjalë për numra, nëse ne tani do të thoshim se në Kroaci kanë vdekur aq dhe aq kroatë, ose njerëz, atëherë

mirë, por kjo menjëherë kuptohet si kroat, nga njëra anë. Nga ana tjetër, në Serbi aq ose aq, nga pala e tretë aq e aq. Por, kur ne ta themi këtë, kur ta bëjmë publik, mos do të jetë kjo kontraproduktive. (...) Mendoj se ky komision do të duhej të merret me verifikimin e fakteve se për çarsye erdhi deri te lufta dhe të merret me gjetjen e personave të zhdukur, dhe që kjo të jetë detyrë e tij kryesore, e jo të publikohen numra. Mendoj se në opinionin e gjerë publik kjo do ishte kontraproduktive. (Igor Pančić, gazeta Pi kanal, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Nish,25 prill 2009).

Të aprovohet ligji për themelimin e KOMRA, në kuadër të parlamenteve kombëtare. Meqenëse KOMRA do të ishte një komision ndër-shtetëror, është e nevojshme gjetja e një mekanizmi të duhur juridik për themelimin e tij.

Mendoj që vullneti politik te ne për t'u themeluar një komision i tillë nuk mungon. Mendoj se asnjë parti nuk do të guxojë të thotë se s'është e interesuar për viktimat. Mendoj se s'duhet të frikësohemi as nga komisioni parlamentar, e as nga debati parlamentar, sepse, siç më duket, askush aty s'do të guxonte të thoshte se s'është i interesuar. (Biljana Adamović nga Nishi, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

Mendoj se dekreti si akt i presidentit të shtetit do të kishte një fuqi më të vogël juridike krahasuar me kuvendin. Çfarë mund të bëjë presidenti i shtetit me atë dekret? Çka do të përmbante ai dekret? Urdhëroj që të formohet komisioni? Prandaj mendoj se do të ishte më e arsyeshme dhe më e fuqishme (të miratohet ligji në Kuvend), pavarësisht asaj që këtu shprehet skepticizmi se Kuvendi nuk ka atë përbërje, nuk ka vullnet politik... Përkundrazi unë mendoj se e ka dhe se do ta ketë gjithnjë e më shumë... Le t'i kujtojmë vitet e 90'a, kur nuk flitej fare për këtë, por sa më shumë që po kalon koha, kalimi i kohës po e bën të veten, prandaj në këtë kuptim gjithsesi se do të ketë edhe vullnet politik (...) Kur të realizohet diskutimi, një propozim i mirë dhe diskutimi parlamentar, të përcjella nga mediat, gjithsesi se ai ligj për formimin e Komisionit do të realizohet... E atëherë, kur ligji të aprovohet në parlament, atëherë Komisionit mund t'i jepen autorizime. (Radomir Mladenović, Gjykata e Qarkut në Nish, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

Pjesëmarrësit propozojnë që KOMRA t'i për-

caktoj faktet edhe për krimet e luftës dhe shkeljen e të drejtave të njeriut, që janë kryer jashtë zonave të konflikteve të armatosura, por në kontekst të atyre konflikteve.

Nuk jam për atë që të seleksionohet se me çfarë të merret komisioni, por që thjesht ai të merret me të gjitha krimet dhe me të gjitha shkeljet drastike të të drejtave të njeriut gjatë të nëntëdhjetave. Jo vetëm jashtë territorit të ndonjë shteti të caktuar, por edhe brenda territorit, jo vetëm të vendeve të përfshira në luftë, por edhe të atyre rajoneve që, sikurse rasti i Sanxhakut në Serbi, paguan një çmim të lartë të paqes, dhe ku po ashtu ndodhi gjithçka, e për këtë shumë njerëz nuk dinë asgjë.. (Semiha Kaçar, Këshilli i Sanxhakut për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

KOMRA duhet t'iu dërgojë prokurorive faktet e verifikuara për krimet e kryera, të cilat, në pajtim me kompetencat e veta, do të iniciojnë hetimet kundër kryesve.

Përgjegjësia politike dhe morale po, e jo fajësia, por unë jam kundër që absolutisht dhe pavarësisht asaj që ende nuk kam besim në sistemin juridik, gjegjësisht në institucione, kjo gjë t'i lihet gjyqit. E ne, nëpërmjet verifikimit të fakteve të caktuara ato do t'ua dërgojmë jo vetëm gjykatave por edhe dikujt tjetër, si sociologëve, psikologëve, historianëve, të cilët ato do t'i shfrytëzojnë si një lloj themeli të tyre për shkrime rreth ndonjë ngjarjeje, ose gjykatës për verifikimin e përgjegjësisë penale. (Vehid Šehić, Forumi i Qytetarëve të Tuzllës, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

Anëtarët e KOMRA duhet të jenë luftëtarë të njohur për të drejta e njeriut, ekspertë dhe përkrahës të dëshmuar të dokumentimit të shkeljes së të drejtave të njeriut.

Mendoj se kriter për përzgjedhjen dhe mënyrën e përzgjedhjes së anëtarëve të komisionit do të duhet të ishte pikërisht përvoja dhe përkushtimi i dëshmuar, dhe nëse doni profesionalizmi, në dokumentimin e të gjitha krimeve dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut, të cilat ndodhën në këto hapësira. (Nenad Popović, Këshilli për Iniciativën Qytetare, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

Ndoshta është më mirë që ata në të vërtetë të jenë

njerëz që fare nuk janë të njohur për opinionin si njerëz që merren me këtë punë, që ata të vijnë pa presion, pa shpërblime, pa paragjykime, që ata në fakt të jenë njerëz të rinj, por që veç kësaj kanë edhe integritet moral, e të cilët do të marrin pjesë në punën e komisionit (Danijela Gavrilović, Këshilli për Iniciativën Qytetare, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

Konsideroj se në punën e këtij Komisioni gjithësesi duhet të përfshihen edhe luftëtarët e dëshmuar për të drejtat e njeriut, që për shkak të besimit të qytetarëve të paktën të jenë anëtarë të atyre komisioneve. (Semiha Kaçar, Këshilli i Sanxhakut për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

Anëtarë të KOMRA duhet të jenë edhe përfaqësuesit e forcave ushtarake dhe policore.

Mendoj se në këtë Komision duhet të përfshihen si anëtarë, ose që madje si dikush që ka një mbi-status, edhe njerëz nga ushtria, policia, nga politika dhe nga organizatat joqeveritare, sepse populli në këtë mënyrë do t'i besojë më tepër atij Komisioni... sado që ndoshta mua nuk më pëlqen që aty ta shoh ndonjë politikan apo dikë nga ushtria, populli do t'i besojë më tepër komisionit nëse aty ka figura të tilla. Fundi i fundit edhe ata duhet ta dinë se çka ka bërë profesioni i tyre dhe të përballen me atë gjë. (Bratislav Ilić, Televizioni Leskovac dhe B92, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

Unë vetëm do të shtoja se, nëse e kam kuptuar mirë, populli paska më shumë besim nëse përfshihen politikanët dhe njerëzit nga ushtria dhe policia... unë i përpunoja të dhënat në një hulumtim të para dy viteve dhe po punoja në një kampion reprezentativ, ndoshta të njëmijë respondentëve nga e gjithë Serbia, dhe pyetja ishte se në cilat institucione keni më së paku besim... në vendin e parë ishte gjyqësori, e pastaj vinte policia. (Maja Pešić, Gratë në të Zeza, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

KOMRA duhet të përpilojë një listë të humbjeve në njerëz gjatë konflikteve të armatosura, të të gjitha rasteve të shkeljes së të drejtave të njeriut, siç janë dhunimet dhe torturat, regjistrimin e të gjithë personave të zhvendosur në ish-Jugosllavi, si dhe regjistrimin e kryesve të veprave.

Ai Komision duhet të bëjë një inventarizim të dëmeve që janë shkaktuar në këtë hapësirë gjatë 10 apo 15 vjetëve të kaluara, e këtu më së paku mendoj në dëmet materiale, ngase mendoj në dëme njerëzore. Mendoj se ai duhet të jetë një trup që më në fund do t'i numërojë se sa njerëz e kanë humbur jetën, sa njerëz janë zhdukur, sa njerëz janë torturuar, dhunuar, sa njerëz janë zhvendosur, pra të bëhet një bilanc përfundimtar i të gjitha këtyre mizorive që ndodhën mes viteve 1990 dhe 2000. Unë do të isha i stërkënaqur nëse gjatë kësaj pune viktimat të mos ndaheshin sipas kombësisë apo vendbanimi. (Nenad Popović, Këshilli për Iniciativë Qytetare, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

Nuk them se duhet mohuar se ka dallime në numra, por mendoj se ndoshta Komisioni do të mund t'i publikonte të gjitha viktimat nga Bosnje e Hercegovina, Serbia, Kroacia, pa asnjë ndarje etnike, pra pa ndarje por vetëm njeri pas njeriu, pa asnjë ndarje territoriale, etnike. Jo për t'i fshehur numrat, jo për këtë, sepse ne e dimë se ekziston kjo ndarje, por çfarë domethënie ka ajo? Në emër të ardhmërisë, thjesht më duket se nuk duhet më të përballen ato, të bëhet thirrje për barazim. (Dani-jela Gavrilović, Këshilli për Iniciativë Qytetare, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

Në punën e vet KOMRA nuk duhet t'i përfshijë të gjithë kryesit.

Mendoj se ai Komision nuk duhet të ketë asgjë me kryesit e krimeve. Hetimin për atë se çka ndodhi, sado që kjo të mos na pëlqej, duhet t'ua lëmë gjykatave, dhe nëse ne mund të bëjmë diçka, atëherë le të ndërmarim një iniciativë të re për t'i forcuar institucionet, për të fituar një gjyqësor të mirë. Sepse, nëse ua mësyjmë autorizimeve dhe detyrave që i kanë gjykatat, atëherë kam frikë se me këtë në fakt vetëm do të hapim rrugë që ato që kanë ndodhur të ndodhin përsëri. (Nenad Popović, Këshilli për Iniciativën Qytetare, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

Mendoj se Komisioni nuk do të duhej të ketë shumë prekje me të dyshuarit potencial. Edhe vetë emri i projektit tregon se duhet zbuluar e vërteta për krimet dhe gjithë atyre veprave, apo jo. Pra, duhet të merremi me viktimat pa i numëruar edhe kuptimet për cilat u fol këtu... mund të hyjnë emrat dhe mbiemrat, por nëse pajtohemi se ato janë viktima, se ato janë gjithkund njësoj, dhe të kenë të njëjtën

pozitë juridike, prandaj këto gjëra edhe to shikohen ashtu. (Radomir Mladenović, Gjykata e Qarkut në Nish, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

Dëgjimi publik i dëshmitarëve përkrahet si një aktivitet i rëndësishëm i KOMRA, por është e nevojshme që ato deklarata të jenë të dokumentuara nga disa burime.

Viktimave duhet t'u jepet rasti për të thënë atë që u tha, por ato fjalime të viktimave nuk duhet të barazohen me faktet për atë që ka ndodhur. Edhe viktimat kanë, nëse mund të shprehem kështu, vizurat e tyre të thyera, subjektivitetin e vet. Natyrisht, fakti që ato janë subjektive nuk do të thotë se nuk duhet të dëgjohen, duhet të dëgjohen dhe duhet t'iu jepet rasti të tregojnë se çka kanë përjetuar, por kjo është diçka duhet të mbahet ndaras nga ajo që do t'i jepja unë Komisionit, një mandat më të plotë, ashtu që numrat t'i krijojë në mënyrë burokratike. (Nenad Popović, Këshilli për Iniciativë Qytetare, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

KOMRA duhet të ketë qasje në arkivat e Tribunalit të Hagës dhe të institucioneve shtetërore.

Rastësisht isha dëshmitar në lëndën e pesësesh, të gjeneralëve tonë udhëheqës dhe atëherë u informova. Ata në Hagë kanë vërtet shumë të dhëna për të dyshuarit eventual... mjafton që, për shembull, në këtë lëndë të përmendet Petar Petrovic si komandant i ndonjë njësi... kaq është indicion i mjaftueshëm që të fillojë, dhe të ekzistojë dyshimi i bazuar apo baza për dyshim. E dyta, Serbia, me sa e di unë, përveç këtij Këshilli për Krime Luftë në Beograd, planifikon të formojë edhe Këshille në Nish, e në Novi Sad. Rrjedhimisht, do të ketë kapacitete, do të ketë kuadro dhe njerëz të aftë dhe të përgatitur që t'i procedojnë këto gjëra. Kështu, nuk duhet pasur dyshime nëse kuadri juridik është i mirë, dhe a do t'ia dalim me këtë, sepse sigurisht se do t'ia dalim. (Radomir Mladenović, Gjykata e Qarkut në Nish, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

KOMRA duhet të sugjerojë reparacione për viktimat dhe për anëtarët e familjet e tyre, sepse me këtë do të sigurohej pranimi publik i tyre. Në shenjë kujtimi të themelohet Dita e Kujtimeve, e cila do të shënohej në të gjitha shtetet e ish-Jugosllavisë.

A është disi e mundur që të organizohen të gjitha vendet e ish-Jugosllavisë dhe që, për shembull, një ditë e muajit të jetë dita e viktimave. Për shembull, njerëzit që janë nëpër ato qytete, ta shënojnë me ndonjë aksion, qoftë me ndezje qirinsh apo me diçka tjetër... por që kjo të jetë një ditë në muaj. Sepse, duhet të punohet pandërprerë, të bombardohet, e bombardohet, e bombardohet me këtë gjë që njerëzit të kuptojnë se për çka bëhet fjalë? A është kjo e mundur? Por që ato viktimat të shfaqen nga të gjitha anët. Do të thotë, jo vetëm nga ana jonë, por që thjesht të bashkohen. A është kjo e mundur? (Igor Pančić, gazeta Pi kanal, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

Kur është fjala te reparacionet, mendoj se viktimat do të dëmshpërbleheshin më së miri nëse do të pranoheshin thjesht si viktimat njerëzore. Dhe, mendoj se një mënyrë e tillë e punës së Komisionit do t'i kontribuonte mjaft kësaj gjëje. (Nenad Popović, Këshilli për Iniciativë Qytetare, Serbi, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Nish, 25 prill 2009).

30. Konsultat lokale me shoqatat e viktimave dhe me organizatat joqeveritare për iniciativën KOMRA

**Srebrenicë, Bosnje e Hercegovinë
26 prill 2009**

Konsultat e dyta ne radhë në Bosnje e Hercegovinë i organizoi *Forumi i Qytetarëve të Tuzllës*. Në punime morën pjesë 35 përfaqësues të shoqatave të viktimave dhe të anëtarëve të familjeve të të vrarëve, të shoqatave lokale joqeveritare, një përfaqësues i shoqatës së të rinjëve, një studente dhe një gazetarë. Në konsulta mori pjesë edhe imami i Srebrenicës. Pjesëmarrësit kryesisht ishin nga Srebrenica, Bratunci dhe Zvorniku, dhe një përfaqësues i viktimave nga Vlasenica. Fjala hyrëse u mbajt nga Vesna Teršelić (Documenta, Kroaci), Bogdan Ivanisević (Qendra Ndërkombëtare për Drejtësinë në Transicion) dhe Branko Todorović (Këshillimi Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republika Srpska, BH), ndërkaq takimin e udhëhoqi Vehid Šehić (Forumi i Qytetarëve të Tuzllës, BH). Fjalimin inauguroes e mbajti edhe Amir Kulagić (anëtar i Këshillit Koordinues, Srebrenicë, BH). Raportuan Press, SAN, Dnevni Avaz, Oslobođenje, Dnevni List, Nezavisne Novine, Tuzlanski List, BHT1 dhe FTV.

Disa shoqata e përkrahën themelimin e KOMRA.

Unë jam këtu për që të duroj gjithë këtë dhe të them se duhet themeluar Komisionin rajonal KOMRA për shkak se, nën një, në atë listë do të futen të gjitha krimet, të zhdukurit, të vrarët nga radhët e popullit serb, dhe unë të paktën pjesërisht do të jem e kënaqur, nëse veç nuk e kam pasur kënaqësinë që të përgjigjej kushdo nga radhët e popullit bosnjak. (Radojka Filipović, Organizata Komunale e Luftëtarëve të Robëruar dhe të Vrarë dhe e Civilëve të Zhdukur, Bratunac, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

Iniciativasi iniciat ivë sigurisht se nevojitet, nëse e marrim definicionin se iniciativa është shpalosja e një problemi të caktuar dhe qasja ndaj atij problemi. Rruga për zgjidhjen e problemeve ka formën e saj. Kësaj mund t'ia shtojë vetëm edhe një porosi: se ilaçi është tableta që nganjëherë, derisa është në formën fillestare është shumë e ithët mirëpo rezultati i atyre tabletave dijnë edhe të shërojnë. (Dževad Bektašević, Shoqata Familjet e Viktimave të Luftës Vlasenica '92-'95, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

KOMRA duhet të përkrahët vetëm nëse merret edhe me shkaqet e konflikteve të armatosura.

Nëse do të mund të punohet në këtë, në çka unë vërtet ende dyshoj, atëherë a mund të formohet një Komision që vërtet do ta hulumtonte të vërtetën. (...) Dëshirojmë që të fillohet nga njerëzit udhëheqës, nga shkak i luftës, dhe nga ai që ishte agjikator i kësaj lufte. (Kada Hotić, Lëvizja e Nënave në Enklavat Srebrenica dhe Zhepa, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

Le t'i radhisim gjërat kronologjikisht ashtu që të gjithë së bashku të mund të vijmë deri te e vërteta, gjegjësisht edhe t'i radhisim deri në vitin 1995, sepse zakonisht atë pjesë (vitin 1995) e dimë të gjithë, por duhet ditur fillimi, gushti i vitit 1991, dhe në këtë kontekst, nëse punojmë në këtë mënyrë, unë mund ta jap përkrahjen time. (Hiba Ramić, Fondacioni Mezarje Bratunac '92, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

Është dashur t'i mbijetojmë gjithë këto vite prandaj edhe duam përgjegjësi, por përgjegjësi nga data e parë, nga krimi i parë. Fare nuk më intereson kombësia. Le të përgjigjet çdokush për veprën e keqe të tij, pavarësisht se çfarë kombësie ka. Por, në asnjë çast nuk do ta kapërcejmë asnjë datë dhe asnjë vrasje, asnjë krim të kryer, s'ka lidhje se ndaj kujt është kryer. (Raza Hrvačić, Organizata e Shehitëve dhe Luftëtarëve të Vrarë në Komunën Srebrenica, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

KOMRA duhet t'i verifikojë faktet për krimet në BH.

Të gjitha ato data, të gjitha ato ngjarje dhe vrasje, duhet të plotësohen me fakte të caktuara, ashtu që gjykatat dhe të gjitha organet hetuese të mund të sjellin aktgjykime adekuate. Prandaj, ja unë personalisht mendoj se kurrë nuk është vonë që faktet të vendosen në tavolinë dhe të bisedojmë për to, ashtu që në fund të mund të jetojmë më të qetë. (Mevludin Lupić, Shoqata e Familjeve e Personave të Robëruar dhe të Zhdukur të Komunës Zvornik, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

Duhet të krijohet një bazë e të dhënave dhe përveç të gjitha viktimave të identifikohen edhe të gjithë urdhërdhënësit dhe kryesit.

Pastaj, përveç identifikimit të viktimave, mungon edhe identifikimi i kryesve të krimeve. Ne po i identifikojmë viktimat, por le t'i identifikojmë edhe kryesit, le t'i lëmë prefikset dhe le t'i identifikojmë ata kryes të krimeve. (Dževad Bektašević, Shoqata Familjet e viktimave të luftës Vlasenica '92-'95, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

T'i japim përkrahje të plotë në punë jurisprudencës penale, që të gjithë kriminelët të kenë emër dhe mbiemër, që të krijojmë një bazë të dhënash dhe të kemi një numër, jo vetë numra por edhe emrat e mbiemrat e fëmijëve tanë. Të gjithë fëmijët e lindur kanë emër dhe mbiemër dhe numër të amzës. Kështu për një kohë do ta shkurtonim këtë garë apo datë se sa dhe ku janë bërë vrasje, e jo të mohohen, sikur që shpesh mohohen viktimat e gjenocidit në Srebrenicë. (Munira Subašić, Lëvizja e Nënave të Enklavave Srebrenicë dhe Zhepë, BH, Konsultat

Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

KOMRA duhet të mbledhë të dhëna për vendet e vrasjes së viktimave, të gjejë varrezat e fshehta masive dhe të hetojë ngjarjet që sollën deri te zhvendosja e viktimave nga varrezat masive primare në ato sekondare, apo terciare.

Përveç informacioneve për ngjarjet na nevojiten edhe informacione për vendet e kryerjes së krimeve, të ekzekutimeve, pushkatimeve individuale, dmth, për të gjitha ngjarjet. Informacionet për lokacionet primare të varrezave, pastaj informacionet për ngjarjet që i shkaktuan prishjen e atyre lokacioneve primare të varrezave masive të viktimave të varrosura, ose të atyre individuale. Në asnjë çast nuk e nënvlerësoj rëndësinë e varrezave individuale në raport me varrezat masive. Pra, informacionet për lokacionet sekondare apo terciare të atyre varrezave masive.. (Dževad Bektašević, Shoqata Familjet e viktimave të luftës Vlasenica '92-'95, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

Kërkimi i të zhdukurve duhet të jetë prioritet i Komisionit.

Meqenëse i përjetuam të gjitha këto tortura dhe të gjitha ato që po i përjetojmë sot, shtrohet pyetja se a do ta përjetojmë edhe gjetjen e më të dashurve tanë. Duke parë këtë material që e morëm për mbledhjen e sotme, për konsultat e sotme, dhe duke shikuar këtë numër prej 16,252 viktimave, të cilat ende qëndrojnë diku, ndoshta në qindra varreza masiv, nëse do të pyeteshja unë, prioriteti i parë sipas meje do të ishte gjetja e të gjithë të zhdukurve, pra e këtyre që janë pjesë e këtij numri. (Mevludin Lupić, Shoqata e Familjeve të Personave të Robëruar dhe të Zhdukur të Komunës Zvornik, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

KOMRA duhet t'i hetojë pohimet për tregtinë me organe të njerëzve gjatë konflikteve të armatosura në BH.

Kemi njohuri se në Milici janë marrë rreth 200 djem të rinj dhe se atyre iu janë marrë organet dhe gjaku. Se aty ishin ekipet dhe pajisja speciale, përmes të cilave merreshin ato pjesë nga djemtë e gjallë. Edhe kjo të hetohet, nëse është e vërtetë apo gënjeshtër. Sepse kështu si është, na dhemb. Unë

shpesh mendoj se fëmija im është rrjepur diku i gjallë dhe se ia janë nxjerrë organet për së gjalli. (Kada Hotić, Lëvizje e Nënave të Enklavave Srebrenica dhe Zhepa, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

Viktimat civile dhe ushtarake nuk mund të barazohen.

Shkatërrimi i popullatës civile nuk mund të krahasohet me të vrarët që bartnin pushkë dhe që i përkisnin formacioneve ushtarake, sepse sot po tentohet që të barazohen vrasjet edhe përmes numrave. E meqë nuk po mund të balancohet nga kjo luftë, po tentohet që diçka të zëvendësohet nga lufta e kaluar. (...) Pra, vetëm kush është civil, sepse kush është në ushtri, as që duhet përmendur, sepse ai megjithatë është pjesëtar i ushtrisë, e këto pastaj janë çështje tjera. Mirëpo, këtu ne bëjmë fjalë vetëm për civilët, për njerëzit që janë marrë dhe vrarë para pragjeve të veta, ose pak më larg, varet se kush ku e ka pësuar. (Hakija Smajlović, Shoqata e familjeve të Personave të Robëruar dhe të Zhdukur të Komunës Zvornik, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

Dhe, nuk mund të jenë viktimat të gjithë të vrarët në këtë luftë. Janë vrarë viktimat edhe me armë në dorë, e këto nuk janë viktimat, por viktimat janë ta që nuk kishin armë, por që ishin të pafuqishëm. Para së gjithash, edhe bota na ka cilësuar si viktimat, kur na ka vendosur embargon në armatim, kur na ka ndaluar që të mbrohemi nga fuqia e katërt ushtarake në Evropë. Ne jemi mbrojtur duarthatë. (Kada Hotić, Lëvizja e Nënave të Enklavave Srebrenica dhe Zhepa, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

Prefikset kombëtare janë të papranueshme edhe për viktimat edhe për kriminelët.

Është e papranueshme që me rastin e identifikimit të aplikohen prefikse kombëtare ndaj viktimave dhe ndaj trupave të identifikuar. Na duhet një qasje e barabartë ndaj viktimave. Të gjitha viktimat kanë emër dhe mbiemër. Viktimën duhet ta pranoj çdokush. (Dževad Bektašević, Shoqata e Familjeve të Viktimave të Luftës Vlasenica '92.-'95, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

Ju lutem, në këto takim gjithnjë i dëgjojmë definicionet e njëjta, termet e njëjta, por, ju lutem, e përse ne jemi viktimat në të vërtetë? E ka vendosur kushdo nga ne që të jetë viktimë vetvetiu? Mendoj se jo. Për t'u bërë viktimë, është dashur të ekzistojë krimi. Për të ekzistuar krimi, duhet të ekzistojë krimineli, pa këtë nuk ka viktimat. Ju lutem, me dhemb jashtëzakonisht shumë kur dëgjoj, prefiksin krimineli serb, kroat, boshnjak. (Amir Kulagić nga Srebrenica, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

Komisioni duhet të parandalojë që në dëgjimet publike të thuhet të pavërteta dhe që të krijohen mekanizmat përmes të cilëve do të pengohet akuzimi i rrejshëm i individëve.

Është fakt që kohëve të fundit shumë njerëz akuzojnë në bazë të disa gjërave të thëna, të cilat më vonë, pas dy apo tri vitesh, dalin se ishin thënë për shkak të ndonjë interesi të caktuar dhe se nuk bazoheshin në të vërtetën. Si të parandalohen këto gjëra? Unë personalisht njoh disa persona, nga njëri apo populli tjetër, të cilët i kaluan dy apo tri vjet në paraburgim, u morën në pyetje, dhe në fund u liruan për shkak të faktit se gjërat e caktuara që u thanë kundër tyre nuk ishin të sakta, ndërkohë që këta persona nuk kanë kurrfarë satisfaksioni për këtë gjë. Mendoj se këto janë gjëra shumë të ndjeshme dhe se këto dëgjime publike mund të prodhojnë kundërefekt. (Nedeljko Simić, Këshilli i të Rinjve të Srebrenicës, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

I mjerë është ai shtet në të cilin dënohesh dhe të turpërojnë për të vërtetën, ndërkohë që për gënjeshtëri shpërblehesh. Ne, fatkeqësisht, jetojmë në një ambient të tillë. Ky Komision dhe këto konsulta duhet t'i inkurajojnë njerëzit që të mund t'i thonë lirshëm, por me plotë përgjegjësi për atë që flasin, disa prej vrotimeve të tyre nga e kaluara. (Vehid Šehić, Forumi i Qytetarëve të Tuzllës, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

Është e nevojshme që nga vendet në shërbimet shtetërore të largohen personat që në mënyrë direkte apo indirekte morën pjesë në krime lufte.

Ajo që është dëshpëruese dhe që ne mjaft shpesh e theksojmë, e nëse ju kujtohet vitin e kaluar Këshilli

i Helsinkit madje pat nënvizuar se në disa institucione dhe sot punojnë individ që kanë marrë pjesë në shkeljet më të mëdha të të drejtës humanitare. Se disa prej tyre madje ndodhen edhe në poste të larta në polici, ushtri, nëpër parlamente, apo në pushtet në nivel lokal, dhe se i fshehin të dhënat për varrezat masive apo të dhënat tjera të rëndësishme për krimet e kryera gjatë luftës, duke demonstruar kështu përkrahjen ndaj ideologjisë së bazuar mbi pastrim etnik dhe mbi përndjekjen e njerëzve për shkak të përkatësisë së tyre etnike apo fetare. (Bran-ko Todorović, Këshilli i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republika Srpska, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

Për punën e KOMRA janë të rëndësishme arkivat e shtetit. Është shprehur shqetësimi se si KOMRA do të mund të vijë deri te këto dokumente.

Dhe, ju lutem, që e vërteta të mund të dëshmohet, pushtetet aktuale duhet të marrin pjesë aktivisht në këtë gjë dhe të japin kontributin e tyre. Ne nuk mund të kryejmë hetime për atë se çka ka ndodhur në luftë, sepse të gjitha janë të shkruara diku. Ai që i ka shënuar këto duhet edhe t'i tregojë. (Senad Avdić, Organizata e Luftëtarëve të Demobilizuar të Komunës Bratunac, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

I dimë ne të vrarët, e dimë ne se ka ende varreza, e dimë se po bëhen identifikimet, të gjitha këto janë duke u bërë, por janë fakte shumë të rëndësishme se e gjithë kjo na ka ardhur nga lartë. Kjo gjë ende fshihet. Kush do të na i lejoj neve që t'i kuptojmë këto gjëra. Në çfarë mënyre të detyrohen njerëzit, Këto janë fshehtësi, dhe atë fshehtësi të fshehura. (Kada Hotić, Lëvizje e Nënave të Enklavave Srebrenica dhe Zhepa, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

Është e nevojshme të shënohen vendet e vrasjes së viktimave.

Duhet t'i shënojmë vendet ku ka ndodhur krimi, pavarësisht se ku dhe si. Ashtu që t'i kemi, sepse duhet ta dimë që pikërisht këtë duhet ta bëjmë për ta. Sepse unë isha në Kroaci dhe e kam parë këtë dhe më ka pëlqyer shumë, sepse askush kurrë s'mund të mohojë diçka nëse është e shënuar. E nëse nuk është e shënuar ne edhe më të mund të flasim,

janë vrarë kaq e janë vrarë aq. (Munira Subašić, Lëvizja e Nënave të Enklavave enklava Srebrenica dhe Zhepa, BH, Konsultat Lokale me Shoqatat e Viktimave dhe me Organizatat Joqeveritare, Srebrenicë, BH, 26 Prill 2009).

31. Konsultat lokale me shoqërinë civile, me shoqatat e viktimave dhe me media, për iniciativën KOMRA

**Livno, Bosnje e Hercegovinë
9 maj 2009**

Në konsultat që i organizoi Qendra për Bashkëpunim Qytetar nga Livno prezentë ishin 16 pjesëmarrës nga Livno, Glamoč dhe Grahovo, përfaqësues të organizatave joqeveritare, medive dhe të shoqatave të viktimave, si dhe një përfaqësues i Mexhllisit të Bashkësisë Islame nga Livno, Fjalën hyrëse e mbajtën Vehid Šehić (Forumi i Qytetarëve të Tuzllës, BH), Eugen Jakovčić (Documenta, Kroaci) dhe Aleksandar Trifunović (Projekti Medial Buka, BH). Teksti për takimin u publikua në gazetën Dnevni List.

Shumica e pjesëmarrësve e mbështetën iniciativën KOMRA.

E përshëndes këtë iniciativë dhe jam për atë që të formohet një trup i tillë, por që kjo të mos [zgjas] deri në amshim. (Himzo Zlatarević, Shoqata e Llogoristëve në Glamoc, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Livno, BH, 9 maj 2009).

Ka ardhur momenti që... shikoni, tani këtu janë bashkuar viktimat, viktimat më të goditura.. E kur të bashkohet një numër i madh i viktimave të profileve të ndryshme – sepse krimi ndaj cilit, ndaj fëmijës është krim, kushdo që ta ketë vrarë dhe në çfarëdo hapësire - paraqet një shans që ata që i kanë kryer të mbështeten për muri. (...) Mendoj se është moment shumë i rëndësishëm që viktimat më të rënda të trimërohen për të vazhduar edhe me këso iniciativash. (Ale Kamber, Avaz, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Livno, BH, 9 maj 2009).

Është e nevojshme që për anëtarë të KOMRA të zgjidhen njerëzit më të mirë.

Në këto Komisione vërtet duhet të zgjidhen njerëzit e ndershëm. Shkencëtarët dhe historianët, lërin

anash të gjeth luftërat që bëjnë zhurmë, sepse secili luftëtar i ka pikëpamjet e veta. Ai e mbron vetveten. Ndërsa prej se mbahet mend është thënë se ai që e ka udhëhequr një luftë s'mund ta udhëheq një paqe. Ne jemi dëshmia më e mirë, në këtë BH, sepse asi luftëtarësh kemi që nga strukturat komunale e deri te ministrat, policia, parlamenti, e për Zotin, një pjesë e madhe e tyre pas vete tërheqin bishta aq të mëdhenj sa që s'mund t'i shpërlajnë kurrë. (Hajro Gromilić, gazeta Oslobodenje, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Livno, BH, 9 maj 2009).

Viktimat e kanë humbur besimin në drejtësi.

Askush askënd nuk e ka ftuar gjyq, që deklarohet para gjyqit, prandaj njerëzit edhe kanë hequr më dorë nga kjo gjë. Nuk duan që të flasin më për këtë. A kuptoni? Dhe, çka të bëjmë ne tani? Si të nisim zgjimin e ndërjegjes së këtyre njerëzve, ashtu që përsëri të dalin e të thonë atë që e tregonin më parë. (...) Askund ska këso dokumentesh dhe këso deklarata. , Nëse janë të ruajtura në Prokurorinë Publike unë nuk e di. E nuk e di as se cila është rruga për të kontaktuar me Prokurorinë Publike në Livno, dhe për t'i pyetur nëse ato dokumente janë atje. (Himzo Zlatarević, Shoqata e Llogoristëve të Glamoç, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Livno, BH, 9 maj 2009).

Nuk ka drejtësi për kriminelët. Nuk ka as në këtë luftë e as në atë luftë, kështu që as nuk do të ketë fare. O njerëz, ne jetojmë në iluzione, sepse nuk do të ketë drejtësi kurrë. Dijeni atë që po ju përsëritet vazhdimisht, se fqinji i parë, me të cilin keni ndarë të mirën e të keqen, korën e fundit të bukës, ju vjen nesër për t'ju prerë. A mos doli dikush atje dhe t'i tregoj mendimet e tij, të vendos një pikë diku... por jo, ja vjen ai, çfarë miku, çfarë kumbarë. Sa më duket mua, këta njerëz gjatë luftës në këto hapësira kanë definitivisht se i kanë sqaruar gjërat me vetveten. (Nurka Bašić, Shoqata Teledom Glamoç, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Livno, BH, 9 maj 2009).

Viktimat duhet të inkurajohen maksimalisht për të vazhduar në këtë proces.

Dhe, mendoj se në këtë moment është shumë e rëndësishme që të inkurajohen viktimat më të rënda, që të bashkohen – e më duket se këtë e kanë bërë tashmë. Të inkurajohen në kuptimin që ët vazhdojnë me iniciativa të tilla. Për njeriun normal dënimi moral është më i rëndë se ai juridik. (Ale

Kamber, gazeta Avaz, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Livno, BH, 9 maj 2009).

Duhet të shënohen dëshmitë për vrasjet, që të mos harrohen kurrë.

Angazhohem për atë që të paktën të punojmë sa të jetë e mundur që dëshmitarët e tillë ta dinë se dëshmitë e tyre, të paktën do të mbeten të regjistruara dhe të shënuara diku. (...) Prandaj dhe angazhohem në këtë punë. (Nurka Bašić, Shoqata Teledom Glamoç, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Livno, BH, 9 maj 2009).

Detyrë e të gjithë neve është që, sikurse që dëshmuat tani këtu, t'ua tregoni rrëfimin tuaj edhe aktivistëve që do të stërviten për mbledhjen e fakteve për hetime. Familjet e të vrarëve në këtë luftë, familjet e të zhdukuara, viktimat e krimeve, llogoristët, femrat e dhunuara, për të cilat dihet dhe për të cilat nuk dihet, fëmijët e keqtrajtuar, të gjithë ata duhet të tregojnë rrëfimet e veta. Në njëfarë mënyre, kur ata të fillojnë t'i tregojnë rrëfimet e tyre, të rrëfohen, kjo atëherë në njëfarë mënyre për ta paraqet edhe një lloj satisfaksioni moral. (...) Pra, kur të vdesin viktimat bashkë me to vdesin edhe rrëfimet e tyre. E për të mos vdekur rrëfimi, ne pra i kemi hyrë kësaj pune kaq të vështirë. (Željka Mihaljević, Radioja lokale, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Livno, BH, 9 maj 2009).

KOMRA duhet ta intervistojë secilin person që mund të ndihmojë në mbledhjen e dëshmive për krimet.

Komisioni do të duhej që të jetë një lloj trupi hetues, i cili duhet ta autorizojë intervistimin e secilit që në ndonjë mënyrë mund të ofrojë informacione relevante, por edhe që gjithashtu do të mbledhë dëshmi rreth institucioneve dhe individëve, rreth rolit të tyre në luftëra dhe rreth të gjithave që kanë ndodhur. (Eugen Jakovčić, Documenta, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Livno, BH, 9 maj 2009).

Duhet t'u ndërtohet një përmendore e përbashkët të gjitha viktimave civile në Bosnje e Hercegovinë.

Përse në BH të mos ndërtohet në një vend, kudo qoftë në një terren neutral, dhe përkundër gjithë këtyre përmendoreve ekzistuese, një përmendore e përbashkët për të gjitha viktimat civile. (Ale Kamber, gazeta Avaz, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Livno, BH, 9 maj 2009).

Një pjesëmarrës shprehu dyshimin se është e mundur arritja e një të vërtete të përbashkët për të vrarët në BH.

Jam skeptik për sa i përket formimit të Komisionit, sepse, sikurse që ju të tretë qëndroni aty ulur, dhe që Presidenca qëndron e ulur atje lartë, njësoj do të qëndrojë i ulur edhe Komisioni. Do t'i kemi tre njerëz, teri të vërteta. Pra, sipas meje, do t'i keni tri të vërteta. Dhe këtë që po e them unë, pastaj dikush mund të thotë që rezultatin pastaj ta ndajmë disi në tri pjesë dhe të shohim se cila është e vërteta dhe deri ku kemi ardhur me të vërtetën. (Sead Delalić, Shoqata e Llogoristëve Livno, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Livno, BH, 9 maj 2009).

Viktimat dhe kriminelët nuk duhet “të etiketohen” me përkatësi kombëtare, sepse çdokush ka emrin, mbiemrin dhe numrin e vet të amzës.

Viktimat dhe kriminelët kanë emër dhe mbiemër, madje kanë edhe numër të amzës. Nuk do t'i etiketojmë me prefiksin e përkatësisë së tyre kombëtare, por do t'i etiketojmë vetëm si kriminelë.. (...) Kriminelë, nëse dihen, duhet të emërohen me emër e mbiemër, dhe e njëjta gjë duhet bërë edhe me viktimat e tyre, sepse të gjitha dihen. (Jozo Vidočić, Shoqata e Familjeve e Mbrojtësve të Vrarë të Degës në Livno, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Livno, BH, 9 maj 2009).

Detyrë e të gjithëve duhet të jetë parandalimi i përhapjes së urrejtjes te gjeneratat e reja.

Detyrë e jona, jo vetëm e atyre që sipas vokacionit janë pedagogë, por edhe të gjithë njerëzve të vullnetit të mirë, duhet të jetë që me shpirt të pastër t'i mësojmë fëmijët që të mos na këndojnë këngë të urrejtjes. Kjo do të ishte një detyrë për të gjithë. Sepse, ata edhe nuk këndojnë aso këngësh ngase ajo urrejtje buron nga zemrat e tyre, ata nuk dinë asgjë për këtë punë, ata nuk dinë asgjë e ne pastaj hyjmë ‘në luftë’ me ta. E ai që hyn në luftë me rininë do ta humbë edhe ardhmërinë e vet. (Anto Mišković, Qendra për Bashkëpunim Qytetar, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Livno, BH, 9 maj 2009).

Duhet të identifikohen të gjithë kriminelët, sepse kjo gjë është një satisfaksion moral i viktimave.

Esenca qëndron në detektimin e kriminelit dhe nëse për asgjë tjetër, këtë satisfaksion moral tija japim viktimës. (...) Nuk ka viktimë të mëdha apo të vogla. Të

gjitha viktimat janë të barabarta. Para zotit të gjithë jemi të barabartë kështu që edhe viktimat do duhej të jenë të barabarta. Posaçërisht nëse bëhet fjalë për personin civil, plak apo fëmijë. (Mirsad Cero, Kuvendi i Bashkësisë Islame Livno, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Livno, BH, 9 maj 2009).

32. Konsultat kombëtare me shoqatat e viktimave dhe shoqërinë civile lidhur me iniciativën KOMRA

**Prishtinë, Kosovë
9 maj 2009**

Konsultat i organizoi Partners Kosova. Në konsultat kanë qenë të pranishëm 22 pjesëmarrës të cilët e kanë përfaqësuar kryesisht sektorin joqeveritar të Kosovës dhe shoqatat e viktimave. Në mesin e pjesëmarrësve kanë qenë edhe dy përfaqësues të Qeverisë së Kosovës (Komisioni për personat e zhdukur), një imam dhe një gazetare. Në diskutime kanë marr pjesë katër vëzhgues nga organizatat ndërkombëtare. Fjalët hyrëse i paraqitën Shukrije Gashi (Partners Kosova-Center for Conflict Management, Kosovë), Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi), Salem Čorbo (Kthimi dhe Mbijetesa e Qëndrueshme, BH) dhe Avni Melenica (Shoqata 22. Maji, Kosovë).

Pjesëmarrësit kishin mendime të ndara nëse në Kosovë është më me rëndësi që të krijohet Komisioni Kombëtar mbi të vërtetën (i cili më vonë, pasi të jetë formuar, do të bashkëpunonte me Komisionin rajonal KOMRA), apo që të përcaktohen për KOMRA.

Ky Komision Kombëtar do të jetë legal, e ne së shpejti do ti dërgojmë një letër Kryeministrit, Kryetarit të Kuvendit dhe Ministrisë së Drejtësisë Komisioni të themelohet këtu. [Sa i përket se] kush do ta themeloj, le të urdhëroj ky Komision dhe të bisedoj me themelesit, e ata janë Fondi për të Drejtën Humanitare, ata në Kroaci dhe në Bosnje. Ata le të bisedojnë me ta se cilat probleme duhet ti zgjidhim ne. Në të kundërtën, ne shoqatat, nuk do të bashkëpunojmë. (Halit Berisha, Shoqata Shpresimi, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Ne nuk do të pengojmë, mirëpo jemi shumë të rezervuar lidhur me anëtarësimin apo themeli-

min e këtij Komisioni mbi të vërtetën. Ne e dimë se Komisionet e tilla mbi të vërtetën kanë ekzistuar në shumë vende të cilat kanë pasur konflikte, dhe ato herë janë shuar e herë janë rimëkëmbur, përderisa Kosova është krejt e ndryshme nga vendet tjera. Mendoj se edhe ne në Këshill [Këshilli i shoqatave të familjeve të personave të zhdukur nga Kosova], ku marrin pjesë rreth 25 shoqata, gjithmonë e kemi ngritur zërin duke thënë që të formohet një Komision Kombëtar në nivel të Kosovës, do të thotë nga Qeveria e Kosovës, i cili Komision do të mund të punonte dhe të bashkëpunonte me të gjitha shoqatat, Fondin [për të drejtën humanitare] dhe gjithë të tjerët. (Ymer Mërlaku, Shoqata e Familjeve të Personave të Zhdukur nga Klina, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Iniciativa [KOMRA] është e mirë. Iniciativa kombëtare, e cila do të ishte shtetërore, është shumë e mirë. Të japim propozim mirëpo deri sa të themelohet ky Komision kombëtar, le të punojmë e jo të ndalemi. Propozimi është i mirë. Duhet të formohet Komisioni kombëtar, mirëpo të gjithë ne duhet të punojmë [në KOMRA]. Le të mbetet si iniciativë dhe si përfundim i kësaj konference, mirëpo prapë se prapë deri atëherë le të punojmë. (Shaban Terziu, OJQ Landsdowne, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Unë mendoj që nëse këtë ia lëmë në duar OJQ-ve të ndryshme dhe individëve nuk do të arrijmë shumë larg. Kjo është detyrë me të cilën duhet të merret një institucion qeveritar dhe ky Komision kombëtar i cili u përmend këtu, sepse do të ketë më shumë mundësi dhe besoj se ne duhet ta ndihmojmë këtë Komision në mënyra të ndryshme. (Sylejman Bytyqi, ish i dënuar politik nga Ferizaj, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Prandaj, unë edhe një herë dua shkurtimisht të theksoj, le të bëhemi organizëm kombëtar, në njërin fushë, le të punohet. Në fushën tjetër le të punohet edhe ky segment [REKOM], le të jenë dy segmente paralele por mos të ndërpritet puna. (Ruzhdi Jahari, Asociacioni i Familjeve të Viktimave, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Nëse veç bëhet në nivelin kombëtar, nuk do të mund ta evitojmë nevojën e të komunikimit me rajonin.

Nuk do të mund ta evitojmë. Le të jenë këto nevoja dhe le të vijë këto nevoja vetvetiu nga njerëzit të cilët punojnë në teren. Mos tu tregojmë atyre se për çka kanë nevojë ata. Dhe nëse kërkesa e tyre është që të qetësohen nevojat e tyre shpirtërore dhe psikologjike, kjo për mua është legjitime dhe duhet llogaritur me këtë. Pas të gjithave jam plotësisht e bindur se kur të themelohet Komisioni në nivel kombëtar, njerëzit do të jenë rehat dhe do të ndihen si pjesë e kësaj iniciative [KOMRA], kur të ndihen se janë të zotët e shtëpive të tyre, për shkak se problemi është më i madh seç mendojmë ne. Këtë që e kemi sot është problem nga e kaluara. (Eli Krasniqi, sociologe, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Tu jepet përkrahja njerëzve të cilët në mënyrë intensive flasin mbi rëndësinë e themelimit të Komisionit mbi të vërtetën në rajonin e Ballkanit. Rëndësinë themelore [Komisioni] e ka për viktimat, familjet, shoqëritë në përgjithësi që të mund të ecet përpara. Ka rëndësi të jashtëzakonshme edhe për marrëdhëniet në rajon dhe marrëdhëniet përbrenda Evropës. Evropa nuk ka pasur asnjëherë një iniciativë të tillë brenda territorit të saj, e cila do të nxirrte në pah një qasje tjetër të hulumtimit të së vërtetës, mirëpo edhe të krijimit të kushteve për pajtim. (Haki Abazi, Fondacioni Rockefeller Brothers, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Nëse themelohet një Komision rajonal, ai nuk do të udhëhiqet nga asnjë organizatë e cila është pjesë e këtij koalicioni në themelim KOMRA. Ne jemi disa organizata, disa njerëz të cilët besojmë në një bashkëpunim rajonal dhe duam të promovojmë, të ushtrojmë presion që ky Komision rajonal të ndodhë, sepse besojmë se ajo do të ratifikoj disa gjëra në të ardhmen. Ju lus të mos e centralizojmë këtë çështje [me themelimin e Komisionit kombëtar të Kosovës]. Komisioni nuk do të udhëhiqet nga shoqëria civile. Do të udhëhiqet nga njerëzit më të besueshëm në botë dhe në Ballkan, kështu që besoj në bashkëpunimin rajonal. (Kushtrim Koliqi, Integra, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Bosnja dhe Hercegovina ka qenë dy herë iniciator për formimin e Komisionit kombëtar boshnjak. Dy herë! Asnjëherë nuk ka pasur sukses për shkak se objektivisht në Bosnje dhe Hercegovinë nuk mund të arrihet te e vërteta dhe faktet, po që se ne këtë nuk

janë të përfshirë edhe kroatët dhe serbët. Për shkak se shumica e autorëve, urdhërdhënësit, vendim-marrësit, formacionet, policia, ushtria, kanë qenë nga Serbia. Prandaj kjo nuk mund të përcaktohet në nivel kombëtar. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Mandati është i rëndësishëm për funksionimin e Komisionit. Mandati i plotë, sepse ne mund të ta organizojmë Komisionin mirëpo varet se çfarë mandati kemi dhe sa mund të jemi funksional, përdërisa Komisioni Rajonal ka shumë më shumë kompetenca dhe njihet nga të gjitha institucionet. Prandaj, ideja e themelimit të Komisionit Rajonal është shumë më e logjikshme. (Ylber Maxhuni, Youth step, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Përse qasja rajonale? Ne kemi tentuar disa herë ta fitojmë Komisionin komunal mbi të vërtetën dhe për pajtim në Bijelinë dhe e kemi fituar. Dhe pastaj a e dini se çka ka ndodhur? Qeveria gjithmonë ju befason. Në Komision zgjedhin njeriun i cili ka qenë komandant i kampit internues në Batkovic, afër Bijelinës. Dhe ai ua bënë të pamundur të gjitha institucioneve dhe shoqatave të pajtohen me një nënçmim të tillë, të marrin pjesë në punën e këtij Komisioni. (Salem Corbo, Kthimi dhe Mbijetesja e Qëndrueshme, BH, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Sektori civil i Kosovës duhet të konsolidohet brenda vetes dhe të ketë një qëndrim me Qeverinë, e pastaj të përkrahë themelimin e Komisionit Rajonal.

Fillimi do të duhet të përfshinte konsultat dhe konsolidimin dhe të merret një qëndrim brenda shoqërisë civile e para se gjithash me qeverinë brenda Kosovës. Kur të vij koha dhe kur të shuhet të gjitha kundërthëniet, të themelohet Komisioni Rajonal, respektivisht të konsolidohen radhët e sektorit civil në bashkëpunim dhe koordinim të plotë me Qeverinë, e cila mund të ndihmojë shumë në konsolidimin e radhëve të sektorit civil në Kosovë, i cili është ende i rezervuar. (Mazlum Baraliju, Fakulteti Filozofik në Prishtinë, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Përkrahja e sektorit civil është e domosdoshme për themelimin dhe punën e KOMRA.

Çfarëdo qoftë struktura dhe përbërja e Komisionit, ai nuk do të ketë sukses pa përkrahjen e shoqërisë civile, respektivisht organizatave joqeveritare. Për arsye se organizatat joqeveritare shtrihen në rajone të caktuara dhe shërbejnë si mjet themelor, plotësisht të pa zëvendësueshme për të arritur deri tek viktimat, deri te të goditurit. E siç dihet, roli i Komisionit është që të merret me trajtimin e viktimave, qoftë me gjetjen e personave të zhdukur qoftë me ofrimin e ndihmës materiale për viktimat e goditura të cilat kanë humbur më të dashurit e tyre, dhe sot askush nuk merret me ta dhe me risocializimin e tyre. (Ylber Maxhuni, Youth step, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Mandatin e Komisionit duhet ta propozojnë viktimat dhe shoqëria civile, ndërkaq shtetet duhet ta themelojnë KOMRA.

Më pëlqen që presidenti i vendit dhe kryeministri kanë përkrahur themelimin [KOMRA], e që ne këtu jemi si propozues të Komisionit për përcaktimin dhe tregimin e të vërtetës, për shkak se në fakt këto Komisione themelohen nga ana e shtetit, dhe pikërisht shteti është ai i cili ua përcakton mandatin dhe qëllimet, ua kufizon veprimtarinë dhe e autorizon Komisionin. Shteti është ai cili duhet të pranojë rekomandimet të cilat do të duhej të ishin pjesë përbërëse e raportit përfundimtar të Komisionit. (Avni Melenica, Shoqata e Familjeve të Personave të Zhdukur, 22 Maj, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Disa pjesëmarrës kanë shprehur dyshimin se po keqpërdoret përkrahja e politikbërësve kosovarë ndaj iniciativës KOMRA. Me këtë nuk u pajtuan të gjithë të pranishmit.

Më duket sikur po politizohet pak përkrahja formale, e kisha thënë ndoshta edhe përkrahja individuale e përfaqësuesve të institucioneve tona. Ju lutem, unë konsideroj që shumica e prijësve tanë shtetëror, me gjithë respektin për pozitën të cilat ata i mbajnë, nuk kanë përvojë në ballafaqimin me vuajtjet e popullit të Kosovës, nuk janë në nivel të detyrave të tyre, nuk janë të përgjegjshëm dhe nuk janë për tu falënderuar, prandaj ne kemi bartur tek burrështet-

asit tanë propozimet, kritikën dhe kërkesën tonë të jenë të kujdesshëm se kënd dhe çfarë po përkrahin, siç e kanë ata shprehur, pasi i dëmtojnë proceset, dëmtojnë aktivitetet humanitare. (Haki Kasumi, Këshilli për Koordinimin e Shoqatave të Familjeve të Personave të Zhdukur në Kosovë, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Gjithmonë do të ketë përkrahje nga Qeveria e Kosovës, e në këtë rast, përkrahja e Komisionit qeveritar për personat e zhdukur, gjitha iniciativave të cilat do të kontribuonin zgjidhjes së fatit të personave të zhdukur. Kjo është një brengë e përgjithshme e shoqërisë, që paraqet edhe një prioritet të Qeverisë së Kosovës. (Kushtrim Gara, Komisioni për Personat e Zhdukur të Qeverisë së Kosovës, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Mendoj se në këtë moment ne nuk kemi kërkuar kurrfarë përkrahje politike për themelimin e Komisionit, sepse kjo do të ndodhë tek pas dy vitesh. Ne si iniciator, si pjesëtarë të Koalicionit, kërkojmë nga politikë bërësit përkrahje për këtë iniciativë në nivelin e bashkëpunimit rajonal, në nivel të qasjes rajonale ndaj kësaj çështje, përveç tjerash edhe për të zhdukurit dhe vërtetimin e fakteve mbi krimet e luftës. Vetëm pasi ti përfundojmë këto konsulta, kur ta krijojmë këtë model të Komisionit, ne shoqëria civile, ne do të shkojmë nga Qeveritë dhe Kuvendet, dhe tek atëherë vjen vërtetë njëfarë vendimmarrje e tyre lidhur me këtë. (Natasa Kandic, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Komisioni duhet të merret me krime nga e kaluara e afërt, të ketë kornizë të definuar kohore dhe hapësimore, dhe të merret ekskluzivisht me krime masive e jo individuale.

Këto komisione duhet të merren me krimet e kryera në të kaluarën e afërt, sepse këto komisione do të përqendrohen në deklaratat e dëshmitarëve, viktimave dhe aktorëve të krimit. Për të funksionuar më shpejt, më sakët dhe në mënyrë më kualitative, Komisioni duhet saktësisht ta dijë se çka do të bëjë, në çka do të përqendrohet, dhe të ketë hapësirë qartësisht të definuar kohore dhe rajonale, në të cilat do të punojnë komisionet e përmendura. Komisioni duhet të merret me krimet e rënda, më sakët me krimet në të cilat kanë pësuar numër i madh njerëzish, sepse nuk është

në fokus të Komisionit të merret me krimet individuale. (Avni Melenica, Shoqata 22 Maji, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Ndihma financiare dhe dëmshpërblimet duhet të drejtohen nga viktimat, e jo si deri më tani nga pjesëmarrësit e luftës.

Dëmshpërblimet në të gjitha shtetet duhet të drejtohen kah viktimat. Përparësi e shumëfishtë i është dhënë popullatës së luftëtarëve, gjë që unë e kuptoj, mirëpo në mënyrë absolutisht të padrejtë është anashkaluar popullata e viktimave, familjeve të viktimave, sidomos nëse janë vrarë mbajtësit e familjes, me që rast familjet janë sjellë në situata jashtëzakonisht të rënda dhe dramatike. (Salem Corbo, Shoqata Kthimi dhe Mbijetesë e Qëndrueshme, BH, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Është e domosdoshme të ndryshohet qëndrimi ndaj dëshmitarëve të krimit në rajon.

Tre marka është shujta të cilën e paguan gjyqësori i Bosnjës dhe Hercegovinës nëse dëshmitari vjen nga Bjelina në Sarajevë. Nuk u pranohet shpenzimet e rrugës. E dini, në mënyrë deklarative të gjithë dëshirojnë që fajtorët të dënohen, mirëpo në praktikë shumë nga ata shkaktojnë opstrukcione të ndryshme, mohojnë të gjitha orvatjet e sektorit jo qeveritar, e shumë më e qartë do të jetë nëse e kujtoni se në vendet kyçe Bjelinë janë absolutisht të njëjtit njerëz të cilët kanë qenë aty në periudhën e viteve nga '92 deri '95, duke filluar nga policia e më tutje. (Salem Corbo, Shoqata Kthimi dhe Mbijetesë e Qëndrueshme, BH, Konsultat kombëtare me shoqatat e viktimave dhe shoqërinë civile, Prishtinë, 9. Maj 2009.)

Në konsultat në Kosovë duhet ftuar edhe shoqatat e veteranëve shqiptarë edhe ato të serbëve nga Serbia.

Apeluj të ftohen: Shoqata e Veteranëve të Luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit dhe Shoqata e Familjarëve të Luftëtarëve të Rënë. Duhet të thirren edhe shoqatat tjera të ish veteranëve të luftës, shoqatat e luftëtarëve të rënë, dhe që në këto konferenca (tryeza) të thirren edhe shoqatat nga Serbia. Kamë marr pjesë në Jahorinë në Sarajevë kur një ushtar rezervist nga zona e Kara-

dakut më ka dhënë shumë informata. Kemi biseduar pse ata nga Serbia nuk thirren që të japin informata konkrete. Ai ishte nga Surdulica dhe këto të dhëna ishin konkrete, me shumë kuptim dhe plotësisht të vërteta. (Shaban Terziu, Landsdowne, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Gjetja e personave të humbur duhet të jetë parakusht për Komisionin e përbashkët me Serbinë.

Kur të themelohet Komisioni, Serbia duhet ti plotësoj disa kushte, që të gjendet edhe personi i fundit i zhdukur. Që të gjithë ata kriminel të sillen para drejtësisë, që të paguajnë dëmshpërblimin për njerëz dhe dëmin e shkaktuar material. Pastaj do të vije deri te themelimi i këtij Komisioni. Komunitat Gllogoc dhe Skenderaj ende i kanë mbi 300 persona të zhdukur. Familjet kurrë nuk do të pajtohen që të vije deri te kjo për të cilën ne po mendojmë. Familjet po i kërkojnë të afërmit e tyre. (Xhafer Veliu, Shoqata Pengu i Lirisë, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Është e nevojshme që bashkësitë fetare të marrin pjesë në konsultat e iniciativës KOMRA.

Bashkësitë fetare gjithsesi të thirren dhe nëse njëherë nuk vijnë mund të vijnë në takimin e radhës. (Mazllum Baraliu, Fakulteti Filozofik në Prishtinë, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

Në punën e Koalicionit për KOMRA duhet të përfshihen edhe psikologët social, për shkak se traumat e njerëzve janë shumë të mëdha.

Dhembja është shumë e madhe e edhe traumat janë shumë të mëdha. Pikërisht ky është një element për shkak të cilit nganjëherë e humbim drejtimin që të ndërtojmë diçka pragmatike, diçka që u nevojitet të gjithëve. (...) Prandaj në këtë aspekt, mendoj se është më se e nevojshme që të kemi njerëz të cilët për një kohë të gjatë janë marr me çështjet e traumave dhe njerëz të cilët janë psikolog social, për shembull, pasi që ne kemi shumë organizata dhe individ të cilët kanë punuar dhe të cilët janë shumë të mirë në këtë drejtim. (Eli Krasniqi, Sociologe nga Prishtina, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Shoqatat e Viktimave dhe me Shoqërinë Civile, Prishtinë, 9 maj 2009).

33. Konsultat Kombëtare me artistët lidhur me iniciativën KOMRA

**Prishtinë, Kosovë
10. Maj 2009.**

Konsultat me artistët lidhur me Iniciativën KOMRA i ka organizuar Nisma Rinore për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (YIHR) nga Prishtina, anëtare e Koalicionit për KOMRA. Morën pjesë 10 artist, kryesisht artist të artit dramatik, nga të cilët shumica janë aktiv në organizata joqeveritare, dhe 22 vëzhgues, numri më i madh nga YIHR, dy nga organizatat ndërkombëtare dhe një vëzhgues nga ambasada Zvicerane. Në konsulta morri pjesë një gazetar. Fjalën hyrëse e paraqitën Natasa Kandic (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi), Haris Pasovic (regjisor teatri nga Sarajeva, BH), dhe Salem Corbo (Kthimi dhe Mbijetesa e Qëndrueshme, BH). Raportoi Koha Ditore.

Së pari është e nevojshme të formohet Komisionin Kombëtar i cili më vonë do të bashkëpunonte me Komisionin Rajonal.

Nuk kam kurrfarë vërejtje për iniciativën, me kusht që ajo të themelohet në një kontekst real, me themelimin e Komisionit të Kosovës, i cili do të koordinohet në njëfarë mënyre me komisionet e ngjashme apo më mirë të them, ndoshta do të formohet ndonjë komision për pjesët tjera të ish Jugosllavisë. Do të ishte shumë më funksionale në kontekstin se pse ndodhi lufta në Kosovë. Këtu ka ndodhur lufta, e të gjithë e injoruan faktin se ka ekzistuar okupimi që nga viti 1989 ku morën pjesë të gjitha vendet e ish Jugosllavisë. Forcat federative kanë qenë të përbëra nga të gjitha viset e ish Jugosllavisë. (...) Me vendin me të cilin kemi qenë në luftë edhe gjende mi në njëfarë lufte të papërfunduar. (Albert Heta, Stacion, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Artistë, Prishtinë, Kosovë, 10 maj 2009).

Kjo ka qenë punë, Shqiptar, duhet të bartësh. Kjo është e rrënjësuar në kujtesën tonë. Ne e dimë se në çfarë mënyre është shfrytëzuar kujtesa kolektive. Kjo është ende e freskët në kujtime. Beteja e Kosovës dhe ndërtimi i politikës e cila e krijoj betejën e Kosovës dhe në bazë të së cilës më vonë u hartuan planet e shfarosjes. (...) Komisioni Kosovar apo iniciativa rajonale. Përse? Në praktikë kjo duket e njëjtë, mirëpo në mendjet e njerëzve, ky imazh është shumë i rëndësishëm, sepse Kosova nuk ka qenë

republikë, i është dhënë autonomia e cila më vonë iu morr. Pas numrit të madh të viktimave njerëzore, (...) njerëzit dëshirojnë ta ndiejnë se janë të zotët e vetvetes, të zotët e vendit tyre. Dëshirojnë ta posedojnë atë. (Eli Krasniqi, Sociologe, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Artistë, Prishtinë, Kosovë, 10 maj 2009).

Qasja rajonale krijon hapësirë për sqarimin e shumë krimeve të pandriçuarra dhe pranimin se ato kanë ndodhur.

Unë jetoj në Bijelinë. Me 1. Prill në mëngjes arritën njësit nga baza e Erdutit dhe thjesht sulmuan qytetin duke vrarë numër shumë të madh civilësh. Në mënyrë selektive janë vrarë një numër i madh i Shqiptarëve. Kjo është pësimi më i madh i shqiptarëve në Bosnje dhe Hercegovinë në luftë, gjatë luftës për Bosnjën dhe Hercegovinën. Trupat e tyre menjëherë u janë dërguar familjeve të tyre në rrethinën e Tetovës, shumica e tyre edhe në vende tjera. Ata janë varrosur pa obduksion, pa gjetje mjekoligjore. Tani vetëm familjet e tyre e dinë se ata janë vrarë në Bjelinë, në Prill të vitit '92. Nuk ka njohuri për këtë. Nuk ka procedura të nisura ligjore (...) Disa [trupa] janë transportuar dhe janë varrosur, të tjerat janë hedhur përgjatë Drinës dhe varrosur përgjatë varrezave nga Mitrovica e Sremi e gati deri në Beograd (...) Ky Komision do ta plotësonte gjithë këtë mund të sektorit civil për të arritur deri te të dhënat. (Salem Corbo, Shoqata Kthimi dhe Mbijetesë e Qëndrueshme, BH, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Artistë, Prishtinë, Kosovë, 10 maj 2009).

Në Serbi ekziston mohimi i krimeve të luftës. Nëse ne nuk bëjmë asgjë, nëse nuk angazhohemi që të konstatohen faktet, që ato fakte të pranohen kur të konstatohen dhe të fitojnë një kontekst regional, atëherë ky është një presion shumë i fort në qeverinë serbe që të mos mund ti mohoj. (...) Nëse ky konstatim i fakteve në të cilin do përfshihet i gjithë rajoni duke ndihmuar, shtyrë këtë qeveri jodemokratike serbe që ta ndërpres mohimin, kundërshtimin, heshtjen, atëherë çka mund të bëjë Kosova, përmes njëfarë Komisioni kosovar. Keni pasur komisionin më të mirë që ndonjëherë ka mundur ta ketë dikush – Komisionin e Goldstonit. Askush, asnjëherë në botë nuk e ka pasur Komisionin e Goldstonit. Keni para Tribunalit të Hagës aktgjykimet e kreut të policisë dhe ushtrisë serbe. Do të thotë ju jeni të njohur ndërkombëtarisht si viktimë. Nuk ka kurrfarë kontesti. Mirëpo ajo që ne dëshirojmë, ne nga Serbia,

nga Kroacia, ne nga organizatat për të drejtat e njeriut – dëshirojmë që kjo të bëhet e ditur publikisht. (Natasa Kandic, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultat Kombëtare me Artistë, Prishtinë, Kosovë, 10 maj 2009).

Kosova, deshi apo jo, duhet të jetë pjesë përbërëse e këtij Komisioni për arsye se edhe nëse i krijojmë komisionet kombëtare, dhe nëse kemi viktimë në Serbi, si mundemi ne si komision të shkojmë në Serbi dhe ti kërkojmë viktimat. Edhe ne duhet të bashkëpunojmë me dikën. (Nora Ahmetaj, aktiviste për të drejtat e njeriut, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Artistë, Prishtinë, Kosovë, 10 maj 2009).

Unë e kuptoj frustrimin i cili është plotësisht i arsyeshëm, që pse futbollistët kosovar nuk mund të luajnë në Beograd. Unë mendoje kjo është e padrejtë. Mirëpo mendoje mënyra për të arritur deri te ndeshja ndërmjet reprezentacionit të Serbisë dhe Kosovës është pikërisht një iniciativë e këtyllë. (...) Mos krijoni ju, të cilët keni qenë viktimë të betejës së Kosovës – mitit, të krijoni një mit tjetër dhe të keni Betejën shqiptare të Kosovës, nga e cila do të pësojnë njerëz të tjerë. (Haris Pasovic, regjisor teatri nga Sarajeva, BH, Konsultat Kombëtare me Artistë, Prishtinë, Kosovë, 10 maj 2009).

Këtu ka njerëz të cilët thonë se nuk ka pasur viktimë serbe, as edhe një të vetme. Prandaj është shumë e rëndësishme, sipas mendimit tim për çka edhe e përkrah idenë e formimit të këtij Komisioni, që të dëgjohet e vërteta në nivel rajonal, që dikush në Shumadi, një fshatar nga Shumadia të njoftohet për viktimitën nga burgu i Dubravës, që ti tregohet se si forcat serbe kanë vrarë të burgosurit. (Bekim Blakaj, Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë, Kosovë, Konsultat Kombëtare me Artistë, Prishtinë, Kosovë, 10 maj 2009).

Artistët e kanë të vështirë të gjejnë motiv për tu marrë me temën e luftës dhe është e nevojshme që të punohet në drejtim që edhe ata të inkua-drohen në këtë iniciativë.

Ka ekzistuar njëfarë dekurajomi i artistëve për tu marrë me temën e luftës, për shkak se ka ndodhë politizimi. Të mos themi shumica, por disa nga artistët të cilët janë marrë me këtë fenomen kanë qenë të politizuar apo janë politizuar, kështu që kjo vërtetë është dekurajuese për ne. (Zana Hoxha Krasniqi, regjisore nga Kosova, Konsultat Kombëtare me Artistë, Prishtinë, Kosovë, 10 maj 2009).

Ndoshta edhe artistët mund të inkuadrohen në njëfarë mënyre në këto aktivitete duke u krijuar hapësirë njerëzve që të flasin, për shkak se kjo është më e mira për ta. Kjo është e drejtë e tyre, kështu do ta qetësojnë vetveten, e ndoshta më vonë mund të fitojnë edhe ndonjë dëmshpërblim material. Me këtë rast, në këtë kontekst, ndoshta do të duhej të kemi pak më shumë donacione për aktivitete artistike, për shfaqje, për film apo diçka të ngjashme. (Visar Krusha, dramaturg nga Kosova, Konsultat Kombëtare me Artistë, Prishtinë, Kosovë, 10 maj 2009).

Është e nevojshme që të ushtrohet presion në publik përmes radios dhe presion në qeveritë rajonale përmes bashkësisë ndërkombëtare, që të themelohet KOMRA.

Unë megjithatë mendoj që duhet të ushtrohet presion përmes mediave, me qëllim që vetëdija e publikut të njoftohet me thelbin e këtyre tendencave tona, e në anën tjetër mendoj që cak më i mirë do të kishte qenë Bashkësia Evropiane dhe Zyra e Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ata duhet të ushtrojnë presion në qeveritë tona me qëllim të themelimit të një Komisioni të tillë. (...) Këto janë gjëra të cilat nxirren me vendim të Qeverisë, e për këto vendime duhet, nëse mundemi, të ushtrojmë presion mbi evropianët dhe amerikanët, që ti detyrojnë ata të bëjnë diçka. Për shembull, ti thuhet Tadiçit "e besa nuk do të jap më para" apo "nuk do ta merrni vizën për Evropë deri sa nuk e bëni këtë", gjë që ata do të detyrohen ta bëjnë. Kështu bëhet kjo punë. (Petrit Çarkaxhiu, Oxygen, Konsultat Kombëtare me Artistë, Prishtinë, Kosovë, 10 maj 2009).

34. Konsultat Lokale me shoqërinë civile lidhur me iniciativën KOMRA

**Prijedor, BH
13 maj 2009**

Organizator i këtyre konsultave lokale ishte Shoqata Izvor Prijedora. Pjesëmarrës ishin 23 përfaqësues të bashkësisë lokale të Prijedorit dhe rrethinës, si dhe pesë vëzhgues, dy nga të cilët nga OSBE. Fjalën hyrëse e paraqitën Edin Ramulic (Shoqata Burimi i Prijedorit, BH), Vesna Terselic (Documenta, Kroaci), Bogdan Ivanisevic (Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale) dhe Branko Todorovic (Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republika Srpska, BH).

Paralajmërimin e ngjarjes e botoi Kozarac.ba.
Pjesëmarrësit përkrahën iniciativën KOMRA.

Në emër të shoqatës së cilës i takoj, sigurisht që e përkrah këtë iniciativë për themelimin e KOMRA, andaj edhe më tutje jemi në dispozicionin tuaj me të gjitha kapacitetet tona, të cilat janë ato që janë. (Sudbin Music, Shoqata e të Internuarve Prijedor 92, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Prijedor, BH, 13 maj 2009).

E përkrahi këtë iniciativë dhe konsideroj që një ditë kjo do të jetësohet në formën e Komisionit Rajonal për përcaktimin e fakteve. (Sabahudin Garibovic, Shoqata e të Internuarve Kozarac, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Prijedor, BH, 13 maj 2009).

Përsëritës iniciativën për themelimin e Komisionit dhe më vjen mirë që gjendem sot këtu në mesin tuaj. Të gjithë ata që gjenden këtu janë të gatshëm ta flasin të vërtetën, të ballafaqohen me te dhe kështu të kontribuojnë që ardhmëria e fëmijëve tanë të jetë më e mirë se që është tani. Për këtë arsye edhe ekziston nevoja e themelimit të Komisionit. (Senka Jakupovic, Shoqata DIAKOM, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Prijedor, BH, 13 maj 2009).

Mendoj se të gjithë ata të cilët ende kanë dyshime, ose të cilët dëshirojnë të fusin ngatërresa në punën e këtij Koalicioni, vërtet më mirë e kanë të heqin dorë. Le të mbetet ky një koalicion pozitiv, do të thotë një proces pozitiv, ndoshta më pozitiv në këtë shtet dhe në rajon, dhe natyrisht le ti bashkëngjiten njerëzit të cilët vërtet me ndershmëri mendojnë të marrin pjesë dhe të ndihmojnë në gjithë këtë. (Sefika Muratagic, Çelësi i Ardhmërisë, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Prijedor, BH, 13 maj 2009).

KOMRA duhet të ndihmojë në zgjedhjen e fatit të personave të zhdukur.

Burri im gjithashtu u morr në vitin 1992, dhe para një viti gjeta një pjesë të eshtrave të cilat i kemi mbledhur për një kohë të gjatë dhe i kemi varrosur siç duhet. Prej atëherë, prej kur i varrosëm eshtrat, kemi vendin ku mund të shkojmë unë dhe fëmijët e mijë. Dhe kemi gjetur njëfarë qetësie. Dhe shumë më brengosë puna e të gjithë atyre të cilët kërkojnë të zhdukurit e vet, ta përjetojnë atë lehtësim pas gjithë atyre viteve dhe ta dinë ata fëmijë ku e kanë anëtarin e familjes, pa marrë parasysh cili është ai. Jam shumë e interesuar për këtë Komision. (Senka

Jakupovic, Shoqata DIAKOM, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Prijedor, BH, 13 maj 2009).
Prioritet i Koalicionit duhet të jetë fitimi i besimit të viktimave.

E ne duhet të fitojmë besimin e të gjithë atyre të cilët e dinë të vërtetën, të cilët janë viktima, për të na i treguar neve ato. E besimin do ta fitojmë vetëm nëse ne e flasim të vërtetën. Le të mos presim përkrahje nga politikat. Neve na duhet ai popull i cili i ka përjetuar ato që i ka përjetuar dhe e vërteta e tyre, e politikë bërësve do tu imponohet kështu që ata gjithë këtë do ta pranojnë më vonë. (Senka Jakupovic, Shoqata DIAKOM, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Prijedor, BH, 13 maj 2009).

KOMRA duhet t'ju mundësojë viktimave që të tregojnë se çka u ka ndodhur, dhe kjo të bëhet pjesë e historisë sonë.

Dikush jeton në Bijelinë, ku jetoj edhe unë, dhe ndoshta kurrë nuk do të marr vesh për diçka që ka ndodhur në Livno, qoftë këtu në Prijedor apo në disa vende të tjera. Për këtë arsye (...) ky Komision duhet ta japë mundësinë që dikush si viktima të vijë dhe të dëshmojë e të thotë saktësisht se çka, ku, kur dhe si i ka ndodhur. Të mbetet një gjurmë në ato dokumente të cilat megjithatë do të mbesin jo vetëm pjesë e historisë, por edhe pjesë e ekzistencës sonë. (Branko Todorovic, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Republika Srpska, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Prijedor, BH, 13 maj 2009).

Shoqatat e viktimave kanë fuqi morale të jenë pjesëmarrës aktiv në konsultat dhe që maksimalisht ta përkrahin themelimin e KOMRA.

Përfaqësuesit e shoqatave të viktimave të luftës arrijnë nivelin më të lart të konsensusit dhe të dakordimit. Përse? Sepse ata kanë fuqinë më të madhe morale dhe çdo fuqi tjetër për të qenë pjesëmarrës aktiv të këtij procesi dhe ti japin përkrahje maksimale këtij projekti. Prandaj është për tu pritur se do të arrihet deri te një qëllim, të cilin, shpresoj, të gjithë sinqerisht e pretendojmë. (Nedeljko Mitrovic, Organizata Republikane e Familjeve të luftëtarëve të Vrarë apo të Zënë Rob dhe Civilëve të Zhdukur të Republika Srpska, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Prijedor, BH, 13 maj 2009).

KOMRA hapë mundësinë që rastet e gjykuara të kontrollohen në kontestin e të dhënave dhe dëshmive të reja.

Atje ku disa njerëz janë liruar nuk është kundërshtuar nga ana e gjyqit se janë kryer krime, bile ato krime janë përshkruar shumë hollësisht. Do të thotë, në këtë domen, nëse dikush konsideron se këtu aktgjykimet kanë dështuar, se është bërë ndonjë lëshim apo diçka është identifikuar si krim, e që në të vërtetë nuk është, aty ka hapësirë për KOMRA, që të rishikoj nëse ka informata të reja. (Bogdan Ivanisevic, Qendra Ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Prijedor, BH, 13 maj 2009).

Shumica e aktgjyqimeve ka vend për plotësime. Për fat të keq, shumica e këtyre aktgjyqimeve nuk kanë përcaktuar me emra të gjitha viktimat e atij krimi të cilin e kanë proceduar, e sidomos nuk i kanë proceduar të gjitha faktet tjera të cilat kanë të bëjnë me pjesimet e këtyre njerëzve. (Edin Ramulic, Shoqata e prijedorasve Izvor, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Prijedor, BH, 13 maj 2009).

Duhet pasur kujdes që iniciativa KOMRA të mos politizohet.

Para së gjithash, mendoj se do të pajtoheni të gjithë me këtë, se i gjithë projekti duhet të jetë i depolitizuar. Kjo nuk do të thotë që ne mos ti përfshijmë institucionet politike. Pa to sigurisht se nuk mundemi. Mirëpo kur them i depolitizuar në kuptimin e politik bërjes, manipulimit. (Nedeljko Mitrovic, Organizata Republikane e Familjeve të Luftëtarëve të Vrarë apo të Zënë Rob dhe e Civilëve të Zhdukur e Republika Srpska, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Prijedor, BH, 13 maj 2009).

Është e nevojshme të theksohen pikat e pajtimit të pjesëmarrësve në procesin këshillues, e mos të theksohen pikat e ndarjes.

Kisha thënë sot, këtu, me siguri se KOMRA është trup i cili është momentalisht motiv apo Iniciativë e të gjithë neve. Sa ka në cilën kokë motiv, iniciativë dhe vullnet nuk duhet analizuar tani. Nuk duhet krijuar parakushte për ndarje por parakushte për verifikimin e vullnetit, që si grup të fillojmë të punojmë në këtë duke përdorur metodologjinë e cila do të kënaqte gjithçka që nuk provokon pakënaqësi. (Enes Alibegovic, Shoqata e Viktimave Civile të Luftës, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Prijedor, BH, 13 maj 2009).

Për disa pjesëmarrës pajtimi duhet të jetë qëllim i KOMRA e për disa kjo është çështje e vendimit personal.

Mendoj se është parësore dhe më e rëndësishme të arrijmë pajtimin. (Nikola Drljaca, Organizata Komunale e Luftëtarëve të Zënë Rob dhe të Vrarë, Novi Grad, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Prijedor, BH, 13 maj 2009).

Nuk di nëse fjala pajtim do të gjendet në dokumentet të cilat do tua dorëzojmë qeverive, pikërisht nga frika që njerëzit e pikëlluar, të cilët janë drejtpërdrejt të goditur, të cilët kanë pësuar drejtpërdrejt, do të mund ta kuptonin këtë si diçka që ndoshta tani po u imponohet. Mendoj se vendimi për pajtim është një vendim thellësisht personal dhe se përcaktimi i fakteve me siguri kontribuon që eventualisht dikush ta merr një vendim të tillë. (Vesna Terselic, Documenta, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Prijedor, BH, 13 maj 2009).

Pjesëmarrja e të rinjve në procesin këshillues është rast që të njihen dhe të bashkë ndiejnë me të tjerët.

Prej '92. te të gjithë popujt është rritur një popullatë e rinisë e cila është rritur në një geto, pa ndonjë kontakt me popujt tjerë. Mendimi im personal është që pjesëmarrja në këso tubimesh, do tu jepte atyre më shumë rast ti ndiejnë këta të tjerët. Vetëm ky ballafaqim me faktet, me të kaluarën, ndoshta do të jepte rezultate më të mira në të ardhmen. Mendoj se pikërisht ajo rini është e ardhmja. (Ervin Blazevic, Shoqata Mladost, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Prijedor, BH, 13 maj 2009).

Bosnjës e Hercegovinës duhet kushtuar kujdes i posaçëm për shkak të ndarjeve të hatashme të njerëzve dhe mesit në të cilin jetojnë.

Duhet ti kushtohet pak më shumë kujdes situatës në Bosnje dhe Hercegovinë, pak më shumë të bazohemi në te, pa marrë parasysh situatën në disa vise tjera. Megjithatë Bosnja dhe Hercegovina, për fat të keq, ende është një mjedis jashtëzakonisht i ndarë. (Sudbin Music, Shoqata e të internuarve Prijedor 92, BH, Konsultat Lokale me Shoqërinë Civile, Prijedor, BH, 13 maj 2009).

35. Konsultat Kombëtare me shoqërinë civile lidhur me iniciativën KOMRA

Mali i Zi, Podgoricë
18 maj 2009

Konsultat i organizoi organizata joqeveritare *Institut Alternativa*. Në diskutime morën pjesë 28

përfaqësues të sektorit civil të Malit të Zi. Fjalët hyrëse i paraqitën Tea Gorjanc-Prelevic (Veprimi për të Drejtat Njerëzore, Mali i Zi), Stevo Muk (Institut Alternativa, Mali i Zi) i Aleksandar Trifunovic (Projekti Mediatik *Buka*, BH). Artikujt u publikuan në *Vjesti* dhe në Evropa e Lirë.

Komisioni i ardhshëm duhet të ketë karakter rajonal.

Për shkak se konflikti ka filluar në një shtet, të cilën të gjithë e njohim si Jugosllavi, e ka përfunduar në disa shtete të cilat janë krijuar nga territoret e saja, konflikti nuk ka qenë i përqendruar në shtete të caktuara, brenda kufijve. Ai shpesh i kalon kufijtë dhe për këtë konsiderojmë se mënyra më efikase për vërtetimin e fakteve mbi krimet të cilat sipas rregullit dhe shumë shpesh kanë qenë përtej kufirit është pikërisht një trup i tillë rajonal. (Tea Gorjanc-Prelevic, Veprimi për të Drejtat Njerëzore, Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009).

Do të kemi opstrukcione maksimale në Mal të Zi. Zgjidhja është pikërisht, që të gjithë ne në këtë përbërje dhe në nivel rajonal, të gjejmë mekanizma të cilët do të mundësonin që ky tregim të hapet. Pa hapjen e këtij tregimi, nuk dua të them pa pajtim, nuk ka normalizim të marrëdhëniesh ndërmjet popujve dhe shteteve të cilat deri më tani kanë luftuar. (Radan Nikolic, Shoqata e Luftëtarëve të Luftërave të 1990-ve, Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009).

Mua, personalisht më duket i papranueshëm modeli i komisioneve kombëtare, po komisionet kanë përfaqësuesit e tyre. Ne i kemi pasur këto tani. Mali i Zi ka pasur Komisionin për personat e zhdukur. Ky Komision ka përfaqësuesit e vet në nivelin rajonal. Mirëpo, ata fare nuk marrin pjesë dhe në këtë mënyrë nuk dëgjohej zëri i Malit të Zi, respektivisht i familjeve të personave të zhdukur. Prandaj, kjo thjesht duhet të jetë diçka në nivel rajonal. (Radan Nikolic, Shoqata e Luftëtarëve të Luftërave të 1990'ave, Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009).

Është i nevojshëm themelimi i komisioneve kombëtare, të cilat më vonë do të bashkëpunonin me komisionet rajonale.

Mendoj se kjo është e vështirë që fillimisht të the-

melohet në nivel rajonal, por duhet të punohet në të gjitha shtetet veç e veç, duke formuar komisione apo qendra hulumtuuese (...)mirëpo në fund, gjithsesi do të formësohet njëfarë Komisioni Rajonal dhe raporti. (Mirsad Rastoder, revista Forum, Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009).

Secili vend duhet ta ketë modelin e vet për shkak se secili nga vendet e përfshira ka specifikat e veta dhe mendoj se nuk ekziston një model i cili do të ishte ideal për secilin vend. (...) Definitivisht nuk duhet që në fillim të ekzistoj Komisioni Rajonal, i cili do të ishte mbi komisionet tjera, por që përfaqësuesit e komisioneve në nivelin kombëtar të jenë përfaqësues të Komisionit Rajonal. (Bosko Nenezic, Qendra për Monitorim, Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009).

Është i nevojshëm inkuadrimi i organizatave të luftës në punën e Komisionit të ardhshëm. Pjesëmarrësit në krime do të mund t'i ndihmonin KOMRA në identifikimin e kriminelëve.

Luftëtarët do të jenë këtu, e jam i sigurt edhe organizatat e luftës, nga të gjitha republikat e RSFJ janë opstrukcioni më i vogël. Mund të ju them që shumë shpejt kemi gjetur gjuhën e përbashkët, sikur lufta të mos ketë ndodhur fare. Ne nuk jemi luftëtarë, ne jemi ushtarë, që do të thotë kemi përmbushur njëfarë obligimi ushtarak, ndërsa kanë luftuar politikat. Pastaj ka ndodhur pajtimi i këtyre politik bërësve. (Radan Nikolić, Shoqata e Luftëtarëve të Luftërave të 1990'ave, Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009).

Mendoj se ka njerëz të cilët kanë marrë pjesë në këto krime, të cilët janë ose viktima ose autor, dhe mendoj se do të pranohet që këto dëshmitë e tyre ti ndanin me ndonjërin. KOMRA mund të krijoj një lloj kontakti, një lidhje telefonike, e cila do të ishte nën mbrojtje, për shkak se e dimë se këta njerëz sigurisht do të ishin në rrezik të drejtpërdrejtë në rast se fillojnë të flasin, mirëpo ata do të mund të na qonin deri te të zhdukurit, të na thonë "këtu dhe këtu kam marrë pjesë me njësinë time". Shikoni se çka ka ndodhur, si kemi arritur deri te incizimi i Shkorpionëve. (Sonja Radosevic, gazeta e lirë nga Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009).

Është e nevojshme që të sigurohet përkrahja e

institucioneve ndërkombëtare për themelimin e KOMRA, sidomos e Komisionit Evropian.

Komisioni Evropian do të ishte ai faktor ndërkombëtar të cilit duhet ti drejtohem, përmes KOMRA, për çdo lloj përkrahje, nga ajo financiare, e cila natyrisht se do të ishte e rëndësishme deri te ajo e cila është më e rëndësishmja, e ajo është përkrahja politike që ato vende të Ballkanit perëndimor të cilat nuk janë të gatshme të hyjnë në këtë proces të shtyhen, qoftë me shkop, qoftë me karroët, që në masë më të madhe dhe në mënyrë më transparente të sillen ndaj të gjithë procesit. (Momcilo Radulovic, Lëvizja Evropiane, Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009).

KOMRA duhet të merret me rolin e mediave në luftërat e të nëntëdhjetave. Media duhet marrë përgjegjësinë për rivendosjen e vlerave evropiane në shoqëritë post-jugosllave.

Për mua si qytetar është shumë i rëndësishëm përcaktimi i drejtë i kritereve për këto fakte dhe urdhërdhënësit e këtyre krimeve, jo ekzekutuesit e thjeshtë po urdhëruesit. Dhe ata të cilët kanë krijuar mendimin publik. (...) Për këtë ka materiale të ruajtura, edhe pse në mënyrë të vazhdueshme është shkatërruar, roli i medias dhe gazetarëve në krijimin e fashizmit në Malit të Zi. Mendoj se këtu KOMRA do të mundte të vijë më së shpejti deri te faktet. (Omer Sarkic nga Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009).

Krahas asaj pjese që merret me viktima, konsideroj se është gjithashtu me rëndësi të merremi edhe me mediat, si të tilla, me rolin e tyre në të nëntëdhjetat, posaçërisht me ata përfaqësues të medias të cilët ende e kryejnë këtë punë (...) Për fat të keq, ata nuk kanë dhënë përgjegjësi ligjore, për çka unë pajtohem dhe do të ishte punë e KOMRA që të merret me shkrimet dhe paraqitjet e tyre, raportimet nga fillimi i viteve ta nëntëdhjeta, që bile në njëfarë mënyre të zgjidhet kategorizimi profesional dhe moral i punës së tyre. (Momcilo Radulovic, Lëvizja Evropiane, Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009).

Televizioni bartë përgjegjësi të posaçme. Ai ka ndikuar në atë që dikush e quajti fashizim të shoqërisë malazeze gjatë viteve të nëntëdhjeta. Ai

tani duhet të bartë barrë të posaçme në procesin e de-fashistizimit, respektivisht të rivendosjes së disa vlerave evropiane. (Daliborka Uljarevic, Qendra për Arsimit Qytetar, Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009).

Anëtarët e Komisionit duhet të jenë në proporcion me përfaqësimin kombëtar në rajon, duke pasur parasysh edhe barazinë gjinore. Ata duhet të jenë njerëz të guximshëm. Është parashtruar edhe pyetja nëse për këtë punë duhet të paguhen.

Keni parasysh që nëse ai Komision kushtimisht përbëhet nga njëqind anëtarë, aty do të gjenden 42 malazez (apo malazeze), 32 serb (apo serbe) dhe 17 boshnjak/mysliman, një kroat (apo kroate), të kemi kujdes edhe për barazinë e vendlindjes, dhe të jenë përfundimisht pesë deri shtatë Shqiptar në atë Komision. Nëse ky Komision nuk i ka njëqind anëtar, atëherë sipas përqindjes. (Gojko Raicevic, Portali i Internetit www.in4s.net, Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009).

Ajo duhet të përbëhet, para së gjithash nga njerëz të guximshëm të cilët do të hulumtojnë pa atë presionin të cilin sipas të gjitha gjasave do ta kenë. (...) Më së miri do të ishte që ai dikush të jetë nga organizatat joqeveritare, të cilat do ti shtyjnë, do ti pyesin deri ku kanë arritur, dhe publikisht të tregojnë se çka kanë zbuluar, çfarë faktesh janë këto dhe çfarë dokumentacioni kanë mbledhur. Mua më duket se kjo do të jetë puna më e vështirë. (Ljiljana Raicevic, Shtëpia e Sigurt për Gra, Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009). Si të motivohen njerëzit më të mirë që të kycen në këtë punë? A do të thotë kjo se duhet të kemi Komision profesional (...) Për shkak se këta njerëz nuk janë rastësisht individ të shquar, kjo do të thotë se këta njerëz duhet ta lënë anash punën dhe profesionin e tyre për tu marrë me këtë çështje, e cila ndoshta nuk është më pak e rëndësishme se sa puna e tyre, mirëpo gjithsesi është punë e re, apo punë tjetër. (Bosko Nenezic, Qendra për Monitorim, Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009).

Dëshmitë publike janë më të rëndësishmet për punën e KOMRA.

Mendoj që dëshmia publike është një nga ngjarjet më të rëndësishme. E di që njerëzit të cilët do ta dëgjonin

këtë marrje në pyetje publike përmes shërbimit publik i cili mbulon më së miri territorin e Malit të Zi. Ndoshta do të dëshironin ta thonë pjesën tyre të së vërtetës, dëshmitë e tyre dhe ndjenjat e tyre për ato tmerre të luftës, të cilat nuk kanë kujt t'ia tregojnë dhe të cilëve në një masë të madhe dyert e kufijve të shteteve fqinje u janë mbyllur. (...) Ende është herët, mirëpo do të ishte efikase dhe do të shtynte edhe njerëzit e tjerë, sepse gjithmonë kur keni dikë i cili futet i pari dhe dëshmon publikisht, thonë: "Ja, ai mbijetoi, mundem edhe unë, unë kam edhe më shumë për të thënë". (Ljiljana Raicevic, Shtëpia e Sigurtë për Gra, Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009).

Është me rëndësi të vërtetohet fati i të gjithë personave të zhdukur.

Ajo në çka kisha vënë theks të veçantë është çështja e personave të zhdukur. Vërtet, nuk ka asgjë më humane dhe asgjë më të nevojshme se sa të gjendet varri i secilës viktimë të luftës. Do të thotë, të gjitha viktimat e luftës janë viktimat, viktimat nuk kanë as përkatësi kombëtare. (Radan Nikolic, Shoqata e Luftëtarëve të Luftërave të 1990's, Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009).

Është e nevojshme përkrahja për themelimin e parqeve përkujtimore për viktimat.

Këtu pres nga ju, që zëshëm të përkrahni iniciativën e rregullimit të parkut përkujtimor për viktimat e krimeve nga viti 1991 deri në 2001, i cili sipas propozimit të Forumit Boshnjak do të gjendej në vendin e parkut Pobrezje, me qëllim që në këtë vend në njëfarë mënyre t'iu përkulemi trupave të gjitha viktimave dhe ti japim rast familjeve dhe të gjithë njerëzve të tregojnë, apo në njëfarë mënyre ta rishqyrtojnë ndërgjegjen e tyre. (Mirsad Rastoder, revista Forum, Mali i Zi, Konsultat Kombëtare me Shoqërinë Civile, Podgoricë, Mali i Zi, 18 maj 2009).

36. Konsultat Kombëtare me organizatat e grave, shkencëtarët dhe me politikanet lidhur me iniciativën KOMRA

Zagreb, Kroaci
21 maj 2009

Konsultat me grupet e grave, shkencëtarët dhe

politikanet i kanë organizuar organizatat e grave, anëtare të koalicionit për KOMRA në Kroaci: Grupi për të drejtat e grave dhe të njeriut, *B.a.b.e.*, Qendra për gratë viktime të luftës ROSA, Koordinimi i grupeve të grave SEKA, Grupi Lezbik KONTRA, Qendra për iniciativa qytetare Porec, *Dhoma e grave*, *Cesi*, *Delfin*, *Domine* Split dhe Documenta. Konsultave iu ka paraprirë konferenca për shtyp, në të cilën folën Vesna Terselic nga Documenta, Marica Seatovic, gruaja e të vrarit Mihajlo Seatovic nga Novska dhe Rada Boric nga Qendra për studime të grave, Zagreb. Për konferencën raportuan HRT dhe Novi List. Në konsulta fjalën hyrëse e paraqitën Nela Pamukovic (Qendra për gratë viktime të luftës, *Rosa*, Kroaci), Paula Zore, Suzana Kunac (*B.a.b.e.* Kroaci), Stasa Zajovic (Gratë në të Zeza, Serbi) dhe Vesna Terselic (Documenta, Kroaci). Konsultat përmbanin edhe ligjëratën *‘Rëndësia e dimensionit të lindjes në procesin e ballafaqimit me të kaluarën’* nga Vesna Kesic (publiciste/gazetare dhe feministe, Kroaci) dhe Rada Boric (Qendra për studime të grave, feministe, Kroaci). Gjatë programit Marica Seatovic, gruaja e të vrarit Mihajlo Seatovic nga Novska dhe Marija Lovric, gruaja e të vrarit Branko Lovric nga Osijeku, përmes dëshmimeve të tyre tërhoqën edhe një herë vërejtjen e të tubuarve për nevojën e vendosjes së mekanizmave të rinjë gjatë ballafaqimit me pjesët e dhimbshme të së kaluarës. Në konsulta morrën pjesë 39 pjesëmarrëse. Për konsulta raportuan Novi List dhe HRT1.

Roli i KOMRA është që të krijojë ballafaqim të qartë dhe efikas me faktet, dhe në këtë mënyrë t’i afrojë bashkësitë e ndara dhe të pengojë konfliktet e reja.

Komisionet do të duhej që përmes strukturave të tyre, këshillave, komisarëve dhe anëtarëve të Komisionit të përcaktojnë të vërtetën për krimet e luftës të cilët pastaj bëhen pjesë e mbamendjes kolektive të bashkësive. Duke ecur nëpër bashkësitë post-konfliktuale në Kroaci, kam ndjenjën se misioni paqësor pothuaj se nuk ka filluar ende. Këto janë ende bashkësi të ndara dhe se ky Komision ka vërtetë një rol të rëndësishëm sepse pa ballafaqim me faktet, të vërtetën dhe drejtësinë për viktimat, mendoj se kemi një hapësirë potencialisht të madhe për konflikte të reja. (Suzana Kunac, Grupi për të Drejtat e Grave dhe të Njeriut, *B.a.b.e.*, Kroaci, Konsultat Kombëtare me Grupet e Grave, Zagreb, Kroaci, 21 maj 2009).

Grave, viktime të dhunimit duhet tu sigurohet qa-

sja drejt mekanizmave të drejtësisë në tranzicion.

Duhet hulumtuar sa procedura gjyqësore janë udhëhequr në gjykatat kombëtare për krimet e dhunimit në luftë. (...) Të hulumtohet se sa kanë qasje gratë, në përgjithësi, në mekanizmat e drejtësisë në drejtësinë në tranzicion. Kur të përfundojmë pas gjithë tregimit se ku kanë ndodhur dhunimet masive dhe momentin i cili e tërhoqi vëmendjen botërore, pas gjithë tregimit kjo natyrisht se u harrua dhe në këtë tregimin tranzicional çështja u lëshoi. (Vesna Kesic, gazetare dhe publiciste nga Zagreb, Kroaci, Konsultat Kombëtare me Grupet e Grave, Zagreb, Kroaci, 21 maj 2009).

Në kuadër të KOMRA duhet të ekzistojë një trup i posaçëm i cili do të merrej me dhunimet.

*Dhe disi më duket shumë interesante ajo përvoja e Rada Boriq nga Japonia, tribunali femëror. Çfarëdo kuptimi të ketë pasur kjo. Në këtë moment ndoshta do të kërkonim tepër, nëse e fitojmë Komisionin ndoshta nuk është e tepërt të kërkojmë tribunalin femërorë. Mirëpo mendoj se është shumë me rëndësi nëse në mandat fusim edhe dhunimet e luftës, sepse atëherë do të duhej që brenda kësaj të kemi një nëngrup i cili në mënyrë specifike do të merrej me këtë problematikë. (Mirjana Bilopavlovic, Qendra për Përkrahje dhe Zhvillim të Shoqërisë Civile, *Delfin*, Kroaci, Konsultat Kombëtare me Grupet e Grave, Zagreb, Kroaci, 21 maj 2009).*

Atë që e quajmë perspektivë feministe është që gratë janë viktime potenciale gjatë luftërave, fillimisht si gra e pastaj si kroate, serbe, myslimane, do të thotë përkrah etnisë së e tyre. Dhe sigurisht që për ne është me rëndësi që secila grua ta meritojë atë trajtim individual. (Rada Boric, Qendra për Studime të Grave, Kroaci, Konsultat Kombëtare me Grupet e Grave, Zagreb, Kroaci, 21 maj 2009).

Duhet pasur kujdes përbërjen gjinore të KOMRA. Grupet e grave duhet të ndihmojnë punën e KOMRA, dhe atë para se gjithash me dokumentacion dhe kontakte me gratë viktime.

Nëse nuk bëhet kujdes për përbërjen gjinore të këtyre komisioneve, sipas meje përsëri nuk kemi bërë asgjë. Çfarë reforma të institucioneve dhe çfarë politika zyrtare propozohen? Ky është njëfarë kuptimi i gjithë Komisionit. Dhe ajo që gjithashtu është me rëndësi: këta mekanizmat e drejtësisë në tranzicion a do të

fuqizojnë grupet lokale të grave, lëvizjet lokale dhe iniciativat lokale për rivendosjen e një shoqëri më e drejt në aspektin gjinorë. (Vesna Kesic, gazetare dhe publiciste, Kroaci, Konsultat Kombëtare me Grupet e Grave, Zagreb, Kroaci, 21 maj 2009).

Pra, edhe në veprimet disiplinore edhe në Komision, duhet pasur parasysh dimensionin gjinor dhe në analizë të merret parasysh dimensionin gjinor i nxitjes dhe ekzekutimit të dhunës së luftës (...).T'i kushtohet kujdes ekspertizës gjinore dhe përvojave të cilat kandidatët dhe kandidatet e besueshëm [anëtar/e të Komisionit] kanë pasur gjatë punës me viktima dhe ekspertizës së tyre në aspektin e qasjes feministe edhe kur propozohen, do të thotë në raportin e Komisionit, reformat e politikës zyrtare, natyrisht duke inkorporuar perspektivën gjinore. (Vesna Terselic, Documenta, Kroaci, Konsultat Kombëtare me Grupet e Grave, Zagreb, Kroaci, 21 maj 2009).

Është mirë që KOMRA është këtu, që jemi të pushuara me gjithçka duke pasur parasysh që çdo gjë rreth nesh ka të bëjë me luftën dhe gratë. Edhe ato që i kemi nga dokumentet e grimcuar shpesh edhe vet i dimë. Nuk e dimë as ku i kemi gratë për ti mbyllur disa tregime. Të mos themi me nostalgji se nuk e bëmë vlerësimin. Ashtu si edhe trauma, procesi rreth traumës, duhet të ketë njëfarë 'closure', njëfarë mbyllje. (Rada Boric, Qendra për Studime të Grave, Kroaci, Konsultat Kombëtare me Grupet e Grave, Zagreb, Kroaci, 21 maj 2009).

KOMRA duhet të rekomandojë futjen e edukimit paqësor në shkolla.

Duhet marrë në mandat rekomandimi i futjes së edukatës paqësore në shkolla, dhe të rekomandoj që të bëhet plani kombëtar i veprimit i cili pastaj u mundëson grave të marrin pjesë në te. Nëse do të merrnin pjesë në hartimin e planit veprues , atëherë do të mundnin të fushnin ndonjë nen i cili do të lidhej me Komisionin, krijimin e komisioneve, ballafaqimin me faktet e kështu me radhë. (Rada Boric, Qendra për Studime të Grave, Kroaci, Konsultat Kombëtare me Grupet e Grave, Zagreb, Kroaci, 21 maj 2009).

Paralelisht me themelimin e KOMRA, do të ishte e dobishme të nxitet themelimi i Komisionit kombëtar.

Kur e paramendoj parlamentin tonë në këtë moment, mund ta paramendoj që kuvendi i Kroacisë

me shumë dëshirë do të përkrahte themelimin e një Komisioni të tillë rajonal, për të treguar se si Kroacia ka qenë viktima më e madhe e kështu me radhë. Prandaj më duket se do të ishte interesante të shihet se në cilin moment kuvendi i Kroacisë do të provoj të zhvilloj një lloj empatie, siç do ta quaja unë. Empati të kësaj shoqërie. Do të thotë, midis asaj që momentalisht paraqet tërësinë territoriale të Kroacisë. Prandaj më duket që ndoshta Komisioni kombëtar është interesant, kështu që ndoshta do të duhej disi në mënyrë paralele të shtyhet. (Aida Bagic, Documenta, Kroaci, Konsultat Kombëtare me Grupet e Grave, Zagreb, Kroaci, 21 maj 2009).

Ndoshta KOMRA do të ishte më i fortë sikur të themelohej nga KB.

Unë me të vërtetë frikohem që goditja e parë me kokë për muri do të jetë e tmerrshme. Pse? Pastaj do ta thirrni nuk e di kë, bashkësinë ndërkombëtare ... Hajde të kërkojmë mandatin e KB. Mendoj a ka menduar dikush për këtë? Unë nuk ofroj asgjë. Nuk mendoj të merrem me këtë. Pse mandati i KB në këtë moment nuk do të ishte më i mirë? (Vesna Kesic, gazetare dhe publiciste nga Kroacia, Konsultat Kombëtare me Grupet e Grave, Zagreb, Kroaci, 21 maj 2009).

KOMRA duhet të merret me përgjegjësinë e mediave.

Unë kërkoj që domosdo të futet veprimi, siç do ta quajmë, apo argumentimi i fajësisë së disa gazetarëve dhe gazetareve. E dimë, së paku në rastin tonë në Kroaci, Bosnje dhe Serbi se kanë kryer një nga punët e pista, e Gjykata e Hagës e ka dënuar gazetarin nga Ruanda. Mendoj që duhet ta bëjmë këtë se përndryshe nëse i lëmë ata që edhe më tutje të jenë kryeredaktor dhe redaktore në televizionet tona dhe të luajnë me fatin tonë, e kemi lënë punën në gjysmë. Ata duhet të japin përgjegjësi për atë që kanë bërë. (Mirjana Galo, Homo, Kroaci, Konsultat Kombëtare me Grupet e Grave, Zagreb, Kroaci, 21 maj 2009).

Është e nevojshme që të formohet fondi për viktimat e luftës.

Fondi për viktima, ne në të vërtetë e kemi fondin për të dënuarit në Gjykatën e Hagës, por nuk kemi fond për viktima. (Mirjana Bilopavlovic, Qendra për Përkrahje dhe Zhvillim të Shoqërisë Civile Delfin, Kroaci, Konsultat Kombëtare me Grupet e Grave, Zagreb, Kroaci, 21 maj 2009).

KOMRA duhet të zhvilloj mekanizmat të cilët do të nxisin empatinë dhe dhembshurinë ndaj tragjedisë së të tjerëve.

Të gjitha Komisionet duhet të kontribuojnë për atë që folëm sot, ndryshimit të klimës morale, emocionale dhe kulturore, në kuptimin e që shembujt dhe modelet e caktuara kulturore të cilët kanë qëndruar në vetë esencën e luftës, respektivisht të cilët kanë nisur luftën janë ende këtu. Dhe se karshi kësaj pandjeshmërie shoqërore dhe institucionale, indiferencës, normalizimit të dhunës dhe mohimit të krimeve nga e kaluara, duhet të zhvillohet, përmes këtij Komisioni, një klimë plotësisht e ndryshme e solidaritetit dhe ndjeshmërisë, si virtyte qytetare kundrejt bërthamës dominante nacionaliste dhe nacionaliste-militante. Edhe zhvillimi i kësaj kulture civile që unë e quaj të demilitarizuar, është njëfarë rruge drejt ndërtimit dhe forcimit të një ardhmërie tjetër. (Stasa Zajovic, Gratë në të Zeza, Serbi, Konsultat Kombëtare me Grupet e Grave, Zagreb, Kroaci, 21 maj 2009).

KOMRA duhet t'u kushtojë kujdes gupeve minoritare. Është e nevojshme të mblidhen dëshmitë e tyre, sepse dëshmitarët po vdesin.

Popujt pakicë, të cilët, i kanë përcjellur të gjitha ngjarjet nga një drejtim krejtësisht i kundërt dhe thjeshtë e dinë tregimin nga vendi i ngjarjes, po vdesin, dhe me ta po humbin edhe të vërtetat lidhur me ngjarjet që kanë ndodhur në ato hapësira. Unë do ta kisha lutur Komisionin i cili do të themelohet, që me një pjesë thjeshtë ti përkushtohet këtyre ngjarjeve, si popullatës civile ashtu edhe aksioneve të drejtpërdrejta ushtarake, të cilat drejtpërdrejtë kanë ndikuar në jetën e popullatës civile në rajonet e okupuara. (Milena Percin, Unioni i Grave, Kroaci, Konsultat Kombëtare me Grupet e Grave, Zagreb, Kroaci, 21 maj 2009).

37. Forumi i pestë rajonal për drejtësinë në tranzicion: Iniciativa KOMRA

**Budvë, Mali i Zi
29-30 maj 2009**

Forum i pestë rajonal kishte mbledhur mbi 200 organizata joqeveritare nga të gjitha vendet e rajonit të RSFJ-së së dikurshme. Me 316 pjesëmarrës, ky ishte njëri nga tubimet më të mëdha

kushtuar drejtësisë në tranzicion. Forumin e kishin organizuar Qendra për Edukim Qytetar dhe Aksioni për të Drejtat e Njeriut nga Mali i Zi, me ndihmën e Sekretariatit të Koalicionit për KOMRA. Ky është forumi i parë në të cilën anëtarët e koalicionit për KOMRA, në kuadër të katër punëtorive, diskutuan për modelin dhe elementet tjera të modelit KOMRA. Një ditë para forumit, anëtarët e Koalicionit kishin mbajtur kuvendin e parë, themelues të Koalicionit, në të cilën u miratua Statuti i Koalicionit dhe u zgjodhën anëtarët e Këshillit Koordinues. Forumin e pestë e hapën Ranko Krivokapiq, kryetar i Kuvendit të Malit të Zi, Pierre Mirel, drejtor i Departamentit të Komisionit Evropian për zgjerim në vendet e Ballkanit perëndimor dhe Ron J.P.M. van Dartel, Ambasador i Mbretërisë së Holandës në Mal të Zi dhe Serbi.

Kuvendi i Malit të Zi ka arritur njëzëri që në kuadër të rezolutës mbi Marrëveshjen e stabilizim asociimit, në kuadër të orientimit të saj evropian, të inkorporoj edhe detyrimin e Qeverisë së Malit të Zi që të formoj qendrën dokumento-hulumtuese e cila do të merrej me hulumtimin e të gjitha ngjarjeve të cilat mund të përmbajnë elemente të krimeve të luftës nga viti 1991 deri më 2001.(...) Qëllim dominues është që kjo të hyjë në librat tona, të hyjë në arsimimin tonë, të hyjë në kulturën tonë. Ka ardhur koha që të mësojmë për humbjet tona dhe për gabimet tona, jo më pak se për fitoret tona. Kur ta arrijmë këtë, mendoj që si shoqëri kemi për të arritur të kuptojmë se mësimi për këto gabime dhe humbje nga fillimi i viteve të 90-ta është pengesa më e madhe në shpirtin njerëzor që ajo të mos përsëritet më. (Ranko Krivokapic, Kryetar i Kuvendit të Malit të Zi, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Pa marrë parasysh gjithë atë që UE mund të bëjë dhe po bën, ai nuk mund ta marr pronësinë mbi vet procesin. Ne mund të ndihmojmë, të ofrojmë përkrahje, mirëpo nuk mund ta marrim pronësinë mbi procesin. Procesi është i juaji, ky është proces i këtyre vendeve këtu. E vërteta, përgjegjësia dhe pajtimi duhet të vijë nga vet rajoni nëse pritet të kenë efekt afatgjatë. Është në shtetet tuaja, e me ndihmën tonë që të tejkalohet trashëgimia e të kaluarës. ... Për këtë arsye dëshiroj që përzemërsisht ta përshëndes këtë iniciativë të organizatave joqeveritare, iniciativën tuaj që të krijoni koalicionin e përbashkët për themelimin e Komisionit Rajonal. Shpresoj që, bashkë me iniciativat të tilla

dhe me përkrahjen dhe presionin tonë të vazhdueshëm, vendet e rajonit ngadalë do të vijnë në situatë që të pajtohen me të kaluarën e tyre dhe ta ndërtojnë të ardhmen e tyre. (Pierre Mirel, Drejtor i Departamentit të Komisionit Evropian për Zgjerim në Vendet e Ballkanit Perëndimor, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Ju, në Koalicionin rajonal për KOMRA, i keni dhënë vetës detyrë që ta gjeni mënyrën e drejtë për tu ballafaquar me të kaluarën. Është me rëndësi që kjo të bëhet përmes procesit inkluziv i cili tubon numër të madh organizatash dhe individësh dhe i cili përfshinë të gjitha palët relevante. Unë me gjithë zemër e përkrah qëllimin tuaj. (Ron J.P.M. van Dartel, Ambasador i Mbretërisë së Holandës në Beograd, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Pjesëmarrësit e forumit përfaqësuan organizatat për të drejtat e njeriut, arsimim, zhvillim demokratik, pastaj shoqatat e viktimave dhe familjeve të viktimave, të rinjve, veteranëve, të internuarve, të zhdukurve e tjera – nga Bosnja, Mali i Zi, Kroacia, Serbia, Sllovenia, Maqedonia dhe nga Kosova. Në tubim ishin të pranishëm edhe disa dhjetëra gazetar, të cilët raportuan apo botuan artikuj për mediat në vijim: TV CG, HRT1, RTS, RTRS, TV FBH, TV Atlas, TV In, TV Vijesti, MBC Montenegro, mediat e shkruara Blic, Borba, Pančevac, Pobjeda, Vijesti, Dan, Novi List dhe Koha Ditore, agjencia Beta dhe portalet e internetit e-Novine, Peščanik, B92, PCNEN Crna Gora, CDM Café del Montenegro, PG Portal Info, Regionalne Poslovne Novine, Centar za Razvoj Nevladinih Organizacija, Smedia.

37.1. Punëtorja: Përse KOMRA

Në debat për mandatin morrin pjesë 57 pjesëmarrës të forumit të pestë për drejtësinë në tranzicion. Drejtuese ishin Shukrije Gashi (Partners Kosova) dhe Vesna Terselic (Documenta).

Veteranët nuk e shohin se KOMRA është e hapur për problemet e tyre.

Ajo që më së shumti ju pengon njerëzve [veteranëve] të cilët ende jetojnë me idenë e qartë se kanë mbrojtur shtetin popullor, diçka të tyren, më së rëndi ju vije kur të gjithë në paketë i thërrasin autor apo kriminel. (Milos Antic, Qendra për Traumat e Luftës, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal

për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

KOMRA është e pranueshme vetëm nëse merr parasysh të gjitha viktimat, nëse nuk shikon se kush si quhet.

Ende konsiderojë nuk do ti afrohem institucionit apo organizatës joqeveritare deri sa të mos bindemi plotësisht se do ti merrni parasysh të gjitha viktimat, të punoni me të gjithë, të shkoni deri në fund për të gjithë, të vërtetoni se kush ka kryer krime duhet përgjigjet për to duke mos shikuar se si quhet, prej nga është dhe kur është zhdukur. (Marko Grabovac, Shoqata për Kërkimin e Luftëtarëve të Zhdukur, Civilëve të Zënë Rob të Komunës Brod, BH, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Pajtimi është proces i gjatë dhe – është shumë herët.

Ne Shqiptarët nuk kemi nevojë të hakmerremi, mirëpo edhe nuk mundemi të harrojmë. Mirëpo momentalisht fjala pajtim ... për këtë është ende herët, për shkaqe të ndryshme. Sepse anëtarët e familjeve nuk e dinë ku i kanë të afërmit e tyre dhe para se të gjenden ata mendoj se familjet do të jenë edhe më të pikëluara dhe më të stresuara. (Ymer Merlaku, Shoqata e Familjeve të Personave të Zhdukur nga Klina, Kosovë, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Jam i mendimit që procesi i pajtimit të nisë dhe të vazhdoj, mirëpo do të zgjas me vite. Konsideroj që do të tejzgjatjet dhe do të zgjas me vite. (Haxhi Nalli nga Krusha e Madhe, Kosovë, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Por një fytyrë e ligë nuk mund të lahet me një fytyrë të ligë. Në këto pyetje duhet pasur përgjigje të padyshimtë dhe qëndrim të palëkundur, që tek atëherë të filloj procesi i pajtimit jo dekorativ para Komisionit Rajonal. (Milika Pavlovic, shkrimtar nga Mali i Zi, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Detyrë e KOMRA është të identifikojë të gjitha krimet, shpejtojë procesin e zbulimit të varrezave dhe gjetjes së mbetjeve mortore.

Detyrë dhe qëllim i KOMRA sigurisht që do të ishte ti identifikoj të gjitha ngjarjet e ndodhura jo vetëm në territorin e komunës Vllasënica, por edhe në mbarë territorin ... identifikimi i lokacioneve të varrezave masive apo individuale ... na nevojiten raportet mbi ngjarjet, respektivisht të dhënat mbi prishjen e lokacioneve primare ... shpejtimi i procesit të kërkimit dhe zhvarrosja. (Dzevad Bektasevic, Shoqata e Familjeve të Viktimave të Luftës Vllasënica '92-'95. BH, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

KOMRA duhet të ndihmojë që gjykatat të jenë më efikase në procedimin e krimeve të luftës, pavarësisht nga kombësia e viktimës.

KOMRA duhet edhe më shumë, edhe më mirë, edhe më fort të ushtroj presion në strukturat udhëheqëse që të angazhohen që organizatat gjyqësore të zbulojnë dhe dënojnë edhe më shpejtë edhe në mënyrë më efikase autorët e krimeve të gjithë popujt sipas të njëjtave kritere, e jo në mënyrë selektive. (Angjellko Kvesiq, Unioni i Llogoristëve në Kantonin e Bosnjës së Mesme, BH, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Çka nëse këta dëshmitar vdesin në ndërkohë, çka ndodhë me të akuzuarit? Duhet menduar edhe për këtë aspekt. Mendoj se ne si KOMRA, duhet ti aktivizojmë respektivisht ti freskojmë me dëshmi të reja këto lëndë të cilat gjenden nëpër gjykata. Nuk duhet lënë që të vjetrohen. (Naser Lajqi, Shoqata Syri i Vizionit, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

KOMRA mund të ndihmojë që të përcaktohet e vërteta për të zhdukurit dhe autorët e krimit.

Unë përshëndes Komisionin e KOMRA. Të na ndihmoj, neve anëtarëve të familjeve të personave të zhdukur ta zbulojmë të vërtetën. Ata kriminel e dinë se kanë kryer krim dhe mos ta hedhin përgjegjësin në bandat paramilitare apo të pakontrolluara, sepse duhet të dihet e vërteta se ka qenë zinxhiri komandues i ushtrisë dhe policisë ai i cili ka kryer krimet. (Xhafer Veliu, Shoqata Pengu i Lirisë, Kosovë, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

KOMRA do të na mësojë që të bashkë ndiejmë me të tjerët.

E falënderoj [Koalicionin] KOMRA që na ka mësu-

ar ta dëgjojmë njëri tjetrin dhe ta lëshojmë lotin edhe për hallin e tjetrit (Gordana Djikanovic, Shoqata e Familjeve të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, revista Kosmetske žrtve, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

KOMRA në nevojitet për ti përcaktuar faktet për ata të cilët kanë kryer krime dhe të largohet anatema se disa popuj janë kriminel.

Nuk është e lehtë të jetohet në Serbi dhe të bartet barra e diçkaje që e ka kryer individi. Them individi, nuk mendoj një njeri, por shumë prej tyre me emër dhe mbiemër. Ndoshta KOMRA do të ndihmojë që secilit popull dhe secilit shtet ti hiqet anatema e popullit kriminel, që fëmijët e mi të cilët kanë lindur në Prishtinë të mund të shkojnë nesër në Prishtinë e të mos mendojnë se dikush mund tu bëjë keq vetëm pse janë serb. Shpresoj që KOMRA do të na ndihmojë të ngrihem mbi atë që populli është kriminel. Le të përgjigjet secili kriminel për krimet që i ka kryer. (Gordana Djikanovic, Shoqata e Familjeve të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, revista Kosmetske žrtve, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

KOMRA mundet të krijoj një dokument të përbashkët mbi atë që ka ndodhë.

Nëse flasim për atë se pse na duhet KOMRA, përveç arsyeve tjera kjo është për shkak se mendoj se i kemi nevojat e përbashkëta. Dokumenti i përbashkët mbi atë që ka ndodhur rreth të cilit pak a shumë të gjithë do të pajtohem. (Lidija Zeković, Aktiviste për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i pestë rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. Maj 2009.)

Kam formuar një grup për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave në nivel të Kosovës dhe këtë e kam institucionalizua. Kam angazhuar përfaqësues nga të gjitha arkivat me qëllim të grumbullimit të të dhënave mbi krimet, vrasjet, masakrat, dëmtimet e objekteve fetare dhe objekteve tjera, shkatërrimet e shtëpive, pastaj për personat e zhdukur, plagosjet, dëbimet, e kështu me radhë. (Jusuf Osmani, Arkivi i Kosovës, Forumi i pestë rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. Maj 2009.)

Si Shoqata ne kemi shënuar dëshmitë, kemi emrat e dëshmitarëve. Shoqata ka dorëzuar listën prej treqind kidnapuesve, vrasësve dhe kriminelëve, poten-

cial, sepse derisa të mos dëshmohej në gjykatë, kjo nuk është e mjaftueshme. Mirëpo, këtë e kemi shënuar vetëm ne. Shumica nga këta dëshmitar nuk janë më gjallë. Do të thotë, vitet kalojnë, këtë duhet dikush ta shënoj, ta regjistroj, që kjo të ketë peshë dhe që ndoshta në bazë të saj të procedohet më tutje. (Gordana Xhikanoviq, Shoqata e familjeve të të kidnapuarve dhe të vvarëve në Kosovë, revista Kosmetske žrtve, Forumi i pestë rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. Maj 2009.)

Komisioni do të ketë legjitimitet nëse shtetet marrin pjesë në formimin e saj.

Prandaj konsideroj se është shumë e rëndësishme që të themelohet një Komision i tillë dhe gjithashtu e konsideroj si shumë të rëndësishme që shtetet tona, qeveritë në të gjitha shtetet (...) thjeshtë i japin legjitimitet këtij trupi. Pa pjesëmarrjen e tyre vështirë që ne do të kemi sukses. (Lidija Zekovic, Aktiviste për të Drejtat e Njeriut, Mali i Zi, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Duhet fillimisht të formohen komisionet në nivel të shteteve e pastaj atë rajonale.

Propozim i shoqatës është që të filloj iniciativa në nivel lokal, e tek pastaj të lidhen shtetet e rajonit... nuk mundet KOMRA të fshehet pas asaj që dikur e quanim vëllazërim bashkim. Komisioni është i domosdoshëm, mirëpo së pari në nivel të shtetit e më vonë të ngrihet në nivel rajonal. (Bajram Qerkini, Shoqata Kujtimi, Kosovë, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Duhet formuar zyra dhe secila prej tyre duhet ta ketë dokumentacionin e vet, me qëllim të evitimit të manipulimeve. (Jusuf Osmani, Arkivi Shtetëror i Kosovës, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

37.2. Punëtorja: Struktura e KOMRA-s

Kriteret për përzgjedhjen e anëtarëve, dhe mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të KOMRA.

Udhëheqës të kësaj punëtorie kanë qenë Aleksandar Trifunovic (Projekti Mediatik, Buka, BH) dhe Bekim Blakaj, (Fondi për të Drejtën Humanitare Kosovë). Në diskutim morën pjesë 24

pjesëmarrës, kryesisht përfaqësues të organizatave joqeveritare.

KOMRA duhet të ketë një zyre qendrore dhe shumë zyre kombëtare, si dhe përfaqësitë në vendet ku janë kryer më së shumti krime.

Zyra kryesore e Komisionit Rajonal ti definoj zyrat, pra brenda territorit të shtetit sepse sipas të gjitha gjasave në Kroaci do të jetë e nevojshme të ketë zyre atje ku janë kryer krimet më të rënda, e ato janë Krajina, Sllavonia, Dalmacia, pra Knini pas operacioneve Olluja dhe Blesak. (Suzana Kunac, B.a.b.e., Kroaci, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Mendoj se është e domosdoshme të ekzistoj një zyre qendrore me qëllim të grumbullimit të dhënave nga zyrat rajonale respektivisht territoriale. Parashihet që secili shtet ta financoj funksionimin e zyrave të veta. Mendoj se kjo ka anën e vet pozitive për shkak se ekziston mundësia që në secilin shtet të zgjerohet rrjeti i zyrave territoriale, në numër më të vogël apo më i madh, varësisht nga nevoja (...) Përse them zyra qendrore? Për arsyen e thjeshtë se ky do të ishte vendi i grumbullimit të gjitha të dhënave e në të njëjtën kohë edhe vendi do të shkonin të gjitha iniciativat në drejtim të kreut të shteteve përkatësisht institucioneve përgjegjëse në kuadër të shteteve. (Zarko Radic, Organizata Republikane e Familjeve të Luftëtarëve të Zënë Rob dhe Civilëve të Zhdukur e Republika Srpska, BH, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Sa u përket anëtarëve të Komisionit, të zyrës qendrore të Komisionit, secili shtet i kandidon anëtarët e saj të cilët do të marrin pjesë në punën e Komisionit. (Ylber Maxhuni, Youth Step, Kosovë, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Komisionet [zyrat] duhet të jenë në nivel kombëtar. Megjithatë, secili komision e njej vendin e vet, njerëzit e vet, ne jemi aq shumë në kontakt sa që të gjithë njihemi dhe që të gjitha ato komisione prapë i dorëzojnë të dhënat ndonjë Komisioni qendror i cili do të jetë në nivel të gjitha shteteve të ish Jugosllavisë. (Lozanka Radoicic, Shoqata e Prindërve Besimi, Shpresa, Dashuria, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

KOMRA me siguri do ta fitoj në Kozarc, prej nga

unë vij, përkrahjen e popullit boshnjak për shkak se këtu është kryer krimi ndaj tyre. Këtu kanë qenë tri kampe përqendrimi të cilat veç janë dëshmuar dhe proceduar e kështu me radhë, do të thotë këto janë faktet (...) Mirëpo çka me Serbët të cilët janë në Prijedor. A do ta përkrahin ata KOMRA, mirëpo jo duke u marr me çështjen e serbëve në Sarajevë, por që serbët të merren me çështjen e krimeve ndaj Myslimanëve në Prijedor, më kuptoni. (...) qëllim i KOMRA duhet të jetë edhe ajo se si do të ballafaqohet popullata civile me faktet se krimet kanë ndodhur dhe ato duhet të pranohen, dhe të gjykoohen. (...) Mendoj që Komisioni kurdoherë të duhet ti ketë zyrat këtu për shkak se këtu kanë qenë tre kamp edhe nëse në Bosnje kjo anashkalohet, do të thotë nuk do të ketë sukses. (Ervin Blazevic, Shoqata Mladost, BH, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Secili shtet duhet të përfaqësohet me numër të njëjtë të anëtarëve në KOMRA.

Mendoj që secili shtet duhet të përfaqësohet me numër të njëjtë të anuarve në Komision. (Ylber Maxhuni, Youth Step, Kosovë, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Komisioni duhet të jetë rajonal, ti ketë komisarët në nivelin rajonal dhe këtu duhet përcaktuar njëfarë principi, ta zëmë dy anëtar për secilin shtet apo diçka të ngjashëm. Ai Komision Rajonal, si trup kryesor dhe si organi më i lartë i miraton të gjitha raportet dhe eventualisht i prezanton në publik hetimet e viktimave. Përveç kësaj, në nivel kombëtar, do të duhej organizuar, le tu themi, trupat operative ekzekutive apo nën komisionet të cilat do të kenë qasje më të lehtë te të dhënat dhe viktimat, lokacionet dhe vendet e ndryshme. (Andrej Nosov, Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

KOMRA duhet të jetë e trup i pavarur dhe të mos u shërbej kërkesave kombëtare.

Ne, këtë projekt veç e kemi sjell në kuptimin mbi kombëtar dhe në këtë kuptim nuk duhet të bëhemi peng i krijimit të njëfarë strukture e cila do të ketë karakter kombëtar sipas sistemit sa banor aq viktima dhe sipas këtij principi të zgjedhën përfaqësuesit. (Amir Talic, Shoqata e llogoristëve Sanski Most, BH, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi

Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Është parashtruar pyetja se a do ta pranojnë serbët e Kosovës zyrën e KOMRA apo për ta do të ishte e pranueshme vetëm zyra në Serbi.

A do të pranohej Komisioni Kosovar [nënkomisioni i KOMRA] nga ana e serbëve të Kosovës apo ndoshta ata do të ishin më të afërt me komisionin në Serbi? Do të thotë kur flasim për ato komisionet lokale, kombëtare, cila do të ishte struktura e anëtarëve të atyre komisioneve? A marrin pjesë vetëm Shqiptarët apo edhe të tjerët? (Gazmir Raci, ProPeace Platform, Kosovë, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Qendra KOMRA duhet të jetë në Bosnje dhe Hercegovinë, apo në ndonjë shtet jashtë rajonit të ish RSFJ.

Sipas të gjithë treguesve, Bosnja ka pësuar më së shumti në të gjitha aspektet. Aty besohet se kanë rënë më së shumti viktimat dhe duket disi logjike, (...) që Bosnja të bëhet njëfarë qendre rajonale për të gjithë, e pastaj vendet tjera do të formonin qendrat e tyre. (Marinko Xhuriq, Shoqata e të kidnapuarve dhe të vrarëve në Kosovë, Serbi, Forumi i pestë rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. Maj 2009.)

Sa i përket zyrës kryesore të Komisionit, ndoshta të jetë në ndonjë vend të tretë, nëse pajtohen të gjitha shtetet. Pra diku jashtë ish RSFJ. (Ylber Maxhuni, Youth Step, Kosovë, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

KOMRA duhet të ketë anëtar të cilët janë të kualifikuar për verifikimin e vërtetësisë së dëshmive dhe dëshmitarëve.

Nëse është qëllimi të emërohen autorët në këto raporte atëherë është e domosdoshme që kjo strukturë e organizatës të ketë disa njerëz, funksione të cilët do ta bënin verifikimin e vërtetësisë së këtyre dëshmive. (Dushko Medic, Rrjeti i Gjellbër i Vojvodinës, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Institucionet nuk duhet të jenë të përfaqësuara në KOMRA.

Njerëzit të cilët do të kandidojnë nuk mund të kenë

në biografinë e tyre diçka me të cilën do ta dëmtonin respektin e KOMRA apo vet idenë e saj. Kjo sipas meje nënkupton asnjë person me të kaluar apo të tashme politike si dhe në çfarëdo mënyre aktiv ushtarak apo cilëso nga strukturat ushtarake. (Marinko Djuric, Shoqata e të Kidnapuarve dhe të Vrarëve në Kosovë, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Unë mendoj se anëtarët e Komisionit nuk duhet të jenë përfaqësues të institucioneve. (...) (Gazmir Raci, ProPeace Platform, Kosovë, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Ka propozime që veteranët të jenë anëtarë të KOMRA.

E pse të mos përfshihen edhe veteranët e luftës. (Gazmir Raci, ProPeace Platform, Kosovë, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Pjesëmarrja e shoqërisë civile siguron dimensionin etik të punës së Komisionit.

Një ditë kur të formohet Komisioni, përfaqësuesit e shoqërisë civile, nuk e di sipas cilit kriter, do të zgjidhen, sepse është shumë e vështirë të përcaktohet legjitimiteti i njerëzve nga shoqëria civile, mirëpo është shumë e rëndësishme që zëri i tyre dhe numri i anëtarëve të komisionit nga radhët e tyre të jetë i tillë që të siguroj një lloj kualiteti të punës etike të Komisionit. (Sanja Elezovic, Instituti për Shoqëri të Hapur, Mali i Zi, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve të KOMRA duhet ta sigurojë përfaqësimin e të gjitha grupeve shoqërore, përfshirë edhe bashkësinë akademike, psikologët, sociologët, juristët, organizatat për të drejtat e njeriut, shoqatat e viktimave, dhe të gjithë anëtarët duhet të japin betimin që i obligon moralisht.

Kuptimi moral i zgjedhjes duhet gjithashtu të rregullohet me kriteret të caktuara, për shembull biografia. (...) Nuk kisha dashur që përsëri të vras mendjen nëse ai është polic, ish oficer apo diçka tjetër, kjo bile për momentin është e parëndësishme (...) Ata njerëz, ashtu si mjekët, duhet të japin një

lloj betimi e cila i përcakton kuptimin moral të punës që do ta bëjë nesër. (Amir Talic, Shoqata e llogoristëve Sanski Most, BH, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Sa i përket vet kriterëve, mendoj që merren parasysh ato themelore, që dikush të mos ketë qenë i dënuar për vepër penale, e që më vonë nga struktura e vet komisarëve duhet pasur parasysh që të jenë të përfaqësuar të gjitha grupet e interesuara, e kjo do të thotë nga luftëtarët për të drejtat e njeriut, organizatave të shoqërisë civile, viktimave dhe të gjitha grupeve tjera të cilat mund ti kontribuojnë kësaj besueshmërie. (Andrej Nosov, Iniciativa e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Ky Komision rajonal duhet të jetë ekip ekspertësh, do të thotë persona që do të jenë në gjendje të bisedojnë me viktimat, të marrin deklaratat, ti dokumentojnë me fakte në mënyrë objektive, pra pa i dhënë kah bisedës, pa manipuluar me atë që flitet dhe kur e them këtë mendoj se këtu duhet të jenë edhe psikologët dhe sociologët, por edhe vet viktimat si the personat me autoritet. (Borka Rudic, Shoqata e Gazetarëve të BH, BH, Forumi i Pestë Rajonal për Drejtësi Tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

80% e bashkëqytetarëve të mijë është nëpër tërë botën dhe mua më intereson se si do ti gjejnë këta hetues gjithë ata njerëz nga Australia e deri në Amerikë. Plus shumica e këtyre njerëzve kanë kaluar nëpër llogore, janë me shëndet të dobët dhe thënë troç me kohë po vdesin. Për këto pesëmbëdhjetë vite kanë vdekur shumë dëshmitar të gjallë. (Ervin Blazheviq, Shoqata rinore Mladost, BH, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Kriter jashtëzakonisht i rëndësishëm është që personat anëtar të Komisionit të kenë kapacitet ta jashtëzakonshëm emotiv, psikologjik dhe mendor për të bartur gjithë atë që mund ta dëgjojnë apo me çka mund të punojnë. (...) Shumë është e rëndësishme të mendohet në përfaqësimin e bashkësisë akademike sepse ajo mund të balancoj nivelin emotiv-psikologjik. (Emina Buzhinkiq, Shoqata e të rinjve të Kroacisë. (Sanja Elezovic, Instituti për shoqëri të hapur, Mali i Zi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Koalicioni për KOMRA duhet ta mbaj një lloj pronësie mbi KOMRA dhe kur të formohet duhet penguar nxjerrjen e të pavërtetave në publik.

Unë mendoj që duhet të kemi strukturë drejtuese dhe se ku Koalicioni i deritashëm me KOMRA duhet të mbaj pronësinë mbi KOMRA-në, për shkak se mendoj që nëse kjo lëshohet në nivel kombëtar, në nivel shtetëror, në qeveri, do të vije deri te politizimi dhe se do të tentohet në mënyra të ndryshme të pengohet të thanit e vërtetës. (Borka Rudic, Shoqata e Gazetarëve të BH, BH, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. Maj 2009.)

Pjesëmarrësit kanë mendime të ndara rreth asaj se a duhet të huajt të marrin pjesë në punën e Komisionit.

Më duket se anëtarët ndërkombëtar të Komisionit do mund të ishin problem shumë i madh në atë bashkësi në të cilën bashkësia ndërkombëtare e ka humbur besueshmërinë. Edhe në këtë kuptim unë nuk do të pajtohesha që ata të jenë të pranishëm. Në anën tjetër mendoj se ekziston një pjesë e mirë e publikut të cilët në ekspertët ndërkombëtar gjejnë ekspert të pavarur kështu që ky është një diskutim shumë, shumë i rëndësishëm. (Emina Buzinkic, Shoqata e të Rinjve të Kroacisë, Kroaci, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

Mendoj se dilema e zgjedhjes eventuale të të huajve në Komision, nuk do të them bashkësisë ndërkombëtare sepse në këtë rast po flas për individ, do të mund të bëhej me të njëjtat kritere si zgjedhja në vendet e rajonit, pra me të njëjtat kritere. Pra që të jetë person me moral, me biografi të vërtetuar dhe me gjithë atë që mund të siguroj pjesëmarrja e tij në aspektin kualitativ. Do të thotë në këtë kuptim nuk duhet të turpërohemi për të krijuar rregullën nëse duhet apo jo të kemi të huaj në Komisionin tonë. (Amir Talic, Shoqata e Llogoristëve Sanski Most, BH, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009).

37.3. Punëtorja: Mandati i KOMRA

Në debatin për mandat morën pjesë 56 pjesëmarrës të forumit të Pestë, në mes të cilëve kishte aktivistë për të drejtat e njeriut, avokatë dhe 10 pjesëmarrës të familjeve të viktimave nga rajoni. Drejtues ishin Gordan Bosanac (Qendra për studime paqësore, Kroaci) dhe Bogdan Ivanisevic (Qendra ndërkombëtare për Drejtësi Tranzicionale).

KOMRA duhet të merret me zbulimin e varreve masive, zhdukjeve me dhunë, vrasjeve masive dhe përndjekjen e popullatës civile.

Nga këto vepra unë sigurisht i kisha veçuar varret masive, dmth këto janë veprat më të rënda... Pastaj vijnë zhdukjet e dhunshme apo me dhunë... Mendoj që kjo është çështja e cila e meriton mandatin e plotë të KOMRA-s, fati i këtyre njerëzve, vendet e mundshme ku gjenden trupat e tyre, mënyra e zhdukjes. Pastaj vijnë vrasjet, do të thotë vrasjet në forma të ndryshme të pavarura nga gjërat të cilat i dimë për varrezat masive, e pastaj vijnë kampet, përndjekja etnike, sigurisht të shtrirjeve më të mëdha. (Salem Ćorbo, Shoqata Kthimi dhe Mbijetesa e Qëndrueshme, BH, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009.)

KOMRA duhet të përfshijë kohën para shpërthimit të luftimeve të armatosura të vitit 1991 por edhe kohën pas vitit 2001.

Shqiptarët nga Kosova këtë diskriminim e shohin në kontinuitet, atje nuk ka filluar në vitet e '90-ta por shumica thonë se ka filluar gjatë viteve të '80-ta, pas vitit 1981 kur patën filluar burgosjet, madje edhe vrasjet, kur ushtarët vriteshin nëpër kazerma të ndryshme nëpër pjesë të ndryshme të Jugosllavisë dhe mua më duket se do të kishte qenë mirë nëse do të flisnim më shumë për këtë gjë sot. (Nora Ahmetaj, aktiviste për të drejtat e njeriut, Kosovë, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, më 29-30 maj 2009.)

Në Kosovë do të duhej të mbulohej koha nga 11 marsi i vitit 1981 kur një student në mensën studentore në Prishtinë e kishte gjuajtur pjatën në tokë, në kohën kur kishte arritur stafeta e Titos në qendër të Prishtinës dhe aty u pat kërkuar që Kosova të firon statusin e republikës dhe në anën tjetër ky student pat thirrur 'Poshtë Tito!...' kështu që në thelb lufta e armatosur në Kosovë nisi më 11 mars të vitit 1981, dhe sipas meje mori fund më 9 qershor të vitit 1999 kur u nënshkrua marrëveshja e Kumanovës. (Teki Bokshi, avokat nga Kosova, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009.)

Komisioni duhet të shpjegojë çka ka ndodhur para se të fillonin veprimet luftarake sepse veprimet luftarake nuk filluan nga vetvetja, atyre iu kanë paraprirë

pësjellime të caktuara politike, konfliktet e kështu me radhë. Dhe duhet të nisët vetëm nga janari i vitit 1991 dhe të flitet si kanë filluar këto veprime luftarake. Mua më duket se nuk do të jetë punë e plotë nëse në fakt nuk bëhet një hyrje, përkatësisht nëse nuk bëhet një bazë e cila do të mund të shërbente për shqyrtim më real të rrethanave para fillimit të veprimeve luftarake. (Amir Kulagic nga Srebrenica, BH, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009.)

Për Kosovën vlen rregulla që çështja ende nuk është e definuar dhe e përfunduar dhe se atje ende ndodhin krimet. Asgjë nuk mund të merr fund me vitin 2001 kur tashmë në vitin 2006 e kemi dikë të kidnapuar dhe për të cilin edhe sot nuk dihet asgjë. (Olivera Budmir, Shoqata e Familjeve e të rrëmbyerve, të zhdukurve dhe të vrarëve në Kosovë, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009.)

Pjesë e mandatit të KOMRA-s duhet të jenë edhe krimet seksuale, mobilizimi i dhunshëm i refugjatëve dhe përgjegjësia institucionale.

Krimet seksuale, dhunimet, prostitucioni i dhunshëm e pastaj robërimi seksual, shtatëzënia e dhunshme... duhet të hyn në mandatin e KOMRA, pastaj mobilizimi i dhunshëm i refugjatëve, gjë që ka ndodhur në Serbi gjatë viteve 1993, 1994 e mjaft masovikisht edhe në vitin 1995... Unë do të dëshiroja se në atë që quhet anatomi e krimit t'i shtohet edhe pyetja e përgjegjësive institucionale. (Staša Zajović, Gratë në zi, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009.)

KOMRA duhet të merret me viktimat e bombardimeve të NATO-s.

Ekzistojnë viktima të cilat janë pasojë e bombardimit, në fakt të bombardimit të NATO-s; për shkak të kësaj ka shumë njerëz të cilët janë zhdukur, nëpër trena, nëpër ura... Kjo gjithashtu është një gjë e cila duhet të njihet. (Olivera Budimir, Shoqata e familjeve të të rrëmbyerve, të zhdukurve dhe të vrarëve në Kosovë, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009.)

KOMRA duhet të zbardhë karakterin e konflikteve të armatosura dhe përgjegjësinë e bashkësisë ndërkombëtare.

Mandati i KOMRA-s do të duhej të ishte dy gjëra. E para, do të duhej të ishte karakteri i konflikteve të armatosura. Sidoqoftë, ne duhet të vejmë në pyetje në tërësi, prej Srebrenicës e më tej, çka ka bërë bashkësia ndërkombëtare për të zgjidhur problemin e konflikteve në ish Jugosllavi. (Narcis Misanovic, Organizata e vetme për luftëtarët e demobilizuar, BH, Forumi i Pestë Rajonal për tranzicionin e drejtësisë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009.)

KOMRA duhet t'i bashkojë shoqatat e viktimave në kërkesën që të gjinden të zhdukurit dhe për dënimin e atyre të cilët kanë kryer krimet.

Nuk kam drejtë që këtu të paragjykoj, të bëj thirrje dhe të gjykoj se kush është keqbërës më i madh apo më i vogël. Nuk kam të drejtë ta bëj këtë gjë por kam të drejtë të them se duhet të bashkohemi dhe të kërkojmë mundësitë e gjetjes së numrit sa më të madh të personave të zhdukur dhe të përgjigjet ai i cili e ka bërë krimin mbi ta. Nëse shndërrohemi në gjykata, nëse e paraqesim veten si avokatë të caktuar, gjyqtarë apo çka do, prej KOMRA nuk do të ketë asgjë. (Marko Grabovac, Shoqata për kërkimin e luftëtarëve të robëruar, civilëve të zhdukur të Republika Serbska, BH, Forumi i Pestë Rajonal për tranzicionin e drejtësisë, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009.)

KOMRA duhet të përpilojë listën e humbjeve në njerëz gjatë luftimeve të armatosura.

Komisioni Rajonal për t'i vërtetuar faktet duhet të krijojë një listë të humbjeve në njerëz, apo listë të atyre që kanë pësuar, por me këtë mënyrë për secilin preson që e ka humbur jetën apo është rrëmbyer dhe larguar apo në ndonjë mënyrë tjetër është zhdukur apo vrarë të ketë një karton në të cilin duhen paraqitur të gjitha të dhënat personale, duhet të ketë vend ku shkruhet nëse ky person ka qenë pjesëtar i ndonjë formacioni të caktuar ushtarak apo ka qenë civil, duhet të shkruhen rrethanat në të cilat ky person e ka humbur jetën apo është larguar e kështu me radhë, a është identifikuar, a është varrosur e kështu me radhë. (Amir Kulagic nga Srebrenica, BH, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009.)

KOMRA duhet të organizojë mbrojtjen e dokumentacionit të organizatave joqeveritare.

Mendoj se do të ishte mirë që KOMRA të punojë

drejt krijimit të një baze të vetme të të dhënave jo vetëm të viktimave por edhe të dokumenteve të cilat mund të gjenden tek institucionet joqeveritare, t'i sistematizon ato, ti mbron në mënyrë adekuate kësh-tu që të mos shkon deri te humbja apo shkatërrimi i dokumenteve të caktuar dhe shumë të rëndësishëm, të cilët mund të ndihmojnë jo vetëm në identifikimin e viktimave por edhe në vërtetimin e fakteve tjera të cilat mund të zbardhin rrethanat apo modelet e kimit në një territor të caktuar. (Amir Kulagic nga Srebrenica, BH, forumi i Pestë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009.)

KOMRA duhet të merret me përgjegjësinë e institucioneve.

Unë do ti jepja KOMRA mandat që të merret jo vetëm me veprimet e individëve por edhe me veprimet e institucioneve, organeve. Pse të mos merret KOMRA me krimet të cilat i kanë kryer shtëpitë mediale ... përkatësisht kryeredaktorët e tyre, gazetarët e kësh-tu me radhë, pastaj pse KOMRA nuk do të merrej me faktin se organe të caktuara policore dhe polici të tëra të shteteve të rajonit në një mënyrë kanë qenë kryes, në fakt urdhërues të krimeve të cilat janë kryer nëpër kampe, burgje etj. (Ibro Bulic, Prokuroria e BH, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësinë tranzicionale. Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009.)

Nuk ka krim, krimi është shumë i sofistikuar, dikush e ka menduar dhe e ka organizuar, dikush e ka kryer, dikush e ka aplauduar, dikush e ka nxitur e kësh-tu me radhë. I përkrahë të gjithë ata të cilët thonë se duhet të merremi me institucionet, në fakt me njerëz në institucione. (Amir Kulagic nga Srebrenica, BH, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009.)

KOMRA duhet të zbardh fakte të cilat deri tani nuk janë vërtetuar, e të cilat kanë të bëjnë me konfliktet në rajon, si dhe faktet të cilat kanë të bëjnë me përgjegjësinë individuale.

Ekzistojnë faktet të cilat i ka vërtetuar Tribunali për ish Jugosllavinë, fakte të cilat nuk mendoj që përsëri duhet t'i vërtetojmë, por thjeshtë duhet të kopjohen, të huazohen... Lista e dytë e fakteve do të jetë për faktet e vërtetuara të cilat deri tani, në fakt që nga fillimi i punës së KOMRA i kanë vërtetuar organet e drejtësisë në shtetet e caktuara të rajonit. Mirëpo, aty do të shfaqen problemet sepse një fakt i vetëm do të vërtetohet ndryshe nga ana e gjykatave të ndryshme. Dhe

lista tjetër do të duhej të ishte ajo e fakteve të cilat nuk janë vërtetuar dhe të cilat duhen vërtetuar, të vihen në listën e fakteve të cilat duhen vërtetuar. Këto do të duhej të ishin fakte që kanë të bëjnë objektivisht me luftën, konfliktet në rajon, e pastaj do të pasonin faktet që kanë të bëjnë me vepra të kryera individualisht, me përgjegjësi individuale. (Ibro Bulic, Prokuroria e BH, forumi i Pestë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009.)

KOMRA duhet të merret me viktimat, të vërtetojë pse janë vrarë njerëz të pafajshëm dhe të ndihmon në gjetjen e mbetjeve mortore.

Zotërinj të dashur për mua aspak nuk ka rëndësi ngushëllimi juaj, që ky shtet është fajtor. Për mua kjo nuk ka rëndësi. Për mua ka rëndësi që të dijë se tre personat (nëna, babai dhe vëllai) për të cilët thash se janë vrarë, t'i gjej mbetjet mortore, ti varrosi në përputhje me zakonet e mia dhe zakonet e kombit tim, dhe të paktën të dijë se kush dhe për çfarë qëllimi e ka bërë këtë. (Milosav Stojković, Shoqata e të rrëmbyerve dhe të vrarëve në Kosovë, Forumi i pestë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)

Viktimat ndaj të cilave është kryer krimi janë persona të mbrojtur nga konventa e Gjenevë.

Në të drejtën ndërkombëtare, në fakt në zakonet e të drejtës ndërkombëtare, persona të mbrojtur janë të gjithë ata ndaj të cilëve është kryer krimi. (Ibro Bulic, Prokuroria e BH, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)

Çdo kush që ka përjetuar dhunë, të mos harrojmë këtë gjë, nga maltretimi fizik, seksual, joseksual e tjera, e deri te vrasja me anë të torturës, është viktimë e cila është e palejueshme dhe e papranueshme. (Srđan Dvornik, aktivist për të drejtat e njeriut, Kroaci, Forumi i pestë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.- 30.maj 2009.)

Mandati i KOMRA nuk duhet të jetë i kufizuar. Komisioni duhet të siguron dhe të ruan dokumentacionin, ndërsa varet nga organet gjyqësore që ta përfundojnë punën.

Për këtë arsye mendoj se kur është në pyetje mandati i vetë organit, duhet të jetë i pakufizuar. Sepse krimi i luftës nuk vjetrohët... Çështja e dytë... të siguron që të mos zhduket dokumentacioni. Nëse

i ruani dokumentacionet herdokurë keqbërësi do të shpallet keqbërës, e viktima do të fitojë satisfaksionin. Secili krim është unik dhe secili dokument i cili sot mund të ruhet duhet të arkivohet në mënyrë që shtetet tona të bëjnë presione mes veti që kjo punë në kuptimin juridik të merr fund. Kush do ta përfundojë? Vetëm organet shtetërore dhe gjykatat. Ne nuk mund të pretendojmë se e kemi karakterin e çfarëdo organi gjyqësor. (Branislav Radulović, Shoqata e juristëve të Mali të Zi, Forumi i Pestë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)

KOMRA duhet të ketë sukses, andaj nuk duhet të merret me shkaqet e luftës.

Mendoj se nuk duhet të merremi me shkaqet e luftës, do të thotë me çështjen se kush ia nisi, me vrasjen e dasmorit serb, apo në Borovo Selo, e kështu me radhë, por të kemi gjithmonë parasysh se KOMRA duhet të ketë sukses. Në të kundërtën nuk do të ketë sukses, nuk do t'i përvetësojë të gjithë shtatë qeveritë dhe parlamentet. (Jasna Bogojević, aktiviste e organizatave joqeveritare nga Serbia, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësinë tranzicionale, 28. dhe 29. 06.2009. Budvë, Mali i Zi)

Shkaqet, implikimet politike, vepruesit, këto janë gjëra të rendit të dytë, të parëndësishme, jo ato të cilat duhen mënjanuar por duhen nxjerrë në pah. Këto vijnë në rend pas dhe e vetmja gjë ku KOMRA mund t'i jep vetes mandat të plotë, është çështja e dëshmimeve të viktimave nga vetë goja e tyre, detektimi i asaj që ka ndodhur, ta çoj çështjen deri në fund. (Srđan Dvornik, aktivist për të drejtat e njeriut, Kroaci, Forumi i pestë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)

Konsideroj që Komisioni duhet të merret më shumë me pyetjen e fakteve se sa me vetë kualifikimet juridike të krimeve të caktuara. Komisioni nuk do të duhet të hynte në implikimet juridike por vetëm duhet të paraqet llojin e krimit në kuptim të rrëmbimit, vrasjes, dhunimit e kështu me radhë, ndërsa në pyetjen e përndjekjes gjyqësore natyrisht të pritët që me këtë do të merren gjykatat dhe organet gjyqësore. (Howard Varney, Qendra ndërkombëtare për drejtësinë tranzicionale – ICTJ, Forumi i pestë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)

KOMRA duhet të merret me shtetësitë e anuluar në Slloveni.

Ka të bëjë me anulimet e nënshtetësisë së Republikës së Sllovenisë dhe të kuptoni se sa problem i madh është ky. Duhet t'u them se ende janë 12.000 njerëz të shlyer nga Sllovenia. Nuk do të doja t' zvogëloja rastet më të rënda të armatosura të cilat kanë ndodhur në Jugosllavi por që edhe këto akte kriminele të përndjekjes, nuk e di a është kjo shprehje adekuate, tashmë e kam harruar gjuhën serbo-kroate, që edhe këso gjëra të hyjnë në interesim të KOMRA. (Aleksandar Todorović, Nisma civile e të shlyerve, Slloveni, Forumi i Pestë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)

37.4. Punëtorja: Dëgjimi publik dhe marrëdhënia ndaj kryesve të krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut

Në debat morën pjesë 75 pjesëmarrës të Forumit të Pestë për drejtësinë tranzicionale, në mes të cilëve ishin 25 përfaqësues nga shoqatat rajonale të familjeve të viktimave. Pos sugjerimeve dhe këshillave në lidhje me temat e punëtorisë, disa pjesëmarrës ishin të mendimit se prioritet ishte vërtetimi i shkaqeve të luftës dhe krimeve,² ndërsa përfaqësuesit e shoqatave serbe shprehën se serbëve u duhej garanci që të gjitha viktimat do të trajtoheshin barabartë.³ Moderatorët e debatit ishin Tea Gorjanc- Prelević (Aksioni për të drejtat e njeriut, Mali i Zi) dhe Dinko Gruhonjić (Shoqata e pavarur e gazetarëve të Vojvodinë, Serbi).

Dëshmia e drejtpërdrejtë e viktimave jep hapësirë për katarsë dhe bashkëndjesi.

Arsyeja pse sipas mendimit tim dëgjimet publike janë shumë të rëndësishme, kur flasim para së gjithash për empatinë, është fakti se për shembull rasti tani i përmendur i vrasjes së të rinjve boshnjakë (Shkorpionët) dhe xhirimet të cilat u treguan nga ana e të gjitha stacioneve televizive në Serbi, ajo të cilën unë arrita ta përcjelli në publik së pari ka shkaktuar shok, e pastaj dhimbje dhe ndjesi për këto viktimat. (...) Mendoj se KOMRA në praktikë është rasti i parë serioz, dhe kam frikë rasti i fundit që të dëgjohet zëri i viktimave. (Dinko Gruhonjić, Shoqata e pavarur e gazetarëve të Vojvodinës, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)

Andaj dëgjimet publike do të jenë një lloj i çlirimit, një lloj i katarsës dhe natyrisht një lloj i ndihmës tejet të çmueshme për ata të cilët do t'i procesojnë krimet

2 Ibrahim Čekić, ish i dënuar politik nga Mali i Zi: Mendoj se kjo që ju po përpigëni të merreni me pasojat është një gabim shumë i madh, sepse para së gjithash mendoj se këtu duhet të merremi me shkaqet, përkatësisht me shkakun që ka sjell të kemi sot Srebrenicën, Dubrovnikun, Bijelinën, çka di, Sarajevën etj.

3 Milena Parlić, Shoqata e familjeve të rrëmbyerve dhe të vrarëve në Kosovë. Serbi: Për ne është shumë me rëndësi individualizmi i krimit, që mos të ketë aspak politikë në KOMRA, që kjo të mos ekzistojë fare. Pra, që të gjitha viktimat të jenë të barabarta, kjo është më e rëndësishme për ne.

e luftës. (Jusuf Trbić, Bashkësia kulturore boshnjake Preporod, BH, Forumi i Pestë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)

Nuk e di a keni dëgjuar për të Shlyerit e Republikës së Sllovenisë? Deri sa nuk filluam të dëshmojmë, personalisht nuk kemi bërë asgjë. Publiku nuk ka ditur për neve, sllovenët nuk kanë bashkëndjerë me neve, e kur filluam të dëshmojmë në publik, nga 5 për qind i depërtimit në publikun slloven kemi arritur në 45 për qind. (Irfan Beširević, Qendra sociale, Rog, Slloveni, Forumi i Pestë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)

Mendoj që është shumë e rëndësishme që t'i shohim viktimat me emër dhe mbiemër dhe në fytyrë, me lot, me dhimbjen, pavarësisht se sa e vështirë do të mund të ishte kjo gjë, por kjo është e vetmja mënyrë se si të vijmë në vete ndoshta, pas tërë këtyre viteve dhe që ndoshta fëmijët tanë të nisin të bëjnë diçka tjetër në këto vende, e të mos kthehemi vazhdimisht dhe të silllemi në rreth. (Ljiljana Stojanović, Qendra për demokraci dhe zhvillim të jugut të Serbisë, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)

Kur është në pyetje dëshmia publike do të doja të them se kjo është gjë e drejtë, që len përshtypje shumë të madhe në të gjithë njerëzit rreth neve dhe në rajon... (Ljubiša Filipović, Shoqata e familjeve të rrëmbyerve dhe të vrarëve në Kosovë, Crveni božur, Mali i Zi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)
Nocionin e viktimës duhet definuar në përputhshmëri me standardet e të drejtave të njeriut.

Viktimë është secili individ apo grup mbi të cilin është kryer krimi, gjithashtu viktimë është qytetari mbi të cilin është kryer çfarëdo lloj i dhunës i motivuar nga akti kriminel dhe jo njerëzor apo me anë të veprimit kundër standardeve të pranuar ndërkombëtarisht të cilat garantojnë realizimin e të drejtave të njeriut. (Velija Murić, Komiteti malazias i juristëve për të drejtat e njeriut, Forumi i Pestë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)

Duhet treguar me gisht mbi atë që është organizatori i të gjithë kësaj, duhet bërë dallimin në mes viktimave. Një gjë është viktimë e cila është vrarë në prag të shtëpisë së saj, tjetër është ai i cili ka shkuar në vend të huaj që të kërkon diçka e kështu me radhë. (Ibrahim Čikić, ish i burgosur politik, Mali i

Zi, Forumi i Pestë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)

Viktimë është edhe ai i cili është vrarë në pragun e vet, por në të njëjtën kohë viktimë janë edhe ata të cilët janë përndjekur dhe përzënë nga shtëpitë e tyre, do të thotë nuk janë vrarë. Andaj nocioni i viktimës ka shumë shumë kuptime dhe mendoj se gjatë punës së KOMRA, dhe posaçërisht në të folurit publik, të mos bëhen vlerësime të njëjta, aty ku nuk guxohet të bëhen. (Esad Kočan, javorja Monitor, Mali i Zi, Forumi i Pestë rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)

Dëgjimet publike nuk duhen kufizuar vetëm në viktimë.

Jam i mendimit se duhen dëgjuar të gjithë ata të cilët duan të japin rrëfimin sepse ne nuk jemi në gjendje e as që jemi të thirrur që të vlerësojmë nëse dikush është keqbërës apo jo. Natyrisht, për këtë duhet siguruar një mekanizëm, ndoshta ky nuk është termin i duhur, për mbrojtjen e dëshmitarit. (Jusuf Trbić, Bashkësia kulturore boshnjake Preporod, BH, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)

Kur janë në fjalë kryesit e krimit, mendoj se ata gjithashtu vuajnë, kanë mjaft trauma dhe se tregimet e viktimave mund t'i shtyjnë që edhe ata të rrëfohen, dhe mendoj se është shumë me rëndësi që gjatë rrëfimit të tregimit të mos kacafyten, të mos fyhen, që tregimi të jetë ashtu si është dhe të krijohet një hapësirë për tregim, të ketë hapësirë për të gjitha tregimet. (Teufika Ibrahimfendić, Gratë Viva, BH, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)

Për të gjetur se ku janë zhdukur, për ata që nuk janë aq të fajshëm, që kanë pasur faje më të vogla, që nuk kanë qenë kriminelë më të mëdhenj lufte, ndoshta duhet aprovohet ajo klauzolë për t'iu mundësuar që të dëshmojnë publikisht, që publikisht të nxjerrin gjënë në të cilën kanë qenë pjesëmarrës, në mënyrë direkte apo indirekte, në mënyrë që të arrijmë deri tek e vërteta. (Nada Dabić, Esperanca, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 29.-30. maj 2009.)

Megjithatë duhen konsideruar ndryshe ata të cilët e kanë kryer krimin duke i zbatuar urdhrat, pra duke i respektuar urdhrat e eprorëve të tyre apo thjeshtë qëndrime politike dhe nacionale nga ata të cilët

praktikisht në emër të tyre kanë kryer krime duke u udhëhequr nga qëllimi kriminal. (Velija Murić, Komiteti malazias i juristëve për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i Pestë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 28. - 29. maj 2009.)

Në mesin e pjesëtarëve të ushtrisë dhe policisë, në çdo vend ka asi që kanë nevojë të madhe që nën kushte të caktuara dhe në lidhje me raste të caktuara të tmerrshme, të flasin. Jo publikisht – tregohet se kur flasin publikisht kjo përfundon tmerrshëm (për ta) ... Mirëpo nëse ne ia arrijmë të krijojmë një klimë të ndryshme, që kjo të jetë klimë e përkrahjes për ata të cilët flasin publikisht, dëshmojnë për krime, atëherë sigurisht edhe për ata do të jetë më e lehtë që të lajmërohen dhe pastaj në kuadër të këtyre dëgjimeve publike të flasin për krimet. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 28. - 29. maj 2009.)

Në përzgjedhjen e viktimave që të dëshmojnë publikisht përparësi duhet dhënë atyre viktimave dëshmitë e të cilave vërtetohen nga dëshmitarët tjerë.

Mendoj se nuk duhet bërë seleksion, mendoj që në fakt duhet t'u jepet mundësia ta thonë publikisht atyre njerëzve të cilët duan ta bëjnë këtë gjë, nuk do të bëja seleksion në bazë të mënyrës se si mund të dëshmojnë, me rëndësi është dëshira e këtyre njerëzve që të marrin pjesë. (Ljupka Kovačević, Anima, Mali i Zi, Forumi i Pestë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 28. - 29. maj 2009.)

Unë jam i mendimit që të dëgjoen edhe viktimat edhe dëshmitarët dhe mendoj se kur të marrim parasysh seleksionin e atyre që do të flasin publikisht, përparësi t'u jepet viktimave dëshmitë ose tregimet e të cilëve mund të mbështeten nga dëshmitarët. (Dragoljub Duško Vuković, gazetar nga Mali i Zi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 28. - 29. maj 2009.)

Mendoj që posaçërisht ishte dashur të dëgjoen gratë, viktimat të dhunimit. (Sonja Radošević, gazetare nga Mali i Zi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Mali i Zi, 28. dhe 29.05.2009.)

Viktimat duhet të dëshmojnë lirshëm, e jo të merren në pyetje si para gjyqit.

Mendoj se duhet lejuar që të flasin lirshëm e të mos e ketë formën e ndonjë veprimi hetues. Thjesht ngase njerëzit në biseda të tilla thonë se kjo gjë duhet respektuar. Disa prej tyre ndoshta mundën pak a shumë, por mendoj që nuk duhen të merren në pyetje... (Ljupka Kovačević, Anima, Mali i Zi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 28. - 29. maj 2009.)

Ekziston dilema se a duhet viktimat publikisht t'i emërtojnë kryesit e krimeve.

A duhen emëruar, kjo gjithashtu është dilemë, a duhet emëruar kryesit e krimeve apo jo. Mendoj se gjatë deklaratave publike, dhëniet publike të dëshmitëve, nuk duhen bërë, por pasi që nuk do të jenë të gjitha dëshmitë publike atëherë mendoj që Komisioni thjesht duhet t'i ketë këto të dhëna. (Ljupka Kovačević, Anima, Mali i Zi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 28. - 29. maj 2009.)

Pra nëse KOMRA nga faktet që disponohen konstaton mjaftë dëshmi të tjera për situatën në fjalë, ai në thelb do të mund të emëronte kryesit e krimeve pa e vrarë mendjen për këtë. Dhe mendoj se në raste të tilla kjo edhe do të duhej të bëhej në këtë mënyrë. (Tea Gorjanc-Prelević, Aksioni për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 28. - 29. maj 2009.)

Kam pasur rastin të dëgjoj shumë njerëz të cilët kanë përmendur emra të atyre që i kanë kryer krimet. Natyrisht, ka dallim në mes asaj se njeriu i cili flet ka dëgjuar për diçka apo është dëshmitar që ka parë, që thuhet, me vetë sytë e tij. (Jusuf Trbić, Bashkësia kulturore boshnjake Preporod, BH, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 28. - 29. maj 2009.)

Nga pozita e gazetarit profesional duhet të them se është shumë e rrezikshme të koklavitemi me emrat e kryesve të krimeve nëse nuk kemi dëshmi për këtë gjë. Ngase, me këtë hymë në një zonë potenciale të mallkimit e kështu me radhë, dhe mund të vijmë në një situatë ku viktimat të cilat për shkak të faktit që eventualisht nuk mund të vërtetojnë se dikush është kryes i krimet, të gjykoen nga ata të cilët i kanë kryer krimet, apo nga ata që thuhet se e kanë kryer krimin, dhe ne nuk do të jemi në gjendje, apo Komisioni nuk do të jetë në gjendje që t'i mbrojë. (Dragoljub Duško Vuković, gazetar nga Mali i Zi,

Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 28. - 29. maj 2009.)

Përdorimi emrave të kriminelëve apo dëshmitarëve apo çfarëdo emrave, kjo shkel principin e drejtësisë, strukturave legale të secilit shtet. Atëherë, a do të kemi dy drejtësi në këtë rast? Një civile dhe tjetrën shtetërore? Apo këto dyja do ta përplotësojnë njëra tjetrën, dhe kështu disi KOMRA do të bëjë servis publik i institucioneve të prokurorisë apo e prokurorit shtetëror në procesimin e kriminelëve të luftës. (Bruno Čavić, veteran nga Kroacia, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 28. - 29. maj 2009.)

Pra, një gjë është që dikush gjatë dëshmisë ta thotë një emër, e tjetër është kur ky emër shkruhet në raport. Në të dy rastet ka rëndësi sasia e dëshmive. Sepse, kini kujdes, ju ndoshta jeni përgjegjës për hakmarrje, apo liroheni nga hakmarrja nëse keni pasur mjaft bazë për të besuar në të vërtetën e asaj që keni folur. Andaj nëse KOMRA për hir të ndërtimit të fakteve ka dhënë mjaft dëshmi tjera mbi këtë situatë, ai në fakt do të mund të emëronte pa frikë kryesit e krimeve dhe mendoj se në këto raste kjo edhe do të duhet bëhet në këtë mënyrë. (Tea Gorjanc-Prelević, Aksioni për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 28. - 29. maj 2009.)

Familjet e viktimave duhet të vendosin për amnistinë e kryesve të krimit.

Duhet dhënë amnisti të gjithë atyre që bëjnë mirë, atyre që duhen shpërblyer. Mendoj se familjet tona duhen vetë të vendosin se a do të amnistojnë. Zoti do t'i dënojë të gjithë ata që kanë bërë keq, dhe secili kriminel ka emër dhe mbiemër. (Verica Tomanović, Shoqata e familjeve të të rrëmbyerve dhe vvarëve në Kosovë, Serbi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 28. - 29. maj 2009.)

Ekziston dilema se a duhen të thirren përfaqësuesit institucioneve që të dëshmojnë publikisht. A duhet mbajtur dëgjime publike të përfaqësuesve të institucioneve, unë mendoj që jo. (Ljupka Kovačević, Anima, Mali i Zi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 28. - 29. maj 2009.)

Kur bëhet fjalë për çështjen se a duhet mbajtur dëgjime publike të përfaqësuesve të institucioneve, mendoj se kjo është një gjë shumë relevante sepse

nëse do t'ia arrinim t'i dëgjonim publikisht përfaqësuesit e institucioneve, në këtë mënyrë do të krijojmë një kontakt specifik me ta, përkatësisht me ata të cilat institucionalisht do të duhej të merreshin me krimet e luftës, me kompensimin e dëmeve, me të dëmtuarit e kështu me radhë. (Velija Murić, Komiteti malazias i juristëve për të drejtat e njeriut, Mali i Zi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 28. - 29. maj 2009.)

Nëse duhet t'i vërtetojmë faktet, dhe nëse kjo është një nga mënyrat për ta bërë këtë gjë, e pastaj nga këto fakte të vërtetuara të arrijmë deri te diçka që do të na sprapsë, madje edhe disa nga paraardhësit tanë nga kryerja e krimit, atëherë pajtohem që atyre të cilët duan të flasin, sepse duan t'i sigurojnë vetes ndonjë lloj amnistie, apo sepse duan të pendohen etj, ta pastrojnë ndërgjegjen e tyre, t'u jepet ndonjë mundësi që t'u bëhet më e lehtë nëse e tregojnë të vërtetën. (Dragoljub Duško Vuković, gazetar nga Mali i Zi, Forumi i Pestë Rajonal për drejtësi tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 28. - 29. maj 2009.)

Organizatave joqeveritare dhe shoqatat e viktimave duhen inkurajuar viktimat që të marrin pjesë në dëgjimet publike.

Roli i organizatave joqeveritare dhe të shoqatave të viktimave në inkurajimin e viktimave që të dëshmojnë, ky është tani si një udhëzim se ato duhet të inkurajohen. (Ljupka Kovačević, Anima, Mali i Zi, Forumi i Pestë rajonal për drejtësinë tranzicionale, Budvë, Mali i Zi, 28. - 29. maj 2009.)

38. Konsulta lokale me shoqatat e të burgosurve, të mbajturve në kampe, luftëtarëve dhe viktimave të luftës rreth nismës KOMRA

**Novi Travnik, Bosnja dhe Hercegovina
6. qershor 2009.**

Konsultat janë organizuar nga Forumi i qytetarëve të Tuzllës, gjatë të cilave për herë të parë janë takuar përfaqësuesit e shoqatave të bashkësive lokale kroate dhe boshnjake të mbajturve nëpër kampe. Morën pjesë 24 përfaqësues të shoqatave të mbajturve në kampe, familjeve të dëshmorëve, luftëtarëve të rënë, si dhe një shoqatë e viktimave civile të luftës. Udhëheqësit ishin Vehid Šehić (Forumi i qytetarëve të Tuzllës), Eugen Jakovčić (Documenta, Kroaci) dhe Bogdan Ivanišević

(Qendra ndërkombëtare për drejtësi tranzicionale). Lajmërimin e ngjarjeve e ka bërë Portali live.ba.

Për shumicën e pjesëmarrësve KOMRA është një rast që të kuptohet e vërteta për atë se çka ka ndodhur në vendin e tyre, që për këtë të flasim njerëzit e thjeshtë dhe të ndalohet ndarja e fëmijëve.

Krimet nuk duhen harruar, por duhen falur sepse më kanë mësuar si fëmijë që njerëzimi përmirësohet nga aftësia dhe gatishmëria që t'ia falë kundërshtarit të vet apo ndoshta thënë më vrazhdë, armikut të vet. Andaj mendoj që KOMRA na detyron të gjithë neve që në një mënyrë të kuptojmë, të njoftohemi dhe të flasim për të gjithë atë që ka ndodhur nëpër këto rajone. (Anđelko Kvesić, shoqata kroate e të mbajturve në kampe në kantonin Bosnja e Mesme, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kampe, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

Na ndihmoni që të formohemi, në fakt të na futni në ligj si të mbajtur në kampe sepse si bashkësi e të mbajturve në kampe të BH nuk e kemi rregulluar statusin tonë. Andaj na ndihmoni tani për këtë gjë e ne pastaj nuk do të jemi kundër asgjëje, si tani që jemi. Le të formojnë, nisma është e mirë, na duhet. (...) Nuk duhet të harrojmë, le të themi, që tek ne edhe fëmijët janë të ndarë. Nuk duhet vonuar me formimin e këtyre komisioneve sepse kjo duhet bërë sa më shpejtë në mënyrë që të mos ketë ndarje të mëtutjeshme në mes neve dhe në mes fëmijëve, sepse kini kujdes, është tjetër gjë shkollimi tek kroatët, dhe gjë tjetër shkollimi tek boshnjakët, ndërsa tjetër shkollimi tek serbët, madje as nuk kemi ligj për edukim. (Husein Plivčić, Shoqata e të mbajturve në kampe e komunës Vitez, BH, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kampe, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

Ne jemi për themelimin e një Komisioni Rajonal për arsyen se një përbërës nuk dëshiron të bashkëpunojë me përbërësin tjetër, këtu e kemi ne problemin, jo te populli i thjeshtë, por te kryetarët dhe politikanët. (...) Lejoni të mbajturit në kampe, lejoni familjet e luftëtarëve të vvarë, lejoni invalidët të flasim për atë që u dhemb para këtij Komisioni. Le të formohet ky Komision dhe do të zgjidhet problemi, problemi i madh tek ne. (Mirsad Dizdara, Shoqata e të mbajturve në kampe të Bosnjës dhe

Hercegovine, Shoqata e të mbajturve në kampe e Jajces, BH, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kampe, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

Torturuesit tanë shëtisin të lirë e madje edhe gjinden nëpër pozita të larta dhe kanë detyra të larta në këtë qeveri e cila nuk bën asgjë të mirë për neve të cilët kemi vuajtur në luftën e mëmëdheut. Shumë është e rëndësishme që të përmendet që gjykatat apo gjyqet nuk bëjnë asgjë në BH kur janë në pyetje viktimat e luftës, e posaçërisht për neve të mbajtur nëpër kampe. Mendoj se themelimi i këtij Komisioni Rajonal do të sjellë vërtetimin e drejtësisë dhe të së vërtetës dhe realizimin e të drejtave të cilat neve të mbajturve nëpër kampe na përkasin sipas konventës së Gjenevës. (Marko Krajina, Kroaci, Shoqata e të mbajturve në kampe nga Fojnica, BH, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kampe, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

Kur është në fjalë kjo nismë me të vërtetë e përshtendës dhe mendoj që duhet nisur nga pozita e viktimës sepse aparati shtetëror nëse ka mundur ta zgjidhë këtë problem, apo nëse ka dashur, deri tani do ta kishte zgjidhur. Kështu që me të vërtetë është për lëvdatë, vetëm përmes dialogut, por dialogut konstruktiv, do të vijmë një ditë deri te një shoqëri me të vërtetë demokratike dhe themeli kryesor i shoqërisë demokratike është shoqëria civile, dhe kjo është qytetarët e bashkuar në realizimin e qëllimeve të përbashkëta. (Sandra Velta, Kroaci shoqata e të mbajturve në kampe nga Busovača, BH, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kampe, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

Me nënshkrimin tim, dhe të shumë shoqatave, e keni bekimin e 150 njerëzve. Unë jam i 151-ti. Do të thotë që keni 151 zëra me këtë nënshkrimin e deklaratës nga ana ime. (Petar Madacki, Shoqata e të burgosurve politikë të Kroacisë, Kiseljak, BH, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kampe, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

Shoqatat e të mbajturve në kampe duhen së bashku të bëjnë presion ndaj qeverisë që të formohet KOMRA.

Shoqatat me cak të njëjtë, me emërim të njëjtë, i kanë shenjat e tyre të ndryshme dhe zakonisht e

kundërshtojnë njëra tjetrën. (...) Me vetë këtë sjelljen e tyre i ndihmojnë qeverisë qëllimi i së cilës në të vërtetë është që të mos hyjmë në sistem të shtetit. (...) Do të mund të formohej një organizatë kulmore ku do të mund eventualisht të veprojmë së bashku për realizimin e të drejtave tona, të të vërtetave dhe qëllimeve, sepse me të vërtetë e kemi një pengesë në mes nesh. (Miralem Aletić, Shoqata e të mbajturve në kampe, BH, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kampe, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

I mbajturi në kamp është i mbajturi në kamp. Nëse do të hyjmë në ligj, shkojmë së bashku. Problemet janë të njëjta, plagët të njëjta, e kemi të drejtën e lirisë së të folurit, kemi fenë, ndoshta është rrahur e stërrahur siç më kanë rrahur mua. Ku është dallimi? Pse duhet të jemi të ndarë? Politikës dhe partive nacionale iu konvenonte të jetë kështu, i përshtatet Zagrebit, i përshtatet Beogradit. Dhe kush paguan, ne paguajmë. (Tahir Tahirović, Shoqata e të mbajturve në kamp të komunës Busovača, BH, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kamp, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

Këtë politikë ne e kemi legalizuar në zgjedhjet, ne në të gjitha zgjedhje i japim pushtet politikës. Nuk vijnë ata vet, andaj këtu ka rëndësi që ne si qytetarë, si njerëz, si qenie njerëzore të vlerësojmë a kemi kapacitet, a kemi fuqi dhe a kemi mjaft moral brenda vetes që të fillojmë në një mënyrë njerëzore të flasim për krimin ndaj çdokujt, pavarësisht se nga cila anë është kryer dhe nga kush është kryer. (Fuad Kečo, Shoqata Luftëtarët e demobilizuar, BH, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kamp, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

Si ta shtrojmë rrugën për politikanët e sodit të cilët nuk kanë vullnet që të na ndihmojnë, të formojnë një Komision të tillë. Sepse kjo nuk u përshtatet. Andaj, të mos flasim për atë se kush do të financojë, kush do të jetë anëtar, së pari t'i gjejmë rrugët e drejta me anë të cilave do të mund të bëjmë presion mbi përfaqësuesit e pushtetit ligjor dhe të lartë, që të sjellin ligjin që do të krijohet Komisioni. (Anđelko Kvesić, Kroaci, Shoqata e të mbajturve në kampe në kantonin e Bosnjës së Mesme, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kamp, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

Disa pjesëmarrës mendojnë se anëtarët e KOMRA duhet të jenë ekspertë dhe individë të cilët janë në gjendje ta dëgjojnë edhe viktimën edhe keqbërësin, pavarësisht nga përkatësia kombëtare, e disa tjerë janë të sigurt që viktimat duhet të jenë në mesin e anëtarëve.

Në këtë Komision për të cilin po flisni, e dini kush duhet të ulet. Njerëz të cilët nuk kanë qenë të lënduar, njerëz të cilët nuk kanë qenë të burgosur e të ngjuar, njerëz të cilët nuk kanë marrë pjesë në këtë konflikt, kuptoni, sepse këtu gjithkush me gjithkë ka luftuar. (...) Në Komision sipas meje duhet të jenë njerëz të cilët janë do të thosha apatikë ndaj të gjitha konflikteve të mundshme. (Petar Madacki, Shoqata e të burgosurve kroatë politikë nga Kiseljak, BH, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kamp, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

Mendoj se ky Komision rajonal duhet të përbëhet nga njerëz profesionalë të cilët nuk janë të sëmurë kur është në pyetje kombësia. (...) Merrni së pari njerëz ekspertë në Komision, që të kenë nerva së pari të dëgjojnë ata njerëz ndaj të cilëve janë bërë padrejtësitë, që kanë fuqi dhe vullnet të dëgjojnë anën e akuzuar, dhe së pari merrni njerëz të cilët nuk do të shikojnë nga ana tjetër e tavolinës se si quhet njeriu por çka ka përjetuar dhe çka ne duhet bërë në emër të pajtimit. (Matija Jakšić, Shoqata e të mbajturve në kamp nga lufta atdhetare nga Jajce, BH, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kamp, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

Ju përshëndes për formimin e këtij Komisioni, krijimin e këtij Komisioni dhe që drejtësia do t'i sjellë vendimet e saja. Në këtë Komision duhen të jetë dikush nga anëtarët e familjeve të të vrarëve, të dëshmorëve, familje e cila e ka humbur dikë të dashur, të hyn dikush nga viktimat e luftës, pavarësisht nga cila anë, serb, kroat, mysliman, dhe të hyn, të jetë anëtar, nëse ka mundësi, sepse metoda e lëkurës personale është diçka tejet specifike. (Marjan Krajina, Shoqata e të mbajturve dhe të burgosurve kroatë në kampe nga Fojnica, BH, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kampe, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

Shoqatat duhen t'i ndihmojnë punës së Komisionit me të dhënat dhe dokumentet që i posedojnë.

Kur është në fjalë dokumentacioni, kur janë në fjalë shifrat, shkresat dhe disa statistika mendoj se të gjithë kryetarët e shoqatave kanë dokumentacion të caktuar dhe duhet të kenë të tilla që do ta lehtësonin punën e Komisionit. (Tahir Tahirović, Shoqata e të mbajturve në kamp të komunës së Busovača, BH, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kamp, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

Ekziston frika se do të ketë keqpërdorime nëse qeveritë e financojnë punën e KOMRA-s.

Nga cilat mjete do të financohet nëse pushtetet e formojnë Komisionin? Do të thotë se mjetet do të sigurohen nga shteti, atëherë ne si të burgosur nuk do të gjendemi askund. Pastaj do të punësohen gjithfarë anëtarë të familjeve të ministrave, do të punësohen shoferë, e ne ende do të zvarritemi si zvarritemi edhe sot e kësaj dite. (Redo Isić, Shoqata e të mbajturve në kampe nga komuna e Travnik, BH, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kampe, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

Është shprehur dyshimi që Komisioni do të ndihmon në shpagimin e të mbajturve në kampe

Kantoni i Bosnjës së mesme është i vetmi kanton me regjim të posaçëm. Duhet të paguani për t'u vlerësuar nga Komisioni dhe në fund, në përfundim të punës së Komisionit, ju merrni përgjigje pozitive ose negative. Paguani 28 KM, por nuk do të merrni përgjigje pozitive sepse ata kërkojnë shënimet e mjekut nga periudha e luftës, do të thotë të viteve '92-93. E kujt i ka rënë në mend që të shkon te mjeku kur ka dalë nga kampi, ju lutem? Dhe kush garanton që ky koalicion, mendoj Komision, do t'u ndihmon njerëzve, t'u ndihmojë të mbajturve në kampe, do të thotë që njerëzit të jenë të shpaguear. (Redo Isić, Shoqata e të mbajturve në kampe nga komuna e Travnik, BH, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kampe, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

Më e rëndësishmja është të gjenden varret dhe mbetjet mortore të atyre që nuk janë.

Koka e vdekur, mendoj se në tërë këtë tregim, në tërë shoqërinë e BH, së paku në rajonin që unë gjendem e edhe më gjerë, më së paku vlen koka e vdekur. (...) Të drejtat materiale janë të shkelura te të gjithë, por diçka është më e vlefshme, është si tha njëri nga ne, që të dihet se ku është varri,

që kjo të zbulohet, ku dhe kush është zhdukur, por është i vdekur. Kjo është gjëja më e rëndësishme, dhe sot në këtë tregim, kërkoj falje nga të mbajturit në kamp, ata e kanë përjetuar goditjen, por goditjen më të madhe e kemi ne viktimat të cilat vetëm na mbetet të mendoj që nuk e kam më djalin. (Kulaš Haso, Shoqata e familjeve të dëshmorëve dhe luftëtarëve të vdekur të ushtrisë BH, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kampe, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

Unë do ta përshëndesja idenë e formimit të Komisionit për shkak arsyes që të gjenden të zhdukurit dhe të shpërblehen viktimat e këto janë familjet e të vdekurve dhe të zhdukurve. (Zilha Imamović, Organizata e familjeve të dëshmorëve dhe luftëtarëve të vrarë Kiseljak, BH, Konsultat lokale me shoqatat e të mbajturve në kampe, të burgosurve dhe viktimave të luftës, Novi Travnik, BH, 6. qershor 2009.)

39. Konsultat lokale me shoqëri-në civile rreth nismës KOMRA

**Leskocë, Serbi
11. qershor 2009.**

Konsultat i organizoi organizata joqeveritare *Gratë për paqen* nga Leskocë. Morrën pjesë 30 pjesëmarrës: 21 aktivistë nga organizatat joqeveritare, dy anëtarë të Partisë Demokratike, një anëtar nga Lëvizja serbe e Përtëritjes, përfaqësues të veteraneve, një përfaqësuese e pushtetit komunal, dhe dy gazetarë, aktiviste të organizatave joqeveritare.

Drejtues ishin Maja Pešić (*Gratë në të zeza*, Serbi), Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi) dhe Staša Zajović (*Gratë në të zeza*, Serbi). Debatin e moderoi Jelena Cakić, aktiviste nga *Gratë për paqe* nga Vlasotince. Konsultat i përcolli Bogdan Ivanišević, konsultues i Qendrës Ndërkombëtare për drejtësi tranzicionale. Të gjithë pjesëmarrësit e përkrahën nismën për themelimin e KOMRA. Për këto konsulta ka raportuar TV Leskovac, TV Studio MT, TV K1, JUG press.com.

Në KOMRA nuk duhet të ketë përfaqësues të pushtetit apo anëtarë të partive politike.

Nuk duhet të ndodhë që në KOMRA të ketë ndonjë anëtar të qeverisë, këtë gjë vazhdimisht e përmendi

nëpër këto mbledhje sepse ky Komision nuk do ta kishte të njëjtën peshë sikur të ketë intelektualë të pavarur, personalitete të njohura, personalitete me integritet të pacenuar, andaj shumë mirë dhe shumë me kujdes duhet të merret parasysh kur të propozohen njerëzit që me të vërtetë do të gjinden në këtë Komision. (Dobrosav Nešić, Këshilli për të drejtat e njeriut, Serbi, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Leskovcë, Serbi, 11 qershor 2009.)

Ka rëndësi tejet të madhe që në këtë Komision të mos ketë përfaqësues të pushtetit. Në momentin që përfaqësuesit e pushteti hyjnë në këto Komisione rajonale, gjithmonë do të shkatërrojnë të gjithën nga arsyeja e thjeshtë që nuk ekziston lloj më i keq i njerëzve se sa politikanët. (...) Për shkak të kësaj arsyeje mendoj që anëtarë të këtij Komisioni duhet të jenë absolutisht njerëz të integritetit, njerëz që janë të vërtetuar në lëmin e tyre, të cilët nuk i përkasin asnjë qarku partiak e as nuk janë përfaqësues të ndonjë partie. (Vjačeslav Nešić, Kryetar i Këshillit qytetar të Lëvizjes Serbe të Përtëritjes në Leskovcë, Serbi, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Leskovcë, Serbi, 11. qershor 2009.)

Veteranëve u pengojnë gjeneralizimet që bëhen, nuk mohojnë se ka pasur të atillë që kanë vrarë dhe vjedhur por në mesin e tyre ka edhe viktime.

Në mesin e veteranëve gjithashtu ka edhe viktime, ndërsa aty ka qëndrime të cilat tani unë i kam përmbledhur kështu, se ka gjeneralizime të cilat u pengojnë edhe atyre gjithashtu. Ata natyrisht nuk mohojnë se ka pasur të atillë që kanë vjedhur, plaçkitur, vrarë e kështu me radhë por kjo nuk do të thotë se këtë e kanë bërë të gjithë veteranët. (Vesna Karanfilović, përfaqësuesja e Shoqatës Veteranët e Serbisë për paqe, Serbi, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Leskovcë, Serbi, 11. qershor 2009.)

Deri sa të mos flasim për atë që ka ndodhur, ne jemi bashkëpjesëmarrës

Do t'ju përkujtoj se sa shumë janë zbardhur kulmet në Leskovcë nga antenat satelitore gjatë luftës së Kosovës, asaj të vitit 1999. A mendoni që ndonjëra nga këto antena ka qenë e blerë? Mua njerëzit në rrugë më kanë ofruar çfarëdo veture që dua për disa qindra marka. Deri sa të heshtim për këtë gjë, ne do të jemi bashkëfajtorë. (Srđan Dimitrijević, Lëvizja për Leskovac, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Lekovcë, Serbi, 11. qershor 2009.)

Do të duhet që prej gjërave më të vogla, djegieve, shkatërrimeve të pronës së huaj, tërë kjo të vendoset nën kompetencat e KOMRA, dhe të shihet se kush, pse, për çfarë arsye dhe në emër të kujt e ka bërë këtë. (Aleksandar Mihajlović, Partia Demokratike, Serbi, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Leskovcë, Serbi, 11 qershor 2009.)

Duhet vërtetuar me saktësi se kush mund të konsiderohet si viktimë. Nuk duhet të harrohen refugjatët dhe qytetarët e mobilizuar me dhunë, dhe dezertorët të cilët kanë përfunduar nëpër burgje.

Mendoj se është shumë e rëndësishme të mos harrohen refugjatët mbi të cilët thjeshtë është bërë gjueti nëpër Maqedoni dhe janë kthyer nëpër fushë-beteja të Kroacisë dhe Bosnjës. Dhe mendoj se duhet ta kthejmë vëmendjen edhe drejtë atyre njerëzve të cilët nuk kanë dashur të shkojnë në luftë, por në mënyra të ndryshme janë detyruar apo kanë përfunduar nëpër burgje. (Ljiljana Stojanović, Qendra për demokratizim dhe zhvillim të jugut të Serbisë, Serbi, Konsultat lokale me shoqërinë civile Leskovcë, Serbi, 11. qershor 2009.)

Mandati i KOMRA duhet të përfshijë kohën para fillimit të luftës në Slloveni.

Fillimi i konfliktit të cilin neve na e paraqesin, ose të cilin unë kam pasur rastin ta kuptoj, l ka qenë tregimi i djegies së flamurit jugosllav në lojën e futbollit në vitin '89. Do të thotë nuk mundemi sërish të lidhemi për Slloveninë e vitit '91, kjo ka nisur shumë shumë më herët. (Nebojša Kitanović, Lëvizja Serbe e Ripërtëritjes, Serbi, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Leskovcë, Serbi, 11. qershor 2009.)

Nga KOMRA pritet që t'i kushtojë vëmendje romëve të vrarë dhe të zhdukur. Pyetja është se a hyn në mandat të KOMRA fakti që romët në Maqedoni ende nuk kanë dokumente.

Shumë pak flitet për këtë gjë, për romët e zhdukur dhe romët e vrarë. Askush nuk e hulumton këtë gjë, sa unë, sa unë, kërkoj falje nëse nuk është kështu... Romët të cilët kanë ikur në Maqedoni ende nuk kanë kurrfarë dokumente. (Ašim Saitović, komuna Leskovcë, Serbi, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Leskovac, Serbi, 11. qershor 2009.)

Organizatave joqeveritare, anëtarët e Koalicionit për KOMRA duhet t'i kontaktojnë pushtetet

lokale dhe të fitojnë përfshirjen e tyre në procesin e konsultimit.

Së pari ne si anëtarë (të Koalicionit), si përfaqësues të këtyre organizatave joqeveritare, ne duhet të kemi kontakt me përfaqësuesit lokalë, me zyrtarë të qyteteve tona, e pastaj në bazë të përfundimeve tona rreth asaj se a janë të interesuar për punë aktive me KOMRA, të nisemi në atë drejtim. (Jasmina Mitrović, Partia Demokratike, Serbi, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Leskovac, Serbi, 11. qershor 2009.)

Për amnistinë e keqbërësve, të cilët do të pendoheshin dhe do të jepnin të dhëna rreth varreve masive, duhet të vendosin familjet e viktimave.

Mendoj se është shumë me rëndësi se si do të ishte reagimi i viktimave, familjeve të viktimave ndaj faktit se duhet edhe keqbërësit të përfshihen në tërë këtë tregim. Thjesht, rreth idesë që të amnistohen njerëzit të cilët do të zbulonin ndonjë të vërtetë rreth varrezave masive apo rreth asaj se ku gjenden njerëzit të cilët ende janë të zhdukur në territorin e ish Jugosllavisë. Nuk jam e sigurt se sa do të haste në kuptim nga ana e viktimave kjo pjesë e përfshirjes së keqbërësve. (Ljiljana Stojanović, Qendra për demokratizim dhe zhvillim të jugut të Serbisë, Serbi, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Leskovac, Serbi, 11. qershor 2009.)

Transparenca e procesit është shumë e rëndësishme. Serbët duhet të binden se nuk janë të vetmit fajtorë.

Kjo transparencë nëpër të gjitha çështjet, edhe mediat elektronike edhe tryezat e rrumbullakëta, do të ishte shumë me rëndësi që edhe mediat ta përcjellin këtë gjë, që njerëzit të fitojnë bindjen që nuk janë vetëm serbët fajtorë, që nuk janë vetëm... Mendoj se njerëzit do të relaksoheshin, ndoshta edhe do të bëhej më lehtë që t'u afrohem. (Valentina Vukosavljević-Pavlović, Fondi për zhvillimin e qytetit të Leskovcit, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Leskovac, Serbi, 11. qershor 2009.)

KOMRA nuk duhet t'i shmangët autorëve të krimeve. Pranimi i tyre është shumë i rëndësishëm.

Viktimat gjithmonë e kanë një raport subjektiv ndaj ngjarjes (...). Në lidhje me këtë nuk duhet t'i shmangem as kryesit të krimit, duhet ta përnd-

jekim, ta bëjmë që edhe ai vetë, që thuhet, ta pranojë krimin... Nuk mendova që kryesit e krimit të kyçen në këtë mënyrë, por me rastin e punës së Komisionit, pra, të dëgjohej edhe kjo anë, kur viktima të drejtohet drejtë dikujt, që Komisioni të shkon deri tek ai dhe të vazhdojë hetimet e veta, dhe edhe këtu të arrijë deri tek të dhënat të cilat do ta japin të vërtetën e plotë. (Živojin Tasić, profesor i letërsisë nga Leskovci, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Leskovac, Serbi, 11. qershor 2009.)

40. Konsultat lokale me të rinjtë për Nismën KOMRA

**Novi Sad, Serbi
12. qershor 2009.**

Konsultat u organizuan nga Fraktal dhe Programi për dialog në mes të rinjve. Morën pjesë 18 të rinj: përfaqësues të organizatave joqeveritare nga Vojvodina, tre pjesëmarrës nga degët e partive politike dhe një pjesëmarrëse nga pushtetet krahinore. Pjesëmarrësit ishin kryesisht nga Novi Sadi, Subotica dhe Kikinda. Janë shfaqur pjesë nga filmi «Ballafaqimi me të vërtetën: Komisionet për të vërtetën dhe shoqëritë në transicion (shembuj nga Afrika Jugore dhe Maroko)». Drejtuesit ishin Marijana Toma (Impunity Watch), Mario Mažić (Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut në Kroaci), dhe Maja Ledenc (Shoqata e pavarur e gazetarëve të Vojvodinës, Serbi). Moderatorët e mbledhjeve ishin Srđan Vezmar (Programi për dialog në mes të rinjve, Serbi) dhe Filip Pavlović (Fraktal, Serbi). Raportimin e konsultave e bënte gazeta ditore Danas dhe MINA.

Qasja rajonale ndaj zbardhjes së fakteve të krimeve është shumë e rëndësishme për shkak të përgjegjësisë të cilën si shoqëri e kemi ndaj viktimave.

Mëfshtë shumë e rëndësishme që të themelohet një Komision i tillë dhe zbardhja e fakteve për shkak të përgjegjësisë të cilën e kemi ndaj të mbijetuarve dhe ndaj vetë shoqërive në të cilat jetojmë. Këto fakte janë mjaftë komplekse dhe e vetmja mënyrë në të cilën këto mund të shqyrtohen është nga kjo qasje rajonale. Përqendrimi në viktima në konceptin rajonal i shlyen kufijtë në mes këtyre viktimave, i barazon dhe kështu viktimat bëhen viktimat tona. (Maja Ledenc, Shoqata e gazetarëve të pavarur të Vojvodinës, Serbi, Konsulta lokale me të rinjtë në Vojvodinë, Novi Sad, Serbi, 12 qershor 2009.)

KOMRA duhet t'i ketë primare interesat e viktimës

Ekzistojnë së paku tre lloje të interesave kur janë në pyetje komisionet: kriminelët duan t'i ikin dënimit dhe poshtërimave publike, Komisioni do që ta luajë drejtësinë dhe të drejtën, kështu më duket, e viktimat duan ta marrin vesh të vërtetën. (...) Është shumë e vështirë të gjendet vija e artë ku asnjë palë nuk dëmtohet. Dhe mendoj se është primare që Komisioni dhe anëtarët e Komisionit t'i kushtojnë vëmendje viktimave sepse mendoj që ky është më së shumti tregimi i tyre. (Dejan Rašeta, Programi për dialog në mes të rinjve, Serbi, Konsulta lokale me të rinjtë në Vojvodinë, Novi Sad, Serbi, 12 qershor 2009.)

Opinionin duhet të përgatitet për themelimin e KOMRA edhe me anë të shembujve pozitivë nga përvojat e shoqërive tjera.

Do të jepet mund i madh nga të rinjtë dhe publiku që të bëhet presion, e pastaj kjo nismë sërish lihet në duart e përfaqësuesve të institucioneve, dhe ekziston mundësia që kjo të bllokohet. Nuk e di se si parashihni që ta ndalni këtë gjë, që të mos i kthehet puna sërish politizimeve dhe animeve. (...) Para se të kalohet tek themelimi i Komisionit, do të bëhet më mirë dhe do të ketë rezultate më të mira nëse opinionin përgatitet për këtë gjë. Mendoj se kjo do të nënkuptonte promovimin e shembujve pozitivë nga bota, që njerëzit këtë të shohin që është gjë normale që dikush të përgjigjet për veprat e veta. (Ruža Helać, Fondi për zhvillimin e sektorit jo fitimprurës të krahinës autonome të Vojvodinës, Konsulta lokale me të rinjtë në Vojvodinë, Novi Sad, Serbi, 12 qershor 2009.)

Garantoj që gjysma e studentëve nuk e di saktësisht se çka është Srebrenica. Sepse ne si sektor civil jemi të informuar dhe pikërisht për këtë gjë nuk jemi të vetëdijshëm se sa sundon mosinformimi dhe mosdija, do të thotë ne nuk e dimë këtë. Andaj janë të rëndësishëm mediat, është me rëndësi që nga RTS-ja, në kanalet e mëdha, në shtëpitë mediale, të shfaqni këto tregime sepse nuk mund ta lejojmë mosinformimin. (Ana Marija Popović, Nisma ekipore e të rinjve, Fakulteti i shkencave politike, Serbi, Konsulta lokale me të rinjtë në Vojvodinë, Novi Sad, Serbi, 12 qershor 2009.)

KOMRA duhet të merret me gazetarë të cilët kanë qenë pjesëmarrës në propagandën e luftës. Mendoj që KOMRA duhet të flet për atë se cilët

gazetarë kanë qenë ata që kanë kryer propagandë luftarake dhe kanë heshtur ndaj kryerjes së krimeve të caktuara. (Srđan Vezmar, Programi për dialog në mes të rinjve, Konsulta lokale me të rinjtë në Vojvodinë, Novi Sad, Serbi, 12 qershor 2009.)

Nisma KOMRA është një mundësi që secila shoqëri t'i përmirësojë gabimet e veta dhe të spastron oborrin e vet.

Në fakt mendoj që njëri nga motivet kryesore për shmangien e ballafaqimit me të kaluarën në njëfarë niveli politik dhe ndërkombëtarë, madje edhe do të kisha guximin ta them, është një iluzion i caktuar se fëlliqet imazhi i kësaj shoqërie dhe shoqërive në rajon dhe se shtrembërohet imazhi dhe krijohet imazh i keq për vetë shtetin. (...) Mendoj se me vetë këtë proces mund të vërtetojmë se i kemi tejkaluar problemet e caktuara dhe se e kemi një pjekuri të caktuar si shoqëri. (Filip Pavlović, Fraktal, Konsultat lokale me të rinjtë në Vojvodinë, Novi Sad, Serbi, 12.06.2009.)

Ne konsiderohemi si agresorë dhe nuk e kemi zërin më të mirin në botë, pra nëpër media. Kështu që së pari do të duhej t'i përmirësonim gabimet tona, e gabimet e tyre, të them të kroatëve, tua lëmi atyre. Pra, së pari t'i spastrojmë papastërtitë para dymëve tona, t'i rregullojmë problemet tona dhe sado pak ta zbusim imazhin e shtetit tonë në botë. Dhe me vetë këtë gjë do ta përmirësonim situatën në përgjithësi. (Mile Novaković, Shoqata Sigo ando Them, Serbi, Konsulta lokale me të rinjtë në Vojvodinë, Novi Sad, Serbi, 12 qershor 2009.)

Më e rëndësishmja për KOMRA është përkrahja ndaj viktimave sepse institucionet nuk mund ti shpërfillin këta.

Në momentin kur shoqatat e viktimave do të fillojnë të bëjnë presion ndaj shtetit do të vij deri te... Sepse këto janë grupe të njerëzve të cilët për një kohë mund t'i shmangeni e të mos i shikoni, por nuk mund t'i injoroni në tërësi kur këta gjenden para dymëve të institucioneve dhe kërkojnë gjëra të caktuara. Dhe këtu me të vërtetë e shoh mundësinë që KOMRA t'i del në fund problemeve eventuale në të ardhmen. (Marijana Toma, Impunity Watch, Serbi, Konsulta lokale me të rinjtë në Vojvodinë, Novi Sad, Serbi, 12 qershor 2009.)

KOMRA duhet të merret me krime kundër

civilëve, me zhdukje dhe me krimet kundër pengjeve të luftës.

Duhet të ketë theksime tek zhdukjet, por gjithashtu mendoj se duhet të përfshihen të gjitha krimet. Periudha kohore të shtrihet më së shumti deri në tre vjet. (Jovana Kolarić, studente nga Novi Sad, Serbi, Konsulta lokale me të rinjtë në Vojvodinë, Novi Sad, Serbi, 12 qershor 2009.)

Ndoshta duhet të rrudhet mandati i Komisionit në disa aspekte të caktuara të krimit për shkak të kapacitetit të kufizuar të shoqërisë sonë, që të mos derdhemi nëpër tërë aspektet e krimit e kështu nuk do të arrinim askund. (Ruža Helac, Fondi për zhvillimin e sektorit jo fitimprurës të krahinës autonome të Vojvodinës, Serbi, Konsulta lokale me të rinjtë në Vojvodinë, Novi Sad, Serbi, 12 qershor 2009.)

Lufta është luftë. Gjuhet, vriten, ushtari në ushtar. Por kur ushtari gjuan në civil kjo me të vërtetë nuk është humane dhe sipas meje nuk ka kurrfarë arsytimi. Së pari kjo do të duhej të rregullohej dhe masakrimet tjera të civilëve, ekshumimi i varreve në Srebrenicë dhe kudo që ka ndodhur. Komisioni do të duhej ta jepte një afat i cili nuk do të duhej të ishte shumë i gjatë, mendoj diku në mes një viti dhe dy, dhe së pari kjo gjë ishte dashur të zgjidhej. Kjo është, për mua, një çështje e nxehtë. (Mile Novaković, Shoqata Sigo and Them, Serbi, Konsulta lokale me të rinjtë në Vojvodinë, Novi Sad, Serbi, 12 qershor 2009.)

Nuk duhet të mos kemi parasysh që krimet ndaj të burgosurve të luftës kanë shumë të tmerrshme dhe nëse përqendrohemi vetëm në banorët civilë atëherë për shembull do të humbin nga vëmendja Lorën, që do të na bëhet problem i madh. (Marijana Toma, Impunity Watch, Serbi, Konsulta lokale me të rinjtë në Vojvodinë, Novi Sad, Serbi, 12 qershor 2009.)

Duhet përfshirë edhe veteranët e luftës në aktivitetet rreth KOMRA

Këshilla ime për KOMRA, është që të përfshihen edhe veteranët e luftës. Ngase veteranët e luftës tashmë bashkëpunojnë me njëri tjetrin. Veteranët kroatë të luftës të cilët dje janë ndeshur me veteranët serbë, tashmë bashkëpunojnë dhe bisedojnë. Mendoj se edhe ata duhet të përfshihen sepse mund të na japin të dhëna nga vija e parë. (Nenad Vezmar, Të Rinjtë e Ligës së socialdemokratëve të

Vojvodinës, Serbi, Konsulta lokale me të rinjtë në Vojvodinë, Novi Sad, Serbi, 12 qershor 2009.)

KOMRA nuk duhet t'i ofrojë amnisti kriminelëve

Nuk mendoj se arsyetohet krimi me vetë pranimin e krimit. Nuk mund të lirohet njeriu nga dënimi, jo vetëm unë, por kushdo tjetër, nëse ai ka kryer gjenocid ndaj civilëve, ushtarëve, të burgosurve të luftës vetëm ngase do të pranojë këtë gjë, e ti thuhet „faleminderit që ke ndihmuar, tash je i lirë„. Jo, nuk duhet të dënohet me 20 vjet, por duhet t'i jepet burg prej pesë deri në dhjetë vite më së paku. (Nenad Vezmar, Të rinjtë e ligës së socialdemokratëve të Vojvodinës, Serbi, Konsulta lokale me të rinjtë në Vojvodinë, Novi Sad, Serbi, 12 qershor 2009.)

Duhet themeluar një televizion me frekuenca rajonale i cili do të merrej vetëm me krime

Sugjeroj që të krijoni një televizion rajonal ku do të flitet vetëm për këtë gjë sepse deri sa të vjen KOMRA ndoshta edhe ndërrohet pushteti, e ndoshta do të jetë një RTS tjetër, dhe do të diktohet ndryshe. (Nenad Vezmar, Të rinjtë e ligës së socialdemokratëve të Vojvodinës, Serbi, Konsulta lokale me të rinjtë në Vojvodinë, Novi Sad, Serbi, 12 qershor 2009.)

41. Konsultat Kombëtare me grupet e grave

**Prishtinë, Kosovë,
25. qershor 2009.**

Organizator i konsultave ishte organizata joqeveritare Partners Kosova. Morën pjesë 24 përfaqësues të organizatave të grave nga Kosova të cilat merren me të drejtat e njeriut dhe me ndihmën e viktimave. Është treguar filmi «Ballafaqimi me të vërtetën: Komisionet për të vërtetën dhe shoqëritë në tranzicion». Drejtueset ishin Shukrije Gashi (Partners Kosova), Nora Ahmetaj (aktiviste për të drejtat e njeriut, Kosovë), Suzana Kunac (B.a.b.e) dhe Gazmir Raci, (Pro Peace Platform).

Pjesëmarrëset në masë të madhe e kanë përkrahur nismën civile KOMRA por mendojnë se është kyçe përfshirja e institucioneve nga rajoni.

Desha t'u përuloja për këtë nismë. Kjo me të vërtetë

është një punë e madhe. (...) duhet të shohim pjesëmarrje më të madhe nga dikush prej Parlamentit, nga ministrinë relevante, dhe pjesëmarrja e tyre gjithmonë do të çon deri tek ndërtimi i dokumenteve konkrete, deri te realizimi i këtyre dokumenteve dhe realizimi i sugjerimeve. (Belgjyza Muharremi, *Dyert e Hapura*, Kosovë, Konsultat kombëtare me grupet e grave, Prishtinë, Kosovë, 25. qershor 2009.)

Sot e mora një porosi dhe që nga kjo ditë do të jem misionarja e këtij Komisioni. Pse e them këtë gjë? Përmbi të gjitha, për ta shëruar vetveten sepse kanë kaluar tashmë dhjetë vite dhe nëse takohemi në një grup pavarësisht se në cilin nivel punohet, ne sërish do të arrijmë deri te lufta. (Sakibe Doli, Shtëpia e Sigurt, Kosovë, Konsultat Kombëtare me grupet e grave, Prishtinë, Kosovë, 25 qershor 2009.)

Shtrohet pyetja a është ky moment i mirë për themelimin e KOMRA duke pasur parasysh jo stabilitetin në Kosovë dhe problemet që vijnë nga Serbia.

Si ka qenë momenti kur janë krijuar këto komisione nëpër shtete tjera? Menjëherë pas konfliktit, apo pak kohë pas konfliktit, apo ka përfunduar konflikti? Njëra nga sfidat për të themeluar këtë Komision apo koalicion, me siguri është jostabiliteti politik i cili në këtë moment e mbizotëron Kosovën dhe problemet që vijnë nga Serbia, dhe në një mënyrë ndoshta paraqesin arsye për rezistim të disa grupeve, kur flasim për punën e këtij koalicioni. (Eli Krasniqi, sociologe, Kosovë, Konsultat kombëtare me grupet e grave, Prishtinë, Kosovë, 25 qershor 2009.)

Koalicioni për KOMRA duhet të kërkoj nga shtetet të cilat ia kanë nisur luftërave kërkim-falje, posaçërisht nga Serbia, gjë e cila do të forcon besimin e viktimave ndaj KOMRA.

Koalicioni, apo Komisioni në fazë të krijimit, duhet të kërkon nga shtetet të cilat ia kanë nisur luftërave, të cilat kanë kryer krimet, në këtë rast Serbia, që së pari publikisht të kërkojnë falje. Kjo ka shumë rëndësi për vetë viktimat, dhe kjo do të ndikojë në përfshirjen e tyre në proceset e dëshmimit, nëse këta e dinë se Komisioni së paku ka kërkuar që publikisht nga shtetet t'u kërkohet falje. (Veprorë Shehu, Medica Kosova, Kosovë, Konsultat kombëtare me grupet e grave, Prishtinë, Kosovë, 25 qershor 2009.)

Kompensimet në para, të cilat KOMRA do t'u

propozojë qeverive, është një motiv me rëndësi për viktimat që ta përkrahin KOMRA.

Më intereson mandati i dhënies së kompensimeve për viktimat. Mendoj se ky është një motivim i rëndësishëm, pos asaj që do të arrihej një drejtësi në shoqërore. (Veprorë Shehu, Medica Kosova, Kosovë, Konsulta kombëtare me grupet e grave, Prishtinë, Kosovë, 25. qershor 2009.)

Dhunimi duhet të jetë në mandatin e KOMRA. Roli i grupeve të grave është që t'u japin kurajë grave që të dëshmojnë.

Dhunimi si krim i luftës hyn në mandat të Komisionit. Besoj se kjo është me rëndësi dhe se pa këtë Komisioni nuk do të ketë besim. (Suzana Kunac, B.a.b.e. Kroaci, Konsultat kombëtare me grupet e grave, Prishtinë, Kosovë, 25. qershor 2009.)

Përfaqësueset e organizatave të ndryshme të cilat punojnë me gra kanë detyrë morale dhe njerëzore që të punojnë me viktimat gra në mënyrë që t'u jepet mundësia që të dëgjohen në mënyrë dinjitoze. Nëse këto gra nuk kanë dëshirë që këto dëshmi të bëhen në prani të palës tjetër dhe njerëzve tjerë, atëherë çfarëdo lloj i dëshmimit tjetër të cilin ato e pranojnë është i dobishëm, sepse përmbi të gjitha u shërben vetë atyre që të çlirohen në kuptimin shpirtëror dhe psikik. (Shukrije Gashi, Partners Kosova, Konsultat kombëtare me grupet e grave, Prishtinë, Kosovë, 25 qershor 2009.)

Anëtarët të cilët zgjidhen në përbërjen e këtij Komisioni duhet të posedojnë dijeni të madhe. Nuk duhet të jenë psikologë, por duhet të kenë dijeni paraprake për trauma, posaçërisht kur flasim për traumën e cila krijohet nga dhunimi seksual gjatë luftës. Kjo do të thotë se vetë procesi i dëshmimit dhe qasjes ndaj këtyre viktimave është shumë i rëndësishëm. (Veprorë Shehu, Medica Kosova, Kosovë, Konsultat kombëtare me grupet e grave, Prishtinë, Kosovë, 25 qershor 2009.)

Bëhet fjalë për dhunime, dhe gratë gjithsesi duhet të jenë në krye të këtij procesi, sepse ato dinë më mirë se çka u duhet. Ato janë viktimat të dyfishta dhe komponenti kryesor i drejtësisë tranzicionale. (Nora Ahmetaj, aktiviste e të drejtave të njeriut, Kosovë, Konsultat kombëtare me grupet e grave, Prishtinë, Kosovë, 25 qershor 2009.)

Gratë janë pjesë themelore dhe vitale e shoqërisë dhe me të drejtën ndërkombëtare dhe humanitare të drejtat e tyre shkelen jo vetëm kur janë cak direkt i regjimit në mënyra të ndryshme, por të drejtat e tyre shkelen edhe në kuptimin fizik dhe psikik. Ka të bëjë me dhunimin, dhe gratë gjithsesi duhen të jenë drejtueset e këtij procesi sepse ato më së miri e dinë se çka u duhet. Ato janë viktima të dyfishta dhe komponent kryesor i së drejtës tranzicionale. (Nora Ahmetaj, aktiviste për të drejtat e njeriut, Kosovë, Konsulta kombëtare me grupet e grave, Prishtinë, Kosovë, 25 qershor 2009)

KOMRA duhet t'i ndihmojë familjeve të të zhdukurve në realizimin e të drejtës në bazë të vdekjes apo zhdokjes së më të afërmve.

Gratë e personave të zhdukur (...) nuk kanë mundur të deklarojnë se burrat e tyre kanë vdekur sepse nuk i kanë parë dhe nuk i kanë marrë kufomat e tyre dhe, fatkeqësisht, të gjitha përpjekjet që të shpallen të vdekur janë gjykuar gabimisht nga ana e familjes së burrit. Kemi bërë diçka me Kryqin e Kuq Ndërkombëtar në mënyrë që t'u lehtësohet qasja ndaj ligjit edhe në rastet kur vjen deri te dërgimi i mbetjeve mortore, por kjo nuk mjafton. Ndoshta edhe këtë gjë mund ta kyçim në fushëveprimin e Komisionit. (Veprorë Shehu, Medica Kosova, Konsultat kombëtare me grupet e grave, Pishinë, Kosovë, 25 qershor 2009.)

KOMRA duhet të ketë mandat që të vlerësojë se çfarë lloj i konfliktit ka qenë në pyetje në mes shteteve, sepse nga kjo varen edhe kompensimet e viktimave.

A ka qenë gjenocid, apo ka qenë spastrim etnik, ekziston huti e madhe rreth kësaj. (...) Vetë definicioni i këtij konflikti apo luftë u jep juve të drejtën që të kërkonit shpagimin. Nëse është konflikt, nuk ka shpagim, harrojeni, nuk keni pse të krijoni Komision. Kjo duhet të quhet luftë edhe atë me tendencë të gjenocidit dhe spastrimit etnik. (Veprorë Shehu, Medica Kosova, Kosovë, Konsultat kombëtare me grupet e grave, Prishtinë, Kosovë. 25 qershor 2009.)

42. Konsultat lokale me shoqëri-në civile rreth nismës KOMRA

**Pejë, Kosovë
Më 26. qershor 2009.**

Konsultat i ka organizuar organizata joqeveritare Syri i Vizionit. Morën pjesë 34 përfaqësues të orga-

nizatave joqeveritare, shoqatave të veteranëve, dhe mediave (1). Debatin e përcollën 4 përfaqësues të pushtetit komunal të Pejës, Istogut dhe Klinës. Si dhe tre përfaqësues të organizatave ndërkombëtare. Drejtuesit ishin Salem Çorbo (Shoqata Kthimi dhe mbijetesa e qëndrueshëm, BH), Bekim Blakaj (FHP, Kosovë), Valdete Idrizi (Community Building Mitrovica, Kosovë) dhe Veton Mujaj (OJQ Syri i Vizionit, Kosovë). Raportuan Zëri dhe TV Dukagjini.

Pjesëmarrësit në numër të madh e përkrahën nismën për themelimin e KOMRA

Dua që të përshëndes këtë nismë dhe mendoj se ky është momenti i vërtetë që shoqëria civile të përqendrohet në këtë pyetje. (...) Mendoj se në Kosovë jemi vonuar në këtë proces kur krahasohemi me Bosnjën dhe Kroacinë. (...) Mendoj se kjo paraqet një rëndësi nga zgjidhjet për mbledhjen e fakteve në mënyrë që pastaj të gjithë këto fakte të dërgohen në adresat e tyre përkatëse. (Elbert Krasniqi, Këshilli i rinitë, Kosovë, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Pejë, Kosovë, 26 qershor 2009.)

Me të vërtetë duhet përshëndetur një nismë të tillë. (...) Dhashtë Zoti që me formimin e këtij Komisioni, të shkon për më të mirë dhe që... njerëzit nuk do të ngurohen. Nuk mund të them se ky apo ky është fajtor. U fol këtu për qeverinë në Serbi. Ai i cili ka vuar me siguri se nuk do të jep dëshmi. Po ta donte ai këtë gjë, ai nuk do të vriste askënd, askund. (Lale Grabanica, OJQ Elena Gjika, Kosovë, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Pejë, Kosovë, 26 qershor 2009.)

Problemet e invalidëve ushtarakë të luftës dhe veteranëve duhen zgjidhur me ligj dhe përmes institucioneve.

Kemi 2500 ushtarë të rënë nga Ushtria çlirimtare e Kosovës. Kemi invalidë të luftës, të cilët ende janë të lënë anash nga ana e shoqërisë dhe të cilët marrin një përqindje të vogël të kompensimit. Pra, veteranët, anëtarë të UÇK-së aspak nuk janë të përfshirë nga ligji. (...) Duhet ta zyrtarizojmë gjetjen dhe rehabilitimin e viktimave të luftës duhet të bëhet në mënyrë ligjore, institucionale. (Pren Marashi, Shoqata e veteranëve të luftës, Kosovë, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Pejë, Kosovë, 26 qershor 2009.)

Nëse KOMRA siguron shpagim për përjetimin e dhunës, kjo do të ketë efekt pozitiv në viktima.

Nuk do ta zvogëloja efektin ligjor apo të drejtësisë të këtij procesi, por do të theksoja edhe efektin psikik mbi viktimën i cili ka dijeninë se dikush e ka shpëguar për tërë dhunën që e ka përjetuar. Drejtësia në një mënyrë të caktuar jep mundësinë e mbylljes së kësaj plaje. (Lulëzim Arapi, Shoqata për ndihmën psiko-sociale të fëmijëve dhe familjeve, Kosovë, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Pejë, Kosovë, 26. qershor 2009.)

Shprehjet dyshimi që identifikimi i mbetjeve mortore nuk është bërë në mënyrë të besueshme.

Kjo është një brengë që unë po e tregoj vetëm sot për të parën herë. Shtrohet pyetja a është personi që është varrosur ai personi i vërtetë, edhe pse janë paguar 70 mijë marka, edhe pse personi tashmë është varrosur dhe e ka aty pllakën e varrit. Pra, a janë personat që po i marrim ato të vërteta, apo janë dikush krejtësisht tjetër. (Sabrije Zeqaj, Hendikos, Kosovë, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Pejë, Kosovë, 26. qershor 2009.)

Gratë, viktimat e dhunës seksuale, duhet të përkrahen moralisht, para ligjit të jenë të barabarta me viktimat tjera civile, të kanë përkrahjen psikike dhe të drejtën e reparacionit. Duhet të respektohet edhe vendimi i tyre se a do të dëshmojnë publikisht

Është çështja e një shtrese të viktimave të luftës, që ka të bëjë me gratë që kanë përjetuar dhunë seksuale ose ndonjë dhunë tjetër. Gjatë aprovimit të ligjit mbi viktimat civile, kemi qenë të zhgënjyera që ligji nuk ka paraparë këtë kategori të viktimave. (...) Kemi propozuar plotësimin e ligjit në mënyrë që këto viktimat, herdokurëdo në të ardhmen, të mund të kërkojnë reparacione dhe të përkrahen dhe njihen moralisht, por deri më sot nga institucionet tona nuk kemi marrë asnjë përgjigje edhe pse në atë tubim kanë qenë të pranishme edhe disa gra deputete. (Ilirijana Hoti, Shoqata Medica Kosova, Kosovë, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Pejë, Kosovë, 26. qershor 2009.)

Sipas njohurive të mia disa organizata joqeveritare merren me këtë çështje por në mënyrë institucionale askush, konkretisht rreth grave që janë dhunuar, pastaj, në raport me pjesëmarrësit në luftë, e që e kanë sindromin e luftës, të mos them të Vietnamit apo të Bosnjës. Të ne askush institucionalisht nuk merret me këtë. Dhe ju e dini se ky tretman është me kosto shumë të lartë, dhe kjo edhe na bren-

gos. (Pren Marashi, Shoqata e veteranëve të luftës, Kosovë, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Pejë, Kosovë, 26. qershor 2009.)

Por kur flasim për rastet e dhunës seksuale, kur flasim për gratë, ne duhet të respektojmë mosgatishmërinë e tyre që të dëshmojnë publikisht. (Valdete Idrizi, Community Building Mitrovica, Kosovë, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Pejë, Kosovë, 26. qershor 2009.)

Janë shfaqur mendime të kundërta se pos zbardhjes së fakteve a duhet të jetë qëllim i KOMRA, edhe pajtimi.

Ne nuk jemi të gatshëm për pajtim, vetëm duam që të zbardhen faktet. Njëkohësisht, edhe kur thuhet fjala e 'vërtetë', Komisioni për të vërtetën, çfarë e vërtetë [mendohet]? Secili e ka versionin e vetë të vërtetës, dhe mu për këtë ne kemi qenë shumë të kujdesshëm me KOMRA. Ky është Komision rajonal për zbardhjen dhe vërtetimin e fakteve mbi krimet dhe shkeljet tjera të rënda të të drejtave të njeriut të bëra në ish Jugosllavi.(...) Ne e mënjanuam me qëllim këtë fjalë. (Valdete Idrizi, Community Building Mitrovica, Kosovë, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Pejë, Kosovë, 26. qershor 2009.)

Çfarëdo qëllimi apo arsye e punës së këtij Komisioni, që do të shkruhet në atë formulimin zyrtarë, në fund të fundit, nënkupton qëllimin gjithëpërfshirës që është pajtimi. Unë nuk do të doja që të kam frikë nga kjo fjalë dhe mendoj se kjo është diçka që i takon drejt dhe shtrigave. Mënyra se si mund të zgjidhim problemet është dialogu, pra të flasim për këto probleme. Ndoshta këto Komisione mund të ndihmojnë nëse njerëzit do të mund të flasin hapur për atë çka kanë përjetuar, më duket se kjo do të kishte efektin psikologjik. Këtë e quajmë katarsë emocionale ku vjen deri te zbrazja e gjithë atyre tensioneve emotive. (Lulëzim Arapi, Shoqata për ndihmë psiko-sociale fëmijëve dhe familjeve, Kosovë, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Pejë, Kosovë, 26. qershor 2009.)

Nuk munden njerëzit që janë këtu të kërkojnë pajtimin, sepse viktimat nuk e kërkon pajtimin. Ju lutem, kini kujdes në të ardhmen që ky Komision të mos kërkojë pajtimin, as që guxon të përmendet pajtimi, sepse bëhet fjalë për viktimën e viktimat nuk e kërkon pajtimin. (Pren Marashi, Shoqata e veteranëve të luftës, Kosovë, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Pejë, Kosovë, 26. qershor 2009.)

Ne nuk duhet të merremi me politikë, ne duhet të gjejmë kush janë autorët e krimit. Sa i përket kërkimfaljes, ka kohë. Francezët dhe Gjermanët kanë pritur 30 vjet, ndoshta edhe ne do të pajtohemi eventualisht pas një periudhe të caktuar kohore. (Atdhe Berisha, Kalaja, Kosovë, Konsultat lokale me shoqërinë civile, Pejë, Kosovë, 26. qershor 2009.)

43. Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, të mbajturit nëpër kampe dhe aktivistët e organizatave joqeveritare

**Trebinje, Bosnja dhe Hercegovina
27 qershor 2009.**

Konsultat i organizuan qendra për bashkëpunim qytetar dhe nga Livno dhe Solidariteti për jug nga Trebinja. Nga 10 pjesëmarrës një ka qenë përfaqësues i mexhllisit të Bashkësisë islame Trebinje.⁴ Fjalën hyrëse e mbajtën Nataša Kandić (Fondi për të Drejtën Humanitare), Aleksandra Letić (Komiteti i Helsinkit i Republika Serbska), dhe moderatorët Sonja Garić (Qendra për bashkëpunim qytetar, Livno) dhe Stanko Buha (Solidariteti për jug, Trebinje). Për tubimin kanë raportuar Radiotelevizioni i Republika Serbska dhe Radio Evropa e lirë. Pjesëmarrësit⁵ e kanë përkrahur themelimin e KOMRA. Artikuj për konsultat kanë botuar EuroBlic, Nezavisne novine dhe agjensioni SRNA.

Bashkësia Islame e Trebinjës përkrah themelimin e KOMRA.

Dua të them se vërtet me shpirt e përshëndes këtë tubim. E përkrah këtë ide. E kam nënshkruar anëtarësimin në emrin tim dhe të mexhllisit të bashkësisë islame të Trebinjës, e cila përbëhet nga 600 familje anembanë botës. (Husein Hodžić, Mexhllisi i Bashkësisë Islame të Trebinjës, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave dhe të mbajturve në kampe, Trebinje, BH, 27 qershor 2009.)

Qëllimi kryesor i KOMRA është zbardhja e fakteve që askush nuk mund t'i kontestojë.

Ne sot e kemi një situatë që nuk e jep as një pjesë të pamjes së plotë të asaj çka ka ndodhur, varësisht nga qyteti në të cilin je, varësisht nga vendi në të cilin bisedon dhe me kë bisedon për këtë, edhe kjo pamje merr një mijë fytyra të veta. (...) Duhet të zbardhen faktet të cilat askush nuk do të mund t'i kontestojë dhe të cilat, mu për shkak të fuqisë së fakteve, do t'i

pranojmë të gjithë dhe të themi se kjo është ajo çka ka ndodhur. (Nataša Kandić, Fondi për të Drejtën Humanitare, Serbi, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave dhe të mbajturve në kampe, Trebinje, BH, 27 qershor 2009.)

Aq shumë gjëra, çështje të dhimbshme nga e kaluara, kanë mbetur të mbuluara diku, kështu që ne asnjëherë nuk e kemi nisur komunikimin, bisedën, dialogun e hapur për këtë. (...) Duhet të fillojmë të flasim për ngjarjet. Thjesht në këtë mënyrë, me dialog të civilizuar, të shtrojmë ato fakte dhe të shohim për çfarë gjëra duhet të punojmë. (Alma Mašić, Nisma e të rinjve për të drejtat e njeriut, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave dhe të mbajturve në kampe, Trebinje, BH, 27 qershor 2009.)

Këto fakte dikush duhet t'i shkruajë. Nëse këto që kanë ndodhur nuk i shkruan (...) fëmijët tanë në të ardhmen do të zgjidhin këto gjëra të njëjta. (...) Viktimat flasin si politikanët, e politikanët shfrytëzojnë viktimat në periudhat parazgjedhore që të manipulojnë me ta. Unë mendoj se është koha që të gjithë të Vetëdijesohemi, të themi dhe të shkruajmë çka na ka ndodhur në të kaluarën, por edhe të nisemi nga e ardhmja. (Sonja Garić, Qendra për bashkëpunimin qytetarë, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave dhe të mbajturve në kampe, Trebinje, BH, 27 qershor 2009.)

KOMRA është rasti i fundit që të dëgjohej zëri i viktimave, dhe viktimat duhet të jenë anëtarë të Komisionit.

Nuk e kam takuar asnjë viktimë që nuk ka pas nevojë që të dëgjohej tregimi i saj. (...) Formimi i këtij Komisioni për krimet e luftës, për shkeljen e të drejtave të njeriut, është dhuratë nga qielli për viktimat e luftës. Është rasti i fundit që të dëgjohej tregimi i tyre, të mbetet i shënuar, sepse kur këto oligarki tona kombëtare që janë ende në pushtet do t'i bëjnë marrëveshjet mes veti, ne askujt më nuk do t'i duhemi. (Izo Rokolj, i kthyeri në Trebinje, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave dhe të mbajturve në kampe, Trebinje, BH, 27 qershor 2009.)

E dua vetëm që viktima të merr pjesë në zgjedhjen e Komisionit (...) Dhe jo që të jetë në Komision ai që ka bërë krime. Është normale që ky [që ka bërë krime] të dëshmojë të kundërtën mbi ngjarjen dhe procesin. Andaj unë them që të jetë viktima organizatori kryesor i Komisionit. Është dëshmitar i gjallë

4 Përfaqësuesi i Mexhllisit të Bashkësisë Islame në Trebinje në emër të mexhllisit e ka nënshkruar deklaratën për anëtarësim në Koalicionin për themelimin e REKOM.

5 Disa pjesëmarrës kanë pas vërejtje në organizimin e konsultimit, p.sh. se nuk kanë mundur ta kontaktojnë Qendrën për bashkëpunim qytetar, sepse në ftesën nuk ka qenë numri i plotë i telefonit. Sipas tyre kjo ka qenë arsyeja për numrin e vogël të pjesëmarrjes të përfaqësuesve të shoqatave dhe të organizatave joqeveritare.

dhe provë. (Borislav Hamović, Shoqata e të mbajturve në kampe, Trebinje, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave dhe të mbajturve në kampe, Trebinje, BH, 27 qershor 2009.)

Këtë përvojë e kanë këta që kanë qenë nëpër kampe, kurrë nuk e përmendin çka kanë përjetuar atje. Unë kurrë nuk ia kam theksuar gruas sime, që edhe sot jeton me mua, e kemi vajzën 15 vjeçare, që të më tregojë asgjë për kampin. (...) Apeloj vetëm tek ju për këtë Komision dhe dëshiroj që të keni sukses në prosperitetin e plotë dhe që të dëgjohet vetëm e vërteta. (Srećko Barićanin, Këshilli i invalidëve të luftës në Trebinje, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave dhe të mbajturve në kampe, Trebinje, BH, 27 qershor 2009.)

A jemi apo jo dhe për çfarë Komisioni? Mendimi im personal është se jam për atë. Një Komision multivalentrik, do të thotë, jo që selia të jetë në një vend dhe që baza e punës së Komisionit të jetë shpalosja e së vërtetës, përkatësisht të tregimeve personale dhe dëshmimeve përmes këtyre tregimeve të drejtuara vendimmarrëse. (Stanko Buha, Solidariteti për jug, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave dhe të mbajturve në kampe, Trebinje, BH, 27 qershor 2009.)

Në zbardhjen e fakteve duhet të fillohet nga përgatitjet për luftë

Kjo luftë është përgatitur shumë më parë seç ka filluar. (...) Unë pohoj sot, dhe do të angazhohem deri sa jam gjallë, që duhet të nismi nga zeroja, nga përgatitjet e luftës, nga lufta dhe të shohim se kush është fajtor. (Kosta Kosović, Shoqata e të mbajturve në kampe Trebinje, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave dhe të mbajturve në kampe, Trebinje,

BH, 27 qershor 2009.)

Në dëgjimet publike duhet të kyçen viktimat, dorasit dhe përfaqësuesit e institucioneve, por KOMRA duhet të sigurojë mbrojtjen për viktimat, veçanërisht për gratë e dhunuara.

Në cilën mënyrë të dëgjohen publikisht viktimat? Mendoj se tek kjo duhet të jemi tejet të kujdesshëm, veçanërisht kur janë në pyetje gratë e dhunuara dhe njerëzit që kanë si pasojë çrregullimet psikosomatike. Duhet t'i mbrojmë njerëzit. Dhe a duhet të kemi dëgjime publike për përfaqësuesit e institucioneve? Natyrisht, unë të gjitha do t'i bëja transparente, edhe viktimat, edhe autorët e krimeve. (Blažo Stevović, Klubi Alternativa, BH, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave dhe të mbajturve në kampe, Trebinje, BH, 27 qershor 2009.)

Në mandatin e KOMRA duhet të jetë kthimi i pronës së uzurpuar.

Prona është kthyer, por edhe sot ka raste të uzurpimeve kështu që pronari, i cili e ka marrë vendimin për kthimin e pronës ka probleme me shfrytëzuesin i cili edhe sot e gjithë ditën nuk e lëshon pronën. Nuk ka fuqi dhe ligj që Ekrem Kadrovići të marrë shtëpinë e vetë këtu në lagjen Bregu i diellit në Trebinje. Ja ku e keni një shembull. Bashkësia islame, prona e saj këtu po shitet në vend që të bëhet restituiimi dhe denacionalizimi, ndërkaq që kishës ortodokse jo që i është kthyer prona por edhe ka marrë gjithfarë dhuratash. Pra, kemi shkelje të të drejtave të njeriut. (Husein Hodžić, Mexhlisi i Bashkësisë Islame Trebinje, Konsultat lokale me shoqatat e viktimave dhe të mbajturve në kampe, Trebinje, BH, 27 qershor 2009.)

Konsultat vazhdojnë.

Shtojca II

Iniciativat zyrtare për zbardhjen e fakteve mbi krimet e luftës

Në vendet trashëguese të RFSJ të dikurshme nuk vepron asnjë trup zyrtar i cili do të punonte sistematikisht dhe në nivelin e tërë shteti, ose të disa shteteve në rajon, në zbardhjen e fakteve mbi shkeljen e të drejtave të njeriut që kanë ndodhur gjatë konflikteve të armatosura ose pas tyre.

1. Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin i Republikës Federale të Jugosllavisë

Republika Federale e Jugosllavisë (RFJ) e dikurshme e vetmja ka themeluar një trup zyrtar për zbardhjen e së vërtetës për të kaluarën. Vendimin për themelimin e Komisionit për të Vërtetën dhe Pajtimin e mori Kryetari i RFJ Vojislav Koshtunica më 29 mars 2001. Detyra e komisionit ishte që të “organizojë punën kërkimore në zbulimin e evidencave mbi konfliktet shoqërore, ndërnacionale dhe politike që kanë sjell deri te lufta dhe zbardhjen e zinxhirit të shkaqeve të këtyre ngjarjeve, të informojë opinionin e vendit dhe atë botëror për rezultatet e punës së tij; të realizojë bashkëpunimin me komisionet dhe trupat e ngjashëm në vendet fqinje dhe në botë, për t’i këmbyer përvojat e punës.”¹ Komisioni nuk është përkrahur nga organizatat për të drejtat e njeriut dhe opinioni kritik në Serbi, nuk është pranuar as në shtetet e rajonit, si dhe nga viktimat e komuniteteve tjera etnike, kështu që është shuar pra se të organizojë ndonjë dëgjim publik apo ndonjë aktivitet tjetër të rëndësishëm. Formalisht ka pushuar së ekzistuari me aprovimin e deklaratës kushtetuese të bashkimit shtetëror të Serbisë dhe Malit të Zi dhe ligjit për implementimin e kësaj deklaratë më 4 shkurt 2003, pa asnjë raport të publikuar.

2. Tentimi për themelimin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtim në BH

Institut Amerikan për Paqe (USIP) dy herë nxiti themelimin e komisionit për të vërtetën dhe pajtimin në Bosnje dhe Hercegovinë, së pari në vitin 1997, pastaj edhe në vitin 2005.

Në lidhje me iniciativën e parë, USIP propozonte dhe përkrahte formimin e rrjetit të organizatave të shoqërisë civile dhe të individëve që kanë interes për këtë, i cili do të zhvillonte procesin e konsultave mbi propozimin që të formohet komisioni për të vërtetën dhe pajtimin në BH. Të gjitha aktivitetet i ka udhëhequr Shoqata e Qytetarëve “E vërteta dhe Pajtimi”, që e kanë themeluar organizatat joqeveritare dhe qytetarët që janë angazhuar për idenë e komisioni për të vërtetën në BH. Kundër iniciativës ishte Tribunali Ndërkombëtar Penal për ish Jugosllavi (Tribunali), me arsyetimin se kompetencat e dy institucioneve në dokumentimin e krimeve, dhe mbledhjen e provave do të ishin të njëjta, dhe se kontaktet e [komisionit] me dëshmitarët do të rrezikonin hetimet dhe punën e Tribunalit. Rezultati i kësaj iniciative të parë ishte propozimi i ligjit mbi komisionin për të vërtetën dhe pajtimin i cili është dërguar në Kuvendin Parlamentar të BH për diskutim dhe aprovim, por asnjëherë nuk është vënë në rend të ditës.

Iniciativa e dytë zhvillohej në dy binare paralele: i pari synonte rrjetëzimin e organizatave të shoqërisë civile, ndërsa i dyti kishte për qëllim themelimin e grupit punues të përfaqësuesve të partive politike parlamentare në Kuvendin e BH, i cili do të përgatiste, i ndihmuar nga USIP, propozimin

¹ Službeni list SRJ [Gazeta zyrtare e RFJ] nr. 15/01, 59/02. 30. mars 2001.

e ligjit mbi formimin e komisioni për të vërtetën dhe pajtimin. Në këtë mënyrë tentohej që të vendoset dialogu i drejtpërdrejtë mes organizatave të shoqërisë civile dhe partive politike mbi nevojën e themelimit dhe modelin e komisionit për të vërtetën. Grupi punues e kishte në disponim propozimin e ligjit mbi themelimin e komisionit për të vërtetën, që ishte hartuar gjatë kohës së veprimit të iniciativës së mëhershme. I tërë procesi është zhvilluar nën kujdesin e organizatës joqeveritare Projekti Dejton. Gjatë mandatit të saj, grupi ka bërë ndryshime të disa neneve të propozimit të ligjit që e kishte trashëguar, por në qershor të vitit 2006 pushoi së punuari, pasi që tërë procesi rreth formimit të komisionit në të vërtetë ishte pezulluar, pa ndonjë shpjegim publik pse ndodhi kjo. Për propozimin inicial të ligjit, as për ndryshimet e tij, nuk është debatuar asnjëherë në Kuvendin Parlamentar të BH. Tribunali e ka përkrahur iniciativën e dytë por kjo nuk ka ndihmuar që ky komision të themelohet.

Opinionin dhe një numër i konsiderueshëm i organizatave të shoqërisë civile në BH, sidomos shoqatat e viktimave, nuk i kanë përkrahur iniciativat e përmendura dhe publikisht kanë shfaqur rezerva, madje edhe qëndrime negative rreth idesë së krijimit të komisionit për të vërtetën.

3. Komisioni për hetimin e ngjarjeve rreth Srebrenicës nga 10 deri 19 korriku 1995 - Komisioni për Srebrenicën

Komisioni në punën e tij në tërësi integroi kontekstin historik që është paraqitur në verdiktin e plotfuqishëm të GJNPJ në rastin *Krstić*, sipas të cilit gjenerali i Armatës së Republikës Serbe (ARS) ndëshkohet për *ndihmën dhe përkrahjen gjenocidit*. Sa i përket metodologjisë, Komisioni punën e tij e bazonte në dokumentacionin e institucioneve zyrtare të ndryshme, siç janë dokumentacioni i Policisë së Republikës Serbe dhe të Policisë së Federatës së BH, si dhe të ministrive të mbrojtjes të RS dhe FBH, të organizatave relevante ndërkombëtare siç janë Komisioni Ndërkombëtar për Personat e Zhdukur (ICMP) dhe Komiteti Ndërkombëtarë i Kryqit të Kuq (ICRC), por edhe në dokumentacionin e shoqërisë civile në BH.

Po kështu, anëtarët e Komisionit i kanë intervistuar edhe shumë individë, anëtarë të familjeve të

të zhdukurve, pjesëtarët e Ushtrisë së Republikës Serbe, si dhe përfaqësuesit e institucioneve të pushtetit, që kanë pas dijeni për krimet.

Komisioni për Srebrenicën ka zbuluar 32 varreza masive që ma herët nuk është ditur për to dhe ka konstatuar se në periudhën që hetohet në Srebrenicë janë vrarë dhe zhdukur gjithsejtë 7.779 viktima.

Komisioni për Srebrenicë është krijuar me vendimin e Qeverisë së Republikës Serbe me 15 dhjetor 2003, si trup i përkohshëm hetues që ka për mandat hetimin e vendeve të krimit dhe të varrezave të viktimave, të zbardh identitetin e tyre, të sqarojë fatin e të zhdukurve familjet e të cilave kanë paraqitur padinë Shtëpisë për të Drejtat e Njeriut në BH në lëndën *Selimoviqët dhe të tjerët kundër Republikës Serbe* (rasti i *Srebrenicës*), si dhe urdhri i Përfaqësuesit të Lartë për BH të atëherëshëm, Paddy Ashdown, që përkrahë vendimin e Shtëpisë për të Drejtat e Njeriut.² Komisioni në qershor të vitit 2004 publikoi raportin e tij inicialë, të cilin Përfaqësuesi i Lartë refuzoi që ta pranojë dhe në harmoni me kompetencat e veta i bëri thirrje Qeverisë së Republikës Serbe që të sigurojë të dhënat në mënyrë që Komisioni të hartojë raport të bazuar në fakte dhe në të vërtetën. Në tetor të vitit 2004 Komisioni ka publikuar raportin e ri të cilin Përfaqësuesi i Lartë e ka aprovuar si dokument të rëndësishëm i cili zbardh faktet mbi krimin më të rëndë që është bërë në territorin e BH.

Mirëpo, raporti i këtij komisioni nuk ka pas jehonë të madhe në opinionin e BH, as në Republikën Serbe, as në Federatën BH

4. Komisioni shtetëror për hetimin e së vërtetës për pësimet e serbëve, kroatëve, boshnjakëve, hebrejve dhe të tjerëve në Sarajevë në periudhën 1992 - 1995 - Komisioni për Sarajevën

Komisioni për Sarajevën është themeluar më 25. maj të vitit 2006 me vendimin e Këshillit të Ministrave të BH, në bazë të konkluzioneve të Kuvendit Parlamentar të BH që ku trup ia dërgoj Qeverisë së Bosnjës dhe Hercegovinës qysh në fillim të vitit 2004. Iniciativën për themelimin e

2 Me vendimin e Shtëpisë për të Drejtat e Njeriut është konstatuar se Republika Serbe ka shkelur nenin 8 të Konventës evropiane për të drejtat e njeriut, sepse familjeve të zhdukurve në Srebrenicë nuk i ka ofruar informatat për fatin e tyre. Me këtë vendim Republika Serbe është obliguar që të ndër marrë hetimin e shpejt, të paanshëm dhe adekuat dhe që në llogarinë e Fondacionit Srebrenica - Potoçari të paguaj katër miliona KM si kompensim kolektivë për viktimat.

Komisionit e kanë nisur shoqatat e viktimave të serbëve nga Sarajeva lindore në vitin 2003 me qëllim që të dokumentohen pësimet e serbëve në Sarajevë. Në lidhje me nismën e paraqitur, Parlamenti i BH e ka aprovuar konkluzionin se është e pamundur që të veçohen pësimet e serbëve nga pësimet e qytetarëve të tjerë të Sarajevës, dhe kjo edhe ka qenë vendimtare për përmbajtjen e cila i është dërguar Këshillit të Ministrave për aprovim.

Këshilli i Ministrave i BH e ka vonuar themelimin e komisionit, dhe për këtë arsye deputetët serbë e kanë lëshuar Kuvendin Parlamentar të BH, me çka e kanë bllokuar punën e tij. Dhe mu kjo e ka detyruar Këshillin e Ministrave që të themelojë Komisionin për Sarajevë.

Mirëpo, ky Komision ende nuk e ka filluar punën. Problemi më i madh ka qenë definimi jo i qartë i mandatit, që pastaj u bë shkak për interpretime dhe mospajtime të reja politike. Në të vërtetë, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave për formimin e Komisionit për Sarajevë, pos pësimeve të banorëve (vrasjet, zhdukjet, veprimet johumane, keqtrajtimit seksual, dëbimet, etj.) ky trup në mandatin e tij e ka pas edhe hetimin e shkeljeve të Konventës së Gjenevës, si dhe të protokolleve të saj. Anëtarët e Komisionit, serbët, kanë insistuar që mandati duhet të jetë dokumentimi i pësimeve të banorëve, ndërkaq që anëtarët e komisionit, boshnjakët dhe kroatët, duke u thirrur në Konventën e Gjenevës, kanë insistuar që pos pësimet të popullsisë në mandat të futet edhe regjistrimi i dëmeve materiale.

Komisioni nuk është pezulluar asnjëherë zyrtarisht, edhe pse në bazë të aktit themelues afati për dorëzimin e raportit i ka kaluar. I vetmi rezultat të punës së tij ka qenë hartimi i projektit shkencor-hulumtues, i cili i ka definuar metodat e mbledhjes të të dhënave.

5. Komisioni për rastin e Avdo Palić³

Shtëpia për të Drejtat e Njeriut në BH më 2001 ka urdhëruar pushtetin e Republikës Serbe që të nis hetimet për fatin e Avdo Palićit, kolonel i Armatës së Bosnjës e Hercegovinës, i cili është zhdukur në korrik të vitit 1995 kur Ushtria e Republikës Serbe e morri me dhunë nga zona e mbrojtur e KB në Zhepë. Pasi që nuk ishte bërë asnjë përparim në hetimet, në janar të vitit 2006 është formuar

Komisioni për rastin e Avdo Palićit, i cili në prill të po këtij vitit prezantoi raportin që nuk solli asnjë përparim në gjetjen e vendit dhe zhvarrosjen e mbetjeve mortore e as në hetimin penal për rastin e zhdukjes së tij. Në dhjetor të vitit 2006 sërish ka vazhduar puna e Komisionit, por kjo nuk ka sjell rezultate konkrete. E veja e Avdo Palićit, Esmā Palić, në ndërkohë ka ngritur padinë para Gjyqit Evropian për të Drejtat e Njeriut.

6. Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin e Kuvendit komunal të Bijelinës – Komisioni për Bijelinë

Themelimin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtimin të Kuvendit komunal të Bijelinës e ka iniciuar në vitin 2004 mediatori ndërkombëtar për BH, më vonë Përfaqësuesi i Lartë për BH, Christian Schwarz Schilling. Vetë Komisionin e ka formuar pushteti lokal në Bijelinë nga mesi i vitit 2008.

Ideja fillestare ka qenë që Komisioni të ketë mandatin për hetimin e torturave dhe vrasjeve të burgosurve në kampin Batković, vrasjen e anëtarëve të familjeve Malagić, Sarajlić dhe Sejmenović, si dhe hetimin e spastrimit etnik në komunën e Bijelinës. Nga fillimi i vitit 2009 është bërë përcaktimi shtesë i mandatit të komisionit me atë se është përfshirë edhe hetimi i dëmeve materiale. Pas nënshkrimit të protokollit mbi bashkëpunimin me organizatën E vërteta, e Drejta dhe Pajtimi, nga Tuzlla, në mandatin e komisionit është futur edhe hetimi i pësimet të pjesëtarëve të ish APJ në Brčanska Malta e Tuzllës (rasti i kolonës tuzllake), 15 maj 1992.

Anëtar i komisionit është edhe njëri nga komandantët më të lartë të kampit Batković, çka aktivistët për të drejtat e njeriut e kuptojnë si ofendim të viktimave. Deri në fund të qershorit të vitit 2009, Komisioni për Bijelinën nuk ka publikuar asnjë raport.

7. Përkrahja ndaj kapaciteteve vendore në proceset e drejtësisë tranzicionale në BH – projekti i UNDP në BH

Agjencioni për Zhvillim e Kombeve të Bashkuara në BH (UNDP BiH) në vitin 2007 nisi projektin

³ 14 vjet pas zhdukjes së Avdo Palić-it, më 5. gusht 2009 Instituti për Personat e Zhdukur i BH ka lajmëruar se mbetjet mortore të Avdo Palić-it janë identifikuar.

'Përkrahje kapaciteteve vendore në procesin e së drejtës tranzicionale në BH'. Njëri nga caqet kyçe të projektit është iniciimi i procesit të konsultave mbi drejtësinë tranzicionale, në të cilin marrin pjesë përfaqësuesit e shoqërisë civile dhe institucionet e të gjitha niveleve të pushtetit, për të përkrahur formimin e grupit punues për të drejtën tranzicionale të Ministrisë së Drejtësisë të BH. Me projekt parashihet që grupi punues të hartojë strategjinë për të drejtën tranzicionale në BH që do të përfshinte mekanizmat jashtëgjyqësor pasi që më 29 dhjetor 2008, Këshilli i Ministrave aprovoj strategjinë shtetërore për punën në lëndët e krimeve të luftës, e cila paraqet strategjinë e aplikimit të mekanizmave gjyqësor. Gjatë viteve 2008 dhe 2009 janë mbajtur konsultat treditore të nivelit kombëtar (Foynica, qershor 2008) dhe konsultat dyditore në nivelin rajonale⁴ (Brčko, prill 2009;⁵ Mostar maj 2009⁶). Në këto konsultime morën pjesë përfaqësuesit e të gjitha institucioneve të pushtetit, nga ato shtetërore deri të komunave. Sa i përket organizatave të shoqërisë civile, morën pjesë shoqatat e viktimave, organizatat joqeveritare për të drejtat e njeriut, shoqatat e veteranëve, shoqatat e të rinjve, shoqatat e grave, të kthyerit, gazetarët, artistët, përfaqësuesit e bashkësive fetare, përfaqësuesit e komunitetit akademik, përfaqësuesit e komunitetit të juristëve dhe të tjerët. Gjatë konsultimeve është diskutuar, pos tjerash, për temat që në mënyrë të drejtpërdrejtë lidhen me mekanizmat e zbardhjes të fakteve dhe tregimin e të vërtetës mbi krimet që janë bërë në periudhën nga viti 1992 deri në vitin 1995.

Konstatimet kryesore që dolën nga konsultat kanë qenë që zbardhja e fakteve për krimet është me rëndësi kyçe për ardhmërinë e Bosnjës e Hercegovinës, dhe se ky proces paraqet bazën e të gjitha mekanizmave të së drejtës tranzicionale. Është theksuar kontributi i madh i shoqërisë civile në drejtimin e dokumentimit të krimeve

të luftës dhe është rekomanduar që institucionet të vendosin raport prej partnerit me organizatat joqeveritare, dhe që organizatat joqeveritare të vendosin mes vete bashkëpunim me të ngushtë, para së gjithash përmes rrjetëzimit të tyre. Mirëpo, edhe pse gjykimet shihen edhe më tej si mekanizëm më i rëndësishëm dhe më kompetent të drejtësisë tranzicionale, pjesëmarrësit kanë rënë dakord se drejtësia penale nuk e ka realizuar ndikimin i cili është supozuar se do të arrihej, kështu që propozohet formimi i trupave specifik hetues jashtë gjykatave, që do të mund të themeloheshin në nivelin shtetëror, rajonal, komunal, dhe atë ndërkombëtarë. Megjithatë, ky nuk ka qenë konkludimi njëzëri i konsultave, ndonëse asnjë pjesëmarrës nuk e ka shprehur hapur qëndrimin negativ për trupat jashtëgjyqësor. Me një fjalë, një pjesë e pjesëmarrësve e ka përkrahur formimin e këtyre institucioneve (në nivelin e komunës, rajonal dhe ndërkombëtarë) dhe ka dhënë rekomandime se cili do të duhej të ishte mandati potencial i tyre, kush do të duhej të ishin anëtarët, si do të bëhej përzgjedhja e anëtarëve, çfarë raporti duhet të kanë me organet e gjyqësorisë, në cilën mënyrë mund të plasohen informatat në opinion etj. Ndërkaq nga ana tjetër, një pjesë e pjesëmarrësve shprehte rezerva nëse fare mund të themelohet ky lloj institucioni, sepse nuk ekzistojnë kushtet e nevojshme që të sigurohet puna e tyre e papenguar: edhe më tej është e pamundur të sigurohet përkrahja e partive politike dhe të institucioneve; opinionin në BH nuk është sa duhet i përgatitur që të dëgjojë për pësimet e të tjerëve etj. Dhe nëse do të themeloheshin këto institucione, atëherë ato shihen si institucione të cilat drejtpërdrejtë bashkëpunojnë me prokurorinë dhe që nuk do të kanë mandat që zbulimet e tyre t'i nxjerrin në opinion, në mënyrë që, nga njëra anë, të mos dëmtohen hetimet dhe procedimet e gjykatës, dhe nga ana tjetër të mos krijohen animozitetet shtesë ndërmjet bashkësive etnike në BH.

4 Në kuptimin e projektit të UNDP BiH, niveli rajonal ka të bëjë me rajonet brenda BH.

5 Konsultimet kanë përfshirë komunat e BH verilindore.

6 Konsultimet kanë përfshirë komunat nga Hercegovina

PËRMBAJTJA

| | |
|---|----|
| Hyrje | 3 |
| 1. Zhvillimi i procesit të konsultimeve | 4 |
| 1.1. Organizimi i procesit të konsultimeve | 4 |
| 2. Qasja rajonale në kërkimin e fakteve mbi krimet e luftës | 5 |
| 2.1. Përkrahja e përfaqësuesve të qeverive dhe institucioneve | 6 |
| 2.2. Dilemat mbi pajtimin..... | 7 |
| 2.3. Përkrahja për komisionet kombëtare për të vërtetën | 7 |
| 2.4. Përkrahja e bashkësisë ndërkombëtare | 8 |
| 3. Nevojat dhe pritjet e viktimave | 8 |
| 3.1. Definicioni i viktimës | 8 |
| 3.2. Problemet e familjarëve të personave të zhdukur | 9 |
| 3.3. Reparacionet materiale dhe simbolike..... | 9 |
| 3.4. Pranimi i të gjitha viktimave | 10 |
| 4. Mandati i KOMRA | 10 |
| 4.1. Vendosja e mandatit | 10 |
| 4.2. Lënda e hetimit dhe analizës së KOMRA-s | 10 |
| 4.3. Lista e humbjeve në njerëz | 11 |
| 4.4. Emërtimi i kryerësve | 11 |
| 4.5. Amnistia | 12 |
| 4.6. Periudha kohore | 12 |
| 4.7. Zgjedhja e anëtarëve të komisionit | 12 |
| 4.8. Nevoja për solidaritet dhe bashkëndjesi | 12 |
| 4.9. Autorizimet e komisionit | 12 |
| 5. Struktura e KOMRA | 13 |
| 6. Dëgjimi publik i viktimave | 13 |
| 7. Raporti i gjykimeve për krimet e luftës dhe KOMRA | 14 |
| 8. Arkiva e Hagës | 14 |
| 9. Mediumet..... | 15 |
| 9.1. Sigurimi i përkrahjes së opinionit për themelimin e KOMRA | 15 |
| 9.2. Informimi mbi punën e KOMRA..... | 15 |
| 9.3. Komra dhe rishqyrtimi i përgjegjësisë morale e penale të gazetarëve | 15 |
| 10. Vërejtjet përfundimtare | 16 |
| SHTOJCA I | |
| 1. Forumi i Parë Rajonal për drejtësi tranzicionale: Nismat dhe perspektivat në Ballkani perëndimor Sarajevë, Bosnja dhe Hercegovina, 5.-6. maj 2006. | 17 |
| 2. Konsultat rajonale me artistë për trashëgiminë e të kaluarës. Beograd, Serbi, 6. dhjetor 2006. | 21 |
| 3. Forumi i dytë rajonal për drejtësinë tranzicionale: Vërtetimi i të vërtetës rreth krimeve dhe konflikteve të luftës, Zagreb, Kroaci, 8-9 shkurt2007. | 23 |
| 4. Konsultat kombëtare me të rinjtë rreth përballimit me të kaluarën Sarajevë, Bosnja i Hercegovina, 27. qershor 2007..... | 27 |
| 5. Konsultat kombëtare me të rinjtë rreth mekanizmave të ballafaqimit me të kaluarën Beograd, Serbi, 8. maj 2007 | 30 |
| 6. Konsultat kombëtare me të rinjtë rreth ballafaqimit me të kaluarën. Zagreb, Kroaci, 20. qershor 2007 | 31 |
| 7. Konsultat rajonale me gazetarë: Instrumentet për zbardhjen e fakteve rreth krimeve të luftës në ish Jugosllavi, Sarajevë, Bosnja i Hercegovina, 29. shtator 2007. | 33 |

| | |
|---|----|
| 8. Konsultat kombëtare me të rinjtë rreth mekanizmave të ballafaqimit me të kaluarën Osijek, Kroaci, 6. tetor 2007 | 36 |
| 9. Konsultat rajonale me të rinjtë rreth instrumenteve dhe nismave për zbardhjen dhe tregimin e fakteve mbi krimet e luftës në ish Jugosllavi Beograd, Serbi, 21. tetor 2007..... | 36 |
| 10. Konsultat rajonale me organizatat për të drejtat e njeriut rreth instrumenteve për zbardhjen dhe tregimin e fakteve mbi krimet e luftës Beograd, Serbi, 29. tetor 2007..... | 39 |
| 11. Forumi i Tretë Rajonal për drejtësi tranzicionale: Mekanizmat për zbardhjen e fakteve mbi krimet e luftës në ish Jugosllavi Beograd, Serbi, 11-12 shkurt 2008..... | 43 |
| 11.1. Punëtorja: Nevojat dhe pritjet e viktimave..... | 44 |
| 11.2. Punëtorja: Qasja rajonale zbardhjes së fakteve mbi krimet e luftës | 46 |
| 11.3. Punëtorja: Roli i mediave në krijimin e klimës pozitive për zbardhjen e fakteve | 49 |
| 12. Konsultat rajonale me shoqatat e viktimave, viktimat dhe veteranë rreth mekanizmave për zbardhjen e fakteve mbi krimet e luftës. Podgorica, Mali i Zi, 9. maj 2008 | 49 |
| 13. Konsultat kombëtare me shoqërinë civile rreth nismës KOMRA Mitrovicë, Kosovë, 26. qershor 2008..... | 54 |
| 14. Konsultat kombëtare me shoqatat e viktimave rreth nismës KOMRA Beograd, Serbi, 15. maj 2008 | 54 |
| 15. Konsultat kombëtare me shoqërinë civile për nismën KOMRA Zagreb, Kroaci, 16 maj 2008..... | 58 |
| 16. Konsultat kombëtare me të rinjtë mbi nismën KOMRA Serbi, Ivanjicë, 21 shtator 2008. | 59 |
| 17. Konsultat kombëtare me shoqatat e viktimave në Kosovë mbi nismën KOMRA Prishtinë, Kosovë, 4 tetor 2008 | 59 |
| 18. Konsultat kombëtare me organizatat për të drejtat e njeriut mbi nismën KOMRA Frushka Gora, Serbi, 10 tetor 2008 | 62 |
| 19. Konsultat kombëtare me gazetarët për nismën KOMRA Frushka Gora, Serbi, 11 tetor 2008 | 65 |
| 20. Konsultat kombëtare me shoqatat e familjeve të mbrojtësve të zhdukur mbi nismën KOMRA Vukovar, Kroaci, 24 tetor 2008 | 66 |
| 21. Konsultat kombëtare me shoqërinë civile mbi nismën KOMRA Podgoricë, Mali i Zi, 25 tetor 2008 | 68 |
| 22. Forumi i Katërt Rajonal për drejtësi tranzicionale: Nisma KOMRA Prishtinë, Kosovë, 28 - 29 tetor 2008..... | 71 |
| 22.1. Mbështetja zyrtare..... | 71 |
| 22.2. Përkrahja e gjyqimeve për krimet e luftës | 72 |
| 22.3. Nevojat e viktimave | 73 |
| 22.4. Formimi i koalicionit për KOMRA | 74 |
| 22.5. Përkrahja nismës për themelimin e KOMRA | 75 |
| 23. Konsultat rajonale me shkencëtarët për nismën KOMRA Zagreb, Kroaci, 10 janar 2009 | 78 |
| 24. Konsultat kombëtare me shoqërinë civile për nismën KOMRA Pançevë, Serbi, 28 mars 2009..... | 82 |
| 25. Konsultat lokale me shoqatat e viktimave mbi nismën KOMRA. Bijelinë, Bosnje dhe Hercegovinë, 11 prill 2009..... | 84 |
| 26. Konsultat kombëtare me studentë për iniciativën KOMRA Prishtinë, 15 prill 2009. | 87 |
| 27. Konsultat kombëtare me të rinjtë për iniciativën KOMRA Beograd, Serbi, 16 prill 2009..... | 89 |
| 28. Konsultat Kombëtare me shoqatat viktimave për iniciativën KOMRA Beograd, Serbi, 25 prill 2009..... | 92 |

| | |
|---|-----|
| 29. Konsultat lokale me shoqërinë civile për iniciativën KOMRA Nish, Serbi, 25 prill 2009..... | 98 |
| 30. Konsultat lokale me shoqatat e viktimave dhe me organizatat joqeveritare për iniciativën KOMRA Srebrenicë, Bosnje e Hercegovinë, 26 prill 2009..... | 102 |
| 31. Konsultat lokale me shoqërinë civile, me shoqatat e viktimave dhe me media, për iniciativën KOMRA, Livno, Bosnje e Hercegovinë, 9 maj 2009..... | 105 |
| 32. Konsultat kombëtare me shoqatat e viktimave dhe shoqërinë civile lidhur me iniciativën KOMRA Prishtinë, Kosovë, 9 maj 2009..... | 107 |
| 33. Konsultat Kombëtare me artistët lidhur me iniciativën KOMRA Prishtinë, Kosovë, 10. Maj 2009..... | 111 |
| 34. Konsultat lokale me shoqërinë civile lidhur me iniciativën KOMRA Prijeđor, BH, 13 maj 2009..... | 113 |
| 35. Konsultat Kombëtare me shoqërinë civile lidhur me iniciativën KOMRA Mali i Zi, Podgoricë, 18 maj 2009..... | 115 |
| 36. Konsultat Kombëtare me organizatat e grave, shkencëtarët dhe me politikanet lidhur me iniciativën KOMRA, Zagreb, Kroaci, 21 maj 2009 | 117 |
| 37. Forumi i pestë rajonal për Drejtësi Tranzicionale: Iniciativa KOMRA Budvë, Mali i Zi, 29-30 maj 2009..... | 120 |
| 37.1. Punëtorja: Përse KOMRA..... | 121 |
| 37.2. Punëtorja: Struktura e KOMRA-s Kriteret për zgjedhjen e anëtarëve dhe mënyra e zgjedhjes së anëtarëve të KOMRA-s..... | 123 |
| 37.3. Punëtorja: Mandati i KOMRA-s..... | 126 |
| 37.4. Punëtorja: Dëgjimi publik dhe marrëdhënia ndaj kryesve të krimeve të luftës dhe shkeljeve tjera të rënda të të drejtave të njeriut..... | 129 |
| 38. Konsulta lokale me shoqatat e të burgosurve, të mbajturve në kampe, luftëtarëve dhe viktimave të luftës rreth nismës KOMRA Novi Travnik, Bosnja dhe Hercegovina, 6. qershor 2009..... | 132 |
| 39. Konsultat lokale me shoqërinë civile rreth nismës KOMRA Leskovcë, Serbi, 11. qershor 2009..... | 135 |
| 40. Konsultat lokale me të rinjtë për Nismën KOMRA Novi Sad, Serbi, 12. qershor 2009..... | 137 |
| 41. Konsultat kombëtare me grupet e grave Prishtinë, Kosovë, 25. qershor 2009. | 139 |
| 42. Konsultat lokale me shoqërinë civile rreth nismës KOMRA Pejë, Kosovë, 26. qershor 2009 | 141 |
| 43. Konsultat lokale me shoqatat e viktimave, të mbajturit nëpër kampe dhe aktivistët e organizatave joqeveritare, Trebinje, Bosnja i Hercegovina, 27 qershor 2009. | 143 |
| SHTOJCA II | |
| 1. Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin i Republikës Federale të Jugosllavisë..... | 145 |
| 2. Tentimi për themelimin e Komisionit për të vërtetën dhe pajtim në BH..... | 145 |
| 3. Komisioni për hetimin e ngjarjeve rreth Srebrenicës nga 10 deri 19 korriku 1995 - Komisioni për Srebrenicën..... | 146 |
| 4. Komisioni shtetëror për hetimin e së vërtetës për pësimet e serbëve, kroatëve, boshnjakëve, hebrenjve dhe të tjerëve në Sarajevë në periudhën 1992 - 1995 - Komisioni për Sarajevën..... | 146 |
| 5. Komisioni për rastin e Avdo Palić..... | 147 |
| 6. Komisioni për të vërtetën dhe pajtimin e Kuvendit komunal të Bijelinës - Komisioni për Bijelinë..... | 147 |
| 7. Përkrahja ndaj kapaciteteve vendore në proceset e drejtësisë tranzicionale në BH - projekti i UNDP në BH..... | 147 |

Botuesi:

Fondi për të drejtën humanitare

Për botuesin:

Nataša Kandić

Tirazhi:

500

Shtypi:

Publikum

Beograd, nëntor 2009.